

Një Udhëzues për Shërbimin Misionar

# Predikoni Ungjillin Tim

(DeB 50:14)



“Pendohuni, të gjitha ju skajet e tokës dhe ejani tek unë dhe pagëzohuni në emrin tim, që të shenjtëroheni nëpërmjet marrjes së Frymës së Shenjtë” (3 Nefi 27:20).



# Predikoni Ungjillin Tim (DeB 50:14)

---

Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.  
Salt Lake City, Utah

Kopertina: *Gjon Pagëzori Duke Pagëzuar Jezusin* © 1988 nga Greg K. Olsen  
Me leje nga Mill Pond Press dhe Dr. Geri Huper. Ndalohet fotokopjimi

© 2005 by Intellectual Reserve, Inc.

Të gjitha të drejtat rezervohen

Printed in the USA

Miratimi në gjuhën angleze: 1/05

Miratimi për përkthim: 1/05

Përkthim i *Preach My Gospel*

Albanian

36617 101

# Predikoni Ungjillin Tim (DeB 50:14)

Mesazh i Presidencisë së Parë .....	v
Hyrje: Si Mund ta Përdor më Mirë Udhëzuesin <i>Predikoni Ungjillin Tim</i> ? .....	vii
1 Cili Është Qëllimi Im si Misionar? .....	1
2 Si të Studioj Efektivisht dhe të Përgatitem të Jap Mësim? .....	17
3 Çfarë Duhet të Studioj dhe t'u Mësoj të Tjerëve .....	29
• Mësimi 1: Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit .....	31
• Mësimi 2: Plani i Shpëtimit .....	47
• Mësimi 3: Ungjilli i Jezu Krishtit .....	60
• Mësimi 4: Urdhërimet .....	72
• Mësimi 5: Ligjet dhe Ordinancat .....	83
4 Si ta Dalloj dhe ta Kuptoj Praninë e Shpirtit? .....	91
5 Cili Është Roli i Librit të Mormonit? .....	107
6 Si të Zhvilloj Cilësi si të Krishtit? .....	119
7 Si Mund ta Mësoj më Mirë Gjuhën e Misionit Tim? .....	131
8 Si ta Përdor Kohën me Mençuri? .....	141
9 Si të Gjej Njerëz për t'i Mësuar? .....	161
10 Si Mund t'i Përmirësoj Aftësitë e Mësimdhënies? .....	181
11 Si t'i Ndihmoj Njerëzit të Marrin dhe të Mbajnë Zotime? .....	203
12 Si t'i Përgatis Njerëzit për Pagëzim dhe Konfirmim? .....	211
13 Si të Punoj me Udhëheqësit e Kunjit dhe të Lagjes? .....	221
Indeksi .....	233



# Mesazh i Presidencisë së Parë

---

*Të Dashur Misionarë:*

*Ne ju përgëzojmë për mundësinë e mrekullueshme që keni për të qenë një misionar. Nuk ka punë më entuziazmuese se puna misionare, ose ndonjë punë tjetër që të sjell kënaqësi më të madhe.*

*Predikoni Ungjillin Tim ka për qëllim t'ju ndihmojë të jeni një misionar më i përgatitur, më i pjekur shpirtërisht dhe një mësues më bindës. Ne ju nxisim ta përdorni atë çdo ditë në përgatitjen tuaj individuale dhe me shokun, si edhe në mbledhjet e distriktit dhe konferencat e zonës. Studioni shkrimet e shenjta të cilave u referohet ky manual dhe mësoni doktrinat dhe parimet.*

*Ne ju ftojmë të arrini një kuptim të ri të zotimit për ta ndihmuar Atin tonë në Qiell në veprën e Tij të laudishme. Çdo misionar ka një rol të rëndësishëm për të ndihmuar që “të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39).*

*Zoti do t'jua shpërblejë dhe do t'ju bekojë së tepërmi ndërsa i shërbeni Atij me përulesë dhe plot lutje. Më shumë lumturi ju pret nga sa keni provuar ndonjëherë më parë ndërsa punoni midis fëmijëve të Tij.*

*Presidencia e Parë*





# Hyrje: Si Mund ta Përdor më Mirë udhëzuesin *Predikoni Ungjillin Tim*?

## *Predikoni Ungjillin Tim*

Përdoren udhëzuesin *Predikoni Ungjillin Tim* për të plotësuar nevojat tuaja si një misionar. Ju mund të kaloni një sesion të tërë studimi vetëm duke u përqendruar në disa paragrafë—ose në një kapitull të plotë. Ju mund t’i studioni kapitujt sipas radhës ose të planifikoni një rend tjetër që do t’i plotësojë më mirë nevojat tuaja. Një elasticitet i tillë ju lejon të studioni atë çfarë ju duhet, atëherë kur ju nevojitet dhe sipas udhëzimeve të presidentit të misionit.

Të gjithë kapitujt në udhëzuesin *Predikoni Ungjillin Tim* do t’ju përgatisin të përmbushni qëllimin tuaj si misionar. Megjithatë, kur të filloni të studioni kapitullin 3, ju do të dalloni një ndryshim në mënyrën e formulimit të tekstit. Shumica e kapitujve ju drejtohen ju misionarëve. Kapitulli 3 i drejtohet një audience më të gjerë. Ju duhet t’i mësoni doktrinat në kapitullin 3 që (a) të forconi njohurinë dhe dëshminë tuaj për ungjillin dhe (b) t’i mësoni të tjerët dhe t’i përgatisni ata të bëjnë dhe të mbajnë zotimet dhe besëlidhjet.


Doktrinat në disa nga kapitujt e tjerë mund t’ju ndihmojnë gjithashtu të mësoni kërkuesit dhe anëtarët. Për shembull, kapitulli 4, “Si ta Dalloj dhe ta Kuptoj Praninë e Shpirtit?” mund t’ju ndihmojë t’i mësoni disa kërkues se si të fitojnë dëshmi nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë. Kapitulli 5, “Cili Është Roli i Librit të Mormonit?” mund t’ju ndihmojë të zgjidhni shqetësimet e një kërkuesi rreth leximit të Librit të Mormonit. Idetë nga kapitulli 2, “Si të Studioj Efektivisht dhe të Përgatitem të Jap Mësim?” mund t’i ndihmojnë të porsakthyerit në besim të fitojnë më shumë nga studimi i Librit të Mormonit.

*Predikoni Ungjillin Tim* përqendrohet në bazat e punës misionare. Ai nuk i përgjigjet çdo pyetjeje ose situatë që do të ndeshni. Ju do të jeni më efektivë ndërsa ndiqni Shpirtin, kërkoni shkrimet e shenja, mbani urdhërimet dhe zbatoni ato që mësoni.

Studiojini këta kapituj gjatë gjithë misionit tuaj. Zbatoni ato që mësoni. Bëni një vlerësim të punës tuaj. Misionarët që përpiqen çdo ditë të përgatisin veten dhe mundohen të përmirohen rregullisht, do të marrin udhëheqjen e Frymës së Shenjtë dhe do të shohin bekime në jetën e tyre.

## Mësimet Misionare

Ju keni elasticitetin t’i jepni mësimet në çfarëdo lloji mënyre që do t’i ndihmojë më mirë njerëzit për t’u përgatitur plotësisht për pagëzimin dhe konfirmimin e tyre. Qëllimi juaj nuk është vetëm të trajtoni materialin; qëllimi juaj është t’i ndihmoni të tjerët të vijnë te Krishti me anë të besimit në Jezu Krisht, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe të durimit deri në fund. Një mësim rrallë duhet të zgjasë më shumë se 45 minuta. Ju mund të vini re se koha mund t’ju lejojë vetëm vizita më të shkurtra mësimdhënieje. Në këtë rast, mund t’ju duhet të bëni vizita të shpeshta dhe të shkurtra mësimdhënieje duke trajtuar pjesë më të vogla të materialit.



Ju mund t'i jepni mësimet në shumë mënyra të ndryshme. Cilin mësim do të jepni, kur do ta jepni atë mësim dhe sa kohë do t'i kushtoni atij, do të përcaktohet më mirë nga nevojat e kërkuesve dhe udhëheqja e Shpirtit. Mos e mësoni përmendësh të gjithë mësimin.

## Studimi Individual, Studimi me Shokun, Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

Studimi efektiv gjatë misionit do t'ju ndihmojë të përmbushni qëllimin tuaj si një misionar dhe të forconi dëshminë tuaj për ungjillin e Jezu Krishtit. Katër nga mundësitë më të rëndësishme të studimit tuaj janë: studimi individual, studimi me shokun, mbledhjet e distriktit dhe konferencat e zonës. Programi juaj ditor përfshin kohën për studim individual dhe studim me shokun, çdo ditë.

### Programi Ditor i Misionarit\*

6:30	Zgjimi, lufta, fizikultura (30 minuta) dhe përgatitja për ditën.
7:30	Mëngjesi.
8:00	Studim individual: Libri i Mormonit, të tjera shkrime të shenjta, doktrina të mësimëve misionare dhe kapituj të tjerë nga <i>Predikoni Ungjillin Tim</i> , <i>Missionary Handbook</i> , dhe <i>Missionary Health Guide</i> .
9:00	Studim me shokun: ndani atë që keni mësuar gjatë studimit individual, përgatituni të jepni mësim, praktikoni mësimdhënien, studioni kapituj nga udhëzuesi <i>Predikoni Ungjillin Tim</i> , konfirmoni planet për ditën.
10:00	Filloni predikimin. Misionarët që janë duke mësuar gjuhën e studiojnë atë gjuhë gjatë një kohe shtesë prej 30 deri në 60 minuta, duke përfshirë planifikimin e aktiviteteve për mësimin e gjuhës që do të përdorin gjatë ditës.  Misionarët mund të kenë një orë kohë për drekë dhe studim shtesë dhe një orë kohë për darkë gjatë atyre orëve të ditës që përshtaten më mirë me orarin e predikimit të tyre. Normalisht darka duhet të përfundojë jo më vonë se ora 18:00.
21:00	Kthehuni në apartament (në qoftë se nuk jeni duke dhënë një mësim, në këtë rast kthehuni në orën 21:30) dhe planifikoni aktivitetet e së nesërme (30 minuta). Shkruani në ditar, përgatituni për shtrat, lutuni.
22:30	Shkoni në shtrat.

\*Në konsultim me Presidencinë e të Shtatëdhjetëve ose me Presidencinë e Zonës, presidenti i misionit mund ta modifikojë këtë program në përshtatje me rrethanat lokale.

Ajo që mësoni gjatë studimit individual do t'ju ndihmojë në studimin me shokun, mbledhjen e distriktit dhe konferencat e zonës, ku ju mund t'i mësoni njëri-tjetrit doktrinën e mbretërisë (shih DeB 88:77). Ajo që fitoni nga sesionet e studimit dhe mbledhjet e distriktit do t'ju ndihmojë t'i mësoni të tjerët me fuqi shpirtërore.

### Studimi Individual

Qëllimi i studimit individual është të forcojë njohurinë dhe dëshminë tuaj për ungjillin e rivendosur dhe t'ju ndihmojë për t'u përgatitur në mënyrë që të plotësoni nevojat e atyre që mësoni. Gjatë studimit individual, përqendrohuni në veprat standarde dhe në bibliotekën e miratuar të misionarit:



- *Jesus the Christ*
- *Our Heritage*
- *Our Search for Happiness*
- *Të Vërtetë ndaj Besimit*

Ju mund ta bëni efektiv studimin individual kur:

- Lexoni nga Libri i Mormonit dhe nga të tjera shkrime të shenjta.
- Studioni doktrinat e mësimëve misionare.
- Studioni kapituj të tjerë nga "*Predikoni Ungjillin Tim.*"

### Studimi me Shokun

Qëllimi i studimit me shokun është (1) të ndërtojë unitet në marrëdhëniet tuaja si shokë/shoqe në mënyrë që t'i mësoni të tjerët nëpërmjet Shpirti dhe (2) të përqendrohemi në përparimin e atyre që mësoni. Ju mund ta bëni efektiv studimin me shokun kur:

- Ndani me njëri-tjetrin zbulesat që ju vijnë nga studimi individual.
- Përgatiteni për takime specifike mësimdhënieje, vizita te anëtarët, mundësi gjetjeje dhe aktivitete të tjera. Studioni materiale që ju ndihmojnë të jepni mësim, të gjeni kërkues dhe të punoni më me efektivitet. Diskutoni rreth njerëzve me të cilët po punoni. Bëni plane për të zbatuar ato që mësoni.
- Gjatë ditës, vazhdoni të diskutoni për parimet, qëllimet, aftësitë dhe planet që diskutuat gjatë studimit me shokun.

### Mbledhjet e Distriktit

Qëllimi i mbledhjeve të distriktit është t'i mësoni njëri-tjetrit doktrinën e mbretërisë (shih DeB 88:77).

- Mbledhjet e distriktit zhvillohen çdo javë për 60 deri në 90 minuta.
- Udhëheqësi i distriktit planifikon dhe drejton mbledhjen e distriktit dhe mund të ftojë misionarë të tjerë që ta ndihmojnë në mësimdhënie.
- Mbledhjet e distriktit mund të përfshijnë:
  - Ndarjen e ndriçimeve shpirtërore që ju vijnë gjatë studimit personal dhe me shokun.
  - Praktikimin e mësimëve në situata të ndryshme.
  - Shpjegimin, demonstrimin dhe praktikimin e parimeve dhe aftësive të përshkuara në *Predikoni Ungjillin Tim.*
  - Diskutimin e përparimit dhe nevojave të kërkuesve.
  - Diskutimin dhe adresimin e sfidave në distrikt.
  - Ndarjen e përvojave dhe dëshmive nga puna misionare.
- Udhëheqësit e distriktit mund ta përdorin mbledhjen e distriktit për të marrë raportime në lidhje me përpjekjet e misionarëve në distrikt. Ata nuk duhet të vendosin qëllime ose kuota për misionarët.

### Konferencat e Zonës

Konferencat e zonës zhvillohen nën drejtimin e presidentit të misionit.

## Pjesët Përbërëse të udhëzuesit *Predikoni Ungjillin Tim*

Çdo kapitull në *Predikoni Ungjillin Tim* ka disa pjesë përbërëse. Këto pjesë duhet t'ju ndihmojnë të përfitonit më shumë nga studimi juaj—jo t'ju detyrojnë të mësoni në një mënyrë të caktuar. Përdorini këto pjesë në një mënyrë elastike bazuar në nevojat tuaja.

### Ditari i Studimit

*Predikoni Ungjillin Tim* shpesh kërkon që të përdorni një ditar studimi për t'ju ndihmuar të kuptoni, sqaroni dhe të kujtoni ato që keni mësuar. Plaku Riçard G. Skot na mëson: “Njohuria e shkruar me kujdes është një njohuri që mund të përdoret në kohë nevojë. Informacioni i ndjeshëm shpirtëror duhet të mbahet në një vend të shenjtë që i komunikon Zotit se si ju e ruani atë. Kjo praktikë rrit mundësinë që ju të merrni dritë të mëtejshme” (“Acquiring Spiritual Knowledge,” *Ensign*, nëntor 1993, 86). Rishikoni ditarin tuaj të studimit për të rikujtuar përvojat shpirtërore, për të marrë zbuluesat të reja dhe për të dalluar rritjen tuaj.

Ditari i studimit mund të jetë një ditar i posaçëm, një bllok shënimesh, ose një dosje. Shkruani dhe organizoni mendimet dhe ndjenjat tuaja në mënyrë të tillë që t'i përshtatet mënyrës se si mësoni. Zhvilloni sistemin tuaj personal me anë të të cilit mund ta gjeni lehtë informacionin kyç në të ardhmen. Përdoreni atë shpesh që të rishikoni, gjeni dhe të zbatoni atë që keni mësuar. Përdoreni ditarin tuaj të studimit për të marrë shënime dhe për të shkruar përshtypjet gjatë studimit individual dhe me shokun, në mbledhjet e distriktit, në konferencat e zonës dhe në intervistat me presidentin e misionit.

### Kutitë e Informacionit

Kutitë në *Predikoni Ungjillin Tim* do t'ju ndihmojnë të mësoni. Disa kuti paraqesin paraprakisht ose përmbledhin pikat kyçe. Të tjerat ju ndihmojnë të përqendroni studimin tuaj, të mësoni nga shkrimet e shenjta, të zbatoni ato që mësoni, të zhvilloni aftësitë tuaja dhe të plotësoni nevojat e atyre që mësoni. Në shumicën e rasteve, këto kuti përmbajnë informacion që shërben thjesht si një pikënisje. Me lutje pasuroni aktivitetet që përmbajnë këto kuti duke zhvilluar aktivitete të reja studimi dhe duke kërkuar të tjera shkrime të shenjta.

#### Mbani Parasysh

- Çfarë do të thotë të
- Si mund ta rris be
- Pse duhet t'i përfsh
- Çfarë roli luajnë rel

“**Mbani Parasysh.**” Shumica e kapitujve fillojnë me pyetje që gjenden brenda kutisë “Mbani Parasysh.” Këto pyetje përqendrohen në pikat kyçe të kapitullit dhe sigurojnë një strukturë për studimin tuaj. Përdorini këto pyetje për të organizuar, kuptuar, medituar dhe zbatuar ato që mësoni.

#### Mbani Mend

- Ndërtoni Kishën du
- Kërkoni dhe ndiqni
- Njerëzit në territorin
- Anëtarët e Kishës—

“**Mbani Mend.**” Shumica e kapitujve mbyllen me kutinë “Mbani Mend” —një përmbledhje e pikave më të rëndësishme nga kapitulli. Kur mbaroni së studiuarit një kapitull, rishikojeni këtë përmbledhje që të siguroheni se i keni kuptuar këto pika kryesore. Vlerësoni se sa mirë po i zbatoni këto pika dhe bëni plane për të zbatuar ato që mësoni.

#### Studim i Shkrimeve të

##### Çfarë thonë këto shkri

- 3 Nefi 12:48
- 3 Nefi 27:21, 27

##### Cila është lidhja ndër

“**Studim i Shkrimeve të Shenjta.**” Këto kuti ju tregojnë referencat e shkrimeve të shenjta që mund të ndërtojnë të kuptuarin dhe dëshminë tuaj. Mbështetuni mbi këto referenca duke kërkuar për të tjera shkrime të shenjta. Bëjini vetes pyetje plotësuese që lidhen me atë që po lexoni për t'ju ndihmuar të merrni zbuluesat dhe të zbatoni ato që mësoni.

**Aktivitet: Studim Individual**

Shikoni me kujdes pikëzimet në kapitullin 1 të kësaj pjesë që gjendet tek 1 Perëndisë (shih 1 Nefi

- Çfarë dëshironte Le

“**Aktivitet.**” Shumica e kapitujve kanë aktivitete për studimin individual dhe me shokun, për të përmirësuar mësimin dhe zbatimin tuaj. Përsëritini këto aktivitete gjatë gjithë misionit. Ju do të merrni zbulesa të reja sa herë ta bëni këtë, sepse nevojat tuaja—dhe nevojat e atyre që mësoni— do të ndryshojnë.

**Ndiqni Shpirtin**

“Shpirti është elementi i parë që ju mund të bëni përparoni pavarësisht e rinj të misionit, 25 qe

**Kutitë e Kuqe.** Këto kuti përmbajnë informacion dhe sugjerime të rëndësishme për shumë situata mësimdhënieje dhe predikimi.

**Historitë**

Të gjitha historitë që gjenden në *Predikoni Ungjillin Tim* janë të vërteta, megjithëse emrat e shumicës së njerëzve janë ndryshuar. Secila histori ilustron disa parime që lidhen me punën misionare. Ndërsa lexoni këto histori, gjeni parimet që ato ilustrojnë.

**Ide për Studim dhe Zbatim**

Çdo kapitull përfundon me ide shtesë për studimin individual, studimin me shokun, mbledhjet e distriktit dhe konferencat e zonës. Ky burim i pasur për aktivitete studimi siguron shembuj të mënyrave efektive për të mësuar materialin. Jini krijues dhe kërkoni frymëzim për të krijuar aktivitete të tjera sa herë që studioni ose mësoni një nga këto seksione. Kryejini këto aktivitete disa herë gjatë misionit tuaj.

**Ide për Studim dhe Zbatim****Studim Individual**

- Lexoni letrën e mëposhtme të një misionareje drejtuar prindëve të saj: “U mësova një zonjë të mrekullueshme në autobus. Po ktheheshim nga mbledhja e distriktit, ishte i vetmi vend bosh dhe unë u ula e po shikoja postën time. Ajo më para ishte letra juaj me foto të bebes Evan. Vura re se sytë e personit përmes dritarës po shikonin gjithashtu fotot, e ngrita kokën dhe ndesha në vështrimin e saj. Ajo më dha një gjysëm buzëqeshje dhe u kthye në dritarja. Më pas ajo mbylli sytë sikur po flinte. Unë u luta, ‘Atë Qielor, unë flas me të. Të lutem më ndihmo.’ Pas një minute ajo hapi sytë dhe qendroi sytë në mua dhe tha: ‘Më duket sikur po flitni.’” U traçua fotoja të

**Misionarët që Shërbejnë në Degë dhe Distrikte**

Shumë misionarë shërbejnë në degë dhe distrikte. Megjithëse ky udhëzues i referohet lagjeve dhe kuneve, të njëjtat parime dhe mënyra zbatohen për *degët* dhe *distriktet*. Presidenti i misionit do t’ju udhëzojë mbi ndonjë përshtatje që duhet të bëni kur punoni me udhëheqësit e degës dhe të distriktit.

**Përdorimi nga Misionarët e Lagjes dhe Udhëheqësit e Lagjes**

*Predikoni Ungjillin Tim* është për misionarët e Kishës me kohë të plotë. Megjithatë, parimet dhe doktrinat e mësuara në të, janë gjithashtu të zbatueshme për misionarët e lagjes dhe udhëheqësit e lagjes, ndërsa ata përpiqen të ndërtojnë mbretërinë e Zotit. Studimi i shpeshtë i këtij udhëzuesi do t’i aftësojë ata të përmbushin përgjegjësitë e tyre si anëtarë misionarë dhe do të mbajë gjallë unitetin me misionarët me kohë të plotë.





Dan Xhons, një nga misionarët më të mëdhenj të kësaj kohe, duke predikuar ungjillin në Uells.

# Cili Është Qëllimi Im si Misionar?

## Qëllimi Juaj

I ftoni të tjerët të vijnë te Krishti duke i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe Shlyerjes së Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund.

## Mbani parasysh

- Cili është qëllimi im si misionar?
- Çfarë është ungjilli?
- Pse e predikojmë ungjillin?
- Pse duhet t'ua mësoj (ungjillin) të tjerëve me forcë dhe autoritet?
- Cili është mesazhi i Rivendosjes? Pse është ai kaq i rëndësishëm?
- Cila është përgjegjësia ime për të ndihmuar të tjerët të kthehen në besim?
- Si mund ta kuptoj nëse jam një misionar i suksesshëm?

## Mandati Juaj për t'u Mësuar të Tjerëve Ungjillin e Rivendosur të Jezu Krishtit

Ju jeni të rrethuar nga njerëz. Ju shkoni udhës me ta, i vizitoni në shtëpitë e tyre dhe Judhëtoni mes tyre. Të gjithë ata janë fëmijë të Perëndisë, vëllezërit dhe motrat tuaja. Perëndia i do ata ashtu si ju do edhe juve. Shumë nga këta njerëz i kanë vënë vetes një qëllim në jetë. Ata janë të shqetësuar për familjet e tyre. Ata kanë nevojë për atë ndjenjë përkatësie që vjen kur e dinë se janë fëmijë të Perëndisë, anëtarë të familjes së Tij të përjetshme. Ata duan të ndihen të sigurtë në një botë ku vlerat ndryshojnë vazhdimisht. Ata duan “paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23), por ata “mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë” (DeB 123:12).

Ungjilli i Jezu Krishtit, i rivendosur nga Profeti Jozef Smith, do të bekojë familjet e tyre, do të përmbushë nevojat e tyre shpirtërore dhe do t'i ndihmojë të përmbushin dëshirat e

Shënime

## Shënime

tyre më të mëdha. Ndonëse nuk mund ta dinë pse, ata kanë nevojë për një lehtësim nga ndjenja e fajit që vjen si pasojë e gabimeve dhe mëkateve. Ata kanë nevojë të përjetojnë gëzimin e shëlbimit nëpërmjet marrjes së faljes për mëkatet e tyre dhe të gëzojnë dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Si një përfaqësues i autorizuar i Jezu Krishtit, ju mund t'u mësoni njerëzve me forcë dhe autoritet se “shëlbimi vjen nëpërmjet Mesias së Shenjtë,” dhe se asnjë nuk “mund të banojë në prani të Perëndisë, përveç nëpërmjet meritave, mëshirës dhe hirit të Mesias së Shenjtë” (2 Nefi 2:6, 8). Kur njerëzit e pranojnë ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit dhe marrin ordinancën e pagëzimit dhe konfirmimit nëpërmjet autoritetit të priftërisë, ata mund



të jenë të sigurtë se “nuk janë braktisur përgjithmonë” (Libri i Mormonit, Faqja e Titullit).

Ndërsa të kuptuarit tuaj për Shlyerjen e Jezu Krishtit rritet, do të rritet edhe dëshira juaj për ta ndarë ungjillin me të tjerët. Ju do të ndieni, atë që ndjeu Lehi, “[rëndësinë e madhe]...që këto gjëra t'u bëhen të njohura banorëve të tokës” (2 Nefi 2:8).

Presidenti Ezra Taft Benson mësoi: “Ne jemi urdhëruar nga Perëndia t'ia çojmë këtë ungjill gjithë botës. Kjo është kauza që duhet të na bashkojë sot. Vetëm ungjilli mund ta shpëtojë botën nga katastrofa e shkatërrimit të vetvetes. Vetëm ungjilli do t'i bashkojë njerëzit e të gjitha racave dhe kombësive në paqe. Vetëm ungjilli do t'i sjellë gëzim, lumturi dhe shpëtim familjes njerëzore” (*The Teachings of Ezra Taft Benson* [1988], 167).

Ju jeni thirrur të përfaqësoni Jezu Krishtin duke i ndihmuar njerëzit të pastrohen nga mëkatet e tyre. Ju e bëni këtë duke i ftuar ata të vijnë te Krishti dhe të kthehen në besim tek ungjilli i Tij i rivendosur. Që të vijnë te Shpëtimtari, ata duhet të kenë besim tek Ai deri në pendim—duke bërë ndryshimet e nevojshme që jeta e tyre të jetë në përputhje me mësimet e Tij. Ju mund t'i ndihmoni njerëzit të arrijnë një besim të tillë duke u mësuar atyre ungjillin e rivendosur nëpërmjet Shpirtit, duke i ftuar ata të zotohen për të jetuar sipas mësimeve të tij. Mbajtja e këtij zotimi i përgatit ata për besëlidhjet e pagëzimit dhe konfirmimit dhe për dhuratën e çmuar të Frymës së Shenjtë. Ata duhet të zhvishen nga “njeriu i natyrshëm” dhe të bëhen shenjtorë “nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot” (Mosia 3:19).

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Shikoni me kujdes pikturën e pemës së jetës në këtë faqe ndërsa studioni vegimin e pemës së jetës që gjendet tek 1 Nefi 8 dhe 11. Në këtë vegim, pema e jetës simbolizon dashurinë e Perëndisë (shih 1 Nefi 11:21–22).

- Çfarë dëshironte Lehi pasi kishte ngrënë frutin? (Shih 1 Nefi 8:10–18.)
- Çfarë duhet të bënin njerëzit, në këtë vegim, që të mund të hanin frutin? Çfarë duhet të bëjnë ne që të marrim të gjitha bekimet e Shlyerjes? Në çfarë mënyre na ndihmojnë zotimet dhe besëlidhjet që t'i marrim këto bekime?
- Si misionar, cila është detyra juaj në ndihmën që u jepni të tjerëve të gjejnë dhe të hanë frutet e ungjillit?



## Ungjilli Bekon Familjet

Mesazhi i ungjillit të Rivendosur të Jezu Krishtit bekon familjet. Si rezultat i Rivendosjes ne kuptojmë planin e Perëndisë për familjet: “Plani hyjnor i lumturisë bën të mundur që marrëdhëniet familjare të vazhdojnë përtej varrit. Ordinancat dhe besëlidhjet e shenja që janë në dispozicion në tempujt e shenjtë bëjnë të mundur që individët të kthehen në praninë e Perëndisë dhe që familjet të bashkohen përjetësisht” (“Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës,” [35602 101]).

Në tokë, marrëdhëniet familjare mund të jenë burim i disa prej gëzimeve tona më të mëdha. Satani po e sulmon familjen në drejtime të ndryshme dhe shumë familje po shkatërrohen nga orvatjet e tij. Mesazhi i ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit bën të mundur që familjet të jenë të bashkuara tani dhe në përjetësi. Duke jetuar parimet e ungjillit, familjet mund të provojnë paqe, gëzim dhe një ndjenjë përkatësie e identiteti në këtë jetë. Përmes dritës së ungjillit, familjet mund të zgjidhin mosmarrëveshjet, grindjet dhe sfidat. Familjet e ndara nga mospërputhjet mund të bashkohen përmes pendimit, faljes dhe besimit në fuqinë e Shlyerjes së Jezu Krishtit. “Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht. Martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, faljes, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese” (*Ensign*, nëntor 1995, 102).

Përpiquni të gjeni dhe të mësoni familje—një baba, një nënë dhe fëmijë—që mund ta mbështesin njëri-tjetrin në të jetuarit e ungjillit dhe në fund të vulosen si një njësi familjare e bashkuar nëpërmjet autoritetit të priftërisë së rivendosur.

*“Puna më e rëndësishme nga të gjitha punët e Zotit që do të bëni ndonjëherë do të jetë brenda mureve të shtëpisë suaj.”*

– PRESIDENTI HAROLD B. LI  
THE TEACHINGS OF HAROLD B. LEE, PËRZGJEDHUR NGA  
CLYDE J. WILLIAMS (1996), 280

## Duke i Mësuar të Tjerët Nëpërmjet Shpirtit

Duke qenë se ungjilli i Jezu Krishtit është “fuqia e Perëndisë për shpëtimin e cilitdo që beson” (Romakëve 1:16), mesazhi i Rivendosjes së ungjillit duhet të mësohet nga fuqia hyjnore—fuqia e Frymës së Shenjtë, që është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi. Shpesh Ai quhet Shpirti dhe një nga rolet e Tij është të mësojë dhe të dëshmojë për të vërtetën. Ndërsa i mësoni të tjerët nëpërmjet kësaj fuqie, Fryma e Shenjtë:

- Do t’ju mësojë të vërteta të reja dhe do t’ju kujtojë doktrinat që ju keni studiuar (shih Gjoni 14:26).
- Do t’ju japë fjalët që duhet të flisni në çdo çast që do t’ju nevojiten (shih DeB 84:85).
- Do ta përcjellë mesazhin tuaj në zemrat e njerëzve që mësoni (shih 2 Nefi 33:1).
- Do të dëshmojë vërtetësinë e mesazhit tuaj dhe do të vërtetojë fjalët tuaja (shih DeB 100:5–8).
- Do t’ju ndihmojë të dalloni nevojat e njerëzve të cilët po mësoni (shih Alma 12:7).

Shpirti është thelbësor për t’ua mësuar të tjerëve të vërtetat e ungjillit në një mënyrë që ndërton besim tek ata. Ndërsa përpiqeni të zhvilloni besimin për t’u mbështetur te Shpirti, ju duhet:

- Të luteni për të pasur Shpirtin (shih DeB 42:14).
- Të pastroni zemrën tuaj (shih DeB 112:28).
- Të mbani urdhërimet (shih DeB 20:77, 79).
- Të mblidhni me zell si thesar fjalën e Perëndisë (shih DeB 11:21, 84:85).
- Të mësoni në atë mënyrë që të tjerët ta kuptojnë mesazhin tuaj dhe të lartësohen shpirtërisht (shih DeB 50:13–22).
- Të ushtroni besim (shih Moroni 10:7).

Ju u veçuat në thirrjen tuaj të shenjtë me premtimin se do t'ju jepet Shpirti ndërsa plotësoni kërkesat e caktuara nga Zoti. Të gëzuarit e dhuratave të Shpirtit duhet të jetë një nga dëshirat tuaja më të zjarrra.

### Fuqia dhe Autoriteti i Thirrjes Suaj

Misionarët duhet të shkojnë “me fuqinë e shugurimit me të cilën [janë] shuguruar, duke shpallur lajmet e mira të gëzimit të madh, madje ungjillin e përjetshëm” (DeB 79:1). Ju keni autoritetin të predikoni ungjillin. Në qoftë se mbani priftërinë, ju keni autoritetin të administroni ordinancat e saj. Ndërsa e ushtroni me lutje dhe denjësi këtë autoritet, ju do të merrni fuqi shpirtërore, që është provë e vërtetësisë së thirrjes suaj. Mos u frikësoni, ose mos ngurroni të plotësoni thirrjen tuaj si misionar. Ashtu si djemtë e Mosias, edhe ju duhet t'i mësoni të tjerët me fuqinë dhe autoritetin e Perëndisë (shih Alma 17:2–3).

Kur u veçuat nëpërmjet autoritetit të priftërisë, juve ju dha e drejta dhe privilegji të përfaqësoni Zotin. Ju morët një certifikatë si shërbëtar që ia vërteton këtë autoritet botës. Presidenti Spenser W. Kimbëll tha: “Veçimi mund të merret në kuptimin e vërtetë të fjalës; ai është një veçim nga mëkati, veçim nga dëshirat trupore, veçim nga gjithçka që është e pahijshme, e ulët, e ligë, e pavlerë, ose vulgare, *veçim* nga bota në një shkallë më të lartë mendimi dhe veprimi. Bekimi varet nga kryerja besnikërisht e detyrës së caktuar” *The Teachings of Spencer W. Kimball, botuar nga: Edward L. Kimball [1982], 478*.

Bashkë me autoritetin vjen përgjegjësia të jetoni të denjë për thirrjen tuaj. Si përfaqësues i Zotit, ju duhet të jeni “shembull për besimtarët” (1 Timoteu 4:12). Përpikuni të jetoni në përputhje me urdhërimet e Perëndisë dhe të mbani besëlidhjet e bëra në tempull; të njihni shkrimet e shenjta; të jeni të sjellshëm, të përpiktë në kohë dhe të besueshëm; të ndiqni standardet e sjelljes misionare, të veshjes dhe paraqitjes së jashtme; t'i doni njerëzit me të cilët shërbeni dhe punoni. Nderoni emrin e Krishtit me anë të veprimeve tuaja.

Përveç autoritetit, ju gjithashtu duhet të ushtroni fuqi në punën tuaj. Autoriteti që keni marrë mund të çojë në fuqi. Në të vërtetë, fuqia shpirtërore është një provë se autoriteti juaj është real. Fuqia shpirtërore është një dhuratë e cila bën të mundur që ju ta bëni punën tuaj me më efektshmëri.

Fuqia dhe autoriteti juaj duhet të bëhen të dukshëm ndërsa punoni dhe jepni mësim. Fuqia mund të manifestohet në shumë gjëra që bëni, të tilla si:

- Të qenit të drejtuar nga Shpirti për të thënë atë që Zoti do të donte që ju të thonit pikërisht në çastin e duhur (shih DeB 84:85).
- Marrjen e udhëheqjes shpirtërore se ku duhet të shkoni apo çfarë të bëni (shih DeB 28:15; 31:11; 75:26–27).
- Konfirmimin e dëshmisë suaj nga dëshmimi i Shpirtit (shih 2 Nefi 33:1; DeB 100:5–8).
- Marrjen pjesë në ordinancat e shpëtimit (shih DeB 84:19–20).
- Dhënien e bekimeve të priftërisë nëse jeni një plak (shih Jakobi 5:14–15 Dhjata e Re).

- Lutjet që bëni me njerëzit dhe për njerëzit me të cilët punoni (shih Alma 6:6; 8:18–22; 10:7–11; 31:26–35; DeB 75:19).
- Të shprehurit e dashurisë për Zotin, familjen tuaj, shokët misionarë dhe për njerëzit të cilëve u shërbeni.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Si merrni fuqi?

Alma 17:2–3

DeB 53:3

1 Korintasve 2:4

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Shikoni pikturën e Krishtit duke shuguruar Apostujt dhe pastaj lexoni Gjoni 15:1–16.

Në ç'mënyrë është Krishti hardhia? Si jeni ju një shermend i kësaj hardhie? Si lidhet veçimi juaj (si misionar) me këtë marrëdhënie?

Lexoni përsëri certifikatën tuaj si shërbëstar. Shkruani ndjenjat dhe mendimet tuaja rreth asaj që lexuat. Sa herë që studioni këtë kapitull, përsëritni këtë proces. Shënoni se si ndjenjat tuaja ndryshojnë me kalimin e kohës.

Studioni Doktrina e Besëlidhje 109:13–15, 21–30, 38–39, 55–57, që janë fragmente nga lutja e frymëzuar e Profetit Jozef Smith dhënë gjatë përkushtimit të Tempullit të Kirtlandit. Çfarë bekimesh kërkoi Jozef Smithi për besnikët?



## Ungjilli i Jezu Krishtit

Ungjilli i Jezu Krishtit përkufizon si mesazhin ashtu edhe qëllimin tuaj; që do të thotë se ai shpjegon si atë se "çfarë" është puna misionare ashtu edhe arsyen se "pse" bëhet puna misionare. Shpëtimtari e përkufizoi ungjillin e Tij si një ungjill që përfshin disa doktrina tepër jetësore dhe themelore. Ai erdhi në botë të bënte vullnetin e Atit të Tij dhe Ati i Tij e dërgoi në botë për t'u kryqëzuar. Me anë të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Tij, të gjithë njerëzit do të ngrihen të qëndrojnë përpara Krishtit për t'u gjykuar për veprat e tyre, nëse ato kanë qenë të mira ose të liga. Ata që ushtrojnë besim në Krisht, pendohen për mëkatet e tyre dhe pagëzohen në emrin e Krishtit, mund të shenjtërohen nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Në qoftë se durojnë deri në fund, ata do të qëndrojnë të panjollë përpara Krishtit në ditën e fundit dhe do të hyjnë në prehjen e Zotit. Krishti do t'i quajë

ata të pafajshëm përpara Atit. Ai do të jetë Ndërmjetësi dhe Avokati i tyre. Ata që nuk do të durojnë në besnikëri deri në fund do të “hidhen në zjarr...për shkak të drejtësisë së Atit.” (Shih 3 Nefi 27:13–22; krahaso 2 Nefi 31:10–21; 3 Nefi 11:31–41; DeB 76:40–42, 50–53.)

Qëllimi i ungjillit është t’i pastrojë njerëzit nga mëkatet e tyre që kështu të mund të marrin mëshirën e Shpëtimtarit në ditën e gjykimit. Pra, thelbi i këtij libri dhe, ajo çka është më e rëndësishmja, thelbi i punës që ju bëni çdo ditë, është t’i ftoni të tjerët të vijnë te Krishti duke i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe Shlyerjen e Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund.

Individët dhe familjet fillojnë të ndjekin Krishtin ndërsa ushtrojnë besim te Ai dhe pendohen për mëkatet e tyre. Ata marrin heqjen e mëkateve nëpërmjet pagëzimit dhe marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë nga dikush që ka autoritet nga Perëndia për ta kryer këtë ordinancë. Pastaj ata durojnë deri në fund, ose, me fjalë të tjera, vazhdojnë gjatë gjithë jetës së tyre të ushtrojnë besim në Jezu Krisht, të pendohen dhe të ripërtërijnë besëlidhjet që kanë bërë. Këto nuk janë hapa që ata i përjetojnë vetëm një herë në jetë, përkundrazi, kur përsëriten gjatë jetës këto parime bëhen një model jetese gjithmonë e më frytdhënës. Në fakt, kjo është e vetmja mënyrë jetese që do t’u sjellë paqe të ndërgjegjes dhe do t’ua bëjë të mundur fëmijëve të Atit Qiellor të kthehen për të jetuar në praninë e Tij.

Bindja ndaj Jezu Krishtit është një zotim që zgjat gjithë jetën. Nëpërmjet të ushtuarit të besimit, pendimit, pagëzimit dhe zotimit për t’i shërbyer Krishtit dhe më pas marrjes së Frymës së Shenjtë, ne mund të përjetojmë shërim shpirtëror, falje të mëkateve dhe një kthim të plotë në besim te Shpëtimtari dhe ungjilli i Tij.

I ndihmoni njerëzit të fitojnë besim në Jezu Krisht deri në pendim duke u mësuar e dëshmuar se plotësia e ungjillit të Jezu Krishtit dhe autoriteti i priftërisë janë rivendosur dhe duke i ftuar ata të jetojnë sipas mësimëve të Tij.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Çfarë është ungjilli, ose doktrina e Krishtit?

2 Nefi 31:10–21

3 Nefi 11:31–41

3 Nefi 27:13–22

*“Predikoni parimet e para të ungjillit—predikojini ato vazhdimisht; ju do të shikoni se nga dita në ditë do t’ju zbulohen ide të reja dhe një ndriçim edhe më i madh në lidhje me këto gjëra. Ju mund t’i shtjelloni më tej ato në mënyrë që t’i kuptoni më qartë. Atëherë do të jeni të aftë t’i bëni ato më të qarta për t’u kuptuar prej atyre që po i mësoni.”*

— HAIRËM SMITH  
HISTORY OF THE CHURCH, 6:323

### Mesazhi i Rivendosjes: Themeli i Besimit

Nuk ka rëndësi se ku shërbeni apo kë mësoni, përqendrojeni mësimin tuaj në Rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit. “Zoti do t’ju bekojë ndërsa i mësoni mesazhin e Rivendosjes një bote që ka qaq shumë nevojë për ungjillin e Jezu Krishtit” (“Deklaratë rreth Punës Misionare,” letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002). Ndërsa studioni doktrinën në mësimet misionare, do të kuptoni se ne kemi një mesazh: Nëpërmjet një profeti të ditëve tona, Perëndia ka

rivendosur njohurinë rreth planit të shpëtimit, i cili përqendrohet në Shlyerjen e Krishtit dhe përmbushet duke jetuar parimet dhe ordinancat e para të ungjillit.

Sigurohuni që secili nga ata që ju mësoni të kuptojë qartë sa më poshtë:

- Perëndia është Ati ynë i vërtetë në Qiell. Ai na do. Çdo njeri në tokë është fëmijë i Perëndisë dhe një anëtar i familjes së Perëndisë. Jezu Krishti, Biri i Perëndisë, është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë.
- Ati ynë i dashur në Qiell u qëndroi pranë fëmijëve të Tij gjatë gjithë historisë biblike duke ua zbuluar ungjillin e Tij profetëve. Është i trishtueshëm fakti që shumë njerëz nuk e pranuan atë ungjill; madje edhe disa nga ata që e pranuan atë ndryshuan doktrinat dhe ordinancat dhe ranë në mosbesim dhe braktisje.
- Ati ynë në Qiell dërgoi Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, në tokë. Ai bëri mrekulli dhe u mësoi njerëzve ungjillin e Tij. Ai kreu Shlyerjen dhe u ringjall.
- Duke filluar me Vegimin e Parë, Zoti iu afrua edhe një herë me dashuri fëmijëve të Tij. Ai rivendosi ungjillin e Jezu Krishtit dhe autoritetin e Tij të priftërisë dhe organizoi Kishën e Tij në botë nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Libri i Mormonit është prova bindëse e kësaj rivendosjeje.



Kur ju i ndihmoni kërkuesit të kuptojnë shembullin e braktisjes dhe rivendosjes, ata do të jenë të përgatitur të kuptojnë nevojën e madhe për Rivendosjen e ditëve të mëvonshme. Ata do të ndiejnë nevojën të pranojnë ungjillin e rivendosur, të marrin ordinancat e shpëtimit nëpërmjet autoritetit të priftërisë së rivendosur dhe të ndjekin rrugën drejt jetës së përjetshme. I ndihmoni njerëzit të kuptojnë se Kisha nuk është thjesht vetëm një fe tjetër dhe as nuk është një kishë amerikane. Përkundrazi, ajo është rivendosja e “plotësisë së ungjillit” (DeB 1:23), ashtu siç ai u zbulua dhe u mësoi që nga fillimi.

Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit është prova bindëse se Jozef Smithi ishte një profet dhe se ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur. Ky është guri kyç i besimit tonë, burimi më i fuqishëm për mësimin e këtij

mesazhi. Disa të vërteta të rëndësishme të rivendosura nga Jozef Smithi përfshijnë dijen se Perëndia është Ati ynë dhe që ne jemi fëmijët e Tij shpirtërorë, se jetonim me Të para lindjes dhe se familjet mund të jetojnë së bashku përgjithmonë në praninë e Perëndisë nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, duke iu bindur ligjeve dhe ordinancave të ungjillit.

Libri i Mormonit është provë e dashurisë së Perëndisë për fëmijët e Tij. Ai tregon se Perëndia u flet fëmijëve të Tij. Ndërsa i mësoni të tjerët dhe u dëshmoni atyre, ftojini ata të lexojnë Librin e Mormonit dhe të luten rreth këtij mesazhi. Çdo person që ju mësoni duhet të vendosë nëse e pranon Librin e Mormonit si zbulës nga Perëndia.

Besoni premtimin e jashtëzakonshëm që gjendet te Moroni 10:3–5. Bëni gjithçka mundni që t’i bindni njerëzit ta lexojnë librin, ta kuptojnë atë dhe ta pyesin Perëndinë sinqerisht nëse ai është i vërtetë. Dëshmia e Frymës së Shenjtë bëhet guri kyç i besimit të tyre se Krishti ka rivendosur Kishën e Tij. I ndihmoni ata që mësoni të marrin një konfirmim shpirtëror.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Si duhet ta përdorni Librin e Mormonit në punën misionare?**

1 Nefi 13:39

Moroni 10:3–5

DeB 42:12–14

2 Nefi 29:8–10

DeB 20:5–16

**Aktivitet: Studim Individual**

Imagjinoni sikur ju do të shkruani një artikull rreth mesazhit të Rivendosjes për një gazetë lokale. Në ditarin tuaj të studimit shkruani një titull që përshkruan mesazhin kryesor. Pastaj shkruani mendimet dhe ndjenjat tuaja rreth këtij mesazhi, duke përfshirë këtu edhe se si të kuptuarit më mirë të tij ka ndryshuar mënyrën se si jetoni dhe mënyrën se si e shikoni botën rreth jush.

**Duke Ndhimuar të Tjerët të Marrin Zotime: Porta drejt Besimit dhe Pendimit**

I ndihmoni njerëzit të përgatiten për pagëzimin dhe konfirmimin duke u mësuar atyre doktrinën e vërtetë dhe duke i ftuar të pendohen dhe të ndryshojnë jetën e tyre nëpërmjet marrjes dhe mbajtjes së zotimeve që ndërtojnë besimin e tyre te Jezu Krishti. Këto zotime i përgatisin njerëzit të bëjnë dhe të mbajnë besëlidhjet e shenjta.

Plaku Xhefri R. Holland mësoi: “Gjëja e parë që do të bëni kur një kërkues ju thotë se ai ose ajo nuk ka lexuar dhe nuk është lutur rreth Librit të Mormonit është të mbeteni të dëshpëruar! ... Në pjesën më të madhe të kohës ne tregohemi shumë të shkujdesur në lidhje me këtë. Kjo është jeta e përjetshme. Ky është shpëtimi i fëmijëve të Perëndisë. Përjetësia është në rrezik... Ky është shtegu më i rëndësishëm nëpër të cilin ky kërkues do të ecë ndonjëherë. Por në qoftë se ai ose ajo nuk e di këtë, të paktën ju e dini! ... Kështu merrni në dorë situatën. Mësoni me fuqi dhe autoritet dhe pastaj jini të dëshpëruar nëse hapat e para drejt mbajtjes së urdhërimeve dhe mbajtjes së besëlidhjeve nuk kanë filluar suksesshëm” (“Making and Keeping Covenants,” transmetim satelitor për misionarët, prill 1997).

Ndërsa u mësoni njerëzve të kuptojnë Rivendosjen e plotësisë së ungjillit, ju “shpallni pendim” (DeB 15:6). Pendimi përfshin një ndryshim të zemrës dhe një dëshirë për të braktisur mëkatën dhe për t’i shërbyer Perëndisë. Ai përfshin nënshtrimin e përlulur ndaj Shpirtit dhe nënshtrimin ndaj vullnetit të Perëndisë. Ai kërkon që njerëzit të rrisin zotimin e tyre për të jetuar në përputhje me vullnetin e Perëndisë. Pendimi kërkon një ndryshim të sinqertë dhe të përhershëm të mendimeve, dëshirave, zakoneve dhe veprimeve. Ai është një përvojë pozitive që sjell gëzim dhe paqe. Jini të guximshëm dhe të dashur ndërsa i ndihmoni njerëzit të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë që të pendohen. Duke i ftuar njerëzit që të zotohen, ju në mënyrë efektive mund të ngrini një zë paralajmërues dhe një zë shprese.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Çfarë na mësojnë këto shkrime të shenjta rreth shpalljes së pendimit?**

Alma 29:1–4

Alma 62:45

DeB 15:6; 16:6

Alma 42:31

DeB 14:8

## Pagëzimi dhe Konfirmimi

Pagëzimi dhe konfirmimi i njerëzve që ju mësoni përbën thelbin e qëllimit tuaj. Pagëzimi është për heqjen e mëkateve dhe dhurata e Frymës së Shenjtë u sjell një varg bekimesh atyre që jetojnë të denjë për të. Përmes këtyre ordinancave njerëzit hyjnë në portë dhe vazhdojnë në shtegun e jetës së përjetshme. Plaku Dallin H. Oaks tha: “Ne nuk predikojmë dhe mësojmë që të ‘sjellim njerëz në Kishë’ ose të rrisim anëtarësinë e Kishës. Ne nuk predikojmë dhe mësojmë vetëm që t’i bindim njerëzit të jetojnë jetë më të mira... Ne i ftojmë të gjithë të vijnë te Krishti nëpërmjet pendimit, pagëzimit dhe konfirmimit me qëllim që t’ua hapim dyert e mbretërisë hyjnore bijve dhe bijave të Perëndisë. Askush tjetër nuk mund ta bëjë këtë” (“The Purpose of Missionary Work,” transmetim satelitor për misionarët, prill. 1995).

Ndërsa u mësoni ungjillin e rivendosur, ndihmohuni njerëzit të kuptojnë natyrën e shenjtë të pagëzimit dhe konfirmimit. I ndihmoni ata të kuptojnë se marrja e dhuratës së Frymës së Shenjtë është një bekim i madh në këtë jetë dhe çelësi për shpëtimin e tyre. Fryma e Shenjtë do “t’ju mësojë [atyre] çdo gjë” (Gjoni 14:26). Presidenti Boid K. Paker mësoi: “Ndërsa i mësoni kërkuesit dhe i përgatisni ata për pagëzimin me ujë, ju duhet të mendoni gjithashtu për dhuratën e Frymës së Shenjtë—pagëzimin me zjarr. Mendoni për të si një e pandarë. I pari vjen pagëzimi me ujë dhe më pas pagëzimi me zjarr” (“Dhurata e Frymës së Shenjtë: Çfarë Duhet Të Dijë Çdo Misionar— dhe Çdo Anëtar,” seminar për presidentët e rinj të misionit, qershor 2003). Profeti Jozef Smith mësoi: “Pagëzimi me ujë është gjysmë pagëzimi dhe nuk vlen për asgjë pa gjysmën tjetër—që është, pagëzimi i Frymës së Shenjtë” (*History of the Church*, 5:499).

I ndihmoni ata që mësoni të kuptojnë se që të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim ata duhet të plotësojnë kushtet e dhëna në Doktrina e Besëlidhje 20:37.

### DeB 20:37 Kërkesat për Pagëzim

- Të përulen përpara Perëndisë.
- Të kenë dëshirë për t’u pagëzuar.
- Të kenë zemra të thyera dhe shpirtra të penduar.
- Të pendohen për të gjitha mëkatet e tyre.
- Të jenë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Jezu Krishtit.
- Të kenë vendosmërinë t’i shërbejnë Krishtit deri në fund.
- Të tregojnë me veprat e tyre se e kanë marrë Shpirtin e Krishtit për heqjen e mëkateve të tyre.

Pasi të kthyerit e denjë pagëzohen, ata konfirmohen anëtarë të Kishës dhe u jepet dhurata e Frymës së Shenjtë. Ky konfirmim bëhet nën drejtimin e peshkopit ose të presidentit të degës në një mbledhje sakramenti jo shumë ditë pas pagëzimit. E ndërsa ekziston një periudhë e shkurtër kohe midis këtyre dy ordinancave, konfirmimi e plotëson dhe e përfundon pagëzimin.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta**

**Në çfarë mënyre është dhurata e Frymës së Shenjtë një nga dhuratat më të mëdha që mund të marrim?**

3 Nefi 19:1–13  
DeB 45:56–57

Gjoni 3:5  
Gjoni 14:26

Galatasve 5:22–25  
Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta  
“Fryma e Shenjtë”

**Pse duhet ta dëshirojnë të kthyerit në besim dhuratën e Frymës së Shenjtë?**

2 Nefi 31:12–17  
2 Nefi 32:1–5

Veprat e Apostujve 8:14–17

Veprat e Apostujve 19:1–6

**Aktivitet: Studim me Shokun**

Studioni shkrimet e mëposhtme dhe bëni një listë të kërkesave dhe besëlidhjes së pagëzimit. Diskutoni me shokun/shoqen tuaj se si t’ua mësoni këto kërkesa të tjerëve.

2 Nefi 31:13  
Mosia 18:8–10

Alma 7:14–16  
3 Nefi 11:21–41

Moroni 6:1–4  
DeB 20:37

**Forcimi i Kishës**

Pasi njerëzit të jenë pagëzuar dhe konfirmuar anëtarë të Kishës, vazhdoni të punoni me udhëheqësit e lagjes dhe anëtarët për t’i ndihmuar këta të porsakthyer në besim të ambientohen me jetën e tyre të re dhe të vazhdojnë rritjen e tyre shpirtërore. Kisha vendoset mbi themele të forta kur njerëzit që kanë dëshmi pagëzohen dhe konfirmohen, mbajnë besëlidhjet e tyre, përgatiten aktivisht të shkojnë në tempull dhe ndihmojnë në forcimin e lagjes ose degës.

Ata të kthyer në besim që kanë shokë anëtarë, që u është ngarkuar një përgjegjësi dhe që ushqehen me fjalën e Perëndisë do të rriten në dëshmi dhe besim. Misionarët, udhëheqësit e lagjes dhe anëtarët e Kishës nuk duhet t’i shmangen përgjegjësisë së tyre për të ushqyer shpirtërisht dhe për të forcuar anëtarët e rinj.

**Një Misionar i Suksesshëm**

Suksesi juaj si misionar matet kryesisht nga përkushtimi juaj për të gjetur, mësuar, pagëzuar dhe konfirmuar njerëzit dhe për t’i ndihmuar ata të bëhen anëtarë besnikë të Kishës që gëzojnë dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Mos e krahasoni veten me misionarët e tjerë dhe mos i matni rezultatet e jashtme të përpjekjeve tuaja me rezultatet e tyre. Mbani mend se njerëzit kanë të drejtën të zgjedhin ta pranojnë apo jo mesazhin tuaj. Përgjegjësia juaj është t’i mësoni ata me qartësi dhe fuqishëm në mënyrë që ata të mund të bëjnë një zgjedhje të saktë. Disa mund të mos e pranojnë mesazhin tuaj madje edhe kur kanë marrë një dëshmi shpirtërore që ai është i vërtetë. Ju do të trishtoheni, sepse i doni ata dhe dëshironi shpëtimin e tyre. Megjithatë, nuk duhet të dekurajoheni; dekurajimi do të dobësojë besimin tuaj. Në qoftë se i humbisni shpresat, efektiviteti i punës suaj do të zvogëlohet, dëshira juaj do të dobësohet dhe do të keni vështirësi më të mëdha për të ndjekur Shpirtin.

Ju mund ta dini se keni qenë një misionar i suksesshëm kur ju:

- E ndieni Shpirtin t’u dëshmojë njerëzve nëpërmjet jush.
- I doni njerëzit dhe dëshironi shpëtimin e tyre.
- U bindeni plotësisht rregullave të misionit.



- Jetoni në mënyrë të tillë që të mund të merrni dhe të dini si të ndiqni Shpirtin, i cili do t'ju tregojë ku të shkoni, çfarë të bëni dhe çfarë të thoni.
- Zhvilloni cilësi si të Krishtit.
- Punoni efektivisht çdo ditë, duke dhënë maksimumin tuaj për të sjellë shpirtra te Krishti dhe kërkoni me zell të mësoni dhe të përmirësoheni.
- Ndhmoni të forconi Kishën (lagjen) ku jeni caktuar të punoni.
- Paralajmëroni njerëzit mbi pasojat e mëkatit. I ftoni ata të bëjnë dhe mbajnë besëlidhjet.
- I mësoni dhe u shërbeni misionarëve të tjerë.
- U bëni mirë dhe u shërbeni njerëzve në çdo rast, pavarësisht nëse ata e pranojnë apo jo mesazhin tuaj.
- Edhe pasi të keni dhënë maksimumin tuaj, mund të përjetoni përsëri zhgënjime, por thellë brenda vetes nuk do të ndiheni të zhgënjyer. Ju mund të ndiheni të sigurt se Zoti është i kënaqur kur ju e ndieni Shpirtin të punojë përmes jush.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Si ndihen shërbëtorët e Zotit rreth punës së Tij? Si ndikojnë shërbëtorët e Zotit tek ata të cilëve u shërbejnë?**

Mosia 28:3	3 Nefi 28:4–10	DeB 68:2–6
Alma 8:14–15	Ethëri 12:13–15	
Helamani 10:3–5	DeB 15:4–6; 16:4–6	

### Aktivitet: Studim Individual

- Lexoni Helamani 10:1–5 dhe 3 Nefi 7:17–18. Si u ndie Zoti rreth këtyre misionarëve dhe shërbimit të tyre?
- Mendoni rreth përpjekjeve misionare të Abinadit dhe Amonit (shih Mosia 11–18; Alma 17–20, 23–24). Pse ishin të suksesshëm të dy këta misionarë edhe pse rezultatet e menjëhershme të përpjekjeve të tyre ishin të ndryshme?
- Shkruani në ditarin tuaj të studimit se çfarë mësuat.

### Mbani Mend

- Qëllimi juaj është t'i ftoni të tjerët të vijnë te Krishti duke i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe Shlyerjen e Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund.
- Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit është rruga e vetme përmes së cilës mund të gjejmë lumturinë e përjetshme.
- Thirrja juaj ju jep autoritet; mbajtja e besëlidhjeve ju jep fuqi.
- Plotësia e ungjillit të Jezu Krishtit u rivendos nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Libri i Mormonit është prova se Jozef Smithi ishte një profet.
- Ju i ndihmoni njerëzit të jetojnë ungjillin duke i ftuar ata të marrin dhe mbajnë zotime.
- Ju tregoni dashurinë tuaj për Zotin dhe mirënjohjen për Shlyerjen e Tij duke sjellë shpirtra tek Ai.
- Ju jeni të suksesshëm kur jeni të bindur, jetoni me ndershmëri dhe bëni më të mirën tuaj duke i ndihmuar të tjerët të jetojnë ungjillin.

## Puna Misionare

Më poshtë gjenden deklaratat të bëra nga Presidentët e Kishës në këtë periudhë ungjillore.

### Presidenti Jozef Smith (1830–1844)

“Pas gjithçkaje që është thënë, detyra më e madhe dhe më e rëndësishmja është të predikojmë Ungjillin” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, përzgjedhur nga Jozef Filling Smith [1976], 113).

“Le të kujtojnë shenjtorët se gjëra të mëdha varen nga përpjekjet e tyre individuale dhe se ata janë thirrur të jenë bashkëpunëtorë me ne dhe me Shpirtin e Shenjtë në përbushjen e punës së madhe të ditëve të fundit” (*Teachings of the Prophet Joseph Smith*, 178–79).

### Presidenti Brigam Jang (1847–1877)

“Nuk ka asnjë burrë apo grua në këtë Kishë që nuk është në një mision. Ai mision do të zgjasë gjatë gjithë jetës së tyre dhe ky mision është të bëjnë mirë, të nxisin drejtësinë, t’u mësojnë të tjerëve parimet e së vërtetës dhe të triumfojë mbi veten dhe njerëzit e tjerë përreth për të jetuar këto parime në mënyrë që të fitojnë jetën e përjetshme” (*Discourses of Brigham Young*, përzgjedhur nga John A. Widtsoe [1954], 322).

### Presidenti Xhon Teilër (1880–1887)

“Detyra jonë është t’u predikojmë ungjillin të gjithë njerëzve... Kjo është ajo çfarë Perëndia pret nga ne” (*The Gospel Kingdom*, përzgjedhur nga G. Homer Durham [1943], 234–35).

### Presidenti Uillford Udrat (1889–1898)

“Ne kemi ardhur në këtë tokë me një mision;...që të mund të kemi fuqi të shkojmë përpara dhe të paralajmërojmë kombet e tokës... Si pleq të Izraelit, shumë pak nga ne e kuptojnë plotësisht detyrën tonë, thirrjen tonë, marrëdhënien tonë me Perëndinë, përgjegjësinë tonë, ose punën që Zoti kërkon nga duart tona” (*The Discourses of Wilford Woodruff*, përzgjedhur nga G. Homer Durham [1946], 124).

### Presidenti Lorenzo Snou (1898–1901)

“Nuk ka asnjë njeri të vdekshëm që të jetë më i interesuar në suksesin e një misionari kur ai është duke predikuar ungjillin sesa Zoti që e dërgoi atë t’u predikojë njerëzve të cilët janë fëmijët e Zotit” (*The Teachings of Lorenzo Snow*, hartuar nga Clyde J. Williams (1984), 70).

### Presidenti Jozef F. Smith (1901–1918)

“Ne kemi një mision në botë: çdo burrë, çdo grua, çdo fëmijë që është në gjendje të kuptojë ose është në moshën e përgjegjshmërisë, duhet...të jetë i përgatitur për të predikuar të vërtetën, për të dëshmuar për të vërtetën” (*Gospel Doctrine*, botimi i 13-të [1968], 251–52).

### Presidenti Hibër. J. Grant (1918–1945)

“Ne si popull (i Kishës) kemi diçka të jashtëzakonshme për të bërë dhe kjo është t’i bëjmë thirrje mbarë botën të pendohet për mëkatin, të vijë tek Perëndia. Dhe është detyra jonë mbi të gjithë të tjerët të shkojmë përpara dhe të shpallim ungjillin e Zotit Jezu Krisht, rivendosjen sërish në tokë të planit të jetës dhe të shpëtimit... Ne kemi me të vërtetë perlën me vlerë të madhe. Ne kemi atë që është me më shumë vlerë se e gjithë pasuria dhe i gjithë informacioni shkencor që zotëron bota. Ne kemi planin e jetës dhe të shpëtimit... Mënyra më e mirë në botë për të treguar dashurinë tonë për të afërmit tanë është të shkojmë përpara dhe të shpallim ungjillin e Zotit Jezu Krisht, për hyjninë e të cilit ai na ka dhënë një njohuri absolute” (në Conference Report, prill 1927, 175–76).

### Presidenti Xhorxh Albert Smith (1945–1951)

“Ky është misioni juaj, vëllezërit dhe motrat e mia të Kishës, kjo është përgjegjësia juaj. Falas e keni marrë dhe Ati ynë Qiellor pret që ju ta ndani falas këtë të vërtetë të lavdishme me bijtë dhe bijat e tjera të Tij.” (*Sharing the Gospel with Others*, përzgjedhur nga Preston Nibley [1948], 213).

“Ne do ta fitojmë ekzaltimin tonë në Mbretërinë Çelestiale vetëm me kushtin që të ndajmë me fëmijët e tjerë të Atit tonë bekimet e Ungjillit të Jezu Krishtit dhe të mbajmë urdhërimet që do ta pasurojnë jetën tonë këtu dhe pas kësaj jete (*Sharing the Gospel with Others*, 190).

**Presidenti David O. McKei (1951–1970)**

“Çdo anëtar... një misionar!” (në Conference Report, prill 1959, 122).

“Kristianizmi i vërtetë është dashuria në veprim. Nuk ka mënyrë më të mirë për të treguar dashurinë për Perëndinë se sa të tregosh një dashuri pa interes për të afërmin tënd. Ky është shpirti i punës misionare” (*Gospel Ideals* [1954], 129).

**Presidenti Jozef Fillding Smith (1970–1972)**

“Ne kemi dëgjuar se jemi të gjithë misionarë. Çdo anëtar... është ose duhet të jetë një misionar; ... si anëtarë të Kishës, duke qenë se jemi zotuar për ta përhapur ungjillin e Jezu Krishtit në bëhemi misionarë. Kjo është pjesë e përgjegjësisë së çdo anëtari të Kishës.” (*Take Heed to Yourselves* [1971], 27–28).

**President Harold B. Li (1972–1973)**

“Puna misionare nuk është gjë tjetër veçse një mësim shtëpie për ata që nuk janë ende anëtarë të Kishës dhe mësimi i shtëpisë nuk është as më shumë e as më pak se punë misionare për anëtarët e Kishës” (*Improvement Era, dhjetor 1964, 1078*).

**President Spenser W. Kimbëll (1973–1985)**

“Sipas programit të Zotit tani është koha për ta çuar më përpara ungjillin nga ç’është çuar më parë. ... Shumë njerëz në këtë botë po thërrasin, me dije dhe pavetëdije, ‘Ejani...dhe na ndihmoni.’ Mund të jetë fqinji juaj. Ajo mund të jetë shoqja juaj. Ai mund të jetë një i afërm. Ajo mund të jetë dikush që e keni takuar vetëm dje. Por ne e kemi atë për të cilën ata kanë nevojë. Le të marrim forca të reja nga studimet dhe lutjet tona, siç bëri Pjetri, ‘dhe tani, Zot,...lejo që shërbëtorët e tu të kumtojnë fjalën tënde me plot çiltërsi’ (Veprat e Apostujve 4:29)” (*Teachings of Spencer W. Kimball* [1982], 546).

**Presidenti Ezra Taft Benson (1985–1994)**

“Ne duhet ta ndajmë ungjillin me të tjerët. Kjo është përgjegjësia jonë—çdo anëtar një misionar. Kjo është thirrja e profetëve të Perëndisë...”

...Puna misionare nga çdo anëtar është një nga çelësat më të mëdhenj të rritjes individuale të anëtarëve tanë. Është bindja ime se puna misionare nga çdo anëtar do të ngrejë përsëritshmërinë në çdo lagje ku aplikohet” (*Teachings of Ezra Taft Benson, 208–9*).

**Presidenti Hauard W. Hanter (1994–1995)**

“Sigurisht çuarja e ungjillit tek çdo fis, gjuhë dhe popull është përgjegjësia unike më e madhe që kemi në vdekshmëri... Ne kemi pasur privilegjin të lindim në këto ditë të fundit, në krahasim me disa periudha më të hershme të ungjillit, që të ndihmojmë për ta çuar ungjillin në të gjithë botën” (“Walls of the Mind,” *Ensign*, shtator 1990, 10).

“Si lidhet Shlyerja me punën misionare? Sa herë provojmë bekimet e Shlyerjes në jetën tonë, është e pamundur të mos ndiejmë një shqetësim për mirëqenien e të tjerëve... Një tregues i madh i procesit personal të kthimit në besim të dikujt është dëshira për ta ndarë ungjillin me të tjerët.” (“The Atonement and Missionary Work,” seminar për presidentët e rinj të misionit, qershor 1994).

**Presidenti Gordon. B. Hinkli (1995–)**

“Ne jemi këtu për ta ndihmuar Atin në punën dhe lavdinë e Tij, për ‘[të bërë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut’ (Mosia 1:39). Detyrimi juaj është po aq i madh brenda sferës së përgjegjësisë tuaj sa ç’është edhe detyrimi im brenda sferës sime” (në Conference Report, prill 1995, 94; ose *Ensign*, maj 1995, 71).

“Në zemrën e çdo anëtari le të zhvillohet vetëdija e potencialit të tij për t’i sjellë të tjerët në njohurinë e së vërtetës. Le të punojë ai për këtë. Le të lutet me zell të madh për të” (“Find the Lambs, Feed the Sheep,” *Ensign*, maj 1999, 106).

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Përgatitni një bisedë dy minutëshe për një nga pyetjet që gjenden në fillim të këtij kapitulli. Përgatituni ta ndani bisedën tuaj me shokun/shoqen ose me misionarët e tjerë në një mbledhje distrikti.
- Kërkojuni të porsakthyerve në besim të tregojnë historitë e tyre të kthimit në besim. Çfarë i ndihmoi ata të fitonin “besimin në pendim” (Alma 34:17)? Pse vendosën ata të pagëzohen dhe të konfirmohen? Si ishte për ta përvoja e të qenit anëtarë të rinj të Kishës? Si mund t’u kishin shërbyer atyre më mirë misionarët?
- Mendoni ç’do të thotë të ngresh zërin e paralajmërimit (shih Jakobi 3:12 (LiM); DeB 1:4; 38:41; 63:57–58; 88:81; 112:5; Ezekieli 3:17–21; 33:1–12). Shkruani me fjalët tuaja ç’do të thotë kjo dhe si mund të veproni për ta kryer atë.
- Lexoni Mormoni 8 dhe Moroni 1 dhe 10. Ndërsa lexoni, pyesni veten: “Cila ishte shpresa e Moronit për kohën tonë? Çfarë donte ai që ne të bëjmë me Librin e Mormonit? Çfarë mund t’i thoja Moronit nëse do ta kisha mundësinë të flisja me të?” Shkruani mendimet tuaja në ditarin tuaj të studimit.
- Mendoni për ngjarje në jetën tuaj që kanë forcuar dëshminë tuaj për Jozef Smithin dhe Rivendosjen. Më pas shkruani përgjigjen e kësaj pyetjeje: Çfarë ju ka ndihmuar të dini se Ati Qiellor dhe Jezu Krishti iu shfaqën Jozef Smithit?

### Studim me Shokun

- Ndani me njëri-tjetrin përgjigjet tuaja për pyetjet që ndodhen në pjesën “Mbani Parasysh” në fillim të kapitullit.
- Ndani me njëri-tjetrin se cilat ishin shpresat dhe dëshirat tuaja për misionin kur morët thirrjen për mision. Deri në çfarë mase përvoja që keni pasur deri tani përputhet me parashikimet tuaja? Si mund t’i plotësoni më mirë këto parashikime?
- Lexoni dhe diskutoni “Shërbej” në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta.
- Zgjidhni një nga misionarët e mëdhenj që vijojnë dhe lexoni referencat e renditura. Ndërsa lexoni, diskutoni si ky misionar (1) kuptoi dhe iu përkushtua thirrjes së tij, (2) shfaqti qëndrimin dhe dëshirën e tij për punën dhe (3) i ndihmoi të tjerët të pranonin ungjillin.
 

Alma (Mosia 18)	Pjetri (Veprat e Apostujve 2)
Aaroni (Alma 22; 23:1–6)	Pali (Veprat e Apostujve 16)
Nefi dhe Lehi (Helamani 5)	
- Në librin e himneve, zgjidhni dy himne rreth rivendosjes të tilla si “Shpirti i Perëndisë,” “Të Falemi Zot për Profetin,” ose “Lutja e Parë e Jozef Smithit” (shih Himne dhe Këngë të Fëmijëve, faqe, 28, 36, 14). Lexoni ose këndonin himnet. Diskutoni kuptimin e fjalëve.
- Lexoni së bashku: “Besim,” “Pendohem, Pendim,” “Pagëzim, Pagëzoi,” dhe “Fryma e Shenjtë” në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta. Lexoni dhe diskutoni të gjitha referencat e shkrimeve të shenjta për secilën nga këto fjalë.
- Lexoni së bashku “Periudhë” në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta. Gjithashtu lexoni dhe diskutoni Doktrina e Besëlidhje 136:37.

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Ftoni dy ose tre të porsakthyer në besim të ndajnë përvojat e tyre të kthimit në besim. Si u ndjenë ata rreth misionarëve? rreth asaj çfarë misionarët i mësuar? rreth mbajtjes së zotimeve? Çfarë ndikoi më fuqishëm në kthimin e tyre në besim?
- Ftoni një udhëheqës priftërie t'u flasë misionarëve rreth mundësive dhe vështirësive të ndërtimit të Kishës në zonën tuaj.
- Lexoni Alma 18 dhe diskutoni këto pyetje: Cilat ishin ndjenjat e Lamonit në fillim të historisë? Si ndryshuan ato? Çfarë ndjenjash duhet të ketë një person në mënyrë që të marrë bekimet e ungjillit? Lexoni Alma 34:15–16 dhe krahasojeni atë me historinë e Lamonit. Si na e bën të mundur Shlyerja e Krishtit të marrim mëshirë?
- Diskutoni çfarë do të thotë të jesh një misionar i suksesshëm. Ftojini misionarët të japin shembuj specifikë të suksesit.
- Ndajini misionarët në tre grupe. I caktoni një grupi të lexojë Veprat e Apostujve 2:36–38 (Pjetri), një grupi tjetër të lexojë Veprat e Apostujve 16:25–33 (Pali) dhe grupit të fundit të lexojë Mosia 18:8–11 (Alma). I kërkonte çdo grupi t'i përgjigjet pyetjes: “Çfarë bëri ky misionar për t'i ndihmuar të tjerët të rriteshin në besim në Krisht, të pendoheshin, të pagëzoheshin dhe të konfirmoheshin?” Diskutoni çfarë mësojnë misionarët nga këto histori, që mund t'i ndihmojë ata të ushtrojnë besim kur i ftojnë njerëzit të pendohen, të pagëzohen dhe të marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë.
- Disa ditë para mbledhjes, caktoni disa misionarë të mendojnë rreth pyetjeve nga pjesa “Mbani Parasysh” që gjendet në fillim të kapitullit. I kërkonte çdo misionari të përgatisë një bisedë dy-tre minutëshe mbi pyetjen që i është caktuar atij ose asaj. Gjatë mbledhjes së distriktit ose konferencës së zonës, u jepni mundësi misionarëve të japin bisedat e tyre. Ndiqini bisedat, diskutoni çfarë kanë mësuar ata dhe si mund ta përdorin atë në punën e tyre misionare.
- Ndajini misionarët në katër grupe. I kërkonte çdo grupi të rendisë sa më shumë të vërteta, besëlidhje dhe ordinanca të munden që u rivendosën dhe u zbuluan nëpërmjet Profetit Jozef Smith. I kërkonte çdo grupi të ndajë rezultatet me të tjerët. Ftojini misionarët të ndajnë me të tjerët se si ndonjëra prej të vërtetave të zbuluara përmes Rivendosjes ka ndikuar në jetët e tyre.

### Presidenti i Misionit

- Gjatë intervistave, herë pas here u kërkonte misionarëve të ndajnë me ju:
  - Dëshminë e tyre për Jezu Krishtin.
  - Dëshminë e tyre për ungjillin e rivendosur dhe misionin e Jozef Smithit.
  - Dëshminë e tyre për Librin e Mormonit.
  - Mendimet e tyre rreth qëllimit të tyre si një misionar.
- Ftojini misionarët të shkruajnë në ditarin e tyre të studimit se çfarë ndiejnë ata se është qëllimi i misionit të tyre. Gjatë një interviste, kërkojuni të ndajnë (me ju) çfarë kanë shkruar.
- Dërgojini një letër urimi anëtarëve të rinj.





# Si të Studioj Efektivisht dhe të Përgatitem të Jap Mësim?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Pse është e rëndësishme të studiojmë ungjillin?
- Si do të ndikojë studimi im te njerëzit që mësoj?
- Pse duhet t'i mbledh vazhdimisht si thesar doktrinat e ungjillit të Jezu Krishtit?
- Si mund të mësoj me efektshmëri doktrinat e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit dhe të përgatitem të mësoj të tjerët?
- Si mund ta përmirësoj studimin tim individual dhe studimin me shokun?

**Z**oti ka thënë, se para se të shpallim fjalën e tij duhet ta kërkojmë atë dhe pastaj gjuha jonë do të zgjidhet; pastaj nëse dëshirojmë, do të kemi Shpirtin dhe fjalën e tij, fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit (shih DeB 11:21). Për të pasur mësimdhënie efektive, ju duhet të zotëroni njohuri shpirtërore. Që të rriteni në ungjill dhe të qëndroni në shtegun që të çon drejt jetës së përjetshme, ju duhet të zhvilloni një traditë të studimit të ungjillit (shih DeB 131:6). Tradita e studimit që zhvilloni si misionar do t'ju bekojë ju personalisht, si edhe njerëzit që mësoni, të rriten në besimin e tyre te Shpëtimtari.

Studimi ditor efektiv duhet të fillojë gjithmonë me lutje. Studimi është një akt besimi që kërkon përdorimin e lirisë së zgjedhjes personale. Shumë misionarë e kanë të vështirë të kuptojnë si mund të studiojnë efektivisht. Disa mbështeten fort tek të tjerët, ose në programe të gatshme, për t'u treguar se çfarë dhe si të studiojnë. Megjithëse të mësosh nga një mësues i mirë është shumë e rëndësishme, është akoma më e rëndësishme që të keni përvoja kuptimplote të të mësuarit individual. Arritja e rezultateve të mira nga studimi juaj varet nga dëshira e fortë që keni për të mësuar, për të studiuar me “qëllim

## Shënime

të vërtetë” (Moroni 10:4), “[duke qenë] të uritur dhe të etur për drejtësi” (Mateu 5:6) dhe në kërkimin e përgjigjeve për pyetjet dhe shqetësimet e ngritura nga kërkuesit tuaj.

**Aktivitet: Studim Individual**

Shikoni pikturën e Jozef Smithit në faqen e mëparshme. Lexoni Joseph Smith—Historia 1:11–13. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme në ditarin e studimit.

- Si e ndihmoi Jozef Smithin leximi dhe meditimi mbi Jakobi 1:5 për të marrë zbulësë?
- Çfarë ndikimi pati studimi i tij për brezat e ardhshëm?
- Çfarë ndikimi ka patur në jetën tuaj vendimi i tij për të studiuar dhe kërkuar?
- Si ka ndikuar studimi i ungjillit në jetën tuaj?

**Studim i Shkrimeve të Shenjta**

**Në ç'mënyrë do Zoti që ne ta trajtojmë studimin e ungjillit?**

2 Nefi 4:15–16

DeB 58:26–28

DeB 88:118

2 Nefi 32:3

**Të mësuarit nëpërmjet Frymës së Shenjtë**

Studimi i ungjillit është më efektiv kur ju mësoheni nga Fryma e Shenjtë. Gjithmonë, fillojeni studimin e ungjillit duke u lutur që Fryma e Shenjtë t'ju ndihmojë të mësoni. Ai do t'ju japë njohuri dhe bindje të cilat do të bekojnë jetën tuaj dhe do t'ju lejojë të bekonin jetën e të tjerëve. Besimi juaj në Jezu Krisht do të rritet. Dëshira juaj për t'u penduar dhe për t'u përmirësuar do të rritet.

Kjo mënyrë studimi ju përgatit për shërbim, ofron ngushëllim, zgjidh problemet dhe ju jep forcën për të duruar deri në fund. Studimi i suksesshëm i ungjillit kërkon dëshirë dhe veprim. “Pasi, ai që kërkon me zell do të gjejë dhe misteret e Perëndisë do t'u shpalosen nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, po aq mirë në këto kohë sa në kohët e vjetra” (1 Nefi 10:19). Ashtu si dhe Enosi, ndërsa ju jeni të uritur të njihni fjalët e jetës së përjetshme dhe i lejoni këto fjalë të “[hyjnë] thellë në zemrën [tuaj]” (Enos 1:3), Fryma e Shenjtë do t'ua hapë mendjen e zemrën ndaj një drite dhe kuptimi më të madh.

Mësimi i ungjillit është gjithashtu një proces i marrjes së zbulësës (shih Jakobi 4:8 LiM). Zoti i tha Oliver Kaudërit se ai nuk e kishte kuptuar, se ai kishte menduar se Zoti do t'i jepte këtë aftësi, kur ai nuk ish menduar aspak, përveçse t'i kërkonte Atij. Zoti i kërkoi Oliverit ta studionte atë në mendjen e tij dhe pastaj ta pyeste Atë nëse ishte e drejtë. Nëse ishte e drejtë, Zoti do të bënte që Oliverit t'i digjej kraharori përbrenda, që kështu ai ta kuptonte se ishte e drejtë (shih DeB 9:7–8). Ndërsa studioni, kushtojini vëmendje të kujdesshme ideve që ju vijnë në mendje dhe ndjenjave që ju vijnë në zemër, veçanërisht ato ndjenja dhe mendime që kanë lidhje me njerëzit që po mësoni.





**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Cili është roli i Frymës së Shenjtë për të na ndihmuar të mësojmë ungjillin?**

2 Nefi 32:5

DeB 11:12–14

Gjoni 16:13

Alma 5:45–46

DeB 39:5–6

1 Korintasve 2:9–14

Moroni 10:5

Gjoni 14:26

**Jetoni Sipas Asaj që Mësoni**

Ndërsa ndieni gëzimin që vjen nga të kuptuarit e ungjillit, ju do të ndieni dëshirën për ta zbatuar atë që mësoni. Përpiquni të jetoni në harmoni me botëkuptimin tuaj. Duke e bërë këtë do të forconi besimin, njohurinë dhe dëshminë tuaj. Të vepruarit sipas asaj që keni mësuar do t'ju sjellë një kuptim të ri dhe të qëndrueshëm (shih Gjoni 7:17).

Ndërsa mblihdni vazhdimisht si thesar fjalët e shkrimeve të shenjta dhe të profetëve të ditëve të mëvonshme me anë të studimit dhe besimit, dëshira juaj për të ndarë ungjillin do të rritet. Juve ju është premtuar se Shpirti do t'ju ndihmojë të dini se çfarë të thoni kur të jepni mësim. Zoti ka thënë se ndërsa mbledhim vazhdimisht si thesar në mendjet tona fjalët e jetës, Ai do të na japë në çastin e duhur atë pjesë që do t'i shpërndalet çdo njeriu (shih DeB 84:85).

*“Doktrina e vërtetë, kur kuptohet, ndryshon qëndrime dhe sjellje... Studimi i doktrinave të ungjillit do të përmirësojë sjelljen më shpejt se sa një studim i sjelljes do të përmirësojë sjelljen.”*

– PRESIDENTI BOID K. PAKER  
“LITTLE CHILDREN,” *ENSIIGN*, 17 NËNTOR 1986

**Studim i Shkrimit të Shenjtë****Çfarë na mësojnë shkrimet e shenjta rreth të mësuarit të ungjillit?**

1 Nefi 10:17–19

DeB 50:19–22

DeB 88:118

DeB 11:21–22

**Studimi dhe Përgatitja për të Dhënë Mësimet**

Mësimet (që gjenden në kapitullin 3) përmbajnë pyetjet e intervistës së pagëzimit, zotimet dhe doktrinën që ju do t'ju mësoni të tjerëve. Në mësimet ju gjithashtu do të gjeni ide të dobishme për mësimdhënien. Megjithatë, mësimet nuk do t'ju tregojnë gjithçka që duhet të thoni—ose si ta thoni atë. Përkundrazi, ju jeni përgjegjës t'i kuptoni plotësisht mësimet dhe të mësoni nëpërmjet Shpirtit me fjalët tuaja. Mësoni në mënyrë të tillë që të tjerët ta forcojnë besimin e tyre në Jezu Krisht, të kenë dëshirë të pendohen dhe të bëjnë besëlidhje me Perëndinë.

Mësuesit efektivë gjithnjë punojnë për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Megjithatë ju nuk do t'ju mësoni të tjerëve gjithçka që dini rreth doktrinës, njohuria juaj në rritje do të ndërtojë dëshminë dhe aftësinë tuaj për t'i mësuar të tjerët me fuqi shpirtërore. Ju do të dini se po i përdorni mësimet siç duhet kur ju:

- Kërkoni dhe ndiqni Shpirtin ndërsa përgatitni dhe jepni mësimet.
- Përpiquni të studioni në mënyrë të vazhdueshme, të mblihdni si thesar dhe të zbatoni doktrinën në jetën tuaj.

## Shënime

- Punoni me shokun/shoqen tuaj për të bërë plane specifike për çdo person që mësoni.
- Përqendrohuni në mesazhet dhe doktrinat qendrore gjatë mësimdhënies.
- E përshtatni rendin, kohëzgjatjen dhe ecurinë e mësimëve në mënyrë që të plotësoni nevojat e atyre që po mësoni.
- Mësoni shpesh nga shkrimet e shenjta me qartësi dhe bindje.
- Dëshmoni shpesh.
- Ndhmoni të tjerët të marrin dhe të mbajnë zotime që çojnë në pagëzim dhe konfirmim.

Bërja e këtyre gjërave do t'ju mundësojë t'i ndihmoni të tjerët të fitojnë një dëshmi për ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit.

Ndërsa filloni misionin tuaj, do t'ju duhet të mësoni organizimin e mesazhit dhe të fitoni aftësitë e nevojshme të mësimdhënies. Ndërsa fitoni përvojë, do të kërkonti të thelloni njohuritë dhe të përmirësoni aftësitë tuaja të mësimdhënies. Ndërsa përgatiteni për takimë mësimi, ju do të doni të keni një plan mësimi që ju jep mundësi të jepni mësim me anë të Shpirtit dhe t'i ndihmoni të tjerët të marrin dhe të mbajnë zotimet. Udhëzimet e mëposhtme janë sugjerime që ju mund t'i zbatoni gjatë gjithë misionit tuaj. Megjithatë, mos u ndieni të detyruar të përdorni çdo udhëzim në çdo rrethanë. Përkundrazi, zbatojni këto udhëzime në mënyrë të tillë që të përmbushni nevojat tuaja dhe ashtu siç ju drejton Shpirti. Nëse po mësoni një gjuhë të re, zbatojni këto udhëzime në fillim në gjuhën tuaj dhe pastaj në gjuhën e misionit tuaj.

- **Përqendrohuni mbi zotimet dhe pyetjet e intervistës së pagëzimit.** I mësoni njerëzit në mënyrë të tillë që ata të marrin zotime dhe të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim. Kuptoni pyetjet e intervistës së pagëzimit dhe zotimet për çdo mësim. Mësoni se çfarë duhet të dijë, të ndiejë, dhe të bëjë dikush, si rrjedhim i atyre që ju i mësoni. Punoni me shokun/shoqen tuaj që t'i shpjegoni këto parime me fjalët tuaja me qartësi dhe fuqi.
- **Mësoni dhe zbatoni doktrinën.** Doktrina është baza e mësimi. Me lutje studioni shkrimet e shenjta, mësimin, broshurat, "Ide për Mësimdhënien" dhe bibliotekën e misionarit për të fituar një kuptim të qëndrueshëm të doktrinës. Kërkonti material që mbështet doktrinën e mësimi. Mbani mend rrjedhën e parimeve doktrimore. Zbatoni atë që mësoni. Shkruani atë çfarë mësoni në ditarin e studimit. Ndani atë çfarë mësoni, me misionarë të tjerë.
- **Organizoni e përmbliidni se çfarë do të mësoni.** Që të përgatiteni t'ua mësoni të tjerëve doktrinën me qartësi e fuqi shpirtërore, organizoni e përmbliidni në një plan mësimor, atë që do të mësoni. Përqendrohuni mbi doktrinën, pyetjet e intervistës së pagëzimit dhe zotimet e mësimëve. Pasurojeni planin mësimor me shkrime të shenjta, pyetje dhe shembuj. Këto duhet të ndryshojnë në varësi të kohëzgjatjes së takimeve tuaja të mësimdhënies. Ju nuk duhet të krijoni një plan tërësisht të ri për çdo kërkues, por duhet ta pasuroni vazhdimisht planin tuaj mësimor e ta modifikoni në përshtatje me nevojat e atyre që u jepni



mësim. Kur hartoni për herë të parë një plan mësimor, përpquni të jeni të thjeshtë e koncizë. Pasurojeni planin mësimor ndërsa fitoni më tepër përvojë.

- **Përqendrohuni mbi nevojat.** Megjithëse doktrinat e ungjillit janë për këdo, ju duhet ta përshtasni mësimdhënien tuaj në mënyrë që të plotësojë nevojat e atyre që ju mësoni. Ndërsa studioni doktrinën dhe hartoni plane mësimore, identifikoni pika ku mund ta përshtasni mënyrën e mësimdhënies për të plotësuar nevoja të mundshme. Rishikojini dhe përsosini këto përshtatje ndërsa përgatiteni për takime të veçanta. Përcaktoni ftesat që do t'u bëni të tjerëve. Përqendrohuni në qëllimin final për t'i ndihmuar ata që mësoni të marrin ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit me anë të pagëzimit dhe të konfirmimit.
- **Përgatituni t'u përgjigjeni pyetjeve.** Si një misionar, ju do të dëgjoni shumë pyetje. Shënojeni këto pyetje në ditarin tuaj të studimit. Kërkoni në shkrimet e shenjta dhe në materiale të tjera për të gjetur përgjigjet. Lutuni që t'i kuptoni. Shënojeni përgjigjet në ditarin tuaj të studimit. Rishikojini ato që keni gjetur me misionarët e tjerë. Shtoni pyetjet më të shpeshta dhe përgjigjet e tyre në ditarin tuaj të studimit që të mund t'i referoheni më vonë.
- **Mësimdhënia.** Mësimdhënia është një mundësi e fuqishme për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë tuaja. Ndërsa mësoni doktrinën dhe organizoni plane mësimore, mësoni shokun/shoqen tuaj dhe misionarët e tjerë. Provoni shpjegime, mënyra komunikimi, përvoja, pyetje dhe mënyra të reja për t'i ftuar të tjerët të marrin zotime. Kërkoni ide dhe sugjerime.
- **Vlerësoni mësimdhënien tuaj.** Pas çdo situatë mësimdhënieje, vlerësoni se sa mirë vepruat. A u përqendruat mbi doktrinën? A i ftuat kërkuesit të pendohen, të marrin zotime dhe t'i mbajnë ato? A punuat për t'i përgatitur ata për pagëzim dhe konfirmim? A përdorët pyetje efektive? A ndatë dëshminë tuaj? A kërkuat rekomandime? Përshtatini planet mësimore ndërsa vazhdoni të përmirësoheni në punën tuaj.

Ndërsa mësoni mësimet, vazhdoni të kërkoni një njohuri të thellë për doktrinën. Punoni aktivisht për t'i mësuar të tjerët me fuqi të madhe. Ndërsa studioni me lutje dhe besim, njohuria dhe dëshmia juaj do të rriten. Sidoqoftë, mos u përpqni t'u mësoni të tjerëve gjithçka që dini. Ua mësoni mesazhin qartë, thjesht dhe të bazuar në nevojat personale, duke ndjekur Shpirtin për t'u mësuar atë pjesë që do t'i shpërndalet çdo njeriu (shih DeB 84:85).

### Përkufizimi i Fjalëve

Ne kemi një mesazh të fuqishëm me një fjalor të veçantë. Ashtu si një mjek flet ndryshe në dhomën familjare të pritjes e ndryshe në sallën e operacionit, kështu edhe ju duhet të mësoni të flisni me ata që nuk janë të familjarizuar me mesazhin tonë, në mënyrë që të kuptojnë çfarë po u mësoni.

Për t'u përgatitur t'i ndihmoni të tjerët të kuptojnë fjalët e panjohura, studioni listën e fjalëve dhe përkufizimeve të rëndësishme në seksionin "Ide për mësimdhënien" të çdo mësimi. Familjarizohuni me përkufizimet e dhëna. Përdorni *Të Vërtetë Ndaj Besimit* dhe Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta për të gjetur përkufizimet e fjalëve të tjera. Shkruajini këto përkufizime në ditarin tuaj të studimit. Diskutojini përkufizimet me shokun/shoqen tuaj dhe të tjerët për të parë nëse i kuptoni saktë. Nëse përkufizimet janë të paqarta për të tjerët, rishikojini përkufizimet tuaja bazuar në materialin që keni studiuar.

## Shënime

Ndërsa jepni mësim, përpikuni të kuptoni nëse një fjalë ose një parim është diçka e re për personin që po mësoni. Merrni kohë të shpjegoni fjalët ose parimet e panjohura. Kujtoni se ju duhet t'i mësoni të tjerët në mënyrë që ata të kuptojnë kështu që vetë ju si edhe ata të cilët ju mësoni të jeni të lartësuar dhe të gëzoheni së bashku (shih DeB 50:22).

**Aktivitet: Studim Individual**

Shkoni tek mësimi "Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit" që gjendet në kapitullin 3. Lexoni listën e përkufizimeve të rëndësishme në seksionin "Ide për Mësimdhënien." Përcaktoni tre fjalë të tjera në mësim që do t'ju pëlqente t'i përkufizonit. Ndiqni sugjerimet e dhëna më lart në krijimin e përkufizimit për secilën fjalë.

**Ide dhe Sugjerime për Studim**

Secila nga idetë dhe sugjerimet në këtë seksion mund ta bëjë kohën e studimit tuaj më frutdhënëse dhe frymëzuese. Merrni parasysh sa më më poshtë ndërsa planifikoni studimin tuaj:

- Gjithmonë filloni me një lutje.
- Planifikoni aktivitete studimi që do të ndërtojnë besimin tuaj te Shpëtimtari dhe përdoreni kohën tuaj me efektshmëri.
- Planifikojeni studimin tuaj rreth njerëzve, nevojave të tyre dhe përgatitjes së tyre për pagëzim, konfirmim dhe durim deri në fund. Shënoni planet tuaj të studimit në planifikuesin tuaj ditor
- Planifikoni studimin duke pyetur: Çfarë do t'u mësoj sot? Si mund ta planifikoj studimin tim për të ndihmuar më mirë ata që po mësoj? Cilat ide dhe sugjerime nga ky seksion do t'i përfshij në studimin tim?

Ndërsa planifikoni aktivitetet tuaja të studimit, eksperimentoni me disa nga idetë dhe sugjerimet e mëposhtme ose me ide të tjera që mësoni nga të tjerët.

**Zbatoni dhe Jetoni Atë që Mësoni**

- "Përshtatni" ato që mësoni me veten tuaj (shih 1 Nefi 19:23).
- Vendosni qëllime të jetoni çka po mësoni.
- Zëvendësoni emrin tuaj në një varg të shkrimit të shenjtë për ta personalizuar atë.
- Pyesni veten: "Si duhet të ndryshoj unë si rezultat i asaj që kam mësuar?" Vendosni qëllime të përshtatshme.

**Aktivitet: Studim Individual**

Zgjidhni një nga referencat e mëposhtme. Ndërsa lexoni dhe meditonin fragmentin e zgjedhur, identifikoni dy ose tre mënyra se si ta zbatoni atë në jetën tuaj.

- 2 Nefi 31
- Alma 32:26–43
- Moroni 7:32–48

Vlerësoni se sa mirë i jetoni parimet që u mësoni të tjerëve. Zgjidhni një mënyrë sipas të cilës mund të përmirësoheni dhe planifikoni ta bëni këtë.

**Kërkoni, Meditoni dhe Kujtoni**

- Jini të vëmendshëm. Stërvituni, lahuni dhe lutuni përpara studimit tuaj.
- Studioni në një tavolinë pune ose tryezë ku mund të shkruani (jo shtrirë ose ndenjor në krevat), organizoni materialet e studimit dhe jini të vëmendshëm.
- Lutuni dhe kërkoni që të mund të kuptoni.
- Studioni sipas një teme të caktuar.
- Pyesni veten: “Çfarë kërkon të thotë autori? Cili është mesazhi kryesor? Si lidhet kjo me mua?”
- Përfytyroni atë që po studioni. Për shembull, përfytyroni si ndihej Amoni kur qëndronte para mbretit Lamanit.
- Studioni fjalët e profetëve të gjallë (në bibliotekën e miratuar të misionarit dhe në revistat e Kishës).
- Shënoni në ditarin tuaj të studimit pyetjet që keni dhe përdorni shkrimet e shenjta, fjalët e profetëve të ditëve të fundit dhe burime të tjera studimi për të gjetur përgjigjet.
- Një varg i vetëm i shkrimit të shenjtë mund të përmbajë disa ide. Nënvizoni dhe shënoni fjalët ose shprehjet që të mund të dalloni ndryshimet ndërmjet ideve në një varg të vetëm.
- Ndani atë që mësoni me misionarët e tjerë. Ju mund të mësoni shumë duke i shpjeguar një doktrinë ose një parim një personi tjetër.
- Nënvizoni shkrimet e shenjta dhe bëni shënime në to. Në anë të fletës shkruani referencat e shkrimeve të shenjta që qartësojnë paragrafët që po studioni.
- Mësoni përmendësh pjesë të shkrimeve të shenjta që shpjegojnë dhe mbështesin parimet që po u mësoni të tjerëve.

**Përdorni Burime Studimi**

- Përdorni materiale ndihmëse studimi në botimin SHDM të shkrimeve të shenjta (krerët e kapitujve, shënimet në fund të fletës, Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta që përmban Përkthimin e Jozef Smithit dhe hartat).
- Përdorni mësimet misionare, bibliotekën e miratuar të misionarit, revistat e Kishës dhe këtë manual.
- Rishikojini krerët e kapitujve në shkrimet e shenjta. Ky rishikim do t’ju japë ide se çfarë të kërkoni në kapitull.
- Përdorni ditarin tuaj të studimit për të shënuar dhe organizuar atë që po mësoni. Rishikoni shpesh mendimet që keni shkruar. Organizojeni ditarin tuaj në mënyrë të tillë që të mund të rikujtoni me lehtësi atë që keni mësuar.
- Përdorni këtë manual si libër pune. Përdorini hapësirat boshe për shënime që të shkruani përshtypjet dhe idetë.
- Studioni fragmentet e shkrimeve të shenjta të renditura në këtë manual. Shënoni në këtë manual ose në ditarin tuaj të studimit fragmente të tjera që keni gjetur nga shkrimet e shenjta.

**Krijoni një Tablo të Gjerë**

- Krijoni një ide të përgjithshme, ose duke i hedhur një sy të shpejtë librit, kapitullit, ose fragmentit ose duke rishikuar krerët e kapitujve. Mundohuni të kuptoni kontekstin ose sfondin e ngjarjes.

## Shënime

- Mundohuni ta shkruani idenë kryesore të fragmentit në një fjali ose paragraf të shkurtër.
- Përdorni hartat e Biblës dhe të historisë së Kishës për të mësuar gjeografinë, distancat, klimën dhe terrenin.
- Rishikoni rrjedhën e ngjarjeve dhe kulturat. Lexoni informacionin historik në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta dhe në përmbledhjen e kapitujve dhe të seksioneve.

**Aktivitet: Studim Individual**

Lexoni përmbledhjet e kapitujve të librave të mëposhtëm dhe shkruani një përshkrim të shkurtër që tregon kohën dhe vendin e ngjarjeve, ngjarjet kryesore dhe doktrinat kryesore të çdo libri.

1 Nefi

Moisiu

Veprat e Apostujve

**Shqyrtoni Hollësitë**

- Kërkoni fjalët kyçe dhe sigurohuni që ta kuptoni domethënien e tyre. Përdorni shënimet në fund të fletës, Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta, ose ndonjë fjalor tjetër për përkufizimet. Studioni fjalët apo frazat përreth për të krijuar ide rreth domethënies së fjalëve kyçe.
- Shikoni fjalët lidhëse si: kështu që, dhe përsëri, kështu, si rrjedhim dhe të tjera. Më pas shikoni se si fragmentet paraardhëse dhe ato pasardhëse lidhen me njëri-tjetrin.
- Përdorni Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta për të parë se si e njëjta fjalë është përdorur në kontekste të ndryshme apo se si profetë të ndryshëm e përdorin të njëjtën fjalë.
- Shikoni për fjalët apo frazat e panjohura dhe sigurohuni që t'i kuptoni ato.

**Nënvizimi i Shkrimeve të Shenjta**

Nënvizimi i shkrimeve të shenjta mund t'ju ndihmojë të thelloheni rreth një fragmenti ose doktrine të ungjillit. Ju mund t'i nënvizoni shkrimet tuaja të shenjta në mënyra të ndryshme. Gjeni një mënyrë të përshtatshme për ju. Më poshtë gjenden disa udhëzime për nënvizimin e shkrimeve të shenjta.

- Përdorni lapsa ose shënues me ngjyra. Eliminoni përdorimin e stilolapsave që u del boja nga ana tjetër e fletës.
- Hijezoni, nënvizoni, futni në kllapa, ose vijezoni anash pjesë të një vargu, një varg të tërë, ose një grup vargësh.
- Mënjanoni shënimet e mbingarkuara. Nuk ka përfitim nëse ju nuk do të kuptoni se çfarë keni shënuar, duke qenë se keni bërë shënime, vija dhe ngjyrosje të shumta.
- Nënvizoni vetëm disa fjalë kyçe për ta vënë në dukje vargun, seksionin ose kapitullin.
- Rrethoni ose nënvizoni fjalë kyçe, dhe pastaj përdorni vija të drejta për të bashkuar fjalët që lidhen ngushtë me njëra-tjetrën.
- Kur një varg pikash brenda një vargu ose paragrafi kanë lidhje me njëra-tjetrën, i renditni këto pika me numra në anë të fletës apo tekstit.
- Përdorni shënimet në fund të faqes si një burim për të nënvizuar dhe interpretuar shkrimet e shenjta.
- Vendosni një simbol (si një shenjë të tillë ✓ kontrolli) në anë të fletës për vargje kyçe që ju mendoni se janë të rëndësishme për t'u kujtuar.

Nënvizimi i shkrimeve të shenjta duhet t'ju ndihmojë të përqendroheshi në zbatimin e asaj që mësoni dhe në mësimin e të tjerëve. Zhvilloni një mënyrë mësimdhënieje që është konsekuente dhe që ju ndihmon të përmbushni qëllimin tuaj si misionar.

#### Aktivitet: Studim Individual

Cilat sugjerime nuk keni provuar ende? Identifikoni një sugjerim nga "Ide dhe Sugjerime për Studim" për ta provuar gjatë sesionit të ardhshëm të studimit individual apo studimit me shokun.

#### Mbani Mend

- Ndjekja e dëshirës për të mësuar është e rëndësishme për shpëtimin tuaj dhe suksesin tuaj si misionar.
- Ju e mësoni ungjillin me anë të studimit, besimit dhe fuqisë së Frymës së Shenjtë.
- Mësimi është gëzim dhe sjell shumë bekime.
- Studimi ditor individual dhe studimi me shokun forcon besimin dhe aftësinë tuaj për t'i mësuar të tjerët nëpërmjet Shpirtit.
- Përdorni një shumëllojshmëri mënyrash studimi që e bëjnë këtë përvojë të këndshme dhe kuptimplotë.

Shënime

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Vlerësojeni veten sipas këtij vlerësimi (1 = kurrë, 3 = ndonjëherë dhe 5 = pothuajse gjithmonë).
  - Kur studioj unë mendoj për njerëzit që po mësoj.
  - Gjatë gjithë ditës mendoj rreth asaj që studiova në mëngjes.
  - Ndërsa studioj, më vijnë në mendje ide që nuk i kam pasur më parë.
  - Unë i shënoj përshtypjet shpirtërore dhe idetë në një vend të përshtatshëm.
  - Më zë gjumi duke studiuar.
  - E pres me padurim studimin personal.
  - E pres me padurim studimin me shokun.

Rishikoni përgjigjet tuaja. Çfarë po bëni mirë? Do të donit që ndonjë nga përgjigjet tuaja të ishte ndryshe? Vendosi një ose dy qëllime që do të përmirësojnë cilësinë e studimit tuaj.

- Rishikoni pyetjet që gjenden në pjesën “Mbani Parasysh” në fillim të këtij kapitulli. Si ndikojnë këto pyetje në studimin tuaj?
- Rishikoni “Ide dhe Sugjerime për Studim.” Identifikoni një sugjerim nga çdo kategori që nuk keni përdorur dhe provojini këto ide gjatë studimit tuaj individual.
- Lexoni Doktrina e Besëlidhje 138:1–11. Ndërsa lexoni këto vargje përgjigjiuni pyetjeve të mëposhtme:
  - Çfarë iu desh të bënte Presidentit Smith që mendja e tij të hapet?
  - Si u ndie ai rreth doktrinës për të cilën po mendonte?
- Lexoni përkufizimin e njohurisë në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta dhe referencat e renditura. Në ditarin tuaj të studimit, shkruani një përgjigje të pyetjes “Çfarë njohurie mund të më ndihmojë që të shërbej efektivisht si misionar?”
- Zgjidhni një doktrinë nga kapitulli 3 që do të donit ta kuptonit më mirë. Shënoni në ditarin tuaj të studimit pyetjet që do të donit t’u përgjigjeshit. Studiojeni me kujdes atë doktrinë për një farë kohe (disa ditë) dhe lutuni veçanërisht që ta arrini ta kuptoni më mirë atë. Shkruani atë që mësoni.
- Lexoni 1 Nefi 10:17; 11:1–6. Ndërsa lexoni këto vargje, përgjigjuni pyetjes “Pse Nefi mundi të mësonte atë që dinte i ati?”

### Studim me Shokun

- Lexoni së bashku paragrafët që vijojnë. Përgjigjuni pyetjes “Pse duhet të kërkojmë dritë hyjnore?”

DeB 11:11–14

Gjoni 8:12

Psalmet 119:105

DeB 84:43–47



- Lexoni së bashku disa nga paragrafët e mëposhtme dhe diskutoni bekimet që vijnë nga të studiuarit e fjalës së Perëndisë. Cilat paragrafë do t'i ndihmojnë më mirë ata që ju mësoni?

1 Nefi 10:19	Alma 37:44–46	Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta. “Shkrime të Shenjta,” nëntitull: “Vlera e shkrimeve të shenjta,” 179–180
2 Nefi 32:3	Alma 49:30	
Mosia 1:6–7	DeB 90:24	
Alma 17:2–3	DeB 130:19	
Alma 32:42–43		

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Zgjidhni një temë nga një prej mësimëve misionare që keni studiuar me kujdes. Bëni sa më poshtë:
  - Diskutoni dy ose tre prej çështjeve më kryesore nga studimi juaj që ishin me vlerë në dhënien e atij mësimi.
  - Përshkruani mënyrën e studimit që ju ndihmoi të zbulonit këto pika (ç’mënyrë leximi ndoqët, burimet që përdorët, pyetjet për të cilat po studionit dhe kështu me radhë).
  - Tregoni si i shënuat dhe organizuat rezultatet e studimit tuaj.

Nëse e lejon koha, kërkoni disa misionarëve të tjerë të bëjnë të njëjtën gjë.

- Ky aktivitet mund të bëhet individualisht ose në grupe të vogla. Udhëzoni misionarët të zgjedhin një nga pyetjet e mëposhtme (ose ju mund të krijoni vetë disa pyetje). U kërkoni atyre ta shkruajnë pyetjen.

– Pse janë familjet kaq të rëndësishme në planin e Perëndisë?

– Pse njerëzit kanë sprova dhe vuajtje?

– Cili është roli i Shpirtit në kthimin në besim?

U shpjegoni atyre se do të kenë pesë deri në shtatë minuta që:

– Të gjejnë të paktën dy referenca nga shkrimet e shenjta që i përgjigjen pyetjes.

– Të shkruajnë një interpretim të thjeshtë se si shkrimet e shenjta që ata zgjodhën i përgjigjen pyetjes.

– Të përshkruajnë çfarë duhet të bëjnë që ta mbajnë mend përgjigjen.

– Të përshkruajnë çfarë duhet të bëjnë për ta studiuar pyetjen më thellësisht.

Ftoni disa misionarë (ose secilin grup) të ndajnë përgjigjet e tyre. Diskutoni përgjigjet e tyre.

- Kërkoni misionarëve të shkruajnë një ose dy pyetje rreth parimeve dhe doktrinave të ungjillit që gjenden në njërin prej mësimëve në kapitullin 3 për të cilat ata do të dëshironin të gjenin një përgjigje. Ftojini misionarët të diskutojnë pyetjet e tyre me grupin. Për secilën nga pyetjet, diskutoni sa më poshtë:

– Si do ta bekojë jetën e një misionari përgjigja e kësaj pyetjeje?

– Si do ta bekojë kjo jetën e kërkuesve?

– Si mund ta gjejë përgjigjen një misionar?

### Shënime

- Kërkojuni disa misionarëve të ndajnë një parim ungjilli që shokët/shoqet e tyre u kanë mësuar. Kërkojuni të shpjegojnë parimin dhe se si shoku/shoqja i/e tyre ua mësoi atë.
- Organizojini misionarët në dyshe ose në grupe të vogla. I caktoni secilit grup të lexojë një kapitull nga Libri i Mormonit. I kërkonte çdo grupi të zgjedhë një ide nga secila prej pesë kategorive në seksionin “Ide dhe Sugjerime për Studim.” Ftojini grupet të zbatojnë secilin sugjerim ndërsa lexojnë kapitullin e tyre së bashku. Lini 15 deri në 20 minuta për lexim dhe diskutim. I kërkonte çdo grupi të shpjegojë sugjerimet që përdorën, sa mirë funksionuan sugjerimet dhe çfarë mësuan.
- Ftoni çdo misionar të mendojë për një histori ose ngjarje nga shkrimet e shenjta që është domethënëse për të (si p.sh. vegimi i Lehit për pemën e jetës, predikimi i mbretit Beniamin, Predikimi në Mal, ose shfaqja e Krishtit Nefitëve). Ftojini misionarët të skicojnë apo të përshkruajnë se si ata i përfytyrojnë tregimet që kanë zgjedhur. Ftoni dy ose tre misionarë të ndajnë çfarë përfytyrojnë. Kërkojuni të tjerëve të tregojnë histori e t'i lidhin ato me doktrinat që gjenden në njërin prej mësimëve. Lexoni Moroni 10:3 dhe diskutoni vlerën që ka meditimi i thellë rreth njohurisë shpirtërore.

### Presidenti i Misionit

- Ftojini misionarët që të sjellin në intervista ditarin e studimit. I ftoni ata të ndajnë me ju një nga shënimet e tyre.
- Gjatë intervistave, bëni disa nga pyetjet e mëposhtme:
  - Çfarë mbresash keni patur kohët e fundit gjatë studimit të shkrimeve të shenjta?
  - Cili është një parim i ungjillit që shoku/shoqja juaj ju ka mësuar kohët e fundit?
  - Cili kapitull apo seksion i këtij manuali ju ka ndihmuar më shumë gjatë dy javëve të fundit?
  - Çfarë bëni ju në studimin individual që ju ndihmon të mësoni më shumë?
- Gjatë konferencave të zonës, ftojini misionarët të ndajnë përvoja kuptimplote që kanë pasur gjatë studimit individual dhe studimit me shokun.
- Gjatë konferencave të zonës, u jepni mundësi misionarëve të ndajnë ide nga Studim Individual.
- Ndani me misionarët ide që keni pasur gjatë studimit tuaj individual. Ndani shënimet nga ditari juaj i studimit dhe dëshminë tuaj për rëndësinë e studimit të ungjillit.
- Sipas mundësisë, merrni pjesë në studimin e tyre me shokun/shoqen.
- Gjatë intervistave, ftojini misionarët të ndajnë një nga planet e tyre mësimore për njërin prej mësimëve misionare. Pyetini ata se ç'kuptim kanë për ta këto doktrina.



# Çfarë Duhet të Studioj dhe t'u Mësoj të Tjerëve?

**M**ësimet në këtë kapitull përmbajnë doktrinat bazë, parimet dhe urdhërimet që ju duhet t'i studioni, besoni, doni, jetoni dhe t'ua mësoni të tjerëve. Ato janë çfarë profetët dhe apostujt e gjallë ju kanë udhëzuar për t'ua mësuar të tjerëve. Ato janë organizuar në mënyrë të tillë që ju të mund t'i ndihmoni të tjerët të kuptojnë me qartësi doktrinat e Krishtit.

Mësimet në këtë kapitull janë:

- Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit
- Plani i Shpëtimit
- Ungjilli i Jezu Krishtit
- Urdhërimet
- Ligjet dhe Ordinancat

Jepni katër mësimet e para, përpara pagëzimit. Sigurohuni që ata që ju mësoni të plotësojnë kërkesat për pagëzim dhe konfirmim duke marrë dhe mbajtur të gjitha zotimet në këto mësimet.

Misionarët me kohë të plotë janë ata që kryesojnë dhënien e mësimëve përpara pagëzimit me ndihmën e misionarëve të lagjes dhe të anëtarëve të tjerë. Pas pagëzimit, anëtarëve të rinj u mësohen përsëri katër mësimet e para, si edhe "Ligjet dhe Ordinancat." Udhëheqësit e lagjes përcaktojnë nëse misionarët e lagjes ose misionarët me kohë të plotë do të kenë përgjegjësinë për t'u siguruar që këto mësimet të jepen si dhe për sa kohë misionarët me kohë të plotë duhen përfshirë në këto mësimet. Nxisni çdo anëtar të ri të mbajë të gjitha zotimet në këto mësimet.

Ju duhet gjithashtu t'i përdorni këto mësimet gjatë studimit individual dhe studimit me shokun, në mbledhjet e distriktit dhe në situata të tjera trajnimi. Ndërsa studioni shkrimet e shenjta dhe mblidhni si thesar në mendjet tuaja doktrinat që gjenden në këto mësimet,

Shënime

Shpirti do t'ju japë në kohën e duhur atë që duhet të thoni dhe të bëni, për t'i ndihmuar të tjerët të marrin dëshminë e vërtetësisë së këtyre mësimëve.

Si një misionar ju keni një përgjegjësi të madhe t'i mësoni të tjerët nga zemra dhe nëpërmjet Shpirtit. Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve deklaroi: "Qëllimi ynë është që të mësojmë mesazhin e ungjillit të rivendosur në mënyrë të tillë që ta lejojmë Shpirtin të drejtojë si misionarët ashtu edhe njerëzit që ata mësojnë. Është e rëndësishme që të mësohen konceptet e [mësimëve] standarde të misionarëve, por ato nuk duhen mësuar përmendësh. Misionari duhet të ndihet i lirë të përdorë fjalët e tij ashtu siç nxitet nga Shpirti. Ai nuk duhet të paraqesë një recitim të cilin e ka mësuar përmendësh, por të flasë nga zemra me fjalët e veta. Ai mund ta devijojë rendin e mësimëve, duke dhënë atë që ai është i frymëzuar të thotë, sipas interesit dhe nevojave të kërkuesve. Duke folur nga bindja e tij personale dhe me fjalët e veta ai duhet të dëshmojë për vërtetësinë e mësimëve të tij" ("Deklaratë rreth Punës Misionare," letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002). Kur ju dhe shoku juaj studioni këto mësimë dhe përgatiteni të jepni mësim, ngulitni në mendje këto udhëzime. Sigurohuni që t'i mësoni të gjitha doktrinat që gjenden në këto mësimë.

Përveç rasteve kur drejtoheni nga Shpirti, për secilin nga tre mësimet e para, ju duhet të jepni përmbajtjen e plotë sipas renditjes në të cilën ato janë shkruar. Disa nga urdhërimet mund të përfshihen gjithashtu si të përshtatshme ose mund të mësohen si mësimë më vete.

Çdo mësim paraqet intervistën e pyetjeve të pagëzimit, zotimet dhe doktrinat që ju duhet t'ua mësoni të tjerëve. Studiojini doktrinat me themel. Vazhdimisht përqendrohuni në përpjekjen për t'i ndihmuar ata që mësoni, të marrin dhe të mbajnë zotime. Përdorni pyetjet e intervistës së pagëzimit për t'i përgatitur ata që mësoni për pagëzim dhe konfirmim. Mësimet gjithashtu përmbajnë ide për mësimdhënie. Përdorini këto sugjerime që ta përforconi mënyrën e përgatitjes dhe të mësimdhënies.

#### Roli i të Mësuarit Përmendësh

Mësoni përmendësh shkrime të shenjta për t'i përdorur gjatë mësimdhënies. Mbani mend rrjedhën e pikave doktrinale në secilin prej mësimëve misionare. Misionarët që po mësojnë një gjuhë të huaj duhet ta përqendrojnë studimin e gjuhës së huaj në përgatitjen për dhënien e mësimëve misionare. Ata duhet të mësojnë përmendësh fjalorin, frazat, strukturën e fjalisë dhe fjali të shkurtra që shprehin doktrinën ashtu siç gjenden në mësim, por vetëm pasi këto të marrin një kuptim personal për ta. Mos mësoni përmendësh të gjithë mësimin.

#### I Mësoni të Tjerët me Qartësi

Në fund të tre mësimëve të para gjendet një listë fjalësh që mund të jenë të panjohura për ata që ju mësoni. Mësoni si t'i përkufizoni thjesht këto fjalë. Ndërsa jepni mësim, bëni gjithçka mundni për ta bërë mesazhin të lehtë për t'u kuptuar.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Çfarë ju udhëzohet t'ua mësoni të tjerëve?

Mosia 18:18–20

DeB 43:15–16

DeB 52:9

##### Pse duhet t'i studioni doktrinat që gjenden në mësimë?

Alma 17:2–3

DeB 84:85

# Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit

Shënime



© 1991 Greg K. Olsen. Mësonet fotografimi.

## Qëllimi Juaj

Ndërsa mësoni kërkuesit, përgatitini ata të plotësojnë kërkesat për pagëzim që na mësohen në Doktrina e Besëlidhje 20:37 dhe në pyetjet e intervistës së pagëzimit. Kjo arrihet më mirë duke i ftuar kërkuesit tuaj të marrin dhe të mbajnë zotimet e renditura më poshtë.

### Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit

- A besoni ju se Perëndia është Ati ynë i Amshuar?
- A besoni ju se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës?
- A besoni ju se Kisha dhe ungjilli i Jezu Krishtit u rivendosën nëpërmjet Profetit Jozef Smith?
- A besoni ju se [Presidenti aktual i Kishës] është një profet i Perëndisë? Ç'do të thotë kjo për ju?

### Zotimet

- A do të lexoni dhe a do të luteni që të dini se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë?
- A do të luteni që të dini se Jozef Smithi ishte një profet?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime të tjera nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

## Perëndia Është Ati Ynë i Dashur Qiellor

Perëndia është Ati Ynë Qiellor. Ne jemi fëmijët e Tij. Ai ka një trup prej mishi dhe kockash që është i lavdëruar dhe i përsosur. Ai na do. Ai vajton me ne kur vuajmë dhe gëzohet kur bëjmë çfarë është e drejtë. Ai dëshiron të komunikojë me ne dhe ne mund të komunikojmë me Të nëpërmjet lutjes së singertë.

Ai na ka dhënë këtë përvojë në tokë që ne të mund të mësojmë dhe të rritemi. Ne mund ta tregojmë dashurinë tonë për Të nëpërmjet zgjedhjeve dhe bindjes tonë ndaj urdhërimeve të Tij.

Ati Qiellor na ka dhënë ne, bijve të Tij, një mënyrë për të qenë të suksesshëm në këtë jetë dhe për t'u kthyer të jetojmë në praninë e Tij. Por, ne duhet të jemi të dëlirë dhe të

pastër me anë të bindjes në mënyrë që ta arrijmë këtë. Mosbindja na largon prej Tij. Qendra e planit të Atit tonë është Shlyerja e Jezu Krishtit. Shlyerja përfshiu vuajtjen e Tij në Kopshtin e Gjetsemanit si edhe vuajtjen dhe vdekjen e Tij në kryq. Me anë të shlyerjes ne mund të çlirohemi nga barra e mëkateve tona dhe të zhvillojmë besim dhe forcë për t'i bërë ballë sprovave tona.

#### Besimi rreth Perëndisë

Përcaktoni çfarë kupton secili nga personat që po mësoni në lidhje me besimet e krishtere rreth Perëndisë. Shumë njerëz në botën e sotme ose nuk kanë asnjë koncept për Perëndinë ose kanë një perceptim shumë të ndryshëm për Hyjninë.

Dy misionarë të Librit të Mormonit, Amoni dhe Aaroni, mësuan njerëz të cilët nuk kishin një prejardhje të krishterë. Ata u mësuan atyre të vërteta të thjeshta dhe i ftuan kërkuesit e tyre të luteshin. Lamoni dhe babai i tij u kthyen në besim. Lexoni Alma 18:24–40 dhe 22:4–23 dhe përgjigjuni pyetjeve më poshtë:

- Çfarë u mësuan njerëzve këta misionarë për natyrën e Perëndisë?
- Si mund ta ndiqni ju shembullin e tyre?

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Cila është natyra e Perëndisë Atit dhe Jezu Krishtit?

1 Nefi 17:36	3 Nefi 27:13–22	Gjoni 3:16–17
2 Nefi 9:6	DeB 38:1–3	Veprat e Apostujve 17:27–29
Mosia 4:9	DeB 130:22	Romakëve 8:16
3 Nefi 12:48	Moisiu 1:39	Hebrenjve 12:9
3 Nefi 14:9–11	Mateu 5:48	1 Gjoni 4:7–9

### Ungjilli Bekon Familjet

Ungjilli i rivendosur bekon dhe ndihmon bashkëshortët e bashkëshortet, prindërit dhe fëmijët ndërsa ata përpiqen të zhvillojnë marrëdhënie më të forta dhe forcë shpirtërore në familjet e tyre. Këto bekime mund t'i kemi tani dhe në përjetësi. Ungjilli i Jezu Krishtit na ndihmon në lidhje me shqetësimet dhe sfidat aktuale.

Duke qenë se familjet janë shuguruar nga Perëndia, ato janë njësi shoqërore më e rëndësishme tani dhe në përjetësi. Perëndia i ka krijuar familjet për t'i sjellë lumturi fëmijëve të Tij, për t'i lejuar ata të mësojnë parime të sakta në një atmosferë dashurie dhe t'i përgatisë ata për jetën e përjetshme. Shtëpia është vendi më i mirë për të dhënë mësim, për të mësuar dhe për të zbatuar parimet e ungjillit të Jezu Krishtit. Një shtëpi e themeluar mbi parimet e ungjillit do të jetë një vend mbrojtjeje dhe sigurie. Ajo do të jetë një vend ku mund të banojë Shpirti i Zotit, duke i bekuar anëtarët e familjes me paqe, gëzim dhe lumturi. Me anë të profetëve në çdo epokë, duke përfshirë edhe epokën tonë, Perëndia ka zbuluar planin e Tij të lumturisë për individët dhe familjet.

### Ati Qiellor Zbulon Ungjillin e Tij në Çdo Periudhë Ungjillore

Një mënyrë e rëndësishme nëpërmjet së cilës Perëndia tregon dashurinë e Tij për ne është duke thirrur profetë, të cilëve u është dhënë priftëria—fuqia dhe autoriteti dhënë njeriut të veprojë në emrin e Perëndisë për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Profetët e mësojnë ungjillin e Jezu Krishtit me anë të zbulësës. Më pas ata ua mësojnë ungjillin të tjerëve dhe

## Shënime

dëshmojnë për Jezu Krishtin si Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tonë. Mësimet e profetëve gjenden në libra të shenjtë të quajtur shkrime të shenjta.

Plani i Atit tonë për ne, që të jemi të suksesshëm në këtë jetë dhe të kthehemi të jetojmë me Të, quhet ungjilli i Jezu Krishtit, duke pasur Shlyerjen e Jezu Krishtit në qendër të këtij plani. Me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit, ne mund të marrim jetën e përjetshme në qoftë se ushtrojmë besim në Jezu Krisht, pendo kemi, pagëzohemi me anë të zhytjes në ujë për heqjen e mëkateve, marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe durojmë deri në fund. “Kjo është udha; dhe s’ka udhë tjetër dhe as emër të dhënë nën qiell, nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtohet në mbretërinë e Perëndisë. Dhe tani, vini re, kjo është doktrina e Krishtit” (2 Nefi 31:21). Të gjithë njerëzit kanë dhuratën e lirisë së zgjedhjes, që përfshin lirinë për ta pranuar ose për ta flakur ungjillin që na është mësuar nga profetët dhe apostujt. Ata që zgjedhin të binden bekohen, por ata që nuk e përfillojnë, e flakin, ose e shtrembërojnë ungjillin nuk do të marrin bekimet e premtuara të Perëndisë.

Kur njerëzit zgjedhin të shpërfillin, të mos binden, ose të shtrembërojnë ndonjë parim ose ordinancë të ungjillit, kur ata flakin profetët e Zotit, ose kur nuk arrijnë të durojnë deri në fund, ata e largojnë veten nga Perëndia dhe fillojnë të jetojnë në errësirë shpirtërore. Në fund kjo çon drejt një gjendjeje të quajtur braktisje. Kur ndodh një braktisje e përgjithshme, Perëndia e heq autoritetin e Tij të priftërisë për të mësuar dhe për të administruar ordinancat e ungjillit.

Historia biblike ka shënuar shumë raste kur Perëndia u ka folur profetëve dhe gjithashtu tregon shumë raste të braktisjes. Në fund të çdo periudhe të një braktisjeje të përgjithshme, Perëndia ka treguar dashurinë Tij për fëmijët e Tij duke thirrur një profet tjetër dhe duke i dhënë atij autoritet priftërie për të rivendosur dhe për t’u mësuar njerëzve sërish ungjillin e Jezu Krishtit. Në thelb, profeti vepron si një kujdestar për të mbikëqyrur familjen e Perëndisë këtu në tokë. Periudha të tilla kohore të kryesuara nga përgjegjësi profetike janë quajtur periudha ungjillore.



Perëndia ia zbuloi ungjillin e Jezu Krishtit Adamit dhe i dha atij autoritetin e priftërisë. Adami ishte profeti i parë në tokë. Me anë të zbulesës, Adami mësoi mbi marrëdhënien e duhur të njerëzimit me Perëndinë Atin, Birin e Tij Jezu Krisht dhe Frymën e Shenjtë; mbi Shlyerjen dhe Ringjalljen e Jezu Krishtit; si edhe parimet dhe ordinancat e para të ungjillit. Adami dhe Eva ua mësuat fëmijëve të tyre këto të vërteta dhe i nxitën ata të zhvillonin besim dhe të jetonin sipas parimeve të ungjillit në të gjitha aspektet e jetës. Adami u pasua nga profetë të tjerë, por me kalimin e kohës pasardhësit e Adamit e flakën ungjillin dhe ranë në braktisje, duke zgjedhur të jenë të ligj.

Kështu filloi modeli i periudhave ungjillore që përbën pjesën më të madhe të historisë së Dhjatës së Vjetër. Ati Qiellor ua zbuloi ungjillin e Tij me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë profetëve të tillë si Noeut, Abrahamit dhe Moisiut. Secili profet u thirr nga Perëndia për të filluar një periudhë të re ungjillore. Secilit prej këtyre profetëve Perëndia i dha autoritetin e priftërisë dhe i zbuloi të vërteta të përjetshme. Fatkeqësisht, në çdo periudhë ungjillore njerëzit në fund e përdorën lirinë e zgjedhjes për të zgjedhur të flaknin ungjillin dhe më pas ranë në braktisje.

Shënime

**Profetët**

Përcaktoni çfarë kupton personi që ju po mësoni rreth profetëve. Në shumicën e kulturave ka njerëz që besojnë se njerëz të shenjtë ose të frymëzuar marrin një lloj udhëheqje dhe drejtimi nga Hyjnia. Megjithatë, sipas përkufizimit në ungjillin e rivendosur, jo të gjithë individët e frymëzuar janë profetë të Perëndisë. Shpjegoni qartë se Perëndia e vendos mbretërinë e Tij në tokë duke thirrur një profet që të vendosë një periudhë të re ungjillore. Ai i jep atij profeti autoritetin e priftërisë. Më pas profeti i ndihmon njerëzit të kuptojnë marrëdhënien e tyre me Hyjninë, duke përfshirë edhe atë se si mund ta marrin jetën e përjetshme me anë të ungjillit të Jezu Krishtit.

Ju mund të mendoni se si mund të jetë i përshtatshëm diskutimi rreth periudhave ungjillore kur mësoni njerëz që nuk kanë një prejardhje ose kulturë të krishtere. Por ju do të zbuloni se duke treguar shkurtimisht historinë e periudhave ungjillore, do të mund t'i ndihmoni njerëzit të kuptojnë se Perëndia i do fëmijët e Tij dhe se ai është i njëjti dje, sot dhe përgjithmonë.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta**

**Profetët**

Jakobi 4:4, 6 (LiM)  
Mosia 8:13–18

Veprat e Apostujve 10:34–43

Amosi 3:7

**Periudhat Ungjillore**

DeB 136:36–38  
Moisiu 5:4–12,55–59

Moisiu 8:19–30

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Periudhë”

**Shërbesa Tokësore e Shpëtimtarit**

Disa qindra vjet para lindjes së Jezu Krishtit, njerëzit përsëri ranë në braktisje. Por kur Shpëtimtari filloi shërbesën e Tij në vdekshmëri Ai vendosi Kishën e Tij përsëri në tokë.

Ati Qiellor dërgoi Birin e Tij në tokë të shlyejë për mëkatet e mbarë njerëzimit dhe të kapërcejë vdekjen: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin...që bota të shpëtohet prej tij” (Gjoni 3:16–17). Ati ynë Qiellor e dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, të merrte mbi vete, me anë të vuajtjeve të Tij, mëkatet e të gjithë atyre që do të jetonin në këtë tokë dhe të mposhtte vdekjen fizike. Shpëtimtari bëri një sakrificë shlyese të pamasë kështu që nëse ne kemi besim tek Ai, pendohemi, pagëzohemi, marrim Frymën e Shenjtë dhe durojmë deri në fund, ne mund të marrim falje për mëkatet tona dhe të hyjmë e të vazhdojmë në udhën që do të na çojë drejt jetës së përjetshme në praninë e Perëndisë (shih 2 Nefi 31:13–21).



Gjatë shërbesës së Tij tokësore, Shpëtimtari mësoi ungjillin e Tij dhe kreu shumë mrekulli. Ai thirri dymbëdhjetë burra të bëhen Apostujt e Tij dhe vendosi duart e Tij mbi kokat e tyre për t’u dhënë autoritetin e priftërisë. Ai organizoi Kishën e Tij, përmbushi profecinë, u mohua dhe u

kryqëzua. Dhe çfarë është më e rëndësishmja, Ai kreu Shlyerjen. Biri i Perëndisë, Zoti Jezu Krisht, kreu të gjitha ato që Ati i Tij Qiellor e dërgoi të bënte.



Përpara vdekjes dhe Ringjalljes së Shpëtimtarit, Ai u dha Apostujve të Tij autoritetin për të mësuar ungjillin e Tij, për të kryer ordinancat e shpëtimit dhe për të ndërtuar Kishën e Tij në botë.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Nenet e Besimit 1:5  
Mateu 10:1–10

Lluka 6:13  
Gjoni 15:16

Hebrenjve 5:4

## Braktisja e Madhe

Pas vdekjes së Jezu Krishtit, njerëz dashakeqë përndoqën Apostujt dhe anëtarët e Kishës dhe vranë shumë prej tyre. Me vdekjen e apostujve, çelësat e priftërisë dhe autoriteti kryesues i priftërisë u morën nga toka. Apostujt i kishin mbajtur doktrinat e ungjillit të pastra dhe kishin ruajtur kërkesat dhe standardin e denjësisë për anëtarët e Kishës. Pa Apostujt, me kalimin e kohës doktrinat u korruptuan dhe u bënë ndryshime të paautorizuara në organizimin e Kishës dhe të ordinancave të priftërisë, të tilla si pagëzimi dhe dhënia e dhuratës së Frymës së Shenjtë.

Pa zbuluesin dhe autoritetin e priftërisë, njerëzit u mbështetën tek urtësia njerëzore për të interpretuar shkrimet e shenja dhe parimet e ordinancat e ungjillit të Jezu Krishtit. Ide të rreme u mësuan si të vërteta. Shumë nga njohuria e karakterit dhe natyrës së vërtetë të Perëndisë Atit, Birit të Tij Jezu Krisht dhe Frymës së Shenjtë humbi. Doktrinat e besimit në Jezu Krisht, pendimit, pagëzimit dhe dhuratës së Frymës së Shenjtë, u shtrembëruan ose u harruan. Autoriteti i priftërisë dhënë Apostujve të Krishtit nuk gjendej më në tokë. Përfundimisht kjo braktisje çoi në shfaqjen e shumë kishave.

Mbas shumë shekujsh errësire shpirtërore, burra dhe gra kërkues të së vërtetës protestuan kundër praktikave të atëhershme fetare. Ata e kuptuan se shumë nga doktrinat dhe ordinancat e ungjillit ishin ndryshuar ose kishin humbur. Ata kërkuan një dritë më të madhe shpirtërore dhe shumë prej tyre folën për nevojën e një rivendosjeje të së vërtetës. Megjithatë, ata nuk pretenduan se Perëndia i kish thirrur të ishin profetë. Por, ata u përpoqën të reformonin mësimet dhe praktikat që ata besonin se ishin ndryshuar ose korruptuar. Përpjekjet e tyre çuan në krijimin e shumë kishave protestante. Kjo lëvizje Reformiste rezultoi në një vëmendje më të madhe ndaj lirisë fetare, që hapi rrugën për Rivendosjen përfundimtare.

Apostujt e Shpëtimtarit e parashikuan këtë braktisje universale. Ata gjithashtu parashikuan se ungjilli i Jezu Krishtit dhe Kisha e Tij do të rivendoseshin edhe një herë mbi tokë.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

1 Nefi 13

2 Nefi 26:20–21

2 Nefi 28

4 Nefi 1:27

DeB 86:1–3

Mateu 24:9–11

Marku 12:1–9

Veprat e Apostujve 3:19–21

Veprat e Apostujve 20:28–30

Galatasve 1:6–9

2 Thesalonikasve 2:1–12

(PJS vargjet 2, 3, 7–9)

1 Timoteut 4:1–3

2 Timoteut 4:3–4

2 Pjetrit 2:1–2

Amosi 8:11–12

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Braktisje”

*Të Vërtetë ndaj Besimit*, “Braktisje”,  
faqe 26–27

*Our Search for Happiness*, faqe 23–32

*Jesus the Christ*, kapitulli 40,

“The Long Night of Apostasy”

Shënime

## Shënime

## Braktisja e Madhe

Kërkuesit duhet të kuptojnë se një braktisje universale ndodhi pas vdekjes së Jezu Krishtit dhe Apostujve të Tij. Në qoftë se nuk do të kishte pasur braktisje, nuk do të kishte qenë nevoja për një Rivendosje. Ashtu si një diamant i vendosur mbi një kadife të zezë duket më i shkëlqyeshëm, kështu dhe Rivendosja qëndron në kontrast goditës me sfondin e zi të Braktisjes së Madhe. Sipas udhëheqjes së Shpirtit, u mësoni kërkuesve rreth Braktisjes së Madhe duke përfshirë detaje sipas një niveli që u përshtatet nevojave dhe rrethanave të tyre. Qëllimi juaj është t'i ndihmoni ata të kuptojnë nevojën e Rivendosjes së ungjillit të Jezu Krishtit.

## Çështjet Kryesore

- Kisha e Jezu Krishtit është ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe profetëve (shih Efesianëve 2:19–20; 4:11–14). Këta udhëheqës kanë autoritetin hyjnor të priftërisë. Me anë të zbulësës ata drejtojnë punët e Kishës. Ata ruajnë pastërtinë doktrinale, autorizojnë administrimin e ordinancave dhe thërrasin e u japin të tjerëve autoritetin e priftërisë.
- Njerëzit e mohuan dhe e vranë Jezusin dhe Apostujt (shih Mateu 24:9; 1 Nefi 11:32–34; 2 Nefi 27:5). Me vdekjen e Apostujve, autoriteti kryesues i priftërisë u largua nga Kisha. Si pasojë, nuk kishte më autoritet për të dhuruar Frymën e Shenjtë ose për të kryer ordinancat e tjera të shpëtimit. Zbulesa u ndërpre dhe doktrina u korruptua.
- Madje edhe para vdekjes së Apostujve, lindën shumë konflikte në lidhje me doktrinën. Perandoria Romake, që fillimisht kishte përndjekur të Krishterët, më vonë përqafoi Krishtërimin. Çështje të rëndësishme fetare u vendosën me anë të këshillave. Doktrinat dhe ordinancat e thjeshta të mësuara nga Shpëtimtari u diskutuan dhe u ndryshuan për t'iu përshtatur filozofive të botës (shih Isaia 24:5). Ata ndryshuan me të vërtetë shkrimet e shenjta, duke hequr prej tyre doktrina të qarta dhe të çmuara (1 Nefi 13:26–40). Ata krijuan bindje, ose deklarata të besimit, të bazuar në doktrina të rreme dhe të ndryshuara (shih Joseph Smith—Historia 1:19). Për shkak të krenarisë, disa prej tyre synuan poste me influencë (shih 3 Gjoni 1:9–10). Njerëzit i pranuan këto ide të rreme dhe nderuan mësues të rremë të cilët u mësuan doktrina të kënaqshme për njerëzit, në vend të të vërtetave hyjnore (shih 2 Timoteut 4:3–4).
- Gjatë gjithë historisë, shumë njerëz kanë besuar sinqerisht bindje dhe doktrina të rreme. Ata kanë adhuruar sipas dritës që kanë pasur dhe kanë marrë përgjigje për lutjet e tyre. Megjithatë ata “mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë (DeB 123:12).
- Prandaj, tashmë kërkohet një rivendosje dhe jo një reformim. Autoriteti i Priftërisë nuk vazhdoi në një linjë të pandërprerë vazhdimësie duke nisur që me Apostullin Pjetër. Të reformosh do të thotë të ndryshosh atë që tashmë ekziston; të rivendosësh do të thotë të rikthesh diçka në formën e saj origjinale. Kështu, rivendosja e autoritetit të priftërisë me anë të lajmëtarëve hyjnorë ishte rruga e vetme e mundshme për të mposhtur Braktisjen e Madhe.

## Rivendosja e Ungjillit të Jezu Krishtit me anë të Profetit Jozef Smith

Kur rrethanat ishin të përshtatshme, Ati Qiellor edhe një herë iu drejtua fëmijëve të Tij me dashuri. Ai thirri si një profet një djalë të ri të quajtur Jozef Smith. Me anë të tij plotësia e ungjillit të Jezu Krishtit u rivendos në tokë.

Jozef Smithi jetonte në Shtetet e Bashkuara, që ishte ndoshta i vetmi vend në atë kohë që gëzonte lirinë fetare. Kjo ndodhi gjatë një kohe trazirash të mëdha fetare në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara. Anëtarët e familjes së tij ishin besimtarë të devotshëm dhe vazhdimisht kërkonin të vërtetën. Por shumë shërbëtarë pretendonin të kishin ungjillin e vërtetë. Jozefi dëshironte “[të dinte] se cili nga të gjitha sektet ishte i drejti,” Joseph Smith—Historia 1:18). Bibla na mëson se ka “një Zot, një besim, një pagëzim” (Efesianëve 4:5).

## Shënime

Jozefi frekuentonte kisha të ndryshme, por vazhdonte të ishte i paqartë rreth asaj se me cilën kishë duhej të bashkohej. Ai më vonë shkroi: “Kaq e madhe ishte ngatërresa dhe grindja midis zotërimeve të ndryshme, sa ishte e pamundur për një njeri, të ri si unë... të arrija në njëfarë përfundimi se kush kishte të drejtë dhe kush ishte gabim... në mes të kësaj lufte fjalësh dhe ngatërrese opinionesh, unë shpesh thashë me vete: ‘Çfarë duhet të bëhet? Cili nga të gjitha grupet ka të drejtë; ose a janë që të gjithë së bashku gabim? Në qoftë se ndonjëri prej tyre kishte të drejtë, cili është ai dhe si do ta njoh unë atë?’” (Joseph Smith—Historia 1:8, 10).

Ndërsa Jozefi kërkonte të gjente të vërtetën midis besimeve të ndryshme, ai iu drejtua Biblës për drejtim. Ai lexoi: “Në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar; dhe atij do t’i jepet” (Jakobi 1:5). Për shkak të këtij vargu, Jozefi vendosi t’i kërkonte Perëndisë se çfarë duhej të bënte. Në pranverën e vitit 1820 ai shkoi në një koriye aty rrotull dhe u gjunjëzua në lutje. Ai e përshkroi përvojën e tij:

“Unë pashë një shtyllë drite tamam mbi kokën time, më e shkëlqyeshme se dielli, e cila zbriti gradualisht derisa ra mbi mua... Kur drita pushoi mbi mua, unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve kapërcejnë të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin: ‘Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje atë!’” (Joseph Smith—Historia 1:16–17).

Në këtë vegim Perëndia Ati dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, iu shfaqën Jozef Smithit. Shpëtimtari i tha Jozefit të mos bashkohej me asnjë nga kishat, sepse ato “ishin [të gjitha të gabuara]” dhe “të gjitha besimet e tyre ishin një fëlliqësi.” Ai u shpreh: “Ata më afrohen me buzët e tyre, por zemrat e tyre janë larg prej meje, ata u mësojnë për doktrina urdhërimet e njerëzve, duke patur një formë shenjtërie, por e mohojnë fuqinë e saj” (Joseph Smith—Historia 1:19). Edhe pse shumë njerëz të mirë besonin në Krisht dhe përpiqeshin të kuptonin e të mësonin ungjillin e Tij, ata nuk kishin plotësinë e së vërtetës ose autoritetin e priftërisë për të pagëzuar dhe për të kryer ordinancat e tjera të shpëtimit. Ata kishin trashëguar një gjendje braktisjeje duke qenë se çdo brez ishte ndikuar prej asaj që kishte trashëguar nga brezi i mëparshëm, përfshirë ndryshimet në doktrina dhe ordinanca të tilla si pagëzimi. Ashtu siç bëri me Adamin, Noeun, Abrahamin, Moisiun dhe profetët e tjerë, Perëndia thirri Jozef Smithin të ishte një profet me anën e të cilit plotësia e ungjillit u rivendos në tokë.



Pas shfaqjes së Atit dhe Birit, lajmëtarë të tjerë qiellorë, ose engjëj, iu dërguan Jozef Smithit dhe shokut të tij Oliver Kaudërit. Gjon Pagëzori iu shfaq dhe i dha Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit Priftërinë Aarone, që përfshin autoritetin për të kryer ordinancën e pagëzimit. Pjetri, Jakobi dhe Gjoni (tre Apostujt e parë të Krishtit) iu shfaqën dhe i dhanë Priftërinë Melkizedeke Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit, duke rivendosur të njëjtin autoritet që iu dha Apostujve të lashtë të Krishtit. Duke pasur këtë autoritet të priftërisë, Jozef Smithi u urdhërua të organizonte përsëri Kishën e Jezu Krishtit në tokë. Nëpërmjet tij, Jezu Krishti thirri dymbëdhjetë Apostuj.

Koha në të cilën jetojmë është quajtur nga profetët e Biblës si ditët e fundit, ditët e mëvonshme, ose periudha ungjillore e plotësisë së kohërave. Kjo është pikërisht periudha e kohës që i paraprin Ardhjes së Dytë të Jezu Krishtit. Kjo është periudha përfundimtare. Kjo është arsyeja që Kisha quhet Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Një profet i gjallë e drejton Kishën sot. Ky profet, Presidenti i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është pasuesi i autorizuar i Jozef Smithit. Ai dhe Apostujt e tanishëm e ndjekin linjën e autoritetit të tyre përmes Jozef Smithit në një zinxhir të pandërprerë shugurimesh deri te Jezu Krishti.

#### Mësoni Përmendësh Joseph Smith—Historia 1:16–17

Mësoni përmendësh përshkrimin e çastit kur Jozef Smithi pa Atin dhe Birin (Joseph Smith—Historia 1:16–17), dhe jini gjithmonë të përgatitur ta përshkruani Vegimin e Parë duke përdorur fjalët e tij. Mos e thoni me nxitim. Jepni dëshmi të sinqertë se ju e dini që është i vërtetë. Mos ngurroni të shpjegoni se si arritët ta njihnit vërtetësinë e tij. Ftojeni shokun/shoqen tuaj të bëjë të njëjtën gjë.

#### Jepni Dëshmi

Një pjesë e rëndësishme e detyrës së një misionari është të dëshmojë për profetin dhe presidentin e tanishëm të Kishës.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

2 Nefi 3  
DeB 112:30

Efesianëve 1:10  
Efesianëve 4:5

Jakobi 1:5 (Dhjata e Re)  
Broshura, *Dëshmia e Profetit Jozef Smith*

### Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit



Duke e ditur se dyshimi, mosbesimi dhe keqinformimi do të rezultonin pas shekujsh të tërë errësire, Ati ynë i dashur Qiellor solli një vëllim të lashtë shkrimesh të shenjta të krahasueshëm me Biblën, që përmban plotësinë e ungjillit të përjetshëm të Jezu Krishtit. Ky vëllim shkrimesh të shenjta siguron prova bindëse se Jozef Smithi është një profet i vërtetë i Perëndisë. Ky anal është Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit.

Jozef Smithi u drejtua nga një lajmëtar qiellor i quajtur Moroni në një kodër ku për shekuj me radhë kishin qëndruar të fshehura fletë të arta. Këto fletë të arta përmbanin shkrimet e profetëve duke dhënë një përmbledhje të marrëdhënieve të Perëndisë me disa prej banorëve të lashtë të

kontinentit amerikan. Jozef Smithi përktheu përmbajtjen e këtyre fletëve nëpërmjet fuqisë së Perëndisë. Profetët në Librin e Mormonit dinin rreth misionit të Shpëtimtarit dhe mësuani ungjillin e Tij. Pas Ringjalljes së Tij, Krishti iu shfaq këtyre njerëzve. Ai u mësoi atyre ungjillin e Tij dhe themeloi Kishën e Tij. Libri i Mormonit provon se “Perëndia

vërtetë i frymëzon njerëzit dhe i thërret ata në punën e tij të shenjtë në këtë kohë e brez, si dhe në brezat e lashtësisë” (DeB 20:11). Që të dijë se Libri i Mormonit është i vërtetë, një person duhet ta lexojë, të meditojë dhe të lutet për të. Kërkuesi i ndershëm i së vërtetës do të arrijë të ndiejë shumë shpejt se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë.

Leximi, meditimi dhe lutja për Librin e Mormonit janë vendimtare për një kthim të qëndrueshëm në besim. Ata që fillojnë të lexojnë Librin e Mormonit për herë të parë ndërmarrin hapa të rëndësishëm për të ditur se Jozef Smithi është një profet i Perëndisë dhe se Kisha e vërtetë është rivendosur në tokë.

### Përdoreni Librin e Mormonit për të Konfirmuar të Vërtetën e Rivendosjes

Më poshtë gjendet një shembull i asaj që ju mund të thoni kur prezantoni Librin e Mormonit:

“Perëndia i do fëmijët e Tij, kështu që Ai siguroi një mënyrë bindëse për të konfirmuar të vërtetën e asaj që ne kemi thënë. Është Libri i Mormonit. A mund të lexoni ju lutem dy paragrafët e fundit në hyrje të librit?” Në qoftë se hyrja nuk përfshihet në përkthimin aktual të Librit të Mormonit, lexoni dy paragrafët e fundit të hyrjes në Librin e Mormonit në anglisht dhe bëni një përmbledhje të paragrafëve.

Shpjegoni me kujdes kuptimin e secilit koncept në të dy paragrafët dhe ftojini kërkuesin të zotohet se do të lexojë pjesë nga Libri i Mormonit dhe do të zbatojë parimet e përshkruara në këto dy paragrafë.

Kur i prezantoni për herë të parë një personi Librin e Mormonit, është e dobishme t'i tregoni atij ose asaj një kopje e librit, t'i jepni një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes dhe të ndani një ose dy paragrafë që janë domethënës për ju personalisht ose që mund të jenë domethënës për ta.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Faqja e Titullit të Librit të Mormonit  
Hyrje e Librit të Mormonit,  
paragrafët 1–7

DeB 1:17–23  
DeB 20:5–12

Joseph Smith—Historia  
1:27–64

## Lutuni për të Ditur të Vërtetën Njëpërmjet Frymës së Shenjtë

Ky mesazh i Rivendosjes ose është ose nuk është i vërtetë. Ne mund ta dimë se ai është i vërtetë njëpërmjet Frymës së Shenjtë, siç është premtuar tek Moroni 10:3–5. Mbase të ketë lexuar dhe medituar mesazhin e Librit të Mormonit, ai që dëshiron të dijë të vërtetën duhet ta pyesë në lutje Atin tonë Qiellor në emër të Jezu Krishtit nëse ai është i vërtetë. Këtë e bëjmë duke iu drejtuar Atit tonë Qiellor. Ne e falënderojmë Atë për bekimet tona dhe i kërkojmë të dimë nëse mesazhi i Librit të Mormonit është i vërtetë. Askush nuk mund të arrijë t'i dijë të vërtetat shpirtërore pa u lutur.

Në përgjigje të lutjeve tona, Fryma e Shenjtë do të na mësojë të vërtetën njëpërmjet ndjenjave dhe mendimeve tona. Ndjenjat që vijnë nga Fryma e Shenjtë janë të fuqishme, por zakonisht ato janë gjithashtu të brishta e të qeta. Sapo të fillojmë të ndiejmë se ajo që

### Lutja

- Drejtojuni Atit tonë Qiellor (“Ati ynë që je në Qiell... ”)
- Shprehni ndjenjat e zemrës suaj (mirënjohje, pyetje, kërkojini t’ju konfirmojë se Libri i Mormonit është i vërtetë dhe kështu me radhë)
- Mbylleni (“Në emër të Jezu Krishtit, amen”)

po mësojmë është e vërtetë, ne do të dëshirojmë të dimë gjithçka që mundim rreth Rivendosjes.

Kur e dimë se Libri i Mormonit është i vërtetë atëherë e dimë gjithashtu se Jozef Smithi u thirr si një profet dhe se ungjilli i Jezu Krishtit u rivendos nëpërmjet tij.

#### Lutja

Megjithëse lutja ka një rol të rëndësishëm në shumë besime fetare dhe kultura, ajo rrallë konsiderohet si një komunikim dypalësh midis Perëndisë dhe njeriut. Ndhimojini ata që mësoni të kuptojnë se ata mund të shprehin ndjenjat e zemrave të tyre në lutje. Tregojeni këtë me mënyrën si luteni në fillim ose në fund të një mësimi. Përdorni një gjuhë të thjeshtë që edhe ata mund ta përdorin kur luten. Ndhimojini të kuptojnë se Ati ynë Qiellor do t'u përgjigjet lutjeve të tyre, zakonisht nëpërmjet ndjenjave të zemrës së tyre dhe mendimeve në mendjen e tyre. Në qoftë se ata janë të sigurtë dhe vërtetë duan të dinë nëse ekziston Perëndia, Ai do t'u përgjigjet. Ftoni kreun e familjes të ofrojë një lutje në gjuhë në fund të mësimit.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Alma 5:45–46  
DeB 8:2–3

Gjoni 14:26

Hyrje e Librit të Mormonit,  
paragrafët 8–9

#### Ftesë për t'u Pagëzuar

Gjatë këtij mësimi ose një mësimi tjetër, mos ngurroni t'i ftoni njerëzit të pagëzohen dhe të konfirmohen.

Për t'i përgatitur njerëzit për një ftesë për t'u pagëzuar dhe konfirmuar, mësojuni doktrinën e pagëzimit dhe dëshmoni shpesh sa e rëndësishme është që të gjithë njerëzit të pagëzohen nëpërmjet autoritetit, të marrin një heqje të mëkateve dhe dhuratën e mrekullueshme të Frymës së Shenjtë. Ju mund të thoni: “Ndërsa Perëndia u përgjigjet lutjeve tuaja dhe ju e ndieni se ky mesazh është i vërtetë, a do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit duke u pagëzuar?”

Ftesa për t'u pagëzuar dhe konfirmuar duhet të jetë specifike dhe e drejtpërdrejtë: “A do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit duke u pagëzuar nga dikush që mban autoritetin e priftërisë së Perëndisë? Ne do të zhvillojmë një shërbesë pagëzimi në (datën). A do të përgatiteni për t'u pagëzuar në atë datë?”

## Ide për Mësimdhënie

Ky seksion përmban ide për t'u përdorur nga ana juaj gjatë përgatitjes dhe dhënies së këtij mësimi. Me lutje ndiqni Shpirtin ndërsa vendosni si t'i përdorni këto ide. Shtoni idetë që zgjidhni në planin tuaj mësimor. Mbani mend se këto ide janë sugjerime—jo kërkesa—për t'ju ndihmuar të plotësoni nevojat e atyre që mësoni.

### Plan i Shkurtër Mësimi (3–5 minuta)

Pasi kishte humbur për shekuj të tërë, ungjilli i Jezu Krishtit u rivendos në tokë nga Ati ynë i dashur Qiellor me anë të një profeti të gjallë. Libri i Mormonit është prova bindëse e kësaj. Ju mund ta mbani atë në duart tuaja. Ju mund ta lexoni atë, të meditonit se si mesazhi në libër mund ta përmirësojë jetën tuaj dhe të luteni për të ditur nëse ky mesazh është fjala e Perëndisë.

- Perëndia Është Ati Ynë i Dashur Qiellor
- Ungjilli Bekon Familjet
- Ati Qiellor Zbulon Ungjillin e Tij në Çdo Periudhë Ungjillore
- Shërbesa Tokësore e Shpëtimtarit dhe Shlyerja
- Braktisja e Madhe
- Rivendosja e Ungjillit të Jezu Krishtit me anë të Profetit Jozef Smith
- Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit
- Lutuni për të Ditur të Vërtetën me anë të Frymës së Shenjtë

### Zotime:

- A do të lexoni dhe a do të luteni të dini se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë?
- A do të luteni të dini se Jozef Smithi ishte një profet?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

### Plan Mesatar Mësimi (10–15 minuta)

Mesazhi ynë është i veçantë dhe i thjeshtë. Perëndia është Ati ynë. Ne jemi fëmijët e Tij. Ne jemi pjesë e familjes së Tij. Ai na do. Që nga fillimi i botës, Ai ka ndjekur një plan dashurie dhe përkujdesje. Shumë herë Ai është përpjekur me dashuri për të zbuluar ungjillin e Jezu Krishtit që kështu fëmijët e Tij të mund të dinë si të kthehen tek Ai. Ai ua zbuloi atë profetëve si Adamit, Noeut, Abrahamit dhe Moisiut. Por njerëzit vazhdimisht kanë zgjedhur ta mohojnë atë ungjill. Dy mijë vjet më parë, Vetë Jezu Krishti na mësoi ungjillin e Tij, vendosi Kishën e Tij dhe kreu Shlyerjen. Në mënyrë të pabesueshme, njerëzit përsëri e mohuan Jezusin. Sa herë njerëzit e shpërfillin ose shtrembërojnë doktrinat dhe ordinancat e vërteta, Perëndia e tërheq autoritetin e Tij për të administruar Kishën.

Ftesa jonë për ju dhe për të gjithë njerëzit është t'u shtoni të vërtetave që tashmë janë të dashura për ju. Mendoni për provën që ne kemi se Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, i janë afruar edhe një herë me dashuri fëmijëve të Perëndisë dhe i kanë zbuluar plotësinë e ungjillit një

Shënime

### Shënime

profeti. Emri i këtij profeti është Jozef Smith. Prova e kësaj të vërtete të lavdishme gjendet në një libër—Libri i Mormonit—të cilin ju mund ta lexoni, të meditonit dhe të luteni rreth tij. Në qoftë se luteni me zemër të singërtë, me qëllim të vërtetë dhe besim në Krisht, Perëndia do t'ju tregojë me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se ai është i vërtetë.

#### Zotime:

- A do të lexoni dhe a do të luteni të dini se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë?
- A do të luteni të dini se Jozef Smithi ishte një profet?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

#### Plan i Plotë Mësimi (30–45 minuta)

- Perëndia Është Ati Ynë i Dashur Qiellor
  - Ne jemi fëmijë të Perëndisë (shih Veprat e Apostujve 17:29)
  - Perëndia na do dhe do të na ndihmojë të bëjmë zgjedhje të drejta.
  - Me anë të Jezu Krishtit, ne mund të jetojmë me Perëndinë përsëri (shih Gjoni 3:16–17)
- Ungjilli Bekon Familjet
  - Ungjilli i Jezu Krishtit i ndihmon familjet të zhvillojnë marrëdhënie më të forta.
  - Familjet janë shuguruar nga Perëndia; ato janë njësi shoqërore më e rëndësishme tani dhe në përjetësi (shih DeB 49:15–16).
  - Familja është vendi më i mirë për të dhënë mësim, për të mësuar dhe për të zbatuar parimet e ungjillit (shih DeB 68:25; Zanafilla 18:19; Ligji i Përtërirë 6:7).
  - Familja mund të jetë një vend sigurie, paqeje dhe gëzimi.
- Ati Qiellor Zbulon Ungjillin e Tij në Çdo Periudhë Ungjillore
  - Perëndia thërret profetë për të na mësuar ungjillin e Tij (shih Amosi 3:7).
  - Braktisje do të thotë të mohosh profetët dhe ungjillin.
  - Periudhat ungjillore janë periudha kohore kur profetët u kanë mësuar njerëzve ungjillin. Periudhat e mëparshme ungjillore kanë përfunduar në braktisje (shih DeB 136:36–38).
  - Adami, Noeu, Abrahami, Moisiu dhe të tjerë profetë të lashtë të gjithë u mësuan njerëzve ungjillin (shih Moisiu 5:4–12).
- Shërbesa Tokësore e Shpëtimtarit dhe Shlyerja
  - Biri i Perëndisë rivendosi dhe mësoi ungjillin. Ai kreu shumë mrekulli (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Mrekulli,” 126).



## Shënime

- Ai thirri apostujt dhe u dha atyre autoritetin e priftërisë për të predikuar ungjillin dhe për të kryer ordinancat e shpëtimit të tilla si pagëzimi (shih Gjoni 15:16).
- Krishti themeloi Kishën e Tij.
- Krishti u kryqëzua dhe apostujt e Tij u mohuan dhe u vranë (shih Mateu 27:35; Marku 15:25).
- Krishti kreu Shlyerjen (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Shlyej, Shlyerje,” 180).
- Braktisja e Madhe
  - Pa zbulësën që vjen nëpërmjet një profeti, njerëzit bien në errësi shpirtërore (shih Amosi 8:11–12).
  - Profetët dhe apostujt e parashikuan Braktisjen e Madhe (shih 2 Thesalonikasve 2:1–3).
- Rivendosja e Ungjillit të Jezu Krishtit me anë të Profetit Jozef Smith
  - Jozefi kërkoi për të vërtetën (shih Joseph Smith—Historia 1:8, 10)
  - Perëndia dhe Jezu Krishti iu shfaqën Jozef Smithit (shih Joseph Smith—Historia 1:16–17).
  - Ashtu si profetët në periudhat e mëparshme ungjillore, Jozef Smithi u thirr si profet në këtë periudhë të fundit ungjillore.
  - Perëndia rivendosi plotësinë e ungjillit me anë të Jozef Smithit (shih DeB 35:17; 135:3).
  - Lajmëtarë të tjerë qiellorë rivendosën priftërinë dhe Kisha e Krishtit u organizua (shih DeB 13; 27:12).
  - Një profet i gjallë drejton Kishën sot.
- Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit
  - Libri i Mormonit është provë bindëse se Jozef Smithi ishte një profet.
  - Jozefi përktheu fletët e arta me anë të fuqisë së Perëndisë (shih Hyrja e Librit të Mormonit, paragrafi 5).
  - Libri i Mormonit provon se Perëndia frymëzon profetët në kohën tonë ashtu si ka bërë në çdo periudhë ungjillore (shih DeB 20:5–12).
  - Libri i Mormonit përmban plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit (shih DeB 20:8–9).
- Lutuni për të Ditur të Vërtetën me anë të Frymës së Shenjtë
  - Ju mund ta dini se Libri i Mormonit është i vërtetë (shih Moroni 10:3–5; Hyrja e Librit të Mormonit, paragrafët 1, 8–9).
  - Fryma e Shenjtë do t’ju mësojë me anë të mendimeve dhe ndjenjave tuaja (shih DeB 8:2–3).

#### Shënime

#### Zotime:

- A do të lexoni dhe a do të luteni të dini se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë?
- A do të luteni të dini se Jozef Smithi ishte një profet?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

#### Pyetje në Fund të Mësimi

- Çfarë pyetjesh keni rreth asaj që ju kemi mësuar?
- Në qoftë se do të kishte një profet sot në tokë, çfarë pyetjesh do t'i bënit atij?
- A e ndieni se Perëndia i dëgjon lutjet tuaja? Pse?
- A do t'ju pëlqente të zbulonit se Libri i Mormonit është i vërtetë? Pse?

#### Përkufizime të Rëndësishme

- **Braktisje:** Një largim nga e vërteta i individëve, Kishës, ose kombeve të tëra. Ajo përfshin rebelimin kundër autoritetit dhe mohimin e profetëve. Provat e braktisjes përfshijnë shkeljen e ligjeve të Perëndisë, ndryshimin e ordinancave të ungjillit dhe thyerjen e besëlidhjeve (shih Isaia 24:5).
- **Liria e zgjedhjes:** Aftësia dhe privilegji që Perëndia u jep njerëzve të zgjedhin dhe të veprojnë për veten e tyre.
- **Periudhë Ungjillore:** Një periudhë kohore në të cilin Zoti ka të paktën një shërbëtor të autorizuar në tokë i cili mban çelësat e priftërisë së shenjtë. Përveç Krishtit, profetët si Adami, Enoku, Noeu, Abrahami, Moisiu dhe Jozef Smithi, secili filloi një periudhë të re ungjillore. Kur Perëndia organizon një periudhë ungjillore, ungjilli zbulohet sërish kështu që njerëzve të asaj periudhe ungjillore nuk do t'ju duhet të varen nga periudhat e kaluara ungjillore për të njohur planin e shpëtimit. Periudha ungjillore e filluar nga Jozef Smithi është e njohur si “periudha ungjillore e plotësisë së kohërave.”
- **Priftëri:** Autoriteti dhe fuqia që Perëndia i jep njeriut të veprojë në emër të Jezu Krishtit në të gjitha gjërat për shpëtimin e mbarë njerëzimit.
- **Profet:** Një burrë që thirret nga Perëndia dhe flet në emër të Tij. Si një lajmëtar i Perëndisë, një profet merr autoritetin e priftërisë, urdhërimet, profecitë dhe zbulesa nga Perëndia. Përgjegjësia e tij është t'i bëjë të njohur mbarë njerëzimit vullnetin dhe karakterin e vërtetë të Perëndisë dhe t'i tregojë kuptimin e marrëdhënieve të Tij me ta. Një profet dënon mëkatet dhe parashikon pasojat e tij. Ai është një predikues i drejtësisë. Ndonjëherë, një profet mund të jetë i frymëzuar të parashikojë të ardhmen për të mirën e njerëzimit. Megjithatë përgjegjësia e tij kryesore, është të dëshmojë për Jezu Krishtin.
- **Reformues:** Të reformosh do të thotë t'i bësh ndryshime diçkaje që ta përmirësosh atë. Termi *reformues* u referohet atyre burrave dhe grave (si Martin Luter, Xhon Kalvin, Uilliam Taindell dhe Xhon Uajklif) që protestuan kundër praktikave të kishave ekzistuese, të cilat ata mendonin se duhej të reformoheshin.
- **Rivendosje:** Të rivendosësh do të thotë të rikthesh në gjendjen e mëparshme ose të risjellësh. Rivendosje, në kuptimin e përdorur nga shenjtoret e ditëve të mëvonshme,

## Shënime

do të thotë se Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit, që ishte zhdukur nëpërmjet braktisjes, u soll sërish ashtu siç ekzistonte në fillim kur u organizua nga Jezu Krishti. Ndryshe nga Reformimi, Rivendosja u krye nëpërmjet autoritetit hyjnor me anë të zbulesës.

- **Shëlbues:** Jezu Krishti është Shëlbuesi i mbarë njerëzimit sepse Ai, me anë të Shlyerjes së Tij, pagoi çmimin për mëkatet e mbarë njerëzimit dhe bëri të mundur ringjalljen e të gjithë njerëzve. Të shëlbosh do të thotë të lirosh, të blesh, ose të shpengosh, si për shembull të lirosh një person nga robëria me anë të pagesës. Shëlbimi i referohet Shlyerjes së Jezu Krishtit dhe çlirimit nga mëkati. Shlyerja e Jezusit shëlbbon gjithë njerëzimin nga vdekja fizike. Me anë të Shlyerjes së Tij, që përfshin vuajtjen e Tij në Gjetseman dhe në kryq si edhe Ringjalljen e Tij, ata që kanë besim në Të dhe që pendohen, shëlbohen nga vdekja shpirtërore.
- **Zbulesë:** Komunikim nga Perëndia me fëmijët e Tij në tokë. Zbulesa mund të vijë me anë të Dritës së Krishtit dhe Frymës së Shenjtë në formën e frymëzimit, vegjimeve, ëndrrave, ose vizitës nga engjëjt. Zbulesa siguron atë drejtim që mund t'i udhëheqë besnikët drejt shpëtimit të përjetshëm në mbretërinë çelestiale. Perëndia u zbulon punën e Tij profetëve dhe u konfirmon besimtarëve se zbulesat e profetëve janë të vërteta (shih Amosi 3:7). Me anë të zbulesës, Zoti siguron drejtim individual për çdo person që e kërkon atë dhe që ka besim, pendohet dhe i bindet ungjillit të Jezu Krishtit.

**Terma të Tjera që Mund të Kenë Nevojë për Përkufizime të Mëtejshme për Ata që Ju Mësoni.**

- |   |                          |  |
|---|--------------------------|--|
| • Apostull                              | • Kujdestari             | • Shkrime të shenjta                         |
| • Bibël                                 | • Lutje                  | • Shpëtimtar                                 |
| • Bindje dhe mosbindje ndaj urdhërimeve | • Mëkat                  | • Të kthehemi për të jetuar në praninë e Tij |
| • Durim deri në fund                    | • Ordinancat e shpëtimit | • Ungjill                                    |
| • Dhurata e Frymës së Shenjtë           |                          |  |

### Reformatorë dhe Udhëheqës Fetarë Botërorë

**Më poshtë jepet një informacion shpjegues për t'u përdorur vetëm kur të jetë e nevojshme.**

**Xhon Uajklif:** Lindur në shekullin e XIV në Angli. Student i teologjisë në Universitetin e Oksfordit. Mësoi se kisha katolike nuk kishte çelësat e priftërisë, se Kungimi i Shenjtë (ose sakramenti) nuk ishte trupi aktual i Krishtit dhe se kisha nuk duhet të ushtrojë fuqi politike mbi njerëzit. Përktheu Biblën në anglisht. Vdiq më 31 dhjetor 1384.

**Martin Luter:** Lindur më 10 nëntor 1483, në Gjermani. Studioi në Universitetin e Erfurtit dhe Uitenbergut. Gozhdoi 95 teza mbi derën e Kishës Kesëll në kundërshtim të hapur me shumë mësim të atëhershme të kishës katolike romake duke përfshirë praktikën e pagimit të parave nga njerëzit për t'u falur për mëkatet e tyre. Vdiq më 18 shkurt 1546.

#### Shënime

**Uilliam Taindëll:** Lindur në Uells në vitin 1494. Studioi në Oksford dhe Kembrixh. Përktheu Dhjatën e Re në anglisht. I bëri shkrimet e shenjta të disponueshme për njerëzit e zakonshëm për të demaskuar doktrinat e rreme dhe korrupsionin e udhëheqësve fetarë. U ekzekutua më 6 tetor 1536.

**Xhon Kalvin:** Ka lindur më 10 korrik 1509, në Francë. Studioi në Paris për t'u bërë prift. Udhëheqësi kryesor në lëvizjet për reformimin e kishës katolike. Jetoj më të shumtën e jetës së tij në Zvicër. Ai mësoi që njerëzit nga natyra janë të shturur dhe se vetëm hiri i Perëndisë mund t'i shpëtojë ata. Shkroi shumë komente shpjeguese mbi Biblën. Vdiq më 27 maj 1564.

Për më shumë informacion mbi reformatorët shih burimet e mëposhtme në materialet e bibliotekës së misionarit: James E. Talmage, *Jesus the Christ*, 692–703; M. Russell Ballard, *Our Search for Happiness*, 26–32.

Po ashtu si bota e krishterë u bekua nga kurajo dhe vizioni i reformatorëve, shumë kombe dhe kultura të tjera janë bekuar nga ata të cilëve iu dha ajo pjesë e fjalës së Tij që “[Perëndia] e shikon të përshtatshme se ata duhet të kenë” (Alma 29:8). Mësimet e udhëheqësve të besimeve të tjera i kanë ndihmuar shumë njerëz të bëhen më të qytetëruar dhe më të moralshëm.

**Buda (Gotama):** Lindur në vitin 563 para Krishtit, bir i një prijësi hindu në Nepal. Ai shqetësohej për vuajtjet që shikonte rreth vetes. U largua nga pallati luksoz i të atit, braktisi botën dhe jetoj në varfëri. Duke u munduar të gjente shpjegim, ai zbuloi atë që ai e quajti “rruga e çlirimit.” Pretendonte se arriti Nirvanën, një gjendje e harresës së shqetësimit, dhimbjes, ose realitetit të jashtëm. U bë një mësues për komunitetin e murgjve.

**Konfuci:** Lindur në vitin 551 para Krishtit. Kur ishte ende fëmijë mbeti jetim. Mësuesi i parë profesionist i Kinës. Mendimtari më i madh moral dhe shoqëror i Kinës. Foli pak rreth qenieve shpirtërore ose fuqive hyjnore. Besonte se qielli e kishte ngarkuar atë me një mision të shenjtë si një mbrojtës i së mirës dhe së vërtetës.

**Muhamedi:** Lindur në vitin 570 pas Krishtit në Mekë. Mbeti jetim në fëmijëri. Jetoj një jetë të varfër. Fitoi famë si një paqebërës i besuar. U martua në moshën 25 vjeçare. Në vitin 610 u lut dhe meditoi në malin Hira. Thuhet se engjëlli Gabriel iu shfaq atij dhe i dha një mesazh nga Allahu (Perëndia). Pretendonte se komunikonte me Perëndinë me anë të Gabrielit nga viti 620 deri në 632. Këto komunikime, të cilat ai ua citonte dishepujve të tij, u shkruan më vonë në Kuran, libri i shenjtë i Islamit.

# Plani i Shpëtimit



Shënime

## Qëllimi Juaj

Ndërsa mësoni kërkuesit, përgatitini ata të plotësojnë kërkesat për pagëzim që na mësohen në Doktrina e Besëlidhje 20:37 dhe në pyetjet e intervistës së pagëzimit. Kjo arrihet më mirë duke i ftuar kërkuesit tuaj të marrin dhe të mbajnë zotimet e renditura më poshtë.

### Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit

- A besoni ju se Perëndia është Ati ynë i Amshuar?
- A besoni ju se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës?
- A jeni ju i gatshëm të mbani të shenjtë ditën e Shabatit, duke përfshirë marrjen e sakramentit çdo javë dhe shërbimin ndaj anëtarëve të tjerë?

### Zotimet

- A do të luteni për të ditur se ajo që ju kemi mësuar është e vërtetë?
- A do të pendoheni për mëkatet tuaja?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A do të ndiqni shembullin e Shpëtimtarit dhe të pagëzoheni në (datën)?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërimet nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

## Ndihmoni të Tjerët të Mësojnë rreth Jezu Krishtit

Misionarët duhet të dëshmojnë për Jezu Krishtin dhe t'i ftojnë të gjithë të vijnë tek Ai që ata të mund të shpëtohen. Dhënia e shpjegimeve të veçanta rreth Shpëtimtarit është e rëndësishme për ata që dinë pak ose asgjë rreth Tij. Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit është hartuar për të ndihmuar të gjithë njerëzit të dinë se “Jezusi është Krishti, ... që ua shfaqti veten të gjitha kombeve” (shiko Faqja e Titullit e Librit të Mormonit). Një nga mënyrat më efektive për të mësuar dhe dëshmuar për Shpëtimtarin është të lexoni së bashku nga Libri i Mormonit. Fragmente nga veprat e tjera standarde mund të jenë gjithashtu të vlefshme.

Merrni parasysh sugjerimet më poshtë. Kjo mund të bëhet si pjesë e këtij mësimi ose mësimëve të tjera, apo si një mësim më vete. Po të jetë e nevojshme përsëriteni këtë aktivitet disa herë para dhe pas pagëzimit dhe konfirmimit.

Shënime

Faqja e Titullit dhe hyrja	Bëni të qartë qëllimin e librit.
1 Nefi 10–11	Lehi dhe Nefi dëshmojnë për Shpëtimtarin.
1 Nefi 19	Nefi tregon profecitë e shërbesës dhe Shlyerjes së Shpëtimtarit.
2 Nefi 2	Lehi dëshmon për Shpëtimtarin si Shëlbues.
2 Nefi 9	Jakobi dëshmon për Shlyerjen.
2 Nefi 31–33	Nefi mëson doktrinën e Krishtit.
Enosi	Enosi përjeton fuqinë e Shlyerjes.
Mosia 2–5	Mbreti Beniamin mëson popullin e tij për Krishtin.
Mosia 12–16	Abinadi jep jetën e tij duke dëshmuar për Jezu Krishtin.
Alma 5, 7	Alma dëshmon për Shpëtimtarin.
Alma 17–22	Lamanitët marrin dëshmi për Jezu Krishtin.
Alma 34	Amuleku dëshmon për Shlyerjen.
Alma 36	Alma përjeton fuqinë e Shlyerjes së Jezu Krishtit.
Alma 40–42	Alma dëshmon për ringjalljen dhe Shlyerjen.
Helamani 5	Nefi dhe Lehi janë mjete në duart e Perëndisë për të dëshmuar për Shpëtimtarin.
3 Nefi 9–10	Shpëtimtari fton njerëzit të vijnë tek Ai.
3 Nefi 11–18	Shpëtimtari u mëson Nefitëve mbi Atin dhe doktrinën e Tij.
3 Nefi 27	Shpëtimtari mëson ungjillin e Tij.
Ethëri 3	Vëllai i Jaredit sheh Shpëtimtarin.
Ethëri 12	Ethëri dhe Moroni dëshmojnë për Shpëtimtarin dhe fuqinë e Shlyerjes së Tij.
Moroni 7–8	Mormoni na mëson për dashurinë e kulluar të Krishtit dhe Shlyerjen e Tij.
Moroni 10	Moroni i fton të gjithë të vijnë te Krishti dhe të përsosen në Të.
“Krishti i Gjallë”	Profetët dhe apostujt dëshmojnë për Shpëtimtarin.

### Jeta Paratokësore: Qëllimi dhe Plani i Perëndisë për Ne

Shumë njerëz pyesin veten: “Nga erdhëm? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë?” Plani i shpëtimit na jep përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Perëndia është Ati i shpirttrave tanë. Ne jemi me të vërtetë fëmijët e Tij dhe Ai na do. Ne jetonim si fëmijë shpirtërorë të Atit tonë në Qiell përpara se të lindeshim në këtë botë. Megjithatë ne nuk ishim si Ati ynë Qiellor dhe nuk do të mund të bëheshim kurrë si Ai dhe të gëzonim të gjitha bekimet që Ai gëzon, pa përvojën e jetës në vdekshmëri me një trup fizik.

I gjithë qëllimi i Perëndisë—vepra dhe lavdia e Tij—është të bëjë të mundur që secili nga ne të gëzojë të gjitha bekimet e Tij. Ai ka përgatitur një plan të përkryer për të plotësuar qëllimin e Tij. Ne e kuptuam dhe e pranuan këtë plan përpara se të vinim në tokë. Në shkrimet e shenjta plani i Perëndisë është quajtur plani i mëshirshëm, plani i lumturisë, plani i shëlbimit dhe plani i shpëtimit.

Jezusi është qendra e planit të Perëndisë. Me anë të Shlyerjes së Tij, Jezu Krishti përmbushi qëllimin e Atit të Tij dhe bëri të mundur për secilin nga ne të gëzojë pavdekësinë dhe jetën e përvetshme. Satani, ose djalli, është një armik i planit të Perëndisë.

Liria e zgjedhjes, ose aftësia për të zgjedhur, është një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë për fëmijët e Tij. Përparimi ynë i përgjithshëm varet nga mënyra se si e përdorim këtë dhuratë. Ne duhet të zgjedhim nëse do të ndjekim Jezu Krishtin ose do të ndjekim Satanin.

Ne jemi fizikisht të ndarë nga Perëndia gjatë jetës sonë në tokë, por Ai do që secili nga fëmijët e Tij të gjejë paqe në këtë jetë dhe një plotësi të gëzimit në praninë e Tij pas kësaj jete. Ai do që ne të bëhemi si Ai.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Fëmijë të Perëndisë

DeB 93:29  
Veprat e Apostujve 17:29

Hebrenjve 12:9

##### Qëllimi i Perëndisë

Moisiu 1:39 Gjoni 17:3

##### Jeta Para Lindjes

DeB 138:53–56  
Moisiu 3:5

Abrahami 3:22–26  
Jeremia 1:5

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Jetë Para Lindjes”

## Krijimi

Nën drejtimin e Atit, Jezu Krishti krijoi tokën si një vend ku ne të jetojmë dhe të fitojmë përvojë. Me qëllim që të përparonim dhe të bëheshim si Perëndia, secili nga ne duhet të merrte një trup dhe të provohej gjatë një kohe prove në tokë. Gjatë kohës që jemi në tokë ne nuk jemi fizikisht në praninë e Perëndisë. Ne nuk na kujtohet jeta jonë para-tokësore. Ne duhet të ecim nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet gjërave që shihen.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

1 Nefi 17:36  
Alma 30:44  
DeB 88:41–47

Moisiu 2:1  
Moisiu 6:63  
Abrahami 3:24–25

PJS, Gjoni 1:1–3  
2 Korintasve 5:6–7

## Liria e Zgjedhjes dhe Rënia e Adamit dhe Evës

Adami dhe Eva ishin fëmijët e parë të Perëndisë që erdhën në tokë. Perëndia krijoi Adamin dhe Evën dhe i vendosi ata në Kopshtin e Edenit. Adami dhe Eva u krijuan sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, me trupa prej mishi dhe kockash. Ndërsa Adami dhe Eva ishin në kopsht, ata ishin akoma në praninë e Perëndisë dhe mund të kishin jetuar përgjithmonë. Ata jetonin në pafajësi dhe Perëndia kujdesej për nevojat e tyre.

Në Kopshtin e Edenit, Perëndia i dha Adamit dhe Evës lirinë e zgjedhjes. Ai i urdhëroi ata të mos hanin frutin e ndaluar, ose frutin e pemës së njohurisë të së mirës dhe të së keqes. Bindja ndaj këtij urdhërimi do të thoshte se ata mund të mbeteshin në kopsht, por nuk do të mund të përparonin duke provuar kundërshtimin në vdekshmëri. Ata nuk mund të njihnin gëzim, sepse nuk mund të provonin trishtim dhe dhimbje.

Satani tundoj Adamin dhe Evën të hanin frutin e ndaluar dhe ata zgjedhën të vepronin kështu. Kjo ishte pjesë e planit të Perëndisë. Për shkak të kësaj zgjedhjeje, ata u dëbuan nga kopshti dhe nga prania fizike e Perëndisë. Kjo ngjarje quhet Rënia. Ndarja nga prania e Perëndisë është vdekje shpirtërore. Adami dhe Eva u bënë të vdekshëm—subjekt i vdekjes

Shënime

fizike, ose ndarjes së trupit nga shpirti. Ata tani do mund të provonin sëmundje dhe të gjitha llojet e vuajtjeve. Ata patën të drejtën morale të zgjedhjes ose aftësinë për të zgjedhur midis së mirës dhe së keqes. Kjo bëri të mundur që ata të mësonin dhe të përparonin. Ajo bëri gjithashtu të mundur që ata të bënë zgjedhje të gabuara dhe të mëkatonin. Përveç kësaj, ata tani mund të kishin fëmijë, kështu që pjesa tjetër e fëmijëve shpirtërorë të Perëndisë mund të vinte në tokë, për të marrë trupa fizikë dhe për t'u provuar. Vetëm në këtë mënyrë fëmijët e Perëndisë mund të përparonin dhe të bëheshin si Ai.

#### Si ta Shpjegojmë Rënie

Kur ua mësoni kërkuesve për herë të parë këtë doktrinë, mos u mësoni gjithçka që dini rreth saj. Shpjegoni shumë thjesht se Perëndia zgjodhi dy nga fëmijët e Tij, Adamin dhe Evën, të bëheshin prindërit e parë në tokë. Pas shkeljes së tyre ata u bënë subjekt i vdekjes dhe i mëkatit. Vetë ata nuk mund të ktheheshin të jetonin me Atin Qiellor. Zoti i foli Adamit dhe i mësoi atij planin e shpëtimit dhe shëlbimin nëpërmjet Zotit Jezu Krisht. Duke ndjekur atë plan, Adami dhe familja e tij mund të kishin gëzim në këtë jetë dhe të ktheheshin e të jetonin me Perëndinë (shih Alma 18:36; 22:12–14).

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Në Kopsht

2 Nefi 2

Moisiu 2:26–31

Moisiu 3:15–17

Moisiu 5:11

Zanafilla 1:26–31

Zanafilla 2:15–17

##### Rënia

2 Nefi 2:25

Alma 12:22–34

Moisiu 4

Moisiu 5:10–12

Zanafilla 3

### Jeta Jonë në Tokë

Jeta në tokë është një mundësi dhe një bekim. Qëllimi ynë në këtë jetë është të kemi gëzim dhe të përgatitemi për t'u kthyer në praninë e Perëndisë. Në vdekshmëri ne jetojmë në një gjendje të tillë ku jemi subjekte si të vdekjes fizike ashtu edhe asaj shpirtërore. Perëndia ka një trup të përsosur, të lavdëruar, të pavdekshëm prej mishi dhe kockash. Që të bëhemi si Perëndia dhe të kthehemi në praninë e Tij, edhe ne duhet të kemi një trup të përsosur, të pavdekshëm prej mishi dhe kockash. Megjithatë, për shkak të Rënies së Adamit dhe Evës, çdo njeri në tokë ka një trup të papërsosur e të vdekshëm dhe në fund do të vdesë. Po të mos ishte Shpëtimtari Jezu Krisht, vdekja do t'u jepte fund të gjitha shpresave tona për një ekzistencë të ardhshme me Atin Qiellor.

Bashkë me vdekjen fizike, mëkati është një pengesë e madhe që na pengon të bëhemi si Ati ynë në Qiell dhe të kthehemi në praninë e Tij. Në gjendjen tonë të vdekshme shpesh ne i dorëzohemi tundimit, thyejmë urdhërimet e Perëndisë dhe mëkatojmë. Gjatë jetës sonë në tokë secili nga ne bën gabime. Megjithëse ndonjëherë duket ndryshe, mëkati gjithmonë çon drejt mjerimit. Mëkati shkakton ndjenja faji dhe turpi. Për shkak të mëkateve tona, ne nuk mund të kthehemi për të jetuar me Atin Qiellor në qoftë se nuk jemi falur dhe pastruar më parë.

Ndërsa jemi në vdekshmëri, ne kemi përvoja që na sjellin lumturi. Ne gjithashtu kemi përvoja që na sjellin vuajtje dhe trishtim, një pjesë e të cilit shkaktohet nga veprimet mëkatore të të tjerëve. Këto përvoja na sigurojnë mundësi për të mësuar dhe për t'u



rritur, për të dalluar të mirën nga e keqja dhe për të bërë zgjedhje. Perëndia ndikon tek ne për të bërë mirë; Satani na tundon të kryejmë mëkat. Ashtu si dhe me vdekjen fizike ne nuk mund t'i kapërcejmë vetë pasojat e mëkatit. Ne jemi të pafuqishëm pa Shlyerjen e Jezu Krishtit.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Prova ose Periudha e Provës

2 Nefi 2:21	Alma 12:21–24	Abrahami 3:25–26
2 Nefi 9:27	Alma 34:31–35	
Mosia 3:19	Alma 42:2–10	

#### Zgjedhja

2 Nefi 2:26–29	<i>Për Forcën e Rinisë, “E drejta për të zgjedhur dhe Përgjegjshmëria”</i>
Jozueu 24:15	

#### E mira dhe e Liga

Moroni 7:12–19

#### Mëkati

Romakëve 3:23	1 Gjoni 1:8–10	1 Gjoni 3:4
---------------	----------------	-------------

#### Ata që Janë të Papastër nuk Mund të Jetojë me Perëndinë

1 Nefi 10:20–21	3 Nefi 27:19	Moisiu 6:57
Alma 41:10–11		

## Shlyerja

Përpara se bota të organizohej, Ati ynë Qiellor zgjodhi Jezu Krishtin të ishte Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Sakrifika shlyese e Jezu Krishtit bëri të mundur që ne të kapërcejmë pasojat e Rënies. Të gjithë profetët, që me krijimin e botës, kanë dëshmuar se Jezu Krishti është Shëlbuesi ynë.

Të gjithë ne do të pësojmë vdekje fizike, por Jezu Krishti e kapërceu pengesën e vdekjes fizike për ne. Kur Ai vdiq në Kryq, Shpirti i Tij u nda nga trupi. Në ditën e tretë, shpirti dhe trupi i Tij u ribashkuan përjetësisht, për të mos u ndarë më kurrë. Ai iu shfaq shumë njerëzve, duke u treguar atyre se Ai kishte një trup të pavdekshëm prej mishi dhe kockash. Ribashkimi i trupit dhe shpirtit quhet ringjallje dhe është një dhuratë e premtuar secilit prej nesh. Për shkak të Ringjalljes së Jezu Krishtit, ne të gjithë do të ringjallemi pavarësisht nëse kemi bërë të mira ose të liga në këtë jetë. Ne do të kemi një trup të përkryer, të pavdekshëm prej mishi dhe kockash që kurrë më nuk do të jetë subjekt i sëmundjes, dhembjes, ose vdekjes. Ringjallja bën të mundur të kthehemi në praninë e Perëndisë për t'u gjykuar, por nuk garanton që ne do të mund të jetojmë në praninë e Tij. Për të marrë këtë bekim, ne duhet gjithashtu të pastrohemi nga mëkati.

Perëndia dërgoi Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, të kapërcente pengesën e mëkatit përveç pengesës së vdekjes fizike. Ne nuk jemi përgjegjës për Rënien e Adamit dhe Evës,



Shënime

#### Shënime

por ne jemi përgjegjës për mëkatet tona. Perëndia nuk mund të shikojë mëkatin as me lëshimin më të vogël dhe mëkati na ndalon të jetojmë në praninë e Tij. Vetëm me anë të hirit dhe mëshirës së Shpëtimtarit ne mund të pastrohemi nga mëkati që të mund të jetojmë përsëri me Perëndinë. Kjo është e mundur me anë të ushtrimit të besimit në Jezu Krisht, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund.

Për të përmbushur planin e shpëtimit, Krishti pagoi dënimin për mëkatet tona. Vetëm Ai ishte i aftë ta bënte këtë. Ai u thirr dhe u përgatit në jetën paratokësore. Ai ishte Biri i vërtetë i Perëndisë në mish. Ai ishte pa mëkat dhe plotësisht i bindur ndaj Atit të Tij. Megjithëse e tunduan, Ai kurrë nuk iu dorëzua tundimit. Kur Ati i kërkoi Birit të Tij të Dashur të paguante çmimin e mëkateve të botës, Jezusi ishte i përgatitur dhe i gatshëm. Shlyerja përfshiu vuajtjen e Tij në Kopshtin e Gjetsemanit dhe vuajtjen e vdekjen e Tij në kryq dhe përfundoi me Ringjalljen e Tij. Ndonëse Ai vuajti përtej të kuptuarit—aq shumë sa i rrodhi gjak nga çdo pore dhe kërkoi nëse ishte e mundur që kjo barrë të largohej prej Tij—Ai iu nënshtrua vullnetit të Atit në një shprehje të lartë dashurie për Atin e Tij dhe për ne. Ky triumf i Jezu Krishtit mbi vdekjen shpirtërore me anë të vuajtjes së Tij dhe mbi vdekjen fizike me anë të ringjalljes së Tij quhet Shlyerja.

Krishti premtonte të na falë mëkatet tona me kusht që ne ta pranojmë Atë duke ushtruar besim në Të, të pendohemi, të pagëzohemi me anë të zhytjes në ujë dhe vënies së duarve për dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe të përpiqemi me besnikëri të mbajmë urdhërimet e Tij deri në fund të jetës sonë. Me anë të pendimit të vazhdueshëm, ne mund të falemi dhe të pastrohemi nga mëkatet tona nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë. Ne lehtësohemi nga barra e fajit dhe turpit dhe me anë të Jezu Krishtit bëhemi të denjë për t'u kthyer në praninë e Perëndisë.

Kur mbështetemi në Shlyerjen e Jezu Krishtit, Ai mund të na ndihmojë të durojmë sprovat, sëmundjet dhe dhembjet tona. Ne mund të mbushemi me gëzim, paqe dhe ngushëllim. Gjithçka që është e padrejtë në jetë mund të ndreqet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Ndonëse Jezusi pagoi dënimin për mëkatet tona, Ai nuk eliminoi përgjegjësinë tonë personale. Ne duhet të tregojmë se e pranojmë Atë dhe se do të ndjekim urdhërimet e Tij. Vetëm me anë të dhuratës së Shlyerjes ne mund të kthehemi të jetojmë me Perëndinë.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Ringjallja

2 Nefi 9:6–7

Alma 11:42–45

Alma 40:23

Helamani 14:15–19

DeB 88:27–32

Lluka 24:1–10, 36–39

1 Korintasve 15:20–23

PJS, 1 Korintasve 15:40–42

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,

“Vdekje, Fizike,” “Vdekje,

Shpirtërore,” “Ringjallje”

##### Shlyerja

2 Nefi 2:6–8

Alma 7:11–13

Alma 34:8–10

DeB 19:15–19

DeB 45:3–5

Gjoni 3:16–17

1 Gjoni 1:7

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,

“Shlyej, Shlyerje”

##### Ungjilli—Udha

2 Nefi 9:1–24

2 Nefi 31

Alma 11:40

3 Nefi 11:31–41

3 Nefi 27

Moroni 7:27–28

## Bota e Shpirtrave

Edhe pse Krishti mposhti vdekjen fizike, të gjithë njerëzit duhet të vdesin, sepse vdekja është pjesë e procesit me anë të të cilit ne transformohemi nga vdekshmëria në pavdekshmëri. Kur vdesim, shpirtrat tanë shkojnë në botën e shpirtrave. Vdekja nuk e ndryshon karakterin tonë ose dëshirat tona për të mirën apo për të ligën. Ata që zgjedhin t'i binden Perëndisë në këtë jetë jetojnë në një gjendje lumturie, paqeje dhe prehen nga hallet e shqetësimit. Ata që zgjedhin të mos binden në këtë jetë dhe nuk pendohen, jetojnë në një gjendje mjerimi. Në botën e shpirtrave ungjilli u predikohet atyre që nuk iu bindën ungjillit ose nuk kishin mundësi ta dëgjonin atë kur ishin në tokë. Ne qëndrojmë në botën e shpirtrave derisa të ringjallemi.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Ungjilli u Predikohet të Vdekurve

DeB 138                                      1 Pjetrit 3:19–20                                      1 Pjetrit 4:6

#### Vdekja dhe Bota e Shpirtrave

Alma 34:34                                      Alma 40:11–14                                      Predikuesit 12:7

## Ringjallja, Gjykimi dhe Pavdekësia

Kur trupat dhe shpirtrat tanë të ribashkohen me anë të ringjalljes, ne do të çohemi në praninë e Perëndisë për t'u gjykuar. Ne do të kujtojmë në mënyrë të përkryer drejtësinë dhe fajet tona. Nëse pendohemi, do të marrim mëshirë. Ne do të shpërblehemi sipas veprave dhe dëshirave tona.

Nëpërmjet ringjalljes të gjithë njerëzit do të bëhen të pavdekshëm—ata do të jetojnë përgjithmonë. Pavdekësia është një dhuratë falas për të gjithë njerëzit, qofshin ata të drejtë ose të ligj. Megjithatë jeta e përjetshme nuk është njëllëj si pavdekësia. Jeta e përjetshme është një dhuratë e Perëndisë që u jepet vetëm atyre që i binden ungjillit të Tij. Ajo është shkalla më e lartë që ne mund të arrijmë. Ajo u vjen atyre që janë çliruar nga mëkati dhe vuajtjet me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Jeta e përjetshme është ekzaltim, që do të thotë të jetosh me Perëndinë përgjithmonë në familje të përjetshme. Ajo është të njohësh Perëndinë dhe Jezu Krishtin dhe të provosh jetën që ata jetojnë.

### Ringjallja dhe Rimishërimi

Disa njerëz mund ta ngatërrojnë doktrinën e ringjalljes me konceptin e rimishërimit. Koncepti i rimishërimit përfshin të rilindurit në botë në një formë tjetër dhe është doktrinë e rreme. Doktrina e ringjalljes përfshin marrjen e shpërblimit të përjetshëm të një trupi të pavdekshëm prej mishi dhe kocke. Kjo është doktrinë e vërtetë. Sigurohuni që ata të cilët ju mësoni ta kuptojnë qartë doktrinën e ringjalljes.

## Mbretëritë e Lavdisë

Gjatë jetës sonë të vdekshme ne bëjmë zgjedhje për sa i përket së mirës dhe së ligës. Perëndia na shpërblen sipas veprave dhe dëshirave tona. Duke qenë se Perëndia e shpërblen secilin sipas veprave të bëra në trup, ekzistojnë mbretëri të ndryshme të lavdisë ku ne mund të caktohem pas Gjykimit. Ata që janë penduar për mëkatet e tyre, dhe kanë marrë

Shënime

Shënime

ordinancat e ungjillit, dhe kanë mbajtur besëlidhjet që i shoqërojnë ato, do të pastrohen me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ata do të marrin ekzaltim në mbretërinë më të lartë, që gjithashtu njihet si mbretëria çelestiale. Ata do të jetojnë në praninë e Perëndisë, do të bëhen si Ai dhe do të marrin një plotësi gëzimi. Ata do të jetojnë së bashku me ata pjesëtarë të familjes së tyre që janë të denjë. Në shkrimet e shenjta kjo mbretëri krahasohet me lavdinë ose shkëlqimin e diellit.

Njerëzit që nuk e pranojnë plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit, por jetojnë në mënyrë të ndershme do të marrin një vend në mbretërinë terestriale. Kjo mbretëri krahasohet me lavdinë e hënës.

Ata që kanë vazhduar me mëkatet e tyre dhe nuk janë penduar në këtë jetë do të marrin shpërblimin e tyre në mbretërinë më të ulët, që quhet mbretëria telestiale. Kjo mbretëri krahasohet me lavdinë e yjeve.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Ringjallja dhe Rivendosja

2 Nefi 9:14–15                      Jakobi 6:8–9 (LiM)                      Alma 42:13–15, 22–23

##### Gjykimi

2 Nefi 28:23                      Alma 5:15–21                      DeB 132:12; 137:9  
Mosaia 3:23–25                      Alma 12:12–14                      Gjoni 5:22

##### Mbretëritë e Lavdisë

3 Nefi 28:10                      DeB 76                      Mateu 5:48  
DeB 76: Hyrje                      DeB 137                      1 Korintasve 15:40–42

##### Jeta e Përvetshme

2 Nefi 31:17–21                      DeB 45:8                      Gjoni 3:16  
DeB 14:7                      DeB 93:19                      Gjoni 17:3  
DeB 29:43–44

#### Plani i Shpëtimit



Shlyerja e Jezu Krishtit e bën shpëtimin të mundshëm.

#### Ftesë për t'u Pagëzuar

Ftesa për t'u pagëzuar dhe konfirmuar duhet të jetë specifike dhe e drejtpërdrejtë: “A do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit duke u pagëzuar nga dikush që mban autoritetin e priftërisë së Perëndisë? Ne do të zhvillojmë një shërbesë pagëzimi në [datën]. A do të përgatiteni për t'u pagëzuar në atë datë?”

## Ide për Mësimdhënie

Ky seksion përmban ide për t'u përdorur nga ana juaj gjatë përgatitjes dhe dhënies së këtij mësimi. Me lutje ndiqni Shpirtin ndërsa vendosni si t'i përdorni këto ide. Shtoni idetë që zgjidhni në planin tuaj mësimor. Mbani mend se këto ide janë sugjerime—jo kërkesa—për t'ju ndihmuar të plotësoni nevojat e atyre që mësoni.

### Plan i Shkurtër Mësimi (3–5 minuta)

Plani i shpëtimit na mëson nga vijnë, pse jemi këtu në tokë dhe ku do të shkojmë pas kësaj jete. Ai shënon udhëtimin tonë të përjetshëm përmes jetës para lindjes, jetës së vdekshme, vdekjes, ringjalljes dhe jetës sonë në përjetësi. Plani gjithashtu shpjegon se çfarë bën Ati ynë i Dashur në Qiell për të na ndihmuar ta kryejmë këtë udhëtim me sukses që kështu ne të mund të kthehemi në praninë e Tij dhe të bëhemi si Ai. Plani përqendrohet në misionin dhe Shlyerjen e Jezu Krishtit, në kapërcimin e pasojave të Rënies dhe bërjen të mundur të jetës së përjetshme për ne. Ne ju ftojmë të meditonit dhe të luteni rreth këtij mesazhi.

- Jeta Paratokësore: Qëllimi dhe Plani i Perëndisë për Ne
- Krijimi
- Liria e zgjedhjes dhe Rënia e Adamit dhe Evës
- Jeta Jonë në Tokë
- Shlyerja
- Bota e Shpirtrave
- Ringjallja, Gjykimi dhe Pavdekësia
- Mbretëritë e Lavdisë

### Zotime

- A do të luteni për të ditur se ajo që ju kemi mësuar është e vërtetë?
- A do të pendoheni për mëkatet tuaja?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A do ta ndiqni shembullin e Shpëtimtarit dhe të pagëzoheni në (datën)?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

### Plan Mesatar Mësimi (10–15 minuta)

Mesazhi ynë na ndihmon të kuptojmë qëllimin e jetës dhe se kush jemi ne. Ai na jep shpresë dhe na ndihmon të gjejmë paqe, gëzim dhe lumturi. Ai na tregon nga vijnë, pse jemi këtu në tokë dhe ku do të shkojmë pas kësaj jete. Perëndia është Ati ynë dhe Ai na do. Ne jemi fëmijët e Tij. Ne jemi pjesë e familjes së Tij dhe ne jetuam me Të përpara se të lindim në këtë tokë. Ai ka një plan lumturie që na bën të mundur të kthehemi në praninë e Tij pas kësaj jete. Përparimi ynë varet nga ajo se si ne e përdorim lirinë e zgjedhjes që na është dhënë nga Perëndia, ose aftësinë për të zgjedhur. Si një pjesë e atij plani, Rënia e Adamit bëri të mundur që ne të vijmë në tokë, të marrim një trup fizik, të fitojmë përvojë dhe të kemi familjet tona. Por Rënia gjithashtu, solli vdekjen fizike, që

Shënime

#### Shënime

është ndarja e shpirtit nga trupi dhe vdekjen shpirtërore, që është ndarja nga Perëndia.

Jezusi është qendra e planit të Perëndisë. Sakrifica shlyese e Krishtit kapërceu pasojat si të vdekjes fizike ashtu dhe të vdekjes shpirtërore. Ne të gjithë do të ringjallemi dhe do të jetojmë përjetësisht me trupa fizikë të çliruar nga dhembja dhe sëmundjet. Krishti gjithashtu bëri të mundur të kapërcejmë vdekjen shpirtërore. Ndërsa ne jetojmë ungjillin e Tij Ai me mëshirë do të na falë mëkatet tona. Ai do të na shërojë dhe do ta zëvendësojë fajin dhe turpin me paqe dhe lumturi në këtë jetë.

Si pjesë e planit të mëshirshëm të Perëndisë, ne të gjithë do të pësojmë një vdekje fizike. Shpirtrat tanë do të ndahen nga trupat tanë dhe do të jetojnë për një kohë në botën e shpirtrave. Më pas do të ringjallemi me një trup të pavdekshëm, një bashkim i përjetshëm i trupit dhe shpirtit tonë. Ne do të gjykohe mi sipas veprave dhe dëshirave tona. Ata që kanë jetuar ungjillin do të marrin dhuratën më të madhe të Atit tonë në Qiell, dhuratën e jetës së përjetshme në praninë e Tij.

Ati ynë Qiellor i është afuar përsëri me dashuri fëmijëve të Tij për të zbuluar planin e Tij të lumturisë. Ne mësojmë rreth këtij plani të mrekullueshëm në Librin e Mormonit, të cilin ju mund ta lexoni, mund të meditoni dhe të luteni rreth tij. Ne ju ftojme të vini në kishë dhe të adhuroni me ne.

#### Zotime:

- A do të luteni për të ditur se ajo që ju kemi mësuar është e vërtetë?
- A do të pendoheni për mëkatet tuaja?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A do ta ndiqni shembullin e Shpëtimtarit dhe të pagëzoheni në (datën)?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

#### Plan i Plotë Mësimi (30–45 minuta)

- Jeta Paratokësore: Qëllimi dhe Plani i Perëndisë për Ne
  - Perëndia është Ati ynë Qiellor dhe ne jemi fëmijët e Tij (shih Veprat e Apostujve 17:16–34; Hebrenjve 12:9).
  - Perëndia ka një plan për lumturinë tonë. Jezu Krishti është qendra e atij plani.
  - Plani i Perëndisë për lumturinë bën të mundur të kthehemi në praninë e Tij (shih Moisiu 1:39).
  - Përparimi ynë i përjetshëm varet nga mënyra se si e përdorim lirinë e zgjedhjes (shih 2 Nefi 2:27–29).
- Krijimi
  - Nën drejtimin e Atit, Jezu Krishti krijoi tokën (shih Hebrenjve 1:1–3).

## Shënime

- Liria e zgjedhjes dhe Rënia e Adamit dhe Evës
  - Adami dhe Eva u krijuan sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë (shih Zanafilla 1:26–27).
  - Në Kopshtin e Edenit ata ishin të pafajshëm dhe jetonin në praninë e Perëndisë.
  - Për shkak se ata hëngrën nga fruti i ndaluar, ata u dëbuan nga kopshti (shih Moisiu 4:19–31). Kjo quhet Rënie.
  - Ata u bënë të vdekshëm, mund të kishin fëmijë dhe u bënë gjithashtu subjekt i mëkatit dhe vdekjes (shih 2 Nefi 2:22–25; Moisiu 5:11).
- Jeta Jonë në Tokë
  - Qëllimi ynë në jetë është të gjejmë paqe, gëzim dhe lumturi të përhershme si familje dhe të përgatitemi të kthehemi për të jetuar me Perëndinë.
  - Ne erdhëm në tokë për t'u provuar (shih Abrahami 3:24–25).
  - Ne morëm një trup prej mishi dhe kockash, por jemi subjekt i vdekjes fizike.
  - Perëndia jep urdhërime. Në qoftë se bindemi, ne jemi të bekuar. Në qoftë se nuk bindemi, mëkatojmë dhe mbartim pasojat.
  - Për të gjithë mëkatet duhet paguar, ose vetë ose me anë të Krishtit (shih DeB 19:15–20).
  - Ne bëjmë zgjedhje dhe të gjithë kryejmë mëkat (shih Romakëve 3:23).
  - Ne kemi përvoja që na sjellin lumturi si edhe trishtim.
  - Ne nuk mund të kapërcejmë as vdekjen fizike dhe as vdekjen shpirtërore pa Krishtin.
- Shlyerja
  - Për shkak se Jezu Krishti kapërceu vdekjen fizike, ne të gjithë do të ringjallemi (shih Alma 11:41–43).
  - Me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit ne mund të pastrohemi nga mëkati që kështu të mund të kthehemi të jetojmë në praninë e Perëndisë (shih 2 Nefi 9:8–9).
  - Krishti do të na falë mëkatet tona, ndërsa kemi besim tek Ai, pendohemi, pagëzohemi dhe marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe durojmë deri në fund.
- Bota e Shpirtrave
  - Të gjithë njerëzit duhet të vdesin.
  - Kur vdesim, shpirtrat tanë shkojnë në botën e shpirtrave.
  - Aty jetojmë ose në një gjendje të mjeruar ose në një gjendje paqeje dhe prehje, në varësi të mënyrës si kemi jetuar në këtë jetë.
- Ringjallja, Gjykimi dhe Pavdekësia
  - Shpirtrat dhe trupat tanë do të ribashkohen në ringjallje (shih Alma 11:42–45; 40:23).

#### Shënime

- Ne do të kthehemi në praninë e Perëndisë për t'u gjykuar sipas veprave dhe dëshirave tona.
- Nëse jemi penduar, do të marrim mëshirë.
- Jeta e përjetshme është një dhuratë e Perëndisë që u jepet atyre që i binden plotësisht ungjillit të Jezu Krishtit (shih DeB 14:7).
- Mbretëritë e Lavdisë (shih DeB 76; 137; 1 Korintasve 15:40–42).
  - Ne shpërblehemi sipas veprave dhe dëshirave tona (shih DeB 137:9).
  - Ata që e pranojnë ungjillin dhe e jetojnë atë me guxim gjatë gjithë jetës së tyre do të marrin mbretërinë çelestiale (shih DeB 76:50–70).
  - Njerëzit e nderuar që janë verbuar nga dinakëria e njerëzve dhe nuk janë të guximshëm në dëshminë e Jezu Krishtit marrin mbretërinë terestriale (shih DeB 76:75, 79).
  - Ata që mëkatojnë dhe nuk pendohen do të marrin lavdinë telestiale pasi të vuajnë dhe të paguajnë për mëkatet e tyre.

#### Zotime

- A do të luteni për të ditur se ajo që ju kemi mësuar është e vërtetë?
- A do të pendoheni për mëkatet tuaja?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A do të ndiqni shembullin e Shpëtimtarit dhe të pagëzoheni në (datën)?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

#### Pyetje në Fund të Mësimi

- Çfarë pyetjesh keni rreth asaj që ju kemi mësuar?
- Çfarë kuptoni rreth planit të Perëndisë për ju dhe familjen tuaj?
- Nga ajo që ju kemi mësuar, çfarë kuptoni ju rreth rolit të Jezu Krishtit? Ç'është kjo për ju?

#### Përkufizime të Rëndësishme

Më poshtë gjenden terma që shpesh nuk kuptohen: Sigurohuni që t'i shpjegoji ato qartë dhe zbuloni nëse ata që ju mësoni i kuptojnë ato.

- **Ekzaltim:** Jetë e përjetshme në praninë e Perëndisë; të bëhemi si Ati ynë në Qiell dhe të jetojmë në praninë e Tij. Dhurata më e madhe nga të gjitha dhuratat e Perëndisë. Ekzaltimi vjen me anë të Shlyerjes së Krishtit dhe me anë të bindjes ndaj të gjitha ligjeve dhe ordinancave të ungjillit.
- **Gjykim:** Perëndia, me anë të Jezu Krishtit, do të na gjykojë individualisht për të përcaktuar lavdinë e përjetshme që do të marrim. Ky gjykim do të bazohet në bindjen tonë ndaj urdhërimeve të Perëndisë, duke përfshirë pranimin nga ana jonë të sakrificës shlyese të Jezu Krishtit. Ne do të marrim shpërblimin tonë të përjetshëm bazuar në veprat dhe dëshirat tona nëse ato kanë qenë të mira apo të liga.



## Shënime

- **Jetë Para Lindjes:** (ekzistencë para lindjes; jetë paratokësore): Si fëmijë shpirtërorë të Atit tonë në Qiell, ne jetonim në praninë e Tij përpara se të lindeshim në këtë tokë. Në jetën para lindjes ne nuk kishim trupa fizike.
- **Pavdekësi:** Kushti i të jetuarit përgjithmonë në një gjendje të ringjallur, jo subjekt i vdekjes fizike.
- **Rënie:** (e Adamit dhe Evës): Kur Adami dhe Eva hëngrën frutin e ndaluar, ata u bënë të vdekshëm—që do të thotë, subjekt i mëkatit dhe vdekjes. Adami u bë i pari mish mbi tokë (shih Moisiu 3:7). Zbulesa e ditëve të mëvonshme bën të qartë se Rënia është një bekim dhe se Adami dhe Eva duhet të nderohen si prindërit e parë të të gjithë njerëzimit.
- **Ringjallje:** Ribashkimi i trupit shpirtëror me trupin fizik prej mishi dhe kockash mbas vdekjes. Mbas ringjalljes, shpirti dhe trupi nuk do të ndahen më kurrë dhe personi bëhet i pavdekshëm. Çdo person i lindur në tokë do të ringjallet, sepse Jezu Krishti e mposhti vdekjen.
- **Shëlbim:** Të çlirosh, të blesh, ose të shpengosh, si për shembull të lirosh një person nga robëria me anë të pagesës. Shëlbimi i referohet Shlyerjes së Jezu Krishtit dhe çlirimit nga mëkati. Shlyerja e Jezusit shëlboi gjithë njerëzimin nga vdekja fizike. Me anë të Shlyerjes së Tij, ata që kanë besim në Të dhe pendohen janë gjithashtu të shëlbuar nga vdekja shpirtërore.
- **Shpëtim:** Të shpëtoesh nga vdekja shpirtërore dhe fizike. Të gjithë njerëzit do të shpëtohen nga vdekja fizike nëpërmjet hirit të Perëndisë, me anë të vdekjes dhe ringjalljes së Jezu Krishtit. Çdo individ mund të shpëtohet gjithashtu nga vdekja shpirtërore nëpërmjet hirit të Perëndisë, me anë të besimit në Jezu Krisht. Ky besim tregohet nëpërmjet një jete të bindur ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit dhe shërbimit ndaj Krishtit.
- **Shlyerje:** Në mënyrën e përdorur në shkrimet e shenja, të shlyesh do të thotë të vuash dënimin për një vepër mëkati, duke hequr kështu pasojat e mëkatit nga mëkatarët e penduar dhe duke i lejuar ata të pajtohen me Perëndinë. Jezu Krishti vuajti në Gjetseman dhe në kryq. Ai ishte i vetmi që mund të bënte një Shlyerje të përkryer për mbarë njerëzimin. Ai vuajti dënimin për mëkatarët tona në Gjetseman dhe vdiq në kryq. Ai mori mbi Vete dhimbjet, sëmundjet, tundimet, mjerimet dhe dobësitë e të gjithëve ne (shih Alma 7:11–12).
- **Vdekje Fizike:** Ndarja e shpirtit tonë, i cili jeton përgjithmonë dhe nuk mund të vdesë, nga trupi ynë fizik.
- **Vdekje Shpirtërore:** Ndarja nga Perëndia dhe ndikimi i Tij; të vdesësh për sa i përket gjërave që kanë të bëjnë me drejtësinë. Vdekja shpirtërore hyri në botë me rënien e Adamit (shih Alma 42:6–7). Njerëzit e vdekshëm që kanë mendime, fjalë, vepra të këqija, janë shpirtërisht të vdekur ndërkohë që ata jetojnë akoma në tokë (shih 2 Nefi 9:39). Me anë të shlyerjes së Jezu Krishtit dhe në varësi nga bindja ndaj parimeve dhe ordinancave të ungjillit, burrat dhe gratë mund të pastrohen nga mëkati dhe të kapërcejnë vdekjen shpirtërore.
- **Vdekshmëri:** Koha nga lindja deri në vdekjen fizike.

## Terma të Tjera që Mund të Kenë Nevojë për Përkufizime të Mëtejshme

- |                           |                            |  |
|---------------------------|----------------------------|--|
| • Besim                   | • Krijim                   | • Pema e njohurisë të së mirës dhe të së keqes |
| • Bota e shpirtave        | • Kopshti i Edenit         | • Përparim i përjetshëm                        |
| • Çelestial               | • Kundërshtim              | • Plani i shpëtimit                            |
| • Falje [e mëkatit]       | • Mbretëritë e lavdisë     | • Provë  |
| • Frut i ndaluar          | • Mëkat                    | • Telestial                                    |
| • I pastruar [nga mëkati] | • Pagëzim me zhytje në ujë | • Terrestrial                                  |
| • Jetë e përjetshme       | • Pendim                   | • Vdekje fizike                                |

Shënime

# Ungjilli i Jezu Krishtit



## Qëllimi Juaj

Ndërsa mësoni kërkuesit, përgatitini ata të plotësojnë kërkesat për pagëzim që na mësohen në Doktrina e Besëlidhje 20:37 dhe në pyetjet e intervistës së pagëzimit. Kjo arrihet më mirë duke i ftuar kërkuesit tuaj të marrin dhe të mbajnë zotimet e renditura më poshtë.

### Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit

- A besoni ju se Perëndia është Ati ynë i Amshuar?
- A besoni ju se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës?
- A besoni ju se Kisha dhe ungjilli i Jezu Krishtit u rivendos me anë të Profetit Jozef Smith?

### Zotime

- A do vazhdoni të zhvilloni besim në Jezu Krisht duke vazhduar të mësoni rreth ungjillit të Tij?
- A do të pendoheni dhe luteni për faljen e mëkateve?
- A do të pagëzoheni si anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në (datë)? A do të konfirmoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërimet nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

## Me Anë të Krishtit Ne Mund Të Pastrohemi nga Mëkati

Perëndia e dërgoi në botë Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, që kështu të gjithë fëmijët e Perëndisë të mund të kenë mundësinë të kthehen për të jetuar në praninë e Tij pasi të vdesin. Vetëm me anë të hirit dhe mëshirës së Shpëtimtarit ne mund të pastrohemi nga mëkati që kështu të mund të jetojmë në praninë e Atit tonë Qiellor. Pastrimi nga mëkati do të thotë të shërohesh shpirtërisht (shih 3 Nefi 9:13; 18:32).

Për shkak të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Krishtit, të gjithë njerëzit do të kthehen në praninë e Zotit për t'u gjykuar sipas veprave dhe dëshirave të tyre (shih 2 Nefi 9:10–16; Helamani 14:15–18; 3 Nefi 27:14–22; DeB 137:9). Ne do të gjykohejmë në bazë të ligjeve të drejtësisë dhe mëshirës.

Drejtësia është ligj i pandryshueshëm që sjell pasoja për veprimet—bekime për bindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë dhe ndëshkime për mosbindje. Ne të gjithë kryejmë

mëkat. Mëkati na bën të papastër dhe asgjë e papastër nuk mund të jetojë në prani të Perëndisë (shih 1 Nefi 10:21; 3 Nefi 27:19; Moisiu 6:57).

Shpëtimtari plotësoi kërkesat e drejtësisë për ata që pendohen për mëkatet e tyre dhe përpiqen të mbajnë të gjitha urdhërimet e Tij kur Ai qëndroi në vendin tonë dhe vuajti dënimin për mëkatet tona. Ky akt është quajtur Shlyerje. Për shkak të këtij akti vetëmohimi, Krishti mund të ndërhyjë te Ati në emrin tonë. Ati Qiellor mund të na japë mëshirë, të tërheqë ndëshkimin nga ne dhe të na mirëpresë në praninë e Tij. Ati ynë Qiellor tregon mëshirë kur Ai na fal për mëkatet tona dhe na ndihmon të kthehemi për të banuar në praninë e Tij.

Megjithatë, Jezusi nuk e eliminoi përgjegjësinë tonë personale. Ai na i fal mëkatet kur ne e pranojmë Atë, pendohemi dhe i bindemi urdhërimeve të Tij. Me anë të Shlyerjes dhe duke jetuar ungjillin ne bëhemi të denjë për të hyrë në prani të Atit tonë Qiellor përgjithmonë. Ne duhet të tregojmë se e pranojmë Krishtin dhe se kemi besim tek Ai duke mbajtur urdhërimet e Tij dhe duke iu bindur parimeve dhe ordinancave të para të ungjillit.

### Mëkat

Nocioni “mëkat” ka kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme. Në disa kultura ai lidhet ngushtë me konceptin e të kryerit krim. Në kultura të tjera përdoret vetëm nëse dikush kapet duke bërë diçka të gabuar duke i sjellë kështu turp familjes ose komunitetit. Sqaroni se mëkat do të thotë mosbindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë dhe se mëkati çon në ndarje nga Perëndia. Perëndia di gjithçka që ne bëjmë dhe mendojmë dhe Ai është i pakënaqur kur mëkatojmë. Mos diskutoni për shkeljet tuaja të kaluara. Mos i lejoni kërkuesit ose u thoni atyre të mos diskutojnë për shkeljet e tyre.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Perëndia Dërgoi Birin e Tij

Alma 11:40

Gjoni 3:16–17

#### Krishti Është Avokati Ynë

DeB 45:3–5

#### Shpëtim me anë të Krishtit

2 Nefi 2:6–8

Alma 34:8–9, 14–16

#### Mëshirë dhe Drejtësi

Mosia 15:9

Alma 42:22–25

2 Nefi 9:21–24

## Besim në Jezu Krisht

Parimi i parë i ungjillit është besimi në Zotin Jezu Krisht. Besimi në Krisht përfshin të paturit e një besimi të patundur që Ai është Biri i Vetëmlindur i Perëndisë dhe Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës. Ne e pranojmë se mund të kthehemi të jetojmë me Atin tonë Qiellor vetëm duke u mbështetur në hirin dhe mëshirën e Birit të Tij. Kur kemi besim në Krisht, ne pranojmë dhe zbatojmë Shlyerjen dhe mësimet e Tij. Ne kemi mirëbesim tek Ai dhe tek ajo që Ai thotë. Ne e dimë se Ai ka fuqinë të mbajë premtimet e Tij. Ati Qiellor i bekon ata që kanë besim t’i binden Birit të Tij.

Besimi në Krisht çon në veprim. Ai çon në pendim të sinqertë dhe të vazhdueshëm. Besimi na nxit të përpiqemi sa më fort të mundemi që të mësojmë dhe të bëhemi më shumë si Shpëtimtari.



Shënime

Ne duam të mësojmë se cilat janë urdhërimet e Tij dhe më pas t'u bindemi atyre. Edhe pse ende bëjmë gabime, ne e tregojmë dashurinë tonë për Të duke u përpjekur të mbajmë urdhërimet e Tij dhe duke shmangur mëkatet.

Ne besojmë në Krisht dhe besojmë se Ai dëshiron që ne të mbajmë të gjitha urdhërimet e Tij. Ne duam të tregojmë besimin tonë duke iu bindur Atij. Ne lutemi me besim për forcë që të mposhtim tundimin. Ne gjithashtu mund të zhvillojmë besim në një parim të veçantë, siç është Fjala e Urtësisë ose pagimi i së dhjetës, në radhë të parë duke besuar në Jezu Krisht aq fort sa t'u bindemi urdhërimeve të Tij. Ndërsa jetojmë një urdhërim të caktuar, ne mësojmë vërtetësinë e tij nga përvoja (shih Gjoni 7:17). Ne gjithashtu rritemi në besim duke dëgjuar fjalën e Perëndisë (shih Romakëve 10:17) dhe duke e lexuar fjalën e Perëndisë (shih Helamani 15:7–8).

Kur i bindemi Perëndisë, Ai na bekon. Ai na jep fuqi të përballojmë sfidat e jetës. Ai na ndihmon të ndryshojmë dëshirat e zemrave tona. Me anë të besimit tonë në Jezu Krisht, Ai mund të na shërojë, si fizikisht ashtu edhe shpirtërisht.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Besim, Fuqi dhe Shpëtim

1 Nefi 7:12                      Moroni 7:33–34  
2 Nefi 9:23                      Moroni 10:7  
2 Nefi 25:23

##### Doktrina e Besimit

Alma 32                              Udhëzuesi për Shkrimet  
Efesianëve 2:8                      e Shenjta, "Besim"

##### Shembuj të Besimit

Ethëri 12                              Hebrejve 11

##### Vepra dhe Bindje

1 Nefi 3:7                              Jakobi 2:17–26  
DeB 130:20–21                      (Dhjata e Re)

##### Besim deri në Pendim

Alma 34

### Pendimi

Parimi i dytë i ungjillit është pendimi. Besimi ynë në Krisht dhe dashuria jonë për Të na bën të pendohemi, ose të ndryshojmë mendimet, besimet dhe sjelljet tona që nuk janë në harmoni me vullnetin e Tij. Pendimi përfshin formimin e një kuptimi të ri për Perëndinë, veten tonë dhe botën. Kur pendohemi, ndiejmë trishtim sipas Perëndisë, pastaj heqim dorë nga bërja e gjërave që janë të gabuara dhe vazhdojmë të bëjmë gjëra që janë të drejta. Përputhja e jetës sonë me vullnetin e Perëndisë nëpërmjet pendimit është qëllimi kryesor i jetës sonë. Ne mund të kthehemi të jetojmë me Perëndinë, Atin, vetëm me anë të mëshirës së Krishtit dhe ne e marrim mëshirën e Krishtit vetëm në kushtet e pendimit.

Që të pendohemi, ne pranojmë mëkatet tona dhe ndiejmë keqardhje, ose trishtim sipas Perëndisë. Ne ia rrëfejme mëkatet tona Perëndisë. Ne gjithashtu ua rrëfejme mëkatet shumë serioze udhëheqësve të Kishës të autorizuar nga Perëndia, të cilët mund të na ndihmojnë të pendohemi. Ne i kërkojmë Perëndisë në lutje që të na falë. Ne bëjmë gjithçka mundim për të ndrequr problemet që mund të kenë shkaktuar veprimet tona; ky quhet rikthim. Kur pendohemi, mënyra se si e shohim veten dhe botën ndryshon. Kur ndryshojmë, ne e kuptojmë se jemi bij të Perëndisë dhe se nuk duhet të vazhdojmë të bëjmë të njëjtat gabime vazhdimisht. Nëse pendohemi sinqerisht, ne largohemi nga mëkatet tona dhe nuk i bëjmë më ato. Ne i bëjmë ballë çdo dëshire për të kryer mëkat. Dëshira jonë për të ndjekur Perëndinë bëhet më e fortë dhe më e madhe.

Pendimi i sinqertë sjell disa rezultate. Ne ndiejmë faljen e Perëndisë dhe paqen e Tij në jetën tonë. Fajet dhe trishtimet tona largohen. Ne ndiejmë ndikimin e Shpirtit me një bollëk më të madh. Dhe kur të largohemi nga kjo jetë, do të jemi më të përgatitur për të jetuar me Atin tonë Qiellor dhe Birin e Tij.

Edhe pasi ta kemi pranuar Krishtin dhe të jemi penduar për mëkatet tona, ne mund të gabojmë dhe të mëkatojmë përsëri. Ne duhet të përpiqemi vazhdimisht t'i korrigjojmë këto shkelje. Përveç kësaj, ne duhet të përmirësohemi vazhdimisht—të zhvillojmë cilësi si të Krishtit, të rritemi në njohuri dhe të shërbejmë me më efektivitet. Kur mësojmë më shumë rreth asaj se çfarë Shpëtimtari pret nga ne, do të kemi dëshirë të tregojmë dashurinë tonë duke iu bindur Atij. Kështu, ndërsa pendohe mi çdo ditë, do të zbulojmë se jeta jonë do të ndryshojë dhe do të përmirësohet. Zemrat tona dhe sjelljet tona do të bëhen më shumë si të Krishtit. Ne do të ndiejmë gëzim të madh në pendimin e përditshëm.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Ne të Gjithë Mëkatojmë

Romakëve 3:23      1 Gjoni 1:7–8

#### Pendimi

Alma 34:8–17      2 Korintasve 7:9–10  
DeB 58:42–43      Udhëzuesi për Shkrimet  
DeB 61:2            e Shenjta, “Pendohem,  
Pendim”

#### Shëlbim dhe Falje

Helamani 5:10–11

#### Mëshira Kërkon të Penduarin

Alma 12:32–35  
Alma 42:13, 21–24  
DeB 18:10–13

## Pagëzimi, Besëlidhja Jonë e Parë

Besimi në Jezu Krisht dhe pendimi na përgatisin për ordinancat e pagëzimit dhe të konfirmimit. Një ordinancë është një ceremoni ose rit i shenjtë, që tregon se kemi hyrë në një besëlidhje me Perëndinë.

Perëndia gjithmonë u ka kërkuar fëmijëve të Tij të bëjnë besëlidhje. Një besëlidhje është një marrëveshje detyruese dhe solemne midis Perëndisë dhe njeriut. Perëndia premton të na bekojë dhe ne i premtojmë se do t'i bindemi Atij. Perëndia vendos kushtet e besëlidhjeve të ungjillit, të cilat ne ose i pranojmë ose nuk i pranojmë. Mbajtja e besëlidhjeve sjell bekime në këtë jetë dhe ekzaltim në jetën që do të vijë.

Besëlidhjet na vendosin nën një detyrim të fortë për të nderuar zotimet që i kemi bërë Perëndisë. Për të mbajtur besëlidhjet tona, ne duhet të braktisim aktivitetet ose interesat që na pengojnë t'i nderojmë këto besëlidhje. Për shembull, ne heqim dorë nga të bërit pazar dhe aktivitetet argëtuese të dielën në mënyrë që ta mbajmë ditën e Shabatit të shenjtë. Ne duhet të kemi dëshirë t'i marrim denjësisht besëlidhjet që Perëndia na ofron dhe më pas të përpiqemi t'i mbajmë ato. Besëlidhjet tona na kujtojnë të pendohe mi çdo ditë të jetës sonë. Duke mbajtur urdhërimet dhe duke u shërbyer të tjerëve ne marrim dhe ruajmë një heqje të mëkateve.

Besëlidhjet bëhen zakonisht me anë të ordinancave të shenjta, të tilla si pagëzimi. Këto ordinanca administrohen nëpërmjet autoritetit të priftërisë. Me anë të ordinancës



## Shënime

së pagëzimit, për shembull, ne besëlidhim të marrim mbi vete emrin e Jezu Krishtit, ta kujtojmë gjithmonë Atë dhe të zbatojmë urdhërimet e Tij. Kur ne mbajmë pjesën tonë të besëlidhjes, Perëndia na premton shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, heqjen e mëkateve tona dhe se do të lindemi sërish.

Me anë të ordiancave të shenjta, të tilla si pagëzimi dhe konfirmimi, ne mësojmë dhe provojmë fuqinë e Perëndisë (shih DeB 84:20). Jezusi na mësoi se duhet të pagëzohemi me anë të zhytjes në ujë për heqjen ose faljen e mëkateve tona. Pagëzimi është një ordiancë thelbësore e shpëtimit. Asnjë person nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë pa qenë i pagëzuar. Krishti dha shembullin për ne duke u pagëzuar.

Pagëzimi me anë të zhytjes në ujë është një simbol i vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së Shpëtimtarit. Në një mënyrë të ngjashme, ai përfaqëson fundin e jetës sonë të vjetër të mëkatit dhe një zotim për të jetuar një jetë të re si një dishepull i Krishtit. Shpëtimtari na mësoi se pagëzimi është një rilindje. Kur pagëzohemi fillojmë procesin e rilindjes dhe bëhemi bij dhe bija shpirtërorë të Krishtit (shih Mosia 5:7–8; Romakëve 8:14–17).

Ne duhet të pagëzohemi për t'u bërë anëtarë të Kishës së rivendosur, Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe që në fund të hyjmë në mbretërinë e qiellit. Kjo ordiancë është një ligj i Perëndisë dhe duhet të kryhet nëpërmjet autoritetit të Tij. Një peshkop ose president misioni duhet t'i japë leje një mbajtësi të priftërisë për të kryer një pagëzim ose konfirmim.

Fëmijët e vegjël nuk është e nevojshme të pagëzohen dhe janë shëlbuar me anë të mëshirës së Jezu Krishtit (shih Moroni 8:4–24). Ata nuk duhet të pagëzohen derisa të arrijnë moshën e përgjegjshmërisë, që është mosha tetë vjeç (shih DeB 68:27).

Para pagëzimit ne tregojmë gatishmërinë tonë për të hyrë në një besëlidhje për të mbajtur të gjitha urdhërimet deri në fund të jetës sonë. Pas pagëzimit ne tregojmë besimin tonë duke mbajtur besëlidhjen tonë. Ne gjithashtu, e ripërtërijmë rregullisht besëlidhjen që bëjmë kur pagëzohemi duke marrë sakramentin. Marrja e sakramentit çdo javë është një urdhërim. Ai na ndihmon që të mbetemi të denjë për të patur Shpirtin me vete gjithmonë. Ai është një kujtesë e përjavshme e besëlidhjes sonë. Jezu Krishti ia paraqiti këtë ordiancë Apostujve përpara Shlyerjes së Tij. Ai e rivendosi atë me anë të Profetit Jozef Smith. Shpëtimtari urdhëroi që mbajtësit e priftërisë duhet ta administrojnë sakramentin në kujtim të trupit dhe të gjakut të Tij, i cili u derdh për ne. Me anë të marrjes së sakramentit denjësisht ne premtojmë ta kujtojmë gjithmonë sakrificën e Tij, ripërtërijmë premtimet tona dhe marrim përsëri premtimin se Shpirti do të jetë gjithmonë me ne.

## Përpara Pagëzimit

Sigurohuni që [kërkuesit] të kenë zhvilluar besim në Krisht, të jenë pënduar për shkeljet dhe të kenë bërë ndryshime të mjaftueshme në jetën e tyre për të qenë të përgatitur siç udhëzohet në Doktrina e Besëlidhje 20:37. Kërkuesit duhet të jetojnë parimet e denjësisë morale, Fjalën e Urtësisë dhe të zotohen për të paguar të dhjetën. Në qoftë se misionarët mendojnë se është e nevojshme një përgatitje më e madhe, ata duhet ta shtyjnë pagëzimin derisa kërkuesi të plotësojë standardin e kërkuar.

“Përpara pagëzimit çdo kërkues duhet të ketë marrë të gjitha mësimet e misionarëve, të ketë takuar peshkopin ose presidentin e degës dhe të ketë marrë pjesë në disa mbledhje sakramenti” (“Deklaratë rreth Punës Misionare,” letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002).

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

## Shembulli i Krishtit

2 Nefi 31:4–18 Mateu 3:13–17

## Besëlidhja e Pagëzimit

Mosia 5:8–10 DeB 20:37  
Mosia 18:8–10

## Kërkesa për Pagëzim

2 Nefi 9:23 Moroni 6:1–4  
Mosia 18:8–10 DeB 20:37  
Alma 7:14–15 Veprat e Apostujve  
3 Nefi 11:23–27 2:37–39

## Zoti Vendos Sakramentin

3 Nefi 18:1–18 Lluka 22:15–20

## Bekimet e Premtuara të Pagëzimit

Mosia 4:11–12, 26 Gjoni 3:5  
Moroni 8:25–26 Romakëve 6:4

## Lutjet e Sakramentit

Moroni 4 dhe 5 DeB 20:75–79

## Marrja e Sakramentit

DeB 27:2 1 Korintasve 11:23–29

## Domosdoshmëria për Autoritet

DeB 22 Hebrejve 5:4

Shënime

## Dhurata e Frymës së Shenjtë

Jezusi na mësoi se duhet të pagëzohemi me anë të ujit dhe gjithashtu të Shpirtit. Pagëzimi me anë të ujit duhet të pasohet nga pagëzimi me anë të Shpirtit përndryshe ai nuk është i plotë. Vetëm atëherë kur pagëzohemi dhe marrim dhuratën e Frymës së Shenjtë ne mund të marrim një heqje të mëkateve tona dhe të bëhemi plotësisht të rilindur shpirtërisht. Ne pastaj fillojmë një jetë të re shpirtërore si dishepuj të Krishtit.

Pasi një person pagëzohet me anë të ujit, një ose më shumë mbajtës të autorizuar të priftërisë vendosin duart mbi kokën e personit dhe e konfirmojnë atë një anëtar të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ata më pas i japin atij dhuratën e Frymës së Shenjtë.

Ata që marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe mbeten të denjë, mund të gëzojnë shoqërimin e Tij gjatë gjithë jetës së tyre. Fryma e Shenjtë ka një efekt shenjtërimi dhe pastrimi mbi ne. Fryma e Shenjtë dëshmon për Jezu Krishtin dhe na ndihmon të njohim të vërtetën. Fryma e Shenjtë na jep forcë shpirtërore dhe na ndihmon të bëjmë atë që është e drejtë. Ai na ngushëllon në kohë sprovash ose trishtimi. Ai na paralajmëron për rreziqet shpirtërore ose fizike. Fryma e Shenjtë na jep fuqinë me anë të së cilës ne mund të mësojmë të tjerët dhe veten. Dhurata e Frymës së Shenjtë është një nga dhuratat më të çmuara të Atit tonë Qiellor. Me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë ne mund të ndiejmë drejtimin dhe dashurinë e Perëndisë për ne. Kjo dhuratë është një shije paraprake e gëzimit të përhjetshëm dhe një premtim i jetës së përhjetshme.

Autoriteti i priftërisë që duhet për ta kryer këtë ordinancë, i cili humbi shekuj më parë si rezultat i braktisjes, u rivendos me anë të Profetit Jozef Smith. Një njeri mund ta marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë vetëm me anë të anëtarësisë në Kishë. Ky autoritet e bën Kishën të ndryshme nga të gjitha besimet e tjera fetare në botë. Vetë Zoti shpalli se kjo është e vetmja kishë e vërtetë dhe e gjallë mbi faqen e të gjithë dheut (shih DeB 1:30).

## Drejtimit nga Fryma e Shenjtë

Shpjegojuni atyre që po i mësoni se Satani i kundërvihet Perëndisë dhe i ndjell njerëzit të kryejnë mëkat. Për të ruajtur ndjenjat e mira që kanë patur kur u takuan me misionarët, ata duhet të lexojnë Librin e Mormonit, të lutën, të shkojnë në kishë dhe t'u binden urdhërimeve. Shpjegoni se të paturit e drejtimit të vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë është një nga të mirat e të qenit i pagëzuar dhe i konfirmuar.

Shënime

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Natyrë e Frymës së Shenjtë

DeB 130:22–23 Gjoni 3:1–8	Galatasve 5:22–23	Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë”
------------------------------	-------------------	--

##### Bekimet dhe Ndikimi nga Fryma e Shenjtë

2 Nefi 32:1–5 2 Nefi 33:1–2	Moisiu 6:61 Gjoni 14:26	Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë”
--------------------------------	----------------------------	--

##### Rëndësia e Dhuratës së Frymës së Shenjtë

2 Nefi 31:11–12, 18, 21 3 Nefi 18:36–37 3 Nefi 19:13	3 Nefi 27:19–20 DeB 19:31	DeB 33:15 Veprat e Apostujve 19:1–6
--	------------------------------	--

### Durimi Deri në Fund

Pasi kemi hyrë në rrugën e ngushtë e të ngushtuar nëpërmjet besimit tonë në Jezu Krisht, pendimit dhe ordinancave të pagëzimit dhe konfirmimit, ne duhet të bëjmë çdo përpjekje për të qëndruar në këtë rrugë. Këtë e bëjmë duke ushtruar vazhdimisht besim në Jezu Krisht, duke u penduar, duke marrë zotime dhe duke ndjekur Shpirtin.

Pasi jemi falur për mëkatet tona, ne duhet të përpiqemi çdo ditë të mbetemi të lirë nga mëkati kështu që të mund të kemi gjithmonë me vete Frymën e Shenjtë. Në besëlidhjen e pagëzimit, ne i premtojmë Atit tonë në Qiell se do t’i bindemi urdhërimeve të Tij deri në fund të jetës sonë. Në qoftë se dështojmë, duhet të pendohemi në mënyrë që të ruajmë bekimet e besëlidhjes. Ne premtojmë të bëjmë vepra të mira, t’u shërbejmë të tjerëve dhe të ndjekim shembullin e Shpëtimtarit. Në shkrimet e shenjta ky zotim që zgjat gjithë jetën shpesh quhet “durim deri në fund.”

Duke ndjekur udhën e ungjillit, ne mund të afrohem me pranë Perëndisë, të mposhtim tundimin dhe mëkatin dhe të gëzojmë dhuratën e Frymës së Shenjtë me bollëk. Ndërsa ndjekim me durim, me besnikëri dhe vazhdimisht këtë rrugë gjatë gjithë jetës sonë, ne do të bëhemi të denjë për jetën e përjetshme.

Besimi në Krisht; pendimi; bërja, ripërtëritja dhe mbajtja e besëlidhjeve; dhe pastrimi nëpërmjet Shpirtit bëhen një model jetese. Veprimet tona në jetën e përditshme formohen dhe drejtohen nga këto parime. Paqja dhe gëzimi vijnë nga ndjekja e kësaj rruge dhe dalë-ngadalë ne zhvillojmë më shumë cilësi si të Krishtit. Në fund, ndërsa ndjekim këtë rrugë dhe “[shkojmë] përpara me një vendosmëri në Krisht...dhe [durojmë] deri në fund,” na është premtuar “Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:20).

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Durimi Deri në Fund

2 Nefi 9:24 2 Nefi 31:14–20	3 Nefi 27:16–17	Mateu 10:22
--------------------------------	-----------------	-------------

##### Bekime për Ata Që Durojnë Deri në Fund

1 Nefi 13:37	3 Nefi 15:9	DeB 14:7
--------------	-------------	----------



**Ftesë për t'u Pagëzuar**

Ftesa për t'u pagëzuar dhe konfirmuar duhet të jetë specifike dhe e drejtpërdrejtë: "A do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit duke u pagëzuar nga dikush që mban autoritetin e priftërisë së Perëndisë? Ne do të zhvillojmë një shërbesë pagëzimi në [datën]. A do të përgatiteni për t'u pagëzuar në atë datë?"

Shënime

Shënime

## Ide për Mësimdhënie

Ky seksion përmban ide për t'u përdorur nga ana juaj gjatë përgatitjes dhe dhënies së këtij mësimi. Me lutje ndiqni Shpirtin ndërsa vendosni si t'i përdorni këto ide. Shtoni idetë që zgjidhni në planin tuaj mësimor. Mbani mend se këto ide janë sugjerime—jo kërkesa—për t'ju ndihmuar të plotësoni nevojat e atyre që mësoni.

### Plan i Shkurtër Mësimi (3–5 minuta)

Ungjilli i Jezu Krishtit është rruga e vetme drejt jetës së përjetshme. Parimet dhe ordinancat e para të ungjillit të Tij janë: besimi në Jezu Krisht, pendimi, pagëzimi me anë të zhytjes në ujë për heqjen e mëkateve dhe dhurata e Frymës së Shenjtë. Më pas ne duhet të durojmë deri në fund. Duke zbatuar këto parime gjatë gjithë jetës sonë, ne ndjekim shembullin e Shpëtimtarit, mësojmë të jetojmë urdhërimet e Tij dhe zhvillojmë cilësi si të Krishtit. Ne mund të marrim falje për mëkatet tona dhe do të mund të kthehemi të jetojmë në prani të Atit tonë në Qiell.

- Me Anë të Krishtit Mund Të Pastrohemi nga Mëkati
- Besim në Jezu Krisht
- Pendim
- Pagëzimi, Besëlidhja Jonë e Parë
- Dhurata e Frymës së Shenjtë
- Durimi Deri në Fund

### Zotime

- A do vazhdoni të zhvillonini besim në Jezu Krisht duke vazhduar të mësoni rreth ungjillit të Tij?
- A do të pendoheni dhe a do të luteni për faljen e mëkateve?
- A do të pagëzoheni si anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në (datë)? A do të konfirmoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërimet nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

### Plan Mesatar Mësimi (10–15 minuta)

Mesazhi ynë është mesazh besimi dhe shprese. Ne e duam dhe e adhurojmë Jezu Krishtin. Ai është qendra e planit të Perëndisë për lumturinë tonë. Sakrifika shlyese e Jezu Krishtit bën të mundur që ne të kemi jetën e përjetshme në prani të Perëndisë. Ndërsa jetojmë ungjillin e Tij, Ai me mëshirë do të na falë mëkatet tona. Ai do të na shërojë dhe do ta zëvendësojë fajin dhe turpin me paqe dhe lumturi në këtë jetë.

Ungjilli i Jezu Krishtit është i thjeshtë. Ai fillon me besimin në Krisht. Ne besojmë në Të, i besojmë Atij dhe mbështetemi tek Ai. Një besim i tillë na bën të pendohemi— të heqim dorë nga bërja e gjërave të gabuara dhe të vazhdojmë të bëjmë gjëra që janë të drejta. Besimi ynë tek Ai gjithashtu na bën të kemi dëshirë të tregojmë dashurinë tonë nëpërmjet mbajtjes së urdhërimeve të Tij, duke përfshirë edhe pagëzimin. Pas pagëzimit, Ai premton të na japë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Fryma e Shenjtë do të na drejtojë, do të na ngushëllojë dhe do të na ndihmojë të njohim të

## Shënime

vërtetën. Ne mund ta ndiejmë në zemrën dhe mendjen tonë kur Fryma e Shenjtë është me ne. Ne do të kemi ndjenjën e paqes, dashurisë dhe gëzimit. Ne do të kemi dëshirë t'u shërbejmë të tjerëve. Ne do të përpiqemi gjatë gjithë jetës sonë të kënaqim Zotin.

Jezu Krishti ka rivendosur ungjillin e Tij me anë të një profeti të ditëve të mëvonshme. Ne mësojmë rreth ungjillit në Librin e Mormonit, të cilin ju mund ta lexoni, të meditonit dhe të luteni rreth tij. Perëndia do t'ua tregojë me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se ai është i vërtetë. Kur arrini ta dini se ai është i vërtetë, do të doni të pendoheni dhe të pagëzoheni kështu që të mund të merrni një heqje të mëkateve tuaja dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë.

## Zotime

- A do vazhdoni të zhvilloni besim në Jezu Krisht duke vazhduar të mësoni rreth ungjillit të Tij?
- A do të pendoheni dhe a do të luteni për faljen e mëkateve?
- A do të pagëzoheni si anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në (datë)? A do të konfirmoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojme një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

## Plan i Plotë Mësimi (30–45 minuta)

- Me Anë të Krishtit Mund të Pastrohemi nga Mëkati
  - Perëndia dërgoi Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, në botë (shih Gjoni 3:16-17).
  - Vetëm me anë të hirit dhe mëshirës së Krishtit ne mund të pastrohemi nga mëkati (shih 2 Nefi 2:6–8).
  - Ne jemi përgjegjës për të pranuar Krishtin, për t'u penduar, dhe për t'u bindur.
- Besim në Jezu Krisht
  - Ne duhet të besojmë te Krishti si Shpëtimtari i botës.
  - Ai do që ne të pranojmë dhe të ndjekim mësimet e Tij.
  - Ne marrim bekime kur bindemi (shih DeB 130:20–21).
- Pendimi
  - Besimi në Krisht çon drejt pendimit (shih Alma 34).
  - Ne ndiejmë trishtim sipas Perëndisë (shih 2 Korintasve 7:9–10).
  - Ne heqim dorë nga bërja e gjërave të gabuara dhe vazhdojmë të bëjmë gjëra që janë të drejta.
  - Ne rrëfejme mëkatet tona, dhe mëkatet serioze ua rrëfejme udhëheqësve të Kishës, të cilët mund të na ndihmojnë të pendohemi (shih DeB 58:43).

#### Shënime

- Ne marrim falje; faji dhe trishtimi zëvendësohen nga paqja (shih Alma 36:17–21).
- Pagëzimi, Besëlidhja Jonë e Parë
  - Një ordinancë është një rit i shenjtë me anë të të cilit ne bëjmë besëlidhje me Perëndinë.
  - Një besëlidhje është një marrëveshje solemne midis Perëndisë dhe fëmijëve të Tij.
  - Mbjajta e besëlidhjeve sjell bekime.
  - Ne pagëzohemi me anë të zhytjes në ujë për heqjen e mëkateve (shih Nenet e Besimit 1:4).
  - Kur pagëzohemi fillojmë një jetë të re zotimi ndaj Krishtit.
  - Pagëzimi duhet të kryhet nga një mbajtës i autoritetit të priftërisë.
  - Ne e përtërijmë besëlidhjen tonë duke marrë sakramentin çdo javë (DeB 20:77, 79).
- Dhurata e Frymës së Shenjtë
  - Pagëzimi me anë të zhytjes në ujë pasohet nga pagëzimi me anë të Shpirtit; të dy këto pagëzime janë të pandarë.
  - Mbjajtësit e priftërisë japin dhuratën e Frymës së Shenjtë me anë të vendosjes së duarve.
  - Fryma e Shenjtë na mëson, pastron, ngushëllon, dëshmon të vërtetën, na paralajmëron dhe na drejton (shih 2 Nefi 32:1–5; Mosia 5:1–6; Moroni 10:5; DeB 36:2).
- Durimi Deri në Fund
  - Pasi jemi pagëzuar dhe konfirmuar duhet të vazhdojmë në atë rrugë.
  - Ne bëjmë ç'është e mundur të mbetemi të lirë nga mëkati që të mund të gëzojmë dhuratën e Frymës së Shenjtë.
  - Duke ndjekur me besnikëri udhën e ungjillit të besimit, pendimit, bërjes dhe mbajtjes së besëlidhjeve dhe marrjes së Frymës së Shenjtë, ne mund të bëhemi të denjë për jetën e përvetshme (shih 2 Nefi 31:14–20).
  - Ne duhet të pendohemi vazhdimisht gjatë gjithë jetës sonë (shih DeB 19:15–20).

#### Zotime

- A do vazhdoni të zhvillonini besim në Jezu Krisht duke vazhduar të mësoni rreth ungjillit të Tij?
- A do të pendoheni dhe a do të luteni për faljen e mëkateve?
- A do të pagëzoheni si anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në (datë)? A do të konfirmoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë?
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë?
- A mund të caktojmi një orë për vizitën tonë të ardhshme?
- Urdhërime nga mësimi 4 që ju zgjidhni të përfshini.

## Shënime

**Pyetje në Fund të Mësimi**

- Çfarë pyetjesh keni rreth asaj që ju kemi mësuar?
- Çfarë do të thotë të pendohesh?
- Pse është dhurata e Frymës së Shenjtë një pjesë thelbësore e ungjillit?
- Pse është e rëndësishme për ju të pagëzoheni dhe të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë?
- Kishte ndonjë gjë rreth mbledhjeve tona të Kishës që ju nuk e kuptuat?
- Çfarë ju pëlqeu në mbledhjet tona të Kishës?

**Përkufizime të Rëndësishme**


- **Besëlidhje:** Një marrëveshje midis Perëndisë dhe fëmijëve të Tij. Ne nuk veprojmë si të barabartë në një marrëveshje. Perëndia vendos kushtet e besëlidhjes dhe ne pranojmë të bëjmë atë që Ai na kërkon. Më pas Perëndia na premtim bekime të caktuara për bindjen tonë. Ne i marrim ordinancat me anë të besëlidhjes. Kur bëjmë këto besëlidhje, ne premtim se do t'i nderojmë ato. Për shembull, anëtarët e Kishës hyjnë në besëlidhje me Perëndinë në pagëzim dhe e përtërijnë atë besëlidhje me marrjen e sakramentit. Ne bëjmë besëlidhje të mëtejshme në tempull. Populli i Perëndisë është populli i besëlidhjes. Ne bekohemi së tepërmi kur mbajmë besëlidhjet tona me Zotin.
- **Durim Deri në Fund:** Të qëndrosh i vërtetë ndaj urdhërimeve të Perëndisë pavarësisht nga tundimi, kundërshtitë dhe vështirësitë gjatë gjithë jetës.
- **Hir:** Fuqi mundësuese nga Jezu Krishti që na lejon të marrim bekimet në këtë jetë dhe të fitojmë jetën e përjetshme dhe ekzaltimin pasi të kemi ushtruar besim, të jemi penduar dhe të kemi bërë përpjekjet tona më të mira për të mbajtur urdhërimet. Një ndihmë, ose fuqi e tillë hyjnore, jepet nëpërmjet mëshirës dhe dashurisë së Jezu Krishtit. Ne të gjithë kemi nevojë për hirin hyjnor për shkak të Rënies së Adamit dhe gjithashtu për shkak të dobësive tona.
- **Jetë e Përjetshme:** Të jetosh përgjithmonë si familje në prani të Perëndisë (shih DeB 132:19–20). Jeta e përjetshme është dhurata më e madhe e Perëndisë për njeriun.
- **Konfirmim:** Vendosija e duarve prej atyre që mbajnë Priftërinë Melkizedeke në mënyrë që të bëhesh anëtar i Kishës dhe të të jepet dhurata e Frymës së Shenjtë.
- **Mëshirë:** Shpirti i dhembshurisë, butësisë dhe faljes. Mëshira është një nga cilësitë e Perëndisë. Jezu Krishti na ofron mëshirë me anë të sakrificës së Tij shlyese mbi kushtet e pendimit.
- **Rikthim:** Kthimi i diçkaje që ishte marrë ose kishte humbur.
- **Ungjill:** Plani i Perëndisë për shpëtim, që është bërë i mundur me anë të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ungjilli përfshin të vërtetat ose ligjet e përjetshme, besëlidhjet dhe ordinancat që i duhen njerëzimit për t'u kthyer në praninë e Perëndisë.

**Terma të Tjera që Mund të Kenë Nevojë për Përkufizime të Mëtejshme**

- |                       |                                   |             |
|-----------------------|-----------------------------------|-------------|
| • Falje               | • Rrëfim                          | • Sakrament |
| • Lutje               | • Rruga e ngushtë dhe e ngushtuar | • Tundim    |
| • Pastruar nga mëkati |                                   |             |

# Urdhërimet

## Përgatitja për Pagëzim dhe Konfirmim



### Si ta Zhvillojmë Këtë Mësim

Ka shumë mënyra për t'ua mësuar kërkuesve urdhërimet që gjenden në këtë mësim. Për shembull, ju mund t'u mësoni atyre disa nga urdhërimet e këtij mësimi si pjesë e tre mësimëve të para, ose mund t'u mësoni disa urdhërime si një mësim të vetëm. Ajo që do të bëni duhet të përcaktohet nga nevojat e kërkuesve dhe udhëheqja e Shpirtit.

### Përgatituni për të Dhënë Mësim

Qëllimi juaj në mësimdhënien e urdhërimeve është t'i ndihmoni njerëzit të jetojnë ungjillin duke ushtruar besim në Jezu Krisht dhe duke u penduar ndërsa përgatiten për pagëzim dhe konfirmim. Duke iu bindur urdhërimeve, njerëzit do të rriten në dëshminë e tyre për ungjillin, do të tregojnë se kanë "zemra të thyera dhe shpirtra të penduar" dhe do të fillojnë të pendohen për të gjitha mëkatet e tyre (shih Moroni 6:1–4; DeB 20:37).

Ky mësim është organizuar ndryshe nga tre të parët. Tre mësimet e para shpjegojnë themelet doktrinale të ungjillit të Jezu Krishtit. Ky mësim shpjegon urdhërime të veçanta që Perëndia ka dhënë për të na ndihmuar të zbatojmë parimet e ungjillit në jetën tonë.

Ka shumë mënyra për ta dhënë këtë mësim. Mënyra që ju përdorni duhet të përcaktohet nga nevojat e kërkuesve dhe udhëheqja e Shpirtit. Mendoni dhe lutuni vazhdimisht si t'i ndihmoni kërkuesit të jetojnë ungjillin. Disa ide përfshijnë:

- Mësoni një ose më shumë urdhërime si pjesë e tre mësimëve të para. Kur bëni këtë, merrni parasysh parimin e mësuar në Alma 12:32: "Perëndia u dha atyre urdhërime, pasi u bëri të ditur planin e shëlbimit" (shkronjat kursive janë shtuar). Disa urdhërime, si lutja dhe studimi i shkrimeve të shenjta, mund të mësohen më mirë si pjesë e tre mësimëve të para. Urdhërime të tjera mund të mësohen më mirë mbase të keni përgatitur themelet doktrinale të ungjillit që gjenden në tre mësimet e para.
- Mësoni dy ose tre nga urdhërimet si një mësim të vetëm.
- Mësoni një urdhërim të vetëm si një mësim më vete.
- Mësoni urdhërimet në kontekstin e ungjillit. Rishikoni shkurtimisht mësimin mbi ungjillin e Jezu Krishtit para se të mësoni një ose më shumë urdhërime. Kur bëni një

gjë të tillë, ju mund t'i ndihmoni kërkuesit të shohin se si urdhërimet zënë vend në një tablo më të gjerë të ushtrimit të besimit të Shpëtimtari dhe pendimit në përgatitje për pagëzim dhe konfirmim. Jeta e tyre mund të bekohet ndërsa ata e shohin ungjillin e Jezu Krishtit si një model jetese.

Ju mund t'i mësoni disa kërkues brenda pak vizitave; të tjerët mund të kërkojnë më shumë vizita. Ju jeni të lirë t'i jepni mësimet në çfarëdo mënyre që i ndihmon më mirë njerëzit të përgatiten plotësisht për pagëzimin dhe konfirmimin e tyre. Qëllimi juaj nuk është vetëm ta trajtoni të gjithë materialin; qëllimi juaj është t'i ndihmoni të tjerët të vijnë te Krishti me anë të besimit në Jezu Krisht, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund.

Një mësim rrallë herë duhet të zgjasë më shumë se 45 minuta. Ju mund të vëreni se koha ju lejon vetëm vizita më të shkurtra mësimdhënieje. Në këtë rast, ju mund t'ju nevojiten vizita të shkurtra dhe të shpeshta gjatë të cilave trajtohen pjesë më të vogla të materialit.

Ka shumë mënyra që ju mund të përdorni kur jepni këtë mësim. Se cilin urdhërim mësoni, kur e mësoni atë dhe sa kohë i kushtoni atij përcaktohet më mirë nga nevojat e kërkuesve dhe udhëheqja e Shpirtit.

## Studioni rreth Urdhërimeve dhe Zotimeve

Kur studioni këtë mësim, ndiqni modelin e mëposhtëm:

- Studioni pjesën që përshkruan urdhërimin dhe shkruani një plan të thjeshtë mësimi me tre deri në pesë pika kryesore.
- Mësojani një variant dy ose tre minutësh shokut/shoqes tuaj. Praktikoni si do t'ua drejtoni kërkuesve secilën ftesë për t'u zotuar dhe si do t'i zgjidhni shqetësimet e tyre.
- Diskutoni mënyra që mund të përdorni për të ndjekur ecurinë e çdo zotimi që kërkuesit kanë pranuar.

## Bindja

Perëndia na jep urdhërimet për të mirën tonë. Ato janë udhëzime nga një At i Dashur në Qiell për të na ndihmuar të kemi jetë të lumtur. Ai gjithashtu na dha të drejtën për të zgjedhur, ose aftësinë dhe mundësinë për të zgjedhur midis së mirës dhe së keqes. Kur i bindemi Perëndisë, ne ndjekim ndikimin e Shpirtit dhe zgjedhim t'i bindemi vullnetit të Tij. Bindja ndaj urdhërimeve na sjell paqe në këtë jetë dhe jetë të përjetshme në botën që do të vijë. Bindja tregon dashurinë tonë për Perëndinë. Mosbindja na sjell trishtim.

Ati Qiellor i di dobësitë tona dhe është i duruar me ne. Ai na bekon kur përpiqemi t'i bindemi urdhërimeve të Tij. Ai pret që ne t'i bindemi Atij kështu që Ai të mund të na bekojë.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Liria e Zgjedhjes

2 Nefi 2:26–29

Alma 12:31

DeB 58:26–29

DeB 82:8–10

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Zgjedhje e Lirë”

#### Bindja

DeB 130:20–21

Gjoni 14:15, 21

Predikuesi 12:13

Shënime

#### Zotim

- A do t'i bindeni ligjeve të Perëndisë?

### Lutuni Shpesh

Perëndia na urdhëron t'i lutemi Atij. Ju mund të luteni në çdo kohë dhe në çdo vend. Perëndia na ka mësuar të gjuhëzohemi dhe të lutemi në mëngjes dhe në mbrëmje, si individë dhe me familjet tona. Ati ynë Qiellor i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tona. Me anë të lutjeve të përditshme ne marrim drejtim hyjnor dhe bekime. Ne duhet të lutemi gjithmonë sinqerisht. Ne duhet gjithashtu të lutemi me "qëllim të vërtetë," që do të thotë se jemi të zotuar të veprojmë në bazë të përgjigjes që marrim.

Ne i lutemi me besim Atit tonë në Qiell në emrin e Jezu Krishtit (shih Moisiu 5:8). Duke qenë se Ai është Ati ynë dhe ne jemi fëmijët e Tij, Ai do t'i përgjigjet lutjeve tona. Ne e fillojmë lutjen duke iu drejtuar Atit tonë në Qiell. E mbyllim lutjen duke thënë: "Në emër të Jezu Krishtit, amen."

Në lutje ne flasim hapur dhe me ndershmëri me Atin tonë të Dashur në Qiell. Ne shprehim mirënjohje dhe falënderime për bekimet tona. Ne mund të shprehim dashurinë tonë për Të. Ne gjithashtu kërkojmë ndihmë, mbrojtje dhe drejtim sipas nevojave tona.

Ndërsa lutemi me besim, sinqeritet dhe qëllim të vërtetë, ne do të shohim ndikimin e Perëndisë në jetën tonë. Ai do të na drejtojë në jetën tonë të përditshme dhe do të na ndihmojë të marrim vendime të drejta. Ai do të na bekojë me ndjenja ngushëllimi dhe paqeje. Ai do të na paralajmërojë për rrezikun dhe do të na forcojë që t'i bëjmë ballë tundimit. Ai do të na falë mëkatet tona. Ne do të ndihemi më pranë Tij. Ne duhet të mësojmë të njohim ndikimin e Tij në jetën tonë. Ne duhet të mësojmë të dëgjojmë zërin e qetë e të vogël të Shpirtit.

Ne mund ta kuptojmë kur Fryma e Shenjtë po na mëson të vërtetën. Mendjet tona do të mbushen me mendime frymëzuese dhe të lartësuara. Ne do të ndriçohemi, ose do të marrim njohuri të reja. Zemrat tona do të kenë ndjenjën e paqes, gëzimit dhe dashurisë. Ne do të duam të bëjmë mirë dhe të jemi një ndihmë për të tjerët. Këto ndjenja janë të vështira të përshkruhen, por mund të dallohen kur i përjetojmë ato.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

2 Nefi 32:8–9

DeB 6:22–23

DeB 19:28

Enosi 1:1–12

DeB 8:2–3

1 Mbretërve 19:11–12

Alma 34:17–28

DeB 9:7–9

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Lutje"

Moroni 10:3–5

#### Zotim

- A do të uleni në gjuhë dhe të luteni çdo ditë si individë dhe si një familje?

### Studioni Shkrimet e Shenjta

Shkrimet e shenjta janë anale të shkruara të marrëdhënieve të Perëndisë me fëmijët e Tij që profetët kanë shkruar nën ndikimin e Frymës së Shenjtë. Ne tregojmë besimin tonë duke studiuar, besuar dhe duke iu bindur fjalëve që Perëndia ka zbuluar. Ne i studiojmë me zell shkrimet e shenjta për të kuptuar të vërtetën. Ne ushqehemi me to, sepse ato



hapin portën drejt zbulësës dhe na tregojnë se çfarë duhet të bëjmë dhe të bëhemi. Ne i studiojmë shkrimet e shenjta për të mësuar rreth Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij. Besimi në Jezu Krisht është një dhuratë nga Perëndia dhe vjen me anë të studimit dhe të jetuarit të fjalës së Tij dhe të ungjillit të Tij. Shkrimet e shenjta të miratuara të Kishës, që quhen gjithashtu veprat standarde, janë: Bibla, Libri i Mormonit, Doktrina e Besëlidhje dhe Perla me Vlerë të Madhe. Ne duhet t'i studiojmë çdo ditë këta libra të shenjtë.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

1 Nefi 19:22–23	2 Nefi 31:19–20	Gjoni 20:31
2 Nefi 9:50–51	2 Nefi 32:3–5	2 Timoteut 3:14–17
2 Nefi 25:26	Alma 32:28–30	2 Pjetri 1:20–21
2 Nefi 29:1–13	Gjoni 5:39	

#### Zotim

- A do t'i lexoni shkrimet e shenjta çdo ditë si individë dhe si familje?

### Mbani të Shenjtë Ditën e Shabatit

Sjellja jonë gjatë ditës së Shabatit është një pasqyrim i zotimit tonë për të nderuar dhe adhuruar Perëndinë. Duke mbajtur të shenjtë ditën e Shabatit, ne i tregojmë Perëndisë gatishmërinë tonë për të mbajtur besëlidhjet tona. Çdo ditë Shabati ne shkojmë në shtëpinë e Perëndisë për ta adhuruar Atë. Atje ne marrim sakramentin për të kujtuar Jezu Krishtin dhe Shlyerjen e Tij. Ne përtërijmë besëlidhjet tona dhe tregojmë se jemi të gatshëm të pendohemi për mëkatet dhe gabimet tona.

Në këtë ditë, ne pushojmë nga punët tona. Kur marrim pjesë në shërbesat e Kishës dhe adhurojmë së bashku, ne forcojmë njëri-tjetrin. Ne përtërihem nga shoqëria e miqve dhe familjes. Besimi ynë forcohet kur studiojmë shkrimet e shenjta dhe mësojmë më shumë rreth ungjillit të rivendosur.

Kur një komunitet ose popull bëhet gjithnjë e më i pakujdesshëm në aktivitetet e ditës së Shabatit, jeta e tij fetare rrënohet dhe të gjitha aspektet e jetës ndikohen negativisht. Bekimet që vijnë nga mbajtja e shenjtë e ditës së Shabatit zhduken. Ne nuk duhet të bëjmë pazar në ditën e Shabatit dhe nuk duhet të marrim pjesë në aktivitete të tjera tregtare dhe sportive që tashmë janë bërë të zakonshme dhe e përdhosin Shabatin.

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme duhet ta veçojnë këtë ditë të shenjtë nga aktivitetet e botës duke hyrë në një shpirt adhurimi, falënderimi, shërbimi dhe aktivitetesh familjare të përshtatshme për Shabatin. Kur anëtarët e Kishës përpiqen t'i bëjnë aktivitetet e tyre të Shabatit të pajtueshme me qëllimin dhe Shpirtin e Zotit, jeta e tyre do të mbushet me gëzim dhe paqe.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

3 Nefi 18:1–25	Eksodi 20:8–11	Isaia 58:13–14
DeB 59:9–15	Eksodi 31:12–17	

#### Në Kishë Uluni me Kërkuesit ose Anëtarët

Gjatë pjesëmarrjes në mbledhjet e sakramentit ose konferencat e kunjit, misionarët duhet të ulen me kërkuesit e tyre, të porsakthyerit në besim, ose anëtarët. Ata nuk duhet të ulen me misionarët e tjerë.

Shënime

## Shënime

## Zotime

- A do ta mbani të shenjtë ditën e Shabatit?
- A do të përgatiteni për të marrë sakramentin denjesisht?

**Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Ditën e Shabatit**

- Çfarë kuptoni ju me ditën e Shabatit, duke përfshirë marrjen e sakramentit çdo javë dhe shërbimin ndaj të tjerëve? A jeni i/e gatshëm t'i bindeni këtij ligji [përpara pagëzimit tuaj]?

**Pagëzimi dhe Konfirmimi**

Mënyra si e tregojmë dëshirën tonë për të ndjekur rrugën e Perëndisë është me anë të pagëzimit dhe konfirmimit. Kur pagëzohemi dhe konfirmohemi, ne hyjmë në një besëlidhje me Perëndinë se do të marrim mbi vete emrin e Jezu Krishtit dhe se do ta kujtojmë gjithmonë Atë dhe do të mbajmë urdhërimet e Tij. Ne gjithashtu premtojmë të qëndrojmë si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe t'i ndihmojmë ata që janë në nevojë (shih Mosia 18:8–9). Si shpërblim, Perëndia na premtton shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, heqjen e mëkateve tona dhe se do të lindemi sërish.

## Zotime

- A do të pagëzoheni dhe konfirmoheni?
- A do të ftoni miqtë dhe familjen tuaj të marrin pjesë në shërbesën e pagëzimit tuaj?
- Në qoftë se është e mundur, ftoni kërkues në një shërbesë pagëzimi dhe një mbledhje sakramenti gjatë së cilës do të konfirmohet dikush.

**Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Pagëzimin dhe Konfirmimin**

- Të gjitha pyetjet e intervistës së pagëzimit.

**Ftesë për t'u Pagëzuar**

Ftesa për t'u pagëzuar dhe konfirmuar duhet të jetë specifike dhe e drejtëpërdrejtë: "A do të ndiqni shembullin e Jezu Krishtit duke u pagëzuar nga dikush që mban autoritetin e priftërisë së Perëndisë? Ne do të zhvillojmë një shërbesë pagëzimi në [datën]. A do të përgatiteni për t'u pagëzuar në atë datë?"

**Ndiqni Profetin**

E vërteta është njohuria e gjërave ashtu si ato janë, ishin dhe do të jenë në të vërtetë. Ajo nuk ndryshon nga kushtet apo koha. E vërteta është e njëjtë në çdo epokë dhe kulturë. Perëndia është burimi i gjithë së vërtetës. Ne mund të kemi besim tek Ai, sepse e dimë se Ai do të na mësojë vetëm të vërtetën. Perëndia do që të gjithë fëmijet e Tij ta njohin të vërtetën. Prandaj, Ai zbulon të vërtetat e nevojshme për shpëtim me anë të profetëve dhe apostujve. Ai na zbulon të vërtetën ne personalisht me anë të shkrimeve të shenjta dhe zbulesës personale.

Një profet zgjidhet dhe thirret nga Perëndia dhe është një burrë i drejtë me besim të madh. Zoti i zbulon atij të vërtetën nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Ai e urdhëron profetin e Tij t'ua të mësojë të vërtetën të gjithë njerëzve. Ata që besojnë në fjalën e Perëndisë ashtu siç është zbuluar me anë të profetit të Tij, janë të bekuar.

Kisha e Krishtit është ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe profetëve, që drejtojnë Kishën me anë të zbulësës. Zoti e thirri Jozef Smithin si profetin e parë dhe kreun e kësaj periudhe të fundit ungjillore. Pasuesit e tij që udhëheqin sot Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë gjithashtu profetë dhe apostuj. Presidenti i Kishës sot është një profet i gjallë. Ne duhet të kemi besim në profetin e zgjedhur të Perëndisë, të fitojmë bindje për hyjninë e thirrjes së tij dhe të ndjekim mësimet e tij.

Ne kemi mundësi të shpeshta të mbështesim udhëheqësit e Kishës publikisht. Të mbështesësh do të thotë të përkrahësh. Ne duhet të përgatitemi kështu që kur profetët dhe apostujt flasin, Fryma e Shenjtë mund të konfirmojë të vërtetën që ata na mësojnë dhe atëherë ne mund të vendosim të ndjekim këshillën që ata na japin.

Ata që dëgjojnë dhe ndjekin këshillën e profetëve të gjallë dhe apostujve nuk do të shkojnë në udhën e gabuar. Mësimet e profetëve të gjallë na sigurojnë një spirancë të së vërtetës së përrjetshme në një botë ku vlerat vazhdojnë të ndryshojnë dhe na ndihmon të shmangim mjerimin dhe trishtimin. Pështjellimi dhe konfliktet e botës nuk do të na mposhtin dhe ne mund të gëzojmë sigurinë e të qenit në harmoni me vullnetin e Perëndisë.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Mosia 15:11–12	DeB 21:1–7	Efesianëve 2:19–20
Alma 13:1–16	DeB 136:37–38	Efesianëve 4:11–14
3 Nefi 12:1–2	Gjoni 15:16	Hebrenjve 5:4
DeB 1:37–38	Veprat e Apostujve 10:34–44	Amosi 3:7

### Zotime

- A do ta takoni peshkopin?
- A do të mbështetni dhe ndiqni këshillën e udhëheqësve të Kishës?

### Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Ndjekjen e Profetit

- A besoni ju se [Presidenti aktual i Kishës] është një profet i Perëndisë? Ç'është kjo për ju?

## Zbatoni Dhjetë Urdhërimet

Ati Qiellor na jep urdhërime kështu që ne të dimë çfarë të bëjmë dhe çfarë të shmangim në mënyrë që të marrim bekimet që Ai do të na japë (gëzim, paqe të ndërgjegjes, lumturi të pafund). Perëndia i zbuloi Moisiut Dhjetë Urdhërimet për të drejtuar popullin e Tij:

- “Nuk do të kesh Perëndi të tjerë para meje” (Eksodi 20:3). “Perëndi” të tjerë mund të përfshijë pasuri, pushtet, ose famë.
- “Nuk do të bësh asnjë shëmbëlltyrë” (Eksodi 20:4).
- “Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd kot” (Eksodi 20:7).
- “Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar” (Eksodi 20:8).
- “Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde” (Eksodi 20:12).
- “Nuk do të vrasësh” (Eksodi 20:13).
- “Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore” (Eksodi 20:14).
- “Nuk do të vjedhësh” (Eksodi 20:15).
- “Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd” (Eksodi 20:16).
- “Nuk do të dëshirosh” (Eksodi 20:17).

Shënime

Dhjetë Urdhërimet janë ende të vlefshme edhe sot. Ato na mësojnë të adhurojmë dhe të tregojmë nderim për Perëndinë. Ato gjithashtu na mësojnë si ta trajtojmë njëri-tjetrin.

#### Asnjë Perëndi Tjetër

Njerëzit në shumë kultura kanë ose respektojnë objekte që u kujtojnë Hyjninë ose paraardhësit. Nganjëherë këto objekte, si statuja, emblema fetare, ose shenjtore të vogla, mund të bëhen gjithashtu epiqendra e adhurimit të tyre. Ndhimojini ata të kuptojnë se Perëndia na ka urdhëruar të mos adhurojmë idhujt. Nxitini ata të heqin nga shtëpitë e tyre ndonjë objekt që adhurojnë ose të cilit i luten. Ndhimojini ta përqendrojnë besimin dhe adhurimin tek Ati i tyre Qiellor dhe tek Jezu Krishti. Mësojuni atyre se ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit përqendrohet në Krishtin e gjallë.

Në ungjillin e rivendosur Zoti na ka mësuar se si ta kujtojmë Atë. Ne e kujtojmë Atë me anë të lutjes, sakramentit dhe adhurimit në tempull. Presidenti i misionit do t'ju japë udhëzime në pika të veçanta.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Mosia 13  
DeB 59:5–6

Mateu 22:36–40  
Eksodi 20:1–17

Ligji i Përtërirë 5:6–21

#### Zotim

- A do t'i zbatoni Dhjetë Urdhërimet?

### Jetoni Ligjin e Dëlirësisë

Perëndia kënaqet në dëlirësi dhe urren mëkatin seksual. Dëlirësia përfshin mospasjen absolute të marrëdhënieve seksuale para martesës dhe besnikëri e devotshmëri të plotë ndaj bashkëshortit/bashkëshortes pas martesë. Ata që jetojnë ligjin e dëlirësisë gëzojnë forcën që vjen nga vetëkontrolli. Ata gëzojnë siguri dhe mirëbesim në marrëdhëniet e tyre familjare. Ata mund të gëzojnë më plotësisht ndikimin e Frymës së Shenjtë në jetën e tyre. Ata që e shkelin këtë ligj janë subjekt i një ndjesie të pafund turpi dhe faji që rëndon jetën e tyre.

Dëlirësia kërkon besnikëri në mendim dhe në veprim. Ne duhet t'i mbajmë mendimet tona të pastra dhe të jemi të thjeshtë në veshje, në të folur dhe në veprime. Ne duhet ta shmangim pornografinë në çdo formë. Ne duhet ta trajtojmë fuqinë riprodhuese që na është dhënë nga Perëndia dhe trupat tanë si të shenjtë. Kandidatët për pagëzim duhet të jetojnë ligjin e dëlirësisë, që ndalon çdo marrëdhënie seksuale ndërmjet një burri dhe një gruaje jashtë martesës së ligjshme. Ata nuk duhet të marrin pjesë në aborte ose marrëdhënie homoseksuale ose lesbike. Ata që kanë kryer mëkat seksual mund të pendohen dhe të falen.

#### Çiftet që Jetojnë Bashkë

Burrat dhe gratë që jetojnë bashkë, por nuk janë të martuar, nuk mund të pagëzohen pa qenë të martuar ose të ndarë më parë. Ata që janë martuar me më shumë se një person në të njëjtën kohë nuk mund të pagëzohen. Kërkoni këshillën e presidentit të misionit, i cili do t'ju japë udhëzime të veçanta në çdo rast.

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

Jakobi 2:28 (LiM)	3 Nefi 12:27–30	Mateu 5:27–28
Mosia 13:22	DeB 42:22–24	Romakëve 1:26–32
Alma 39:3–5	DeB 63:16	Efesianëve 5:3–5

## Zotim

- A do ta jetoni ligjin e dëlirësisë?

## Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Ligjin e Dëlirësisë

- Çfarë kuptoni me ligjin e dëlirësisë, që ndalon çdo marrëdhënie seksuale ndërmjet një burri dhe një gruaje jashtë lidhjeve të ligjshme martesore? A jeni i/e gatshëm t'i bindeni këtij ligji [përpara pagëzimit tuaj]?
- A keni marrë pjesë ndonjëherë në një abort? Në një marrëdhënie homoseksuale? [Shënime: Një person që i përgjigjet po njëherë prej këtyre pyetjeve duhet të intervistohet nga presidenti i misionit para se të pagëzohet.]

Shënime

## Bindjuni Fjalës së Urtësisë

Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith një ligj të shëndetit të quajtur Fjala e Urtësisë. Ky ligj na mëson çfarë ushqimesh dhe substancash duhet dhe nuk duhet të përdorim që të ruajmë shëndetin e trupave tanë dhe të jemi të lirë nga ndikimet e liga. Perëndia premtion bekime të shëndetit, forcës, mbrojtjes kundër së ligës dhe një perceptim më të madh të të vërtetave shpirtërore.

Kujtoni se trupat tanë janë të shenjtë. Ne duhet t'i trajtojmë ata me respekt dhe nderim. Fjala e Urtësisë na mëson se ne duhet të hamë ushqime të shëndetshme. Ajo na mëson në mënyrë shumë specifike se duhet të eliminojmë substancat e dëmshme, duke përfshirë alkoolin, duhanin, çajin dhe kafën. Ne duhet gjithashtu të eliminojmë drogat e dëmshme të çdo forme. Për t'u pagëzuar dhe konfirmuar, ata që ju mësoni duhet të heqin dorë nga këto substanca. Njerëzit që i binden Fjalës së Urtësisë i perceptojnë më shpejt të vërtetat shpirtërore.

Presidenti i misionit do t'i përgjigjet pyetjeve nëse substanca të tjera të veçanta në kulturën tuaj përfshihen në Fjalën e Urtësisë.

## Mposhtja e Varësisë nga Veset

Ju mund t'i ndihmoni më mirë ata që po përpiqen të lënë duhanin, alkoolin dhe zakone të tjera duke ndjekur këto parime. Sugjerimet e mëposhtme lidhen veçanërisht me Fjalën e Urtësisë, por mund të përshtaten edhe për vese të tjera.

1. I ndihmoni njerëzit të vendosin qëllime se kur dhe si ata do ta jetojnë Fjalën e Urtësisë.
2. Lutuni për ta në lutjet tuaja personale dhe kur jeni me ta.
3. Mbani një qëndrim pozitiv dhe inkurajues—madje edhe nëse ata i kthehen sërish vesit të tyre.
4. Vazhdoni t'u mësoni ungjillin. U mësoni atyre si ta përdorin lutjen dhe besimin si burim force.
5. Ndhmijoni ata të shkojnë rregullisht në kishë dhe të miqësohen me njerëz që jetojnë Fjalën e Urtësisë dhe kanë mposhtur të njëjtin ves.
6. Si të jetë e përshtatshme, ofroni t'u jepni atyre bekime priftërie.
7. Nxitini ata të largojnë substancat e dëmshme nga shtëpia e tyre.

Shikoni kapitullin 10 për më shumë udhëzime rreth ndihmës që mund t'u jepni njerëzve për të mposhtur varësinë nga veset.

Shënime

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

DeB 89

1 Korintasve 3:16–17

1 Korintasve 6:19–20

#### Zotim

- A do ta jetoni Fjalën e Urtësisë?

#### Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Fjalën e Urtësisë

- Çfarë kuptoni ju me Fjalën e Urtësisë? A jeni i/e gatshëm t'i bindeni këtij ligji [përpara pagëzimit tuaj]?

### Mbani Ligjin e së Dhjetës

Një nga bekimet më të mëdha të anëtarësisë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është privilegji për të kontribuar në rritjen e mbretërisë së Perëndisë me anë të pagimit të së dhjetës. E dhjeta është një ligj i lashtë dhe hyjnor. Për shembull, Abrahami, profeti i Dhjetës së Vjetër pagoi të dhjetën e gjithçkaje që zotëronte (shih Alma 13:15).

Atyre që paguajnë të dhjetën, Zoti u premton: “unë .. do t’i hap pragjet e qiellit, dhe do të derdh mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini” (Malakia 3:10). Këto bekime mund të jenë materiale ose shpirtërore, por ato do t’u vijnë atyre që i binden këtij ligji hyjnor.

E dhjetë do të thotë një e dhjeta dhe Zoti na ka urdhëruar të japim një të dhjetën e fitimeve tona, që do të thotë të ardhura, që të mund të bekohemi. Ligji i së dhjetës na jep mundësinë të ndihmojmë në ndërtimin e mbretërisë së Tij. Të dhjetat tona janë të shenjta për Zotin dhe ne e nderojmë Atë duke paguar të dhjetën. Perëndia premton se do t’i bekojë së tepërmi ata që paguajnë një të dhjetë të ndershme. Ata që nuk paguajnë të dhjetën vjedhin Perëndinë (shih Malakia 3:8). Ata mbajnë për vete diçka që me të drejtë i takon Atij. Ne duhet të kërkojmë së pari mbretërinë e Perëndisë dhe e dhjeta është një mënyrë e rëndësishme për ta bërë këtë. Pagimi i së dhjetës është një shprehje e besimit tonë. Ajo është një shenjë e jashtme e besimit tonë në Perëndi dhe në punën e Tij.

Fondet e së dhjetës përdoren për të mbështetur aktivitetet e vazhdueshme të Kishës, të tilla si ndërtimi dhe mirëmbajtja e tempujve dhe e ndërtesave të mbledhjeve, shpërndarja e ungjillit në të gjithë botën, drejtimi i punës në tempull dhe historisë familjare dhe shumë aktivitete të tjera në të gjithë botën. E dhjeta nuk përdoret për të paguar udhëheqësit lokalë të Kishës, të cilët shërbejnë pa marrë asnjë lloj pagese.

Udhëheqësit lokalë të Kishës e dërgojnë të dhjetën e marrë çdo javë, drejtpërdrejt në selinë qendrore të Kishës. Një këshill i përbërë nga Presidencia e Parë, Kuorumi i të Dymbëdhjetëve dhe Këshilli Kryesues i Peshkopëve përcakton mënyra specifike për përdorimin e fondeve të shenjta të së dhjetës.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### E Dhjeta

DeB 119

Hebrenjve 7:1–2

Levitiku 27:30–33

DeB 120

Zanafilla 14:18–20

Malakia 3:7–12

##### Besimi

3 Nefi 13:33

Ethëri 12:6

**Zotim**

- A do ta jetoni ligjin e së dhjetës pasi të pagëzoheni?

**Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Ligjin e së Dhjetës**

- Çfarë kuptoni ju me ligjin e së dhjetës? A jeni ju i/e gatshëm t'i bindeni këtij ligji?

**Zbatoni Ligjin e Agjërit**

Bekime të mëdha do t'u jepen atyre që i binden urdhërimit të Perëndisë për të agjëruar. Agjërim do të thotë të mos hash as të pish për një periudhë kohe. Zakonisht e diela e parë e çdo muaji është caktuar si një ditë e veçantë për të agjëruar për dy vakte të njëpasnjëshme, për t'u lutur dhe për të dhënë dëshmi. Agjërimi dhe lutja shkojnë së bashku. Kur agjërojmë dhe lutemi me besim, jemi më të ndjeshëm ndaj marrjes së përgjigjeve për lutjet tona dhe bekimeve që vijnë nga Zoti. Ai na premtun se do të na drejtojë vazhdimisht. Ne duhet të agjërojmë dhe të lutemi për qëllime të caktuara. Agjërimi është personal dhe shpirtëror dhe ne nuk duhet të tërheqim vëmendjen në faktin se po agjërojmë.

Një besim i vërtetë fetar përfshin kujdesin për të varfërit. Ne duhet t'i ndihmojmë ata duke iu përgjigjur nevojave të tyre fizike dhe shpirtërore. Kur agjërojmë, ne dhurojmë para në Kishë për kujdesin ndaj të varfërve dhe atyre në nevojë. Këtë e quajmë ofertë agjërimi. Ne japim të paktën shumën e parave që kursyem duke agjëruar për dy vakte. Megjithatë, ne nuk duhet ta kufizojmë kontributin tonë vetëm në koston e dy vakteve. Ne nxitemi të jemi aq bujarë sa na e lejojnë mundësitë tona. Duke u kujdesur për të varfërit, ne plotësojmë besëlidhjen e pagëzimit dhe marrim një heqje të mëkateve tona.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Agjërimi**

Omni 1:26	Alma 17:2–3	DeB 59:12–16
Alma 5:45–46	Moroni 6:5	Mateu 6:1–4, 16–18
Alma 6:6	DeB 88:76	Isaia 58:6–11

**Kujdesi për të Varfërit**

Mosia 4:16–27	Alma 4:12–13	Jakobi 1:27 (Dhjata e Re)
Mosia 18:8–10	Mateu 25:34–46	Isaia 58:3–12

**Zotime**

- A do të agjëroni dhe luteni të dielën tjetër të agjërit për një nevojë të veçantë?
- A do të dhuroni një ofertë bujare agjërimi [pasi të pagëzoheni]?

**Si të Dhuroni të Dhjetën dhe Ofertën e Agjërit**

Të dhjetat dhe ofertat e agjërit paguhen vullnetarisht dhe privatisht. Anëtarët mund t'i paguajnë të dhjetat dhe ofertat e agjërit në çdo kohë, por zakonisht është më mirë që të paguhet e dhjeta e të ardhurave sapo të merren këto të ardhura dhe ofertat e agjërit në ditën e agjërit. Anëtarët i bëjnë këto dhurime duke plotësuar një formular dhurimi, që merret nga këshilli i peshkopit. Anëtari mban kopjen e verdhë ndërsa kopjen e bardhë

Shënime

## Shënime

bashkë me paratë e dhuruara i fut në një zarf që përdoret për këtë qëllim. Zarfi i dorëzohet një anëtar të kishillit të peshkopit. Këto dhurime konsiderohen të shenjta dhe i përkasin Zotit. Një anëtar i kishillit të peshkopit dhe një nëpunës i financës mbajnë një llogari konfidenciale të kujdesshme të gjitha dhurimeve.

Anëtarët marrin pjesë në intervistën e deklaramit të së dhjetës me peshkopin në fund të çdo viti për të deklaruar besnikërinë e tyre në pagimin e së dhjetës. Në këtë takim privat, anëtarët marrin një raport fund-viti të të gjithë dhurimeve të tyre. I gjithë informacioni financiar mbahet rreptësisht konfidencial.

**Mësojuni Si të Dhurojnë të Dhjetën dhe Ofertën e Agjërimit**

Tregojini një formular dhurimi dhe u shpjegoni si ta përdorin atë. Pasi të kthyerit në besim janë pagëzuar, mund të jetë e nevojshme që ju t'i ndihmoni ata të plotësojnë formularin.

**Bindjuni dhe Nderoni Ligjin**

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme kudo besojnë në bindjen ndaj ligjeve të vendit ku ata jetojnë. Anëtarët e Kishës këshillohen të jenë qytetarë të mirë, të marrin pjesë në qeverisjen civile dhe në proceset politike dhe të japin shërbim në komunitet. Por këtë ata e bëjnë, si qytetarë të interesuar dhe jo si përfaqësues të Kishës.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta**

DeB 58:21  
DeB 98:5

DeB 130:20–21  
DeB 134

Nenet e Besimit 1:12

**Zotim**

- A do t'u bindeni ligjeve të vendit në të cilin jetoni ?

**Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit që Lidhen me Bindjen ndaj Ligjit**

- A keni kryer ndonjëherë një krim serioz? Nëse po, a jeni tani në lirim me kusht? [Shënim: Një person që i përgjigjet po njëres prej këtyre pyetjeve duhet të intervistohet nga presidenti i misionit para se të pagëzohet.]

**Aktivitet:**

Për secilin nga urdhërimet në këtë mësim, renditni premtimet në shkrimet e shenjta që Zoti u bën atyre që i mbajnë urdhërimet. Shënoni në ditarin tuaj të studimit premtimet që janë realizuar në jetën tuaj.



# Ligjet dhe Ordinancat

## *Pas Pagëzimit dhe Konfirmimit*



© 1998 Dei Patson. Ndarshet fotokopjimi.

Shënime

### Përgatituni të Jepni Mësim

Pasi të kthyerit në besim të jenë pagëzuar dhe konfirmuar, udhëheqësit e lagjes përcaktojnë nëse misionarët e lagjes ose misionarët me kohë të plotë kanë përgjegjësinë për t'u siguruar që këto mësim të jepen dhe për sa kohë misionarët me kohë të plotë duhet të përfshihen në këto mësim. Ky mësim duhet t'u mësohet anëtarëve të rinj menjëherë pasi ata të jenë pagëzuar dhe konfirmuar. Ju mund të filloni t'i mësoni ata rreth këtyre ligjeve dhe ordinancave gjatë kohës midis pagëzimit dhe konfirmimit të tyre ose madje edhe para pagëzimit. Kandidatët për pagëzim duhet të paktën të jenë në dijeni të këtyre ligjeve dhe ordinancave përpara pagëzimit.

Ky mësim funksionon pak a shumë si mësimi 4. Mënyra që përdorni në dhënien e këtij mësimi duhet të përcaktohet nga nevojat e të porsakthyerve në besim dhe nga udhëheqja e Shpirtit. Në mënyrë të vazhdueshme mendoni dhe lutuni si t'i ndihmoni të porsakthyerit në besim të jetojnë ungjillin. Disa ide përfshijnë:

- Mësojini anëtarit të ri secilin prej ligjeve dhe ordinancave nga ky mësim ndërkohë që rishikoni njëkohësisht mësimet “Mesazhi i Rivendosjes,” “Plani i Shpëtimit” dhe “Ungjilli i Jezu Krishtit.” Për shembull, ndërkohë që rishikoni mesazhin e Rivendosjes ju mund të doni që ta mësoni anëtarin e ri rreth priftërisë dhe punës misionare; ndërsa rishikoni planin e shpëtimit mund të flisni rreth martesës së përjetshme, tempujve dhe punës së historisë familjare dhe mësimdhënies dhe të mësuarit në Kishë. Kur rishikoni ungjillin e Jezu Krishtit ju mund të zgjidhni të flisni rreth shtegut e ngushtë e të ngushtuar dhe shërbimit në Kishë.
- Mësoni dy ose tre nga ligjet dhe ordinancat si një mësim i vetëm.
- Mësoni një ligj ose ordinancë si një mësim më vete.

Punoni me anëtarët që ata t'i ndihmojnë anëtarët e rinj të pranojnë dhe të fillojnë t'i jetojnë këto ligje dhe ordinanca. I ndihmoni anëtarët e rinj të kuptojnë se duke mbajtur ligjet e Perëndisë, ata do të marrin një heqje të mëkateve të tyre dhe do të qëndrojnë në rrugën e jetës së përjetshme. Ata do të provojnë paqe dhe gëzim më të madh. Ata do të gjejnë përgjigje për pyetjet e jetës dhe siguri në njohurinë se i përkasin Kishës së vërtetë të Jezu Krishtit. Ligjet dhe ordinancat shërbejnë si drejtime për të jetuar me gëzim, me besim në Jezu Krisht dhe me shpresën e patundur për marrjen e jetës së përjetshme me Atin tonë në Qiell.

## Studioni rreth Urdhërimeve, Ordinancave dhe Zotimeve

Ndërsa studioni “Ligje dhe Ordinanca” do t’ju vijë në ndihmë ndjekja e modelit të mëposhtëm.

- Studioni pjesën që përshkruan doktrinën dhe shkruani një plan të thjeshtë mësimi me tre deri në pesë pika kryesore.
- Mësojani një variant dy ose tre minutësh shokut/shoqes tuaj. Praktikoni si do ta bëni secilën ftesë zotimi dhe si do t’i zgjidhni shqetësimet e kërkuësve.
- Diskutoni mënyrat efektive për të ndjekur ecurinë e çdo zotimi që kërkuësit kanë pranuar.

## Priftëria dhe Organizatat Ndhmëse

Priftëria është fuqia dhe autoriteti që i jepet njeriut për të vepruar në emrin e Perëndisë për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Me anë të priftërisë ne marrim ordinancat e shpëtimit, si edhe bekimet e shërimit, ngushëllimit dhe këshillimit.

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme udhëhiqet nga Jezu Krishti me anë të apostujve dhe profetëve. Këta janë burra të drejtë që janë thirrur nga Perëndia dhe u është dhënë priftëria. Në lashtësi Krishti shuguroi Apostujt e Tij dhe u dha atyre priftërinë. Ai autoritet u zhduk kur njerëzit e mohuan ungjillin dhe vranë Krishtin dhe Apostujt.

Autoriteti i priftërisë u rivendos në vitin 1829 kur Gjon Pagëzori iu shfaq Profetit Jozef Smith dhe Oliver Kaudërit. Ai vendosi duart mbi kokat e tyre dhe u dha atyre Priftërinë Aarone (shih DeB 13). Pak më vonë Pjetri, Jakobi dhe Gjoni që ishin ndër dymbëdhjetë Apostujt e parë vendosën duart mbi Jozef Smithin dhe Oliver Kaudërin dhe u dhanë atyre Priftërinë Melkizedeke, që Pjetri, Jakobi dhe Gjoni e kishin marrë nga Jezu Krishti (shih DeB 27:12–13).

Një burrë mund ta marrë autoritetin e priftërisë vetëm me anë të shugurimit të duhur nëpërmjet vendosjes së duarve nga dikush që ka autoritetin. Një burrë që merr priftërinë merr një mundësi të mrekullueshme. Ai hyn në një besëlidhje për të plotësuar detyrat e shenjta, për t’u shërbyer të tjerëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e Kishës. Ai duhet të ketë një dëshirë për t’i shërbyer Perëndisë dhe duhet të jetë shuguruar në këtë fuqi (shih DeB 4:3; 63:57). Është gjithashtu e nevojshme që mbajtësit e priftërisë të kryejnë ordianca të shenjta, si pagëzimi dhe konfirmimi. Kur autoriteti i priftërisë përdoret denjësisht, manifestohet fuqia e Perëndisë. Fuqia e Priftërisë mund të përdoret vetëm në drejtësi, dashuri dhe durim.

E gjithë priftëria vjen nga Perëndia. Ka dy priftëri në Kishë: Priftëria Aarone dhe Priftëria Melkizedeke. Priftëria Aarone administron ordianca si pagëzimi dhe sakramenti. Meshkujt e denjë nga mosha 12 vjeç e lart marrin Priftërinë Aarone menjëherë pas pagëzimit dhe konfirmimit.

Me kalimin e kohës, meshkujt e rritur që janë të denjë marrin Priftërinë Melkizedeke ose Priftërinë më të lartë. Anëtarët e Kishës marrin shumë bekime shpirtërore dhe tokësore nëpërmjet fuqisë së kësaj priftërie. Mbajtësit e denjë të Priftërisë Melkizedeke mund të japin dhuratën e Frymës së Shenjtë, të shugurojnë të tjerët në priftërinë që i takon, të vajosin të sëmuret me vaj të shenjtëruar dhe të japin bekime shërimi dhe ngushëllimi. Bashkëshortët dhe baballarët e denjë që mbajnë Priftërinë Melkizedeke mund t’u japin bashkëshorteve, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes bekime të veçanta. Mësuesit e shtëpisë vizitojnë shtëpitë e anëtarëve të Kishës dhe kujdesen për ta dhe familjet e tyre. Peshkopët dhe presidentët e kunjit janë gjykatës në Kishë. Ata kanë autoritetin për t’i ndihmuar shenjtorët që kanë mëkatuar të pendohen dhe të gëzojnë bekimet e plota të anëtarësisë në Kishë. Ata intervistojnë njerëzit për të siguruar denjësinë e tyre për të hyrë në tempull.

Nën drejtimin e priftërisë, organizatat ndihmëse ndihmojnë në forcimin e anëtarëve. Ato janë një burim i madh në punën misionare, sepse ndihmojnë në gjetjen dhe mësimin e kërkuesve dhe shoqërimin e të porsakthyerve në besim. Gratë nga mosha 18 vjeç e lart janë anëtare të Shoqatës së Ndhmës, e cila u vjen në ndihmë të tjerëve nëpërmjet shërbimit ndaj familjeve, individëve dhe komunitetit. Vajzat e reja nga mosha 12 deri në 18 vjeç janë anëtare të Programit të të Rejave. Djemtë e së njëjtës moshë marrin pjesë në programin e të Rinjve. Të gjithë fëmijët nga mosha 3 deri në 11 vjeç janë pjesë e organizatës së Fillores. Të gjithë anëtarët nga mosha 12 vjeç e lart janë të regjistruar në klasat e Shkollës të së Dielës.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Mosia 18:17	DeB 84:19–20	Lluka 9:1–6
Alma 13:1–19	DeB 107	Gjoni 15:16
DeB 20:38–65	DeB 121:34–46	Jakobi 5:14–15 (Dhjata e Re)

#### Zotime

- A do të përgatiteni të merrni Priftërinë Aarone (meshkujt që i plotësojnë kushtet dhe janë të denjë nga mosha 12 vjeç e lart)?
- A do të përgatiteni të merrni Priftërinë Melkizedeke (meshkujt e rritur që i plotësojnë kushtet dhe janë të denjë)?
- A do të merrni pjesë aktive në organizatën ndihmëse që ju takon?

### Puna Misionare

Anëtarët që ndajnë ungjillin ndiejnë gëzim dhe kanë Shpirtin e Zotit më me bollëk. Kur ndajmë ungjillin, ne vlerësojmë se sa i çmuar dhe i rëndësishëm është ai për ne dhe ndiejmë një dashuri më të madhe për Perëndinë dhe të tjerët. Zoti i urdhëroi pasuesit e Tij të predikonin ungjillin në të gjithë botën, duke i dhënë mundësi çdo personi ta pranojë ose ta mohojë atë. Kur njerëzit pagëzohen, ata bëjnë një besëlidhje për të qëndruar gjithmonë si dëshmitarë të Perëndisë. Ata janë të urdhëruar ta ndajnë ungjillin me ata që nuk e kanë pranuar ende atë. Ndërsa e jetojnë ungjillin me besnikëri, ata japin një shembull, duke i treguar anëtarëve të familjes së tyre dhe shokëve bekimet e mëdha që vijnë nga të jetuarit e ungjillit. Ata duhet gjithashtu të shfrytëzojnë mundësitë për t'ju përgjigjur pyetjeve, për të ndarë materiale të shtypura ose audiovizive dhe për t'i ftuar të tjerët të mësojnë më shumë rreth mesazhit të ungjillit të rivendosur. Anëtarët duhet të lutën për ata që nuk janë anëtarë të Kishës. Ata duhet të lutën për të pasur mundësi për të bërë punë misionare—t'u shërbejnë atyre që nuk janë të besimit tonë dhe të ndajnë me ta atë që besojnë. Zoti premton t'i ndihmojë anëtarët të dinë se çfarë të thonë dhe çfarë të bëjnë kur ndajnë ungjillin.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Jakobi 5:70–75 (LiM)	DeB 19:29	DeB 84:74–76, 88
Mosia 28:3	DeB 33:8–11	DeB 88:81
DeB 18:10–16	DeB 38:40–42	DeB 100:5–8

Shënime

#### Shënime

#### Zotime

- A do të përgatiteni të ftoni miqtë dhe të afërmit që nuk i përkasin Kishës të takohen me misionarët për t'u mësuar ungjillin?
- A do të luteni për misionarët dhe për mundësi për të ndarë ungjillin?
- A do të përgatiteni të shërbeni në një mision?

### Martesa e Përjetshme

Njësia bazë e Kishës është familja. Brenda familjes, njerëzit përjetojnë shumë nga gëzimet dhe hidhërimet e jetës. Martesa midis një burri dhe një gruaje është shuguruar nga Perëndia dhe është thelbësore në planin e përjetshëm të Perëndisë për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Mënyra nëpërmjet së cilës është krijuar jeta e vdekshme është përcaktuar në mënyrë hyjnore dhe mbrohet nga martesa. Plani hyjnor i lumturisë bën të mundur që marrëdhëniet familjare të vazhdojnë përtej varrit. Megjithatë, martesa mund të jetë e përjetshme vetëm kur mbajtësit e autorizuar të priftërisë kryejnë ordinancën e vulosjes në tempujt e shenjtë dhe kur bashkëshortët e bashkëshortet që vulosen së bashku, mbajnë besëlidhjet që kanë bërë. Bashkëshortët e bashkëshortet duhet ta duan njëri-tjetrin. Ndërsa mbajnë urdhërimet dhe jetojnë parimet e ungjillit, ata duhet të nderojnë betimet e tyre martesore me besnikëri të plotë (shih “Familja Një Proklamatë Drejtuar Botës,” (35602) shih gjithashtu DeB 42:22).

Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Jezu Krishtit dhe kur prindërit i japin familjeve të tyre përparësinë më të lartë. “Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënëat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë” (35602). Së bashku, prindërit duhet t’u mësojnë fëmijëve të tyre ungjillin e Jezu Krishtit dhe t’i ndihmojnë ta jetojnë atë.

Satani po e përqendron sulmin e tij tek familja. Vite më parë, udhëheqësit e Kishës e caktuan pasditen e së hënës si një kohë kushtuar mbrëmjes familjare të shtëpisë. Prindërit duhet ta përdornin këtë kohë për t’u mësuar fëmijëve të tyre ungjillin, për të forcuar marrëdhëniet me ta dhe për t’u gëzuar së bashku. Mënyra të tjera për forcimin e familjes përfshijnë lutjen familjare dhe studimin e përditshëm familjar të shkrimeve të shenjta, adhurimin në Kishë si një familje dhe shërbimin ndaj të tjerëve. Qielli është një vazhdimësi e shtëpisë ideale. Me anë të ordinancave të priftërisë dhe të jetuarit me drejtësi, ne mund të jetojmë si familje në praninë e Perëndisë përjetësisht.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Martesa

DeB 42:22  
DeB 49:15  
DeB 131:1–4

DeB 132:7  
Zanafilla 2:24  
Efesianëve 5:25

“Familja: Një Proklamatë  
Drejtuar Botës”

##### Familja

Mosia 4:14–15  
3 Nefi 18:21

DeB 130:2  
1 Timoteut 5:8

“Familja: Një Proklamatë  
Drejtuar Botës”

##### Mësoni Fëmijët

Alma 56:47  
Alma 57:21

Moisiu 6:55–62  
DeB 68:25–30

Efesianëve 6:4  
Fjalët e Urta 22:6

## Zotime

- A do të zhvilloni mbrëmje familjare të shtëpisë çdo javë, lutje familjare të përditshme, studim të përditshëm familjar të shkrimeve të shenjta dhe aktivitete të tjera familjare?
- A do të përgatiteni të hyni në tempull për të (1) marrë indaumentin tuaj? (2) për t'u martuar për kohën dhe për përjetësinë? (3) në qoftë se jeni të martuar, për t'u vulosur për përjetësi si bashkëshort e bashkëshorte dhe (4) që fëmijët tuaj të vulosen me ju?
- Do të adhuron në ditën e Shabatit si një familje?
- A do t'u shërbeni të tjerëve?

## Shënime

## Tempujt dhe Historia Familjare

Perëndia e ka urdhëruar popullin e Tij të ndërtojë tempuj. Në tempull ne bëjmë besëlidhje të shenjta dhe pajisemi me (ose na jepet) një dhuratë fuqie dhe njohurie nga lart. Kjo fuqi na ndihmon në jetën tonë të përditshme dhe na bën të mundur të ndërtojmë mbretërinë e Perëndisë. Në tempull ne gjithashtu mund të marthohemi për kohën dhe për përjetësinë, duke bërë kështu të mundur që familjet të jenë së bashku përgjithmonë në praninë e Perëndisë. Mbas të paktën një viti anëtarësie, anëtarët e rritur që janë të denjë mund të jenë të përshtatshëm të marrin nga peshkopi një rekomandim për të marrë indaumentin e tyre. Pas marrjes së indaumentit, çiftet e martuara mund të vulosen ose të marthohen përjetësisht.

Shpëtimtari i do të gjithë njerëzit dhe dëshiron shpëtimin e tyre. Megjithatë miliona njerëz kanë vdekur pa pasur asnjë mundësi për të dëgjuar mesazhin e ungjillit të rivendosur të Jezut Krishtit ose për të marrë ordinancat e shpëtimit. Me anë të hirit dhe mëshirës së Tij të dashur Zoti e bën shpëtimin të mundur për të gjithë ata që nuk patën mundësi ta pranonin, ta kuptonin dhe t'i bindeshin ungjillit gjatë jetës së tyre të vdekshme. Ungjilli u predikohet këtyre njerëzve të vdekur në botën e shpirtave. Anëtarët e Kishës në tokë kryejnë ordinancat e shpëtimit në emër të paraardhësve të tyre të vdekur dhe të tjerëve. Njerëzit e vdekur që jetojnë në botën e shpirtave kanë mundësinë të pranojnë ose të mos pranojnë ungjillin dhe ordinancat e kryera në emrin e tyre.

Për këtë arsye, anëtarët e Kishës kërkojnë informacion për paraardhësit e tyre. Ata plotësojnë tabelën e prejardhjes familjare dhe dokumentet e grupit familjar dhe i dërgojnë emrat e të afërmve të vdekur, që kanë nevojë t'u kryhen ordinancat e shpëtimit në emër të tyre, në tempujt e shenjta. Kjo është puna për historinë familjare. Anëtarët e denjë nga mosha 12 vjeç e lart, duke përfshirë edhe anëtarët e rinj, mund të marrin nga peshkopi një rekomandim për të kryer pagëzime për të vdekurit.

## Historia Familjare

I ftoni anëtarët e rinj të takohen me një anëtar ose të shkojnë në qendrën lokale të historisë familjare (aty ku ka një të tillë) për t'u njohur me punën e historisë familjare dhe me burimet që janë në dispozicion të tyre. U jepni atyre një kopje të materialeve të historisë familjare.

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

DeB 43:16	DeB 131	1 Korintasve 15:29
DeB 95:8–9	DeB 132	Psalmet 65:4
DeB 124:22–42	DeB 138	Broshurë, <i>Welcome to the Family History Center</i>
DeB 128	1 Pjetri 3:18–21	

#### Shënime

#### Zotime

- A do të përgatiteni të merrni ordinancat e tempullit? (Jo shumë kohë pas pagëzimit dhe konfirmimit, anëtarët e denjë nga mosha mbi 12 vjeç e lart mund të marrin një rekomandim për të shkuar në tempull dhe për të marrë pjesë në pagëzime për të vdekurit.)
- A do të merrni pjesë në punën e historisë familjare dhe të çoni në tempull emrat e paraardhësve për të marrë ordinancat mëkëmbëse të tempullit?

#### Shërbimi

Një nga bekimet më të mëdha të anëtarësisë në Kishë është mundësia për të shërbyer. Kur u shërbejmë të tjerëve me dashuri, i shërbejmë Perëndisë. Kur pagëzohemi ne besëlidhim se do të japim një shërbim të tillë (shih Mosia 18:8–10). Ne duhet t'i njohim nevojat fizike dhe shpirtërore të të tjerëve. Më pas ne japim nga koha, talentet dhe mjetet tona për të ndihmuar në plotësimin e këtyre nevojave. Ne ndjekim shembullin e Shpëtimtarit, i cili erdhi për t'u shërbyer të tjerëve. Ne duhet të bëjmë çfarë bëri Jezusi dhe të bëhemi si Ai.

Jo shumë kohë pas pagëzimit, anëtarët e rinj marrin nga udhëheqësit e priftërisë bekimin e një përgjegjësie për të ndihmuar në Kishë. Këtë e quajmë thirrje. E gjithë puna në Kishë është vullnetare. Asnjëri nuk paguhet për një shërbim të tillë. Kur e pranojmë një thirrje, ne mbështetemi publikisht në mbledhjet e Kishës kështu që anëtarët e tjerë mund ta pranojnë thirrjen tonë dhe të na mbështesin. Ne gjithashtu veçohemi nga një udhëheqës priftërie dhe na jepen bekime të veçanta për të na ndihmuar në përmbushjen e thirrjeve tona. Kisha ka nevojë për talentet dhe aftësitë e çdo anëtari për të përmbushur shumë thirrje të ndryshme. Të gjitha thirrjet janë të rëndësishme dhe ndihmojnë në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë. Ne duhet t'i pranojmë këto thirrje dhe të punojmë me zell për t'i mësuar dhe përmbushur detyrat tona. Ndërsa e bëjmë këtë, ne rritemi në besim, zhvillojmë talente të reja e aftësi më të mëdha për të shërbyer dhe marrim bekime të tjera të panumërta.

Mbajtësit e priftërisë mund të thirren si mësues shtëpie. Mësuesit e shtëpisë kryejnë vizita së paku mujore në shtëpitë e familjeve anëtare që u janë caktuar. Ata mësojnë ungjillin, mbështesin prindërit, forcojnë miqësi dhe i ndihmojnë familjet të përgatiten për të marrë dhe mbajtur besëlidhjet e tempullit. Mësueset e vizitave përfaqësojnë Shoqatën e Ndhmës duke kryer vizita mujore tek çdo motër e rritur që iu është caktuar.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Dashuria hyjnore

Moroni 7:43–48      DeB 88:125      Mateu 22:36–40      1 Korintasve 13:1–8

##### Kujdesi për të Varfërit

Mosia 4:26      Alma 34:28–29      DeB 52:40      Mateu 25:40

##### Ne Duhet të Shërbejmë

Mosia 2:17      Mosia 18:8–10      DeB 42:29      DeB 107:99–100

#### Zotime

- A do të pranoni dhe përmbushni detyrat e një thirrjeje (duke përfshirë detyrën si një mësues shtëpie ose mësuese vizitash)?
- A do t'i mbështetni të tjerët në thirrjet e tyre?

## Mësimdhënia dhe të Mësuarit në Kishë

Kisha është organizuar që të përsosë dhe të bekojë jetën e anëtarëve. Ajo na jep mundësi t'i mësojmë ungjillin njëri-tjetrit, të shoqërojmë dhe t'i shërbejmë njëri-tjetrit dhe të mbështesim njëri-tjetrin në kërkimin tonë për shpëtim. Në familje dhe nëpërmjet Kishës, çdo anëtar mëson doktrinat e ungjillit. Kur anëtarët thirren për të dhënë mësim, atyre u jepen materialet dhe ndihma që u duhet për të qenë të suksesshëm.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

DeB 88:77–79

Efesianëve 4:11–14

### Zotime

- A do ta frekuentoni Kishën?

## Durimi Deri në Fund

Kur vazhdojmë të jetojmë ungjillin, ne afrohem me pranë Atit Qiellor. Ne gëzojmë dhe vlerësojmë më shumë Shlyerjen e Shpëtimtarit. Familjet tona bëhen më të bashkuara. Ne përjetojmë ndjenja më të forta dashurie, gëzimi dhe paqeje që vijnë nga Shlyerja. Zemrat tona ndryshojnë dhe ne gjejmë siguri në të jetuarit e ungjillit të rivendosur.

Kur vazhdojmë të ushtrojmë besim në Jezu Krisht, të pendohemi dhe të përtërijmë besëlidhjet tona, ne gëzojmë udhëheqjen e vazhdueshme nga Fryma e Shenjtë. Nëse durojmë deri në fund të jetës sonë në të qenit të vërtetë ndaj besëlidhjeve tona, ne do të kemi jetën e përjetshme.

Disa anëtarë nuk durojnë deri në fund ose nuk qëndrojnë plotësisht aktivë. Megjithatë, të duruarit deri në fund është një përgjegjësi personale. Ne “punojmë për shpëtimin [tonë]” (Filipianëve 2:12) dhe u shërbejmë e i duam ata besimi i të cilëve është dobësuar për shkak të mosardhjes në Kishë.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

2 Nefi 31:20–21  
Moroni 6:4DeB 20:37  
Nenet e Besimit 1:3Gjoni 14:15, 21  
Efesianëve 4:11–14

Filipianëve 2:12

### Zotime

- A do të vazhdoni ta jetoni ungjillin duke mbajtur besëlidhjen e pagëzimit gjatë gjithë jetës suaj?

Shënime







# Si ta Dalloj dhe ta Kuptoj Praninë e Shpirtit?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Pse kam nevojë të marr zbulësë personale?
- Kush është Fryma e Shenjtë dhe si punon Ai?
- Pse duhet të lutem me besim?
- Cili është roli i ndikimit të Shpirtit në punën misionare?
- Si mund t'i dalloj nxitjet e Shpirtit?

## Zbulesa Personale

**J**ozef Smithi ka thënë: “Shpëtimi nuk mund të vijë pa zbulësë; është e kotë që dikush të shërbejë pa të” (shih *History of the Church*, 3:389). Ju do të përparoni në punën tuaj ndërsa mësoni të merrni e të ndiqni zbulësën personale. Jozef Smithi gjithashtu na mësoi se zbulësja është jetike për punën tuaj të përditshme: “Ky është parimi sipas të cilit drejtohet qeveria e qiellit—me anë të zbulësës përshtatur me rrethanat në të cilat ndodhen bijtë e mbretërisë” (shih *History of the Church*, 5:135).

Perëndia ju do ju dhe të gjithë fëmijët e Tij. Ai pret me padurim t’ju mbështesë në sfidat tuaja praktike dhe të veçanta. Juve ju është premtuar frymëzim për të ditur se çfarë të bëni dhe ju është dhënë fuqia ta bëni atë (shih DeB 43:15–16). Ai do t’ju ndihmojë ndërsa ju përpigjeni ta dalloni dhe kuptoni praninë e Shpirtit me anë të studimit të zellshëm të shkrimeve të shenjta. Ai do t’u udhëheqë tek njerëzit që do ta pranojnë mesazhin e Rivendosjes. Ai do t’ju japë fuqinë ta transmetoni mesazhin dhe të dëshmoni për Krishtin dhe ungjillin e Tij. Ai do të derdhë bekimet e Tij mbi ju nëpërmjet dhuratës së Frymës së Shenjtë. Ai kërkon që ju të mbeteni të denjë për këtë dhuratë dhe që të lypni, të kërkonti dhe të trokisni (shih DeB 4:7; Mateu 7:7–8).

Ne jetojmë në ditën e profetizuar nga profetët e Librit të Mormonit—një ditë kur njerëzit do të “grinden me njëri-tjetrin dhe ... do t’i mësojnë të tjerët me diturinë e tyre dhe do të mohojnë Frymën e Shenjtë, që jep fuqi shprehëse” (shih 2 Nefi 28:4; shih gjithashtu 3 Nefi 29:6; Mormoni 9:7–8). Por ka ende shumë njerëz që dëshirojnë gjëra shpirtërore. Ndërsa mësoni të merrni zbulesë personale, ju do t’i mësoni të tjerët me fuqi dhe autoritet (shih Alma 17:3), sepse Fryma e Shenjtë ju jep fuqi për të folur (shih Nefi 10:22).

Ju duhet të kërkonte dhe të merrni zbulesë personale nëpërmjet Frymës së Shenjtë ndërsa i ndihmoni njerëzit të pagëzohen dhe të konfirmohen. Kini besim se do të merrni zbulesë personale për t’ju udhëhequr nga dita në ditë. Fryma e Shenjtë do t’ju ndihmojë në çdo aspekt të punës suaj.

#### Aktivitet: Studim Individual

Në dëshminë e tij të fundit, Moroni shkroi “pak fjalë për t’ju këshilluar” (Moroni 10:2). Lexoni Moroni 10 dhe shkruani me fjalët tuaja çfarë këshillon Moroni të bëjë lexuesi i Librit të Mormonit. (Këshillim do të thotë të inkurajosh fort ose të shtysh dikë të bëjë diçka.)

### Drita e Krishtit

Një person është i aftë të marrë udhëheqje shpirtërore përpara se të pagëzohet dhe të konfirmohet. Ky ndikim shpirtëror fillon me Dritën e Krishtit, që “i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja” (Moroni 7:16; shih gjithashtu vargjet 14–19).

Drita e Krishtit është “energji, fuqi, ose ndikim hyjnor që vjen nga Perëndia nëpërmjet Krishtit dhe i jep jetë e dritë gjithçkaje. Është ligji sipas të cilit të gjitha gjërat qeverisen në qiell dhe në tokë. Ajo gjithashtu i ndihmon njerëzit të kuptojnë të vërtetat e ungjillit dhe ndihmon për t’i futur ata në atë shteg të ungjillit i cili çon drejt shpëtimit. Drita e Krishtit nuk duhet të ngatërrohet me Frymën e Shenjtë. Drita e Krishtit nuk një njeri. Ajo është një ndikim që vjen nga Perëndia dhe e përgatit një njeri për të marrë Frymën e Shenjtë. Është një ndikim për mirë në jetën e të gjithë njerëzve. Një manifestim i dritës së Krishtit është ndërgjegjja, e cila e ndihmon një njeri të zgjedhë midis së drejtës dhe së gabuarës. Ndërsa njerëzit mësojnë më shumë rreth ungjillit, ndërgjegjja e tyre bëhet ndjeshme. Njerëzit që i binden dritës së Krishtit udhëhiqen tek ungjilli i Jezu Krishtit” (Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Dritë, Dritë e Krishtit;” shih gjithashtu DeB 84:46–47).

President Boid K. Paker ka thënë: “Është e rëndësishme për...një misionar...të dijë se Fryma e Shenjtë mund të veprojë nëpërmjet dritës së Krishtit. Një mësues i të vërtetave të ungjillit nuk mbjell diçka të huaj apo të re tek një i rritur ose tek një fëmijë. Përkundrazi, misionari ose mësuesi kontakton me Frymën e Shenjtë që tashmë ndodhet tek ta. Ungjilli do t’u tingëllojë i njohur njerëzve” (“The Light of Christ” [Drita e Krishtit], fjalim i mbajtur në seminar për presidentët e rinj të misionit, 22 qershor 2004, 2).

### Fryma e Shenjtë

**Personazhi i Frymës së Shenjtë.** Fryma e Shenjtë është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi. Ai është një personazh shpirti dhe nuk ka një trup prej mishi e kockash (shih DeB 130:22). Ai është Ngushëlluesi, për të cilin Shpëtimtari premtoi se do t’u mësonte pasuesve të Tij çdo gjë dhe t’u kujtonte atyre çdo gjë që Ai u kish mësuar (shih Gjoni 14:26).

**Fuqia e Frymës së Shenjtë.** Dëshmia që marrin kërkuesit e sinqertë përpara pagëzimit vjen me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë. “Fuqia e Frymës së Shenjtë mund të vijë mbi një njeri përpara pagëzimit dhe të dëshmojë se ungjilli është i vërtetë” (Udhëzuesi për

Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë.” Kjo fuqi na jep një dëshmi për Jezu Krishtin dhe punën e Tij, si edhe për punën e shërbëtorëve të Tij në tokë. Fryma e Shenjtë dëshmon për të vërtetën. Të gjithë njerëzit mund të dinë për vërtetësinë e Librit të Mormonit me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë. “Dhe nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund të dini të vërtetën e të gjitha gjërave” (Moroni 10:5).

**Dhurata e Frymës së Shenjtë.** Kërkesit që marrin një dëshmi ende nuk e kanë premtimin e shoqërimin të vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë. Jozef Smithi ka thënë: “Ekziston një ndryshim midis Frymës së Shenjtë dhe dhuratës së Frymës së Shenjtë. Korneli mori Frymën e Shenjtë përpara se të pagëzohej, që ishte për të fuqia bindëse e Perëndisë për vërtetësinë e Ungjillit, por ai nuk mundi ta merrte dhuratën e Frymës së Shenjtë deri pas pagëzimit. Po të mos e kish marrë këtë shenjë ose ordinancë, Fryma e Shenjtë që e bindi për vërtetësinë e Perëndisë, do të ishte larguar prej tij (shih History of the Church, 4:555).

“... e drejta për të pasur shoqërinë e vazhdueshme të Frymës së Shenjtë, kurdo që dikush është i denjë, është një dhuratë që mund të merret vetëm me anë të vënies së duarve nga një mbajtës i Priftërisë Melkizedeke pas pagëzimit të autorizuar në Kishën e vërtetë të Jezu Krishtit” (Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë”).

Si një anëtar i Kishës, ju keni marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë nëpërmjet autoritetit të priftërisë. Kjo dhuratë ju jep të drejtën për të pasur shoqërinë e vazhdueshme të Frymës së Shenjtë në qoftë se qëndroni të denjë për të. Lutuni për udhëheqjen e Shpirtit dhe ndiqni me guxim nxitjet që merrni.

**Shpirti i Shenjtë i Premtimit.** Frymën e Shenjtë e quajmë gjithashtu edhe Shpirti i Shenjtë i Premtimit (shih DeB 88:3). Të vulosesh nga Shpirti i Shenjtë i Premtimit do të thotë që Fryma e Shenjtë konfirmon se veprimet e drejta, ordinancat dhe besëlidhjet janë të pranueshme nga Perëndia. Shpirti i Shenjtë i Premtimit i dëshmon Atit se ordinancat e shpëtimit janë kryer në mënyrën e duhur dhe se besëlidhjet e shoqëruara me to janë mbajtur. Ata që janë vulosur nga Shpirti i Shenjtë i Premtimit marrin gjithçka që ka Ati (shih DeB 76:51–60; Efesianëve 1:13–14). Të gjitha besëlidhjet dhe ordinancat duhet të vulosen nga Shpirti i Shenjtë i Premtimit që të jenë të vlefshme pas kësaj jete (shih DeB 132:7, 18–19, 26). Thyerja e besëlidhjeve mund ta heqë vulosjen.

**Dhuratat e Shpirtit.** Dhuratat e Shpirtit janë bekime shpirtërore të veçanta që Zoti u jep individëve të denjë në të mirë të tyre dhe që të përdoren për të bekuar të tjerët. Për shembull, misionarët që duhet të mësojnë një gjuhë të re mund të marrin dhuratën e gjuhëve për t’u dhënë atyre ndihmë hyjnore në mësimin e saj. Disa dhurata të Shpirtit përkrahohen tek Moroni 10:8–18; Doktrina e Besëlidhje 46:11–33; dhe 1 Korintasve 12:1–12. Këto janë vetëm disa shembuj të dhuratave të shumta të Shpirtit. Zoti mund t’ju bekojë në mënyra të tjera në varësi të besnikërisë, nevojave tuaja dhe nevojave të atyre të cilëve u shërbeni. Ju duhet t’i dëshironi dhe t’i kërkonit me zell dhuratat

*“Dhurata e Frymës së Shenjtë vjen pasi dikush pendohet dhe bëhet i denjë...Fryma e Shenjtë dëshmon për të vërtetën dhe ngulit në shpirt realitetin e Perëndisë Atit dhe të Birit Jezu Krisht aq thellë sa asnjë fuqi apo autoritet tokësor nuk mundet ta ndajë atë nga ajo njohuri.”*

— PRESIDENTI XHEIMS E. FAUST  
“THE GIFT OF THE HOLY GHOST—A SURE COMPASS,”  
ENSIGN, PRILL 1996, 4

## Shënime

shpirtërore (shih DeB 46:8; 1 Korintasve 12:31; 14:1, 12). Këto dhurata vijnë nëpërmjet lutjes, besimit dhe veprave sipas vullnetit të Perëndisë (shih DeB 63:9–12; 84:64–73).

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

Lexoni referencat e mëposhtme:

- Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Frymë e Shenjtë,” “Dritë, Dritë e Krishtit” dhe “Shpirt”.
- *Our Search for Happiness*, 84:86, 91–92.
- *Të Vërtetë ndaj Besimit*, “Fryma e Shenjtë”, 56-58, “Dhurata Shpirtërore”, 43-45.

Shkruani një përshkrim të natyrës dhe rolit të Frymës së Shenjtë.

Lexoni Veprat e Apostujve 4:23–33.

- Si i kërkuan Pjetri dhe Gjoni dhuratat shpirtërore?
- Si iu përgjigj Zoti lutjeve të tyre?
- Çfarë mund të mësoni nga kjo përvojë rreth punës suaj?

**Fuqia e Shpirtit në Kthimin në Besim**

Fuqia e Frymës së Shenjtë është thelbësore në kthimin në besim. Përpiquni të kuptoni doktrinën e kthimit në besim dhe gjithashtu përvojën e kthimit në besim. Plaku Boid K. Parker shpjegoi rolin kryesor të Shpirtit në kthimin në besim:

“Kur kthimi në besim ndodh, ai ndodh nëpërmjet fuqisë së Shpirtit. Në mënyrë që të përparohet në punën misionare, duhet të ndodhin këto tre gjëra:

Ne duhet të kuptojmë se çfarë duhet të ndiejë një kërkues në mënyrë që të kthehet në besim.

Ne duhet të kuptojmë se çfarë duhet të ndiejë një misionar në mënyrë që të japë mësim me fuqinë kthyesë të Shpirtit.

Dhe më pas duhet të kuptojmë se çfarë duhet të ndiejë një anëtar që të përparojë kur merr pjesë në përvojën e kthimit në besim” (konferenca e presidentëve të misionit, 3 prill 1985).

Sa më mirë ta kuptoni si ndihen kërkuesit, misionarët dhe anëtarët kur marrin dëshminë e Shpirtit, aq më mirë do ta kuptoni rolin tuaj, i cili është :

- Të lartësoheni shpirtërisht dhe të ndriçoni mendjen tuaj ndërsa hetoni shkrimet e shenjta dhe u mësoni të tjerëve doktrinën.
- Të krijoni një klimë të tillë kur jepni mësim, në të cilën Fryma e Shenjtë të mund të dëshmojë. Bëjeni këtë duke mësuar dhe duke dëshmuar për mesazhin e Rivendosjes. I mësoni të tjerët ashtu siç ju drejton Shpirti dhe dëshmoni se ju e dini nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë se ajo që po u mësoni atyre është e vërtetë.
- Të ndiqni udhëheqjen e Shpirtit për t’ia përshtatur mesazhin nevojave të çdo personi.



- T'i ftoni njerëzit të veprojnë. Besimi i tyre do të rritet ndërsa ata pendohen, u binden urdhërimeve dhe bëjnë e mbajnë besëlidhjet.

Plaku M. Rasëll Ballard foli për fuqinë e Shpirtit: “Kthimi i vërtetë në besim vjen nëpërmjet fuqisë së Shpirtit. Kur Shpirti prek zemrën, zemrat ndryshojnë. Kur individët... ndiejnë Shpirtin të punojë me ta, ose kur ata shohin provën e dashurisë dhe mëshirës së Zotit në jetën e tyre, ata lartësohen dhe forcohen shpirtërisht dhe besimi i tyre tek Ai rritet. Këto përvoja me Shpirtin rrjedhin natyrshëm kur një person dëshiron të eksperimentojë me fjalën. Kështu arrijmë ta ndiejmë që ungjilli është i vërtetë” (“Now Is the Time,” *Ensign*, nëntor 2000, 75).

Fryma e Shenjtë punon në zemrat e njerëzve për të shkaktuar këto ndryshime. Ndërsa njerëzit zgjedhin të mbajnë zotimet, ata do të ndiejnë më fort fuqinë e Frymës së Shenjtë dhe do të zhvillojnë besimin për t'iu bindur Krishtit. Kështu, ju duhet t'i ndihmoni njerëzit me të cilët punoni që të rriten në besim duke i ftuar ata të pendohen dhe të marrin e të mbajnë zotime.

#### Aktivitet: Studim Individual

- Lexoni një ose dy nga fragmentet e mëposhtme, dhe meditoni se çfarë duhet të ndiejë një kërkues që të kthehet në besim. Shkruani ndjenjat dhe përshtypjet tuaja në ditarin e studimit. Diskutojini idetë tuaja me misionarët e tjerë dhe me anëtarët.

2 Nefi 4:16–35; Enosi 1; Mosia 4–5; 18:7–14; 27–28; Alma 5; 17–22; 32; 36; 38

- Lexoni një ose dy nga fragmentet e mëposhtme dhe meditoni se çfarë duhet të ndieni ju si misionar dhe si anëtar që t'i mësoni të tjerët me fuqinë kthyesë të besimit. Shkruani ndjenjat dhe përshtypjet tuaja në ditarin e studimit. Diskutojini idetë tuaja me misionarët e tjerë dhe me anëtarët.

1 Nefi 8:11–12; Mosia 28:1–4; Alma 26; 29; 31:26–38; 32; Moroni 7:43–48; DeB 4; 18:10–16; 50:21–22

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Çfarë ju mësojnë këto shkrime të shenjta rreth fuqisë së Shpirtit në punën tuaj?

2 Nefi 33:1–2  
DeB 42:11–17

DeB 50:13–22  
Veprat e Apostujve  
2:37–38

1 Korintasve 2:11–14  
Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Kthim, Kthyer (i)”

##### Çfarë mund të bëni për të gëzuar fuqinë e Shpirtit në punën tuaj?

Alma 32:27–28

DeB 42:14

Gjoni 7:17

##### Pse është e rëndësishme t'u mësoni të tjerëve atë çfarë ju dini dhe besoni?

Alma 5:43–47

DeB 52:9

DeB 80:4

## Lutuni me Besim

Ju mund t'i mësoni të tjerët sipas mënyrës së Zotit vetëm me anë të fuqisë së Shpirtit dhe Shpirtin e merrni me anë të lutjes së besimit. Zoti tha: “Shpirti do t'ju jepet me anë të lutjes së besimit; dhe nëse nuk e merrni Shpirtin, ju s'duhet të jepni mësim (DeB 42:14). Kur luteni për ndihmë në mësimdhënien tuaj, fuqia e Frymës së Shenjtë do t'i çojë mësimet tuaja “në zemrat e fëmijëve të njerëzve” (2 Nefi 33:1).

Presidenti Gordon B. Hinkli e ilustroi këtë parim duke treguar një përvojë nga misioni i tij:

## Shënime

“Gjithmonë më kujtohen dy të rinj që shërbyen në misionin tim. Njëri ishte shumë i talentuar. Ai ishte i arsimuar. Ishte i shkëlqyer. Ishte i shpejtë. Ai ishte pak arrogant. Kishim edhe një misionar tjetër që merrej me shkruarjen e tabelave. Ai vinte nga një dyqan ku shkruheshin tabela dhe kishte shumë pak arsim, por ai i njihte mangësitë e veta dhe mbështetej tek Zoti. Kur ai lutej, mund ta kuptonit se po fliste me Zotin. Nuk ishte diçka e mësuar përmendësh, ishte një bashkëbisedim dhe ky i ri bëri mrekullira ndërsa i riu tjetër thjesht bëri detyrën. Fuqia që ishte tek njëri dhe mungesa e saj tek tjetri ishte shumë e dukshme. Thirrini Zotit. Ai ju ka drejtuar një ftesë dhe Ai do t’ju përgjigjet” (Teachings of Gordon B. Hinckley [1997], 469).

Përpiquni të luteni sinqerisht, me bindje të vërtetë dhe me “me gjithë energjinë e zemrës” (Moroni 7:48). Lutja e frytshme kërkon përpjekje të mëdha (shih Moroni 10:3–3; DeB 8:10; 9:7). Mendoni seriozisht për sjelljen dhe fjalët që përdorni. Kur luteni mbani parasysh sa vijon:

- Përdorni gjuhën e lutjes, që tregon se ju e doni dhe e respektoni Atin tuaj Qiellor. Përdorni një fjalor të përshtatshëm dhe që tregon respekt në çfarëdo gjuhe që flisni.
- Gjithmonë shprehni mirënjohje për bekimet tuaja. Një përpjekje e vetëdijshme për të qenë mirënjohës do t’ju ndihmojë të kuptoni se sa mëshirëplotë ka qenë Zoti në jetën tuaj.
- Lutuni në mënyrë specifike për udhëheqjen dhe ndihmën e Frymës së Shenjtë. Tregoni se e vlerësoni këtë bekim duke qenë të ndjeshëm dhe të vëmendshëm ndaj nxitjeve shpirtërore. E më pas, me kurajo ndiqini këto nxitje.
- Lutuni me dashuri dhe dashuri hyjnore. Lutuni për njerëzit duke i përmendur me emra. Kërkoni frymëzim që t’ju ndihmojë të kuptoni dhe të plotësoni nevojat e tyre. Lutuni për mirëqenien e njerëzve që kontaktoni, kërkuesve, të të porsakthyerve dhe anëtarëve më pak aktivë. Lutuni për anëtarët dhe udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse në zonën tuaj. Lutuni për familjen tuaj. Lutuni për shokun/shoqen tuaj, për misionarët e tjerë dhe për presidentin e misionit. Lutuni për të ditur si t’i ndihmoni të tjerët dhe jini të gatshëm të sakrifikoni për ta.
- Lutuni që t’ju tregohet ku të shkoni e çfarë të bëni. Lutuni



*“Çdo mëngjes...misionarët duhet të bien në gjunjë e t’i përgjërohen Zotit t’u zgjidhë gjuhën e të flasë nëpërmjet tyre për bekimin e atyre që ata po mësojnë. Nëse ata do ta bëjnë këtë, një dritë e re do të vijë në jetën e tyre. Do të ketë më shumë entuziazëm për punën. Ata do të arrijnë ta kuptojnë se në një kuptim shumë të vërtetë, ata janë shërbëtorë të Zotit që flasin në emër të Tij. Ata do të shikojnë se do të kenë një reagim tjetër prej atyre që po mësojnë. Ndërsa veprojnë kështu nëpërmjet Shpirtit, kërkuesit e tyre do të përgjigjen nën ndikimin e po të njëjtit Shpirt.”*

—PRESIDENTI GORDON B. HINKLI  
“MISSIONARY SERVICE,” FIRST WORLDWIDE LEADERSHIP  
TRAINING MEETING, 11 JANAR 2003, 20

që të drejtoheni tek ata që janë të përgatitur të pranojnë mesazhin e Rivendosjes. Lutuni që të mund t'i dalloni ata.

- Pranoni se Ati juaj Qiellor e di më mirë se ju vetë se çfarë ju nevojitet. Mbështetuni te Shpirti që të dini se për çfarë të luteni (shih 3 Nefi 19:24; DeB 46:28, 30).
- Natën kur të luteni, jepini Zotit një llogari të veprimtarisë tuaj ditore. Pastaj diskutoni me Të planin tuaj për të nesërmen. Dëgjoni nxitjet e Shpirtit.
- Lutuni që të mposhtni tundimin. Dhënia ndaj tundimit pengon ndikimin e Shpirtit.
- Lutuni dhe, kur është me vend, agjëroni për bekime të veçanta.
- Lutuni dhe meditonit për shkrimet e shenjta. Shkrimet e shenjta hapin dritaren drejt zbulësës.
- Besoni se Perëndia do t'u përgjigjet lutjeve tuaja. Pranoni se mendimet e Perëndisë nuk janë mendimet tuaja (shih Isaia 55:8–9) dhe besojini Perëndisë që t'u përgjigjet lutjeve tuaja në mënyrën e Tij dhe në kohën e Tij.


### Aktivitet: Studim Individual

Meditoni rreth thënieve të mëposhtme në lidhje me lutjen e sinqertë:

“Problemi me pjesën më të madhe të lutjeve tona është se ne i bëjmë ato sikur po ngremë telefonin e po porosisim ushqime—bëjmë porosinë dhe e mbyllim telefonin. Ne duhet të meditojmë, të mendohe mi thellë se për çfarë dhe për kë po lutemi dhe pastaj të flasim me Zotin si një njeri flet me një tjetër” (Gordon B. Hinckley, *Teachings of Gordon B. Hinckley*, 469).

“Në qoftë se lutja është vetëm një lutje sporadike, në rast krize, atëherë ajo është krejtësisht egoiste dhe kështu ne fillojmë të mendojmë për Perëndinë si një teknik apo agjenci shërbimesh që na ndihmon vetëm në raste emergjence. Ne duhet ta kujtojmë Më Të Lartin ditë e natë—gjithmonë—jo vetëm në rastet kur çdo ndihmë tjetër ka dështuar dhe ne kërkojmë ndihmë me dëshpërim” (Howard W. Hunter, *The Teachings of Howard W. Hunter*, redak. Clyde J. Williams [1997], 39).

Duke përdorur shkallën e mëposhtme, vlerësoni personalisht lutjet tuaja. Në ditarin e studimit, shkruani përgjigjet e pyetjeve të tilla: Ku do ta vendosni veten tuaj në këtë shkallë? Ku do t'ju pëlqente të ishit në këtë shkallë? Si do të ndryshoni?



## Studim i Shkrimeve të Shenjta

## Pse duhet të luteni për të pasur Shpirtin?

2 Nefi 32:8–9

DeB 42:14

DeB 50:13–22

## Për çfarë duhet të luteni?

Alma 6:6

Alma 37:36–37

DeB 50:29–30

Alma 13:28

3 Nefi 18:20

Udhëzuesi për Shkrimet e

Alma 34:17–27

3 Nefi 19:9

Shenjta, “Lutje”

## Mësoni të Dalloni Nxitjet e Shpirtit

Shpirti është gjithnjë i gatshëm t’ju udhëzojë dhe drejtojë. Megjithatë, Shpirti flet me qetësi, si me anë të ndjenjave ashtu edhe me anë të mendjes suaj. Një sfidë e madhe për ju dhe për ata me të cilët punoni është të dalloni nxitjet e qeta e të padukshme të Frymës së Shenjtë.

Presidenti Boid K. Paker mësoi: “Zëri i Shpirtit përshkruhet në shkrimet e shenjta si një zë që nuk është as ‘i lartë’ as ‘i ashpër.’ Nuk është ‘një zë bubullime, as...zëri i zhurmës së një trazire të madhe.’ Përkundrazi është një ‘zë i qetë i një butësie të përsosur, sikur të ishte një pëshpëritje’ dhe ai mund të ‘depërtojë thellësinë e shpirtit’ dhe ‘e bën [zemrën] të digjet.’ (3 Ne. 11:3; Hel. 5:30; DeB 85:6–7.) Kujtoni, Elia zbuloi se zëri i Zotit nuk ishte në erë, as në tërmet ose në zjarr, por ishte një ‘shushuritje e ëmbël.’ (1 Mbretërve 19:12.)

Shpirti nuk na tërheq vëmendjen duke ulëritur apo duke na shkundur me një dorë të rëndë. Përkundrazi, ai pëshpërit. Ai na përkëdhel aq butë, sa po të jemi të zënë ndofta nuk e ndiejmë fare atë. (Nuk është çudi që Fjala e Urtësisë na u zbulua ne, sepse si do mund ta ndiente një zë të tillë i alkoolizuari apo ai që është i varur ndaj veseve të tij?)

Ndonjëherë ai do të na shtyjë fort që t’i kushtojmë vëmendje. Por shumicën e rasteve, nëse nuk i kushtojmë vëmendje ndjenjës së brishtë, Shpirti do të tërhiqet e do të presë derisa ne të kërkojmë dhe dëgjojmë e të themi sipas mënyrës dhe shprehjes sonë, si Samueli në kohët e lashta ‘Folë [Zot], sepse shërbëtori yt të dëgjon’. (1 Sam. 3:10.)” (“The Candle of the Lord,” *Ensign*, janar 1983, 53).

Shumë zëra në botë konkurrojnë për vëmendjen tuaj dhe ato kollaj mund të mbysin mbresat shpirtërore nëse nuk jeni të vëmendshëm.

## Aktivitet: Studim Individual ose Studim me Shokun

Studioni tabelën e mëposhtme. Mendoni për kohët kur keni përjetuar ndonjë nga ndjenjat, mendimet, ose përshtypjet e përshkruara në fragmentet e mëposhtme. Ndërsa studioni e fitoni përvojë, shtoni fragmente të tjera në këtë listë. Mendoni se si mund t’i përdorni këto parime për t’i ndihmuar të tjerët të ndiejnë dhe të dallojnë praninë e Shpirtit.

DeB 6:23; 11:12–14; Romakëve 15:13; Galatasve 5:22–23	Jep ndjenja dashurie, gëzimi, paqeje, durimi, zemërbutësie, mirëdashjeje, besimi dhe shprese.
DeB 8:2–3	Jep ide në mendje, ndjenja në zemër.
DeB 128:1	Pushton mendjen dhe ndikon në ndjenjat.
Joseph Smith—Historia 1:11–12	Ndihmon që shkrimet e shenjta të kenë ndikim të fortë.
DeB 9:8–9	Jep ndjenja të mira për të na mësuar nëse diçka është e vërtetë.





dhe të porsakthyerit. Detyra juaj është të jetoni me denjësi, të luteni me zell dhe të mësoni të dalloni e të ndiqni me kurajo udhëheqjen e Shpirtit.

### Mbështetuni tek Shpirti

Si shërbëtor i Zotit, ju duhet ta bëni punën e Tij në mënyrën e Tij dhe nëpërmjet fuqisë së Tij. Disa misionarë janë të sigurtë në vetvete se e dinë si të jenë të suksesshëm. Disa të tjerëve u mungon kjo siguri. Kujtohuni, gjithsesi, se siguria dhe besimi juaj duhet të jetë tek Krishti dhe jo tek vetja juaj. Mbështetuni tek Shpirti më tepër se në talentet dhe aftësitë tuaja. Besojini Shpirtit që t'ju udhëheqë në çdo aspekt të punës suaj. Profeti Jozef Smith na mësoi se Shpirti është themelor në mësimdhënie dhe predikim:

“Askush nuk mund të predikojë Ungjillin pa Frymën e Shenjtë” (*shih History of the Church*, 2:477).

“Disa u thirrën e u shuguruan nga Shpirti i zbulesës e i profecisë dhe filluan të predikojnë ashtu siç Shpirti i drejtoi të flisnin dhe megjithëse të dobët, ata u fuqizuan nga fuqia e Perëndisë” (*shih History of the Church*, 4:538).

“[Jozef Smithi] vazhdoi t'i udhëzonte Pleqtë në lidhje me predikimin e Ungjillit dhe u theksoi atyre domosdoshmërinë e pasjes së Shpirtit, që kështu ata të mund të predikonin me Frymën e Shenjtë dërguar nga qielli” (*shih History of the Church*, 4:13).

Gjatë seancave tuaja planifikuese javore e ditore, do t'ju duhet të bëni çdo ditë disa pyetje themelore—madje disa herë në ditë (shih kutinë Studim i Shkrimeve të Shenjta që ndodhet më poshtë për shembujt e pyetjeve). Kërkoni frymëzim për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve në mënyrën që i përshtatet çdo situatë. Më pas përgjigjet duhet të gjejnë zbatim në planet tuaja. Por ju gjithashtu duhet të jeni të gatshëm të ndiqni Shpirtin e të ndryshoni planet kur ju dalin mundësi të paparashikuara.

Studioni shkrimet e mëposhtme dhe mendoni si ato u përgjigjen këtyre pyetjeve të rëndësishme që ju duhet t'i bëni çdo ditë. Mendoni se ç'kuptim kanë këto fragmente për sa i përket përpjekjeve tuaja për të gjetur njerëz për të mësuar, sesioneve planifikuese dhe studimit individual dhe me shokun. Gjithashtu mbani parasysh kuptimin e tyre ndërsa jepni mësimet, ftoni njerëzit për të marrë zotime, ndiqni ecurinë e zotimeve, forconi anëtarët e rinj dhe anëtarët më pak aktivë dhe punoni me anëtarët.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Ku duhet të shkoj?

Helamani 10:17                      DeB 75:26–27  
DeB 31:11                              DeB 79:1–2

##### Çfarë duhet të bëj?

1 Nefi 4:6                              DeB 28:15  
2 Nefi 32:2–5                        DeB 52:3–4

##### Çfarë duhet të them?

2 Nefi 33:1	DeB 33:8–10	Mateu 10:19–20
Alma 5:43–46	DeB 50:13–22	Marku 13:11
Alma 11:22	DeB 68:1–4	1 Korintasve 2:4–5, 12–13
Helamani 5:18	DeB 75:3–11	Eksodi 4:10–12
Helamani 13:3–5	DeB 100:5–8	

**Si ta përshtas mësimdhënien me nevojat e kërkuesve të mi?**

Alma 12:7	3 Nefi 17:2–3	DeB 84:85
Alma 41:1	DeB 71:1	

**Cilat shkrime të shenjta duhet të përdor dhe si duhet t'i përdor ato?**

Mosia 18:19–20	DeB 32:4	DeB 71:1
Mosia 27:35	DeB 42:11–17	DeB 80:4
DeB 18:32–36	DeB 68:1–4	Lluka 24:13–32

**Një Fjalë Paralajmëruese**

Kur luteni për frymëzim, ju duhet gjithashtu t'i verifikoni ndjenjat tuaja. Për shembull, krahasojini vendimet tuaja me shkrimet e shenjta dhe mësimet e profetëve të gjallë. Sigurohuni që ndjenjat të përputhen me detyrën që keni; për shembull, ju nuk do të merrni zbulesë për t'i treguar një peshkopi se si duhet ta kryejë ai thirrjen e tij. Diskutojini vendimet dhe konkluzionet tuaja me shokun/shoqen tuaj, udhëheqësin e distriktit, ose presidentin e misionit kur është e arsyeshme.

Presidenti Hauard W. Hanter ofroi këtë këshillë: “Më lejoni t’ju them një fjalë paralajmëruese...Unë mendoj se nëse ne nuk jemi të kujdesshëm..., mund të fillojmë të përpiqemi ta falsifikojmë ndikimin e vërtetë të Shpirtit të Zotit me mënyra të padenja e manipuluese.

Unë shqetësohem kur duket se emocionet e forta apo lotët rrëke, barazohen me praninë e Shpirtit. Sigurisht Shpirti i Zotit mund të shkaktojë ndjenja të forta emocionale, përfshirë lotët, por kjo shfaqje e jashtme nuk duhet ngatërruar me praninë e vetë Shpirtit” (*The Teachings of Howard W. Hunter*, 184). Shpirti i Zotit gjithmonë lartëson.

Zbulesat dhe përvojat shpirtërore janë të shenjta. Ato duhen mbajtur për vete dhe duhen diskutuar vetëm në raste të përshtatshme. Si një misionar, ju mund të jeni më të vetëdijshëm ndaj përvojave shpirtërore nga ç’keni qenë më parë në jetën tuaj. Rezistojini tundimit për të folur lirshëm për këto përvoja.

Presidenti Boid K. Paker këshilloi: “Kam mësuar se përvojat e forta, mbresëlënëse shpirtërore nuk na ndodhin shumë shpesh. Dhe kur ndodhin, ato janë përgjithësisht për lartësimin, udhëzimin ose korrigjimin tonë. Në qoftë se nuk jemi thirrur nëpërmjet autoritetit të duhur, ato nuk na vendosin në pozitën për të këshilluar apo korrigjuar të tjerët.

Unë besoj gjithashtu, se nuk është një gjë e mençur të flasësh vazhdimisht për përvojat e pazakonta shpirtërore. Ato duhen ruajtur me kujdes e të ndahen me të tjerët vetëm nëse vetë Shpirti ju shtyn t'i përdorni ato për bekimin e të tjerëve” (*Ensign*, janar 1983, 53).

*“Nëse jemi të denjë, ne kemi të drejtën të marrim zbulesë për veten tonë, prindërit për fëmijët e tyre dhe anëtarët e Kishës në thirrjet e tyre.*

*Por e drejta e zbulesës për të tjerët nuk e tejkalon kujdestarinë tonë.”*

— PRESIDENTI XHEIMS E. FAUST  
“COMMUNION WITH THE HOLY SPIRIT,”  
*ENSIGN*, MARS 2002, 4

Shënime

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

Mbështetja tek Shpirti është kaq e rëndësishme sa që Zoti na paralajmëron me forcë të mos e mohojmë ose të mos e pengojmë Shpirtin. Çfarë mësoni nga fragmentet e mëposhtme të shkrimeve të shenjta?

Jakobi 6:8–9 (LiM)  
3 Nefi 29:5–6

Mormoni 9: 7–9  
Moroni 10:7–8

DeB 11:25–26  
1 Thesalonikasve 5:19–20

### Mbani Mend

- Lutuni me besimin se lutjet tuaja do të marrin përgjigje.
- Mësoni të kuptoni, dalloni dhe ndiqni nxitjet e Shpirtit.
- Mësoni të mbështeteni tek Shpirti për t'ju treguar se ku duhet të shkoni, çfarë të bëni dhe çfarë të thoni.
- U mësoni të tjerëve si ta dallojnë Shpirtin.

## Ide për Studim dhe Zbatim

Shënime

### Studim Individual

- Shkruani përvojat tuaja shpirtërore në ditarin tuaj. Për shembull, përgjigjiuni pyetjeve të tilla si: A i kam kuptuar më mirë disa gjëra pasi kam studiuar shkrimet e shenjta? A kam patur mundësi të pazakonta të takohem me njerëz me të cilët mund të ndaj një mesazh? A më janë dhënë në mendje fjalët në çastin kur kam patur nevojë për to? A kam patur ndjenja të forta dashurie për njerëzit që kam takuar? Si kanë marrë përgjigje lutjet e mia?
- Ndajeni faqen në dy kolona. Emërtojeni njëren kolonë “Çfarë bëri Zoti” dhe kolonën tjetër “Çfarë bëri Lehi apo Nefi.” Lexoni historinë e Liahonës dhe të harkut të thyer (1 Nefi 16:9–30) ose historinë e Nefit që ndërtoi një anije (1 Nefi 17:7–16; 18:1–6). Ndërsa lexoni, renditini ngjarjet e këtyre historive në kolonën përkatëse. Mendoni se çfarë mund t’ju mësojnë këto histori rreth natyrës së frymëzimit.
- Shfletoni ditarin tuaj dhe gjeni rastet kur jeni drejtuar nga Shpirti ose keni përjetuar zbulesën ose ndonjë dhuratë tjetër të Shpirtit. Mendoni se kur, ku dhe pse ndodhën këto përvoja. A bëtë ndonjë gjë të veçantë për t’u përgatitur për këto përvoja? Si u manifestua dora e Zotit në atë përvojë? Si u ndiet? Çfarë mund të bëni për të patur përvoja të ngjashme? Rikujtimi i këtyre përvojave mund t’ju ndihmojë të dalloni dhe të keni Shpirtin përsëri.
- Libri i Veprave të Apostujve në Bibël është quajtur “Libri i Veprave të Shpirtit të Shenjtë nëpërmjet Apostujve.” Lexoni titujt e kapitujve të librit të Veprave të Apostujve dhe shpjegoni pse ky titull mund të jetë i përshtatshëm. Gjenero fakte që të vërtetojnë shpjegimin tuaj.
- Studioni e meditonit këshillën e mëposhtme. Si lidhet ajo me aktivitetet tuaja predikuese ditore?

“U thuj vëllezërve të jenë të përlur dhe besnikë dhe të sigurohen që ta ruajnë Shpirtin e Zotit, i cili do t’i udhëheqë në mënyrë të pagabueshme. Jini të kujdesshëm dhe mos e largoni zërin e vogël dhe të qetë; ai do t’u mësojë atyre se çfarë të bëjnë dhe ku të shkojnë; ai do të japë frytet e mbretërisë. U thuj vëllezërve t’i mbajnë zemrat të hapura ndaj bindjes, kështu që kur Fryma e Shenjtë të vijë tek ata zemrat e tyre do të jenë gati ta pranojnë atë. Ata mund ta dallojnë Shpirtin e Zotit ndër të gjithë shpirtat e tjerë— ai do të pëshpërisë paqe dhe gëzim në shpirtat e tyre; do ta largojë ligësinë, urrejtjen, grindjen dhe gjithë ligësinë nga zemrat e tyre dhe e gjithë dëshira e tyre do të jetë për të bërë mirë” (cituar në *Juvenile Instructor*, 19 korrik 1873, 114).

Profeti Jozef Smith ia dha këtë këshillë Brigam Jangut në një ëndërr gati tre vjet pas vdekjes së Jozef Smithit. Sikur ju të ishit në vend të Brigam Jangut dhe të merrnit këtë këshillë çfarë do të bënit?

- Studioni Alma 33:1–12; 34:17–29, 38. Cilave pyetje iu përgjig Alma? (Rishikoni Alma 33:1–2.) Si iu përgjig Alma këtyre pyetjeve? Çfarë sigurie dha ai se Perëndia i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve?
- Zoti na ka premtuar se Shpirti do të na udhëheqë në shumë mënyra të rëndësishme. Ndërsa lexoni fragmentet e mëposhtme, identifikoni aspekte të punës suaj që kërkojnë udhëheqjen e Shpirtit. Çfarë kuptimi kanë urdhërimet dhe premtimet që përmbajnë shkrimet e mëposhtme për sa i përket studimit tuaj individual dhe studimit me shokun/shoqen? mbledhjeve të distriktit, konferencave të zonës, shërbesave të pagëzimit dhe mbledhjeve të tjera?

### Lutja

3 Nefi 19:24  
DeB 46:30

DeB 50:30  
Romakëve 8:26

## Shënime

**Drejtimi i mbledhjeve**

Moroni 6:9                      DeB 20:45                      DeB 46:2

**Të Shkruarit**

DeB 9:9                      DeB 47:4                      DeB 124:4  
DeB 24:6                      DeB 104:81                      Moisiu 6:6

- Lexoni fragmentet e mëposhtme të shkrimeve të shenjta (përfshirë përmbledhjen e këtyre seksioneve).

DeB 60:1–5                      DeB 61:1–4, 21–22                      DeB 62:4–8

Në këtë ngjarje, çfarë ishte shumë e rëndësishme për Zotin?

Çfarë nuk kishte rëndësi për Zotin?

Mendoni rreth thënies së Plaku Dallin H. Ouks:

“[Një person mund të ketë] dëshirë të madhe për t’u udhëhequr nga Shpirti i Zotit por... pa mend e tejkalon atë dëshirë deri në atë pikë sa kërkon të jetë i udhëhequr në të gjitha gjërat. Dëshira për t’u udhëhequr nga Zoti është një forcë, por ajo duhet të shoqërohet me të kuptuarit se Ati ynë Qiellor i lë shumë vendime për t’u zgjedhur nga vetë ne. Marrja e vendimeve personale është një nga burimet e rritjes që ne duhet të përjetojmë në vdekshmëri. Personat që përpiqen t’ia lënë Zotit të gjitha vendimet dhe luten për zbulësë për çdo zgjedhje, shpejt do ta gjejnë veten në rrethana ku ata do të luten për udhëheqje dhe nuk do ta marrin atë. Për shembull, kjo ka të ngjarë të ndodhë në ato rrethana të shumta në të cilat zgjedhjet janë të parëndësishme ose kur çdonjëra nga zgjedhjet është e pranueshme.

Ne duhet t’i studiojmë gjërat në mendjet tona, duke përdorur fuqinë e arsytimit që Krijuesi ynë ka vendosur brenda nesh. Pastaj duhet të lutemi për udhëheqje dhe të veprojmë sipas saj në qoftë se e marrim atë. Nëse nuk marrim udhëheqje, ne duhet të veprojmë si ta gjykojmë më mirë. Personat që këmbëngulin të marrin udhëheqje nëpërmjet zbulësës, mbi subjekte për të cilat Zoti nuk ka zgjedhur të na drejtojë, mundet të sajojnë një përgjigje nga fantazia ose paragjykimet e tyre, ose madje mund të marrin një përgjigje nëpërmjet mjetit të zbulësës së rreme” (“Our Strengths Can Become Our Downfall,” *Ensign*, tetor 1994, 13–14).

Cila është lidhja ndërmjet ndjekjes së gjykimit tuaj personal dhe mbështetjes tek Shpirti?

**Studim me Shokun**

- Flisni rreth lutjeve që ju bëni si shokë/shoqe. Janë ato të drejtuara nga Fryma e Shenjtë? A keni marrë përgjigje për lutjet tuaja? Kur luteni si shokë/shoqe a:
  - Besoni se Perëndia do t’u japë çfarë kërkonti në drejtësi?
  - Shprehni mirënjohjen për përgjigjet e lutjeve tuaja?
  - Luteni për njerëzit me emra dhe merrni parasysht nevojat e tyre?
  - Luteni për njëri-tjetrin dhe për Shpirtin që t’ju udhëheqë?
  - Merrni përgjigje për lutjet tuaja?

Diskutoni me shokun/shoqen si ta kërkonti më me zell Shpirtin.

- Diskutoni mënyrat e ndryshme si njerëzit e përshkruajnë ndikimin e Frymës së Shenjtë. Shkruani komentet që kërkuesit kanë bërë rreth përvojave të tyre me Shpirtin gjatë mësimit të ungjillit dhe përpjekjeve për të mbajtur zotimet. Si mund t’i ndihmoni të tjerët ta dallojnë këtë ndikim të shenjtë? Si mund ta shmangni të qenit manipulues kur bëni këtë?

- Mendoni dhe diskutoni se si këshilla e mëposhtme lidhet me ju: “Ju nuk mund t’i impononi gjërat shpirtërore. Fjalë të tilla si shtyj, shtrëngo, detyroj, bëj presion, urdhëroj, nuk përshkruajnë privilegjet tona me Shpirtin. Ju nuk mund ta detyroni Shpirtin t’ju përgjigjet, po ashtu si nuk mund ta detyroni një fasule të mbijë ose një vezë të çelë zogj para kohe. Ju mund të krijoni një klimë për të nxitur rritjen, të ushqyerit dhe mbrojtjen e tyre, por nuk mund të detyroni ose shtrëngoni: duhet të prisni rritjen” (Boid K. Paker, “The Candle of the Lord,” *Ensign*, janar 1983, 53).

- Diskutoni thëniet e mëposhtme dhe si këto parime mund të ndryshojnë si lutjet ashtu edhe punën tuaj. Si mund të ndikojnë lutjet në planifikimin, vënien e qëllimeve, punën dhe aktivitetet tuaja të përditshme?

“Veprimet tona, në një shkallë të gjerë, janë fryt i lutjeve tona. Pasi jemi lutur, ne veprojmë; lutjet e duhura kanë efektin e dhënies së një drejtimi të saktë për mënyrën se si duhet të veprojmë” (Bruce R. McConkie, “Why the Lord Ordained Prayer,” *Ensign*, janar 1976, 12).

“Lutja e sinqertë nënkupton se kur kërkojmë ndonjë bekim apo virtyt, ne duhet të punojmë për bekimin dhe të kultivojmë virtytin” (David O. McKay, *Secrets of a Happy Life*, 114–15).

“Kërkojini [Perëndisë] t’ju vendosë atje ku Ai dëshiron, dhe t’ju tregojë se çfarë Ai do që të bëni dhe ndihuni se jeni të zotë ta bëni atë” (Brigham Young, *Discourses of Brigham Young*, përzgj. John A. Widtsoe [1954], 46).

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Paraqitni një mësim mbi përdorimin e një gjuhe të përshtatshme dhe që tregon respekt kur lutemi.
- Si të jetë e përshtatshme, ftojini misionarët të tregojnë një histori ose përvojë që kanë dëgjuar gjatë një mbledhjeje dëshmish të kohëve të fundit, gjatë një përvoje mësimdhënieje, ose diku tjetër. Historitë dhe përvojat shpirtërore që tregojnë të tjerët, mund t’ju ndihmojnë të zhvilloni besimin dhe të kuptoni se ndikimi i Shpirtit shfaqet shpesh dhe gjerësisht.
- Shprehni mirënjohje për praninë e dorës së Zotit në punën tuaj (shih DeB 59:21). Diskutoni se si shprehja e mirënjohjes ju ndihmon të shihni mënyrat e vogla, por shumë të rëndësishme me anë të të cilave Zoti ju bekon (shih Ethëri 3:5).
- Kërkojuni misionarëve të japin biseda rreth misionit dhe fuqisë së Frymës së Shenjtë.
- Kërkojini një të porsakthyeri në besim të tregojë se si ai ose ajo u ndikuan nga Shpirti kur ishin ende kërkues.

### Presidenti i Misionit

- Herë pas here u kërkoni misionarëve të përfshijnë përvoja shpirtërore të përshtatshme në letrat javore që ju shkruajnë.
- Gjatë intervistave, pyetini misionarët herë pas here rreth lutjeve të tyre të mëngjesit dhe të mbrëmjes. Pyetini nëse e ndiejnë se lutjet e tyre janë kuptimplote.
- Pyetini misionarët se si i ndihmojnë ata kërkuesit të ndiejnë dhe të dallojnë praninë e Shpirtit.
- Kur ta shihni të arsyeshme, u tregoni misionarëve se si ju merrni zbuluesë në lidhje me transferimet, misionarët e pabindur ose ata që kanë nevojë për ndihmë dhe doktrinat që u mësoni atyre.







# Cili Është Roli i Librit të Mormonit?

Shënime

## Mbani Parasysh


- Si është Libri i Mormonit guri kyç i besimit tonë?
- Si i përgjigjet Libri i Mormonit pyetjeve të mëdha të shpirtit?
- Pse është kaq i fuqishëm Libri i Mormonit në procesin e kthimit në besim?
- Si duhet ta përdor unë Librin e Mormonit për të ndërtuar besim dhe për t'i ndihmuar të tjerët t'i afrohen Perëndisë?
- Pse premtimi në Moroni 10:3–5 është thelbësor në punën misionare?

**L**ibri i Mormonit është një dëshmi e fuqishme e hyjnisë së Krishtit. Ai është gjithashtu një provë e Rivendosjes me anë të Profetit Jozef Smith. Një pjesë e rëndësishme e kthimit në besim është marrja e një dëshmie nga Fryma e Shenjtë se Libri i Mormonit është i vërtetë. Si një misionar, në fillim ju duhet të keni vetë një dëshmi personale se Libri i Mormonit është i vërtetë. Kjo dëshmi mund t'ju udhëheqë drejt një besimi të thellë dhe të qëndrueshëm në fuqinë e Librit të Mormonit gjatë procesit të kthimit në besim. Kini besim se Fryma e Shenjtë do t'i dëshmojë të gjithë atyre që lexojnë dhe meditojnë rreth Librit të Mormonit dhe i kërkojnë Perëndisë nëse ai është e vërtetë, me një zemër të singërtë, me qëllim të vërtetë dhe besim te Krishti. Dëshmia e Frymës së Shenjtë duhet të jetë epiqendra e mësimdhënies tuaj.

## Libri i Mormonit Është Guri Kyç i Besimit Tonë

Profeti Jozef Smith mësoi se Libri i Mormonit është “guri kyç i besimit tonë” (Hyrja e Librit të Mormonit). Në një rast tjetër ai deklaroi: “Hiqni Librin e Mormonit dhe zbutet dhe ku është besimi ynë? Ne nuk kemi asgjë” (*History of the Church*, [Historia e Kishës], 2:52).

Një hark është një strukturë e fortë arkitektonike e përbërë nga copëra gurësh trapezoidalë që mbështeten te njëri-tjetri.



Guri i mesit, ose guri kyç, është zakonisht më i madh se gurët e tjerë trapezoidalë dhe i mban këta gurë të shtrënguar fort me njëri-tjetrin që të mos luajnë nga vendi. Kur Jozef Smithi e quajti Librin e Mormonit “guri kyç i besimit tonë,” ai mësoi se Libri i Mormonit e mban besimin tonë të bashkuar. Presidenti Ezra Taft Benson tha se Libri i Mormonit është guri kyç i besimit në të paktën tre drejtime:

**Dëshmi e Krishtit.** “Libri i Mormonit është guri kyç në dëshminë tonë për Jezu Krishtin dhe Ai vetë është guri kyç i çdo gjëje që ne bëjmë. Libri i Mormonit dëshmon për realitetin e Tij me fuqi dhe qartësi.”

**Plotësi e doktrinës.** “Zoti Vetë ka deklaruar se Libri i Mormonit përmban plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit (shih DeB 20:9)...Në Librin e Mormonit do të gjejmë plotësinë e atyre doktrinave që kërkohen për shpëtimin tonë. Dhe ato mësohen qartë dhe thjeshtë, kështu që madje dhe një fëmijë mund të mësojë udhën e shpëtimit dhe të ekzaltimit.”



**Themeli i dëshmisë.** “Ashtu si harku shembet në qoftë se i hiqet guri kyç, po kështu edhe e gjithë Kisha qëndron ose bie me vërtetësinë e Librit të Mormonit. Armiqtë e Kishës e kuptojnë qartë këtë. Ja përse ata bëjnë çmos për t’u përpjekur ta hedhin poshtë Librin e Mormonit, sepse në qoftë se ai mund të diskreditohet, Profeti Jozef Smith shkon bashkë me të. Po kështu edhe pretendimet tona ndaj çelësave të priftërisë, zbulesës dhe Kishës së rivendosur. Por në të njëjtën mënyrë, në qoftë se Libri i Mormonit është i vërtetë—dhe miliona njerëz kanë dëshmuar tashmë se kanë pasur me të vërtetë një dëshmi nga Shpirti se ai është i vërtetë—atëherë duhen pranuar pretendimet ndaj

Rivendosjes dhe gjithçkaje që lidhet me të” (*A Witness and a Warning* [1988], 18–19).

Libri i Mormonit, i ndërthurur me Shpirtin, është burimi juaj më i fuqishëm në procesin e kthimit në besim. Ai është libri më i saktë nga çdo libër tjetër në tokë (shih hyrjen e Librit të Mormonit). Ai na mëson doktrinën e Krishtit qartë, veçanërisht në mësimet që ju u mësoni kërkuesve. Përdoreni atë si burimin tuaj kryesor për t’u mësuar të tjerëve ungjillin e rivendosur. Më poshtë gjenden shembuj të të vërtetave të mësuara qartë në Librin e Mormonit që ju do t’ua mësoni kërkuesve.

Mësimet e Misionarëve	Doktrinat	Referencat e shkrimeve të shenjta
Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit	Braktisja, Rivendosja, Jozef Smith, autoritet priftërie	1 Nefi 12–14 2 Nefi 3; 26–29 Mosia 18
Plani i Shpëtimit	“Plani i madh i Perëndisë së Amshuar,” përfshirë Rënien e Adamit dhe Evës, Shlyerjen, Ringjalljen dhe Gjykimin	2 Nefi 2; 9 Mosia 3; 15 Alma 12; 40–42
Ungjilli i Jezu Krishtit	Besim në Krisht, pendim, pagëzim, dhurata e Frymës së Shenjtë dhe durimi deri në fund	2 Nefi 31–32 3 Nefi 11; 27
Urdhërimet; Ligjet dhe Ordinancat	Ordinancat si pagëzimi, konfirmimi, shugurimi në priftëri dhe sakramenti	3 Nefi 11:22–28; 18 Moroni 2–6

**Aktivitet: Studim Individual**

Shkruani përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme në ditarin tuaj të studimit:

- Si ka ndikuar studimi i Librit të Mormonit në dëshminë tuaj për Jezu Krishtin?
- Si mund ta përdorni ju Librin e Mormonit për të ndihmuar të forconi dëshminë e të tjerëve?

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Çfarë thotë Shpëtimtari rreth Librit të Mormonit?**

DeB 1:29	DeB 19:26–27	DeB 42:12
DeB 3:19–20	DeB 20:5–16	Moisiu 7:62
DeB 17:6	DeB 33:16	



Fotografia përdorur me leje nga C. Harrison Conroy Co., Inc. Ndahet fotografimi.

**Libri i Mormonit Dëshmon për Krishtin**

Qëllimi kryesor i Librit të Mormonit është t'i bindë të gjithë njerëzit se Jezusi është Krishti (shih faqen e titullit të Librit të Mormonit). Ai dëshmon për Krishtin duke vërtetuar realitetin e jetës, misionit dhe fuqisë së Tij. Ai mëson doktrinën e vërtetë në lidhje me Shlyerjen—themelin e planit të shpëtimit. Disa nga ata, shkrimet e të cilëve janë ruajtur në Librin e Mormonit, e panë Krishtin personalisht. Vëllai i Jaredit, Nefi dhe Jakobi panë Krishtin para se Ai të lindë në tokë. Mormoni dhe Moroni panë Krishtin e ringjallur. Përveç kësaj, turma të tëra qenë të pranishme gjatë shërbesës së shkurtër, por të fuqishme të Shpëtimtarit mes Nefitëve (shih 3 Nefi 11–28). Ata që dinë pak ose

asgjë rreth Shpëtimtarit do të arrijnë ta njohin Atë duke lexuar, medituar dhe duke u lutur rreth Librit të Mormonit.

Dëshmia e Librit të Mormonit vërteton dëshminë e Biblës se Jezusi është Biri i Vetëmlindur i Perëndisë dhe Shpëtimtari i botës. Ndërsa u mësoni të tjerëve plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit, ju do të dëshmoni shpesh rreth Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit të botës. Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju do të shtoni dëshminë tuaj të gjallë për vërtetësinë e këtij mesazhi.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Çfarë arsyesh dhanë profetët e Librit të Mormonit për shkruarjen e anave të tyre?**

1 Nefi 6:4–6	2 Nefi 33:13–15	Fjalët e Mormonit 1:3–8
1 Nefi 9:3–5	Jakobi 1:4–7 (LiM)	Alma 37:2, 14
2 Nefi 4:15–16	Jakobi 4:1–6, 12 (LiM)	3 Nefi 5:14–15
2 Nefi 25:23–29	Enosi 1:13	Mormoni 8:35
2 Nefi 26:15–16	Jaromi 1:2	DeB 3:16–20
2 Nefi 29:11–14	Omni 1:25–26	DeB 10:46–48

## Libri i Mormonit dhe Bibla Mbështesin Njëri-Tjetrin

Besimet e njerëzve rreth Biblës ndryshojnë shumë. Disa besojnë se Bibla është krejt e përkryer, pa gabime dhe se ajo është gjithçka që na duhet për t'u shpëtuar. Të tjerët mendojnë se Bibla është literaturë që ja vlen të studiohet, por ata mendojnë se ajo është dëshmi e hyjnisë dhe mrekullive të Krishtit ose zbulesë e drejtëpërdrejtë nga Perëndia. Disa zgjedhin ta shpërfillin Biblën dhe të tjerë nuk e kanë parë kurrë Biblën ose nuk kanë pasur mundësi ta lexojnë atë.

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme besojnë “Biblën të jetë fjala e Perëndisë, për aq sa ajo përkthehet me saktësi” (Nenet e Besimit 1:8). Jo vetëm që Libri i Mormonit nuk konkurren Biblën, por ai e mbështet atë, na nxit ta lexojmë dhe dëshmon vërtetësinë e mesazhit të saj. Ju duhet ta përdorni Librin e Mormonit dhe Biblën për të mbështetur njëri-tjetrin.

Libri i Mormonit flet për besëlidhjet e lashta që Perëndia bëri me fëmijët e Tij; Bibla tregon për profetë të mëdhenj që gjithashtu i morën këto besëlidhje më anë të besimit. Libri i Mormonit dëshmon për Jezu Krishtin dhe Shlyerjen e Tij; Bibla jep historinë e lindjes, shërbesës, vdekjes, Shlyerjes dhe Ringjalljes së Tij. Kështu, Bibla dhe Libri i Mormonit plotësojnë dhe pasurojnë njëri-tjetrin.

Botimi SHDM në anglisht i Biblës sipas variantit të Mbretit Xheims dhe Libri i Mormonit kanë referenca kryq dhe ndihma studimore që e bëjnë drurin e Judës (Bibla) dhe drurin e Jozefit (Libri i Mormonit) një të vetëm në duart tona (shih Ezekieli 37:15–17; shih gjithashtu 1 Nefi 13:34–41; 2 Nefi 3:12; 29:8). Jepini përparësi pjesëve nga Libri i Mormonit gjatë mësimit, por gjithashtu tregoni se si Libri i Mormonit dhe Bibla mësojnë të njëjtat parime.

Përdoreni Librin e Mormonit për të sqaruar dhe shpjeguar pjesë nga Bibla. Për shembull, Dhjata e Re deklaroi se Krishti u pagëzua për të “[përmbushur] çdo drejtësi” (Mateu 3:14–15). Libri i Mormonit shpjegon se ç’do të thotë të përmbushësh çdo drejtësi (shih 2 Nefi 31:5–9).

Ndërsa e përdorni Librin e Mormonit dhe Biblën si vëllime shoqëruese shkrimesh të shenjta, ata do të mposhtin grindjet dhe do të korrigojnë doktrinat e reme (shih 2 Nefi 3:12).

Bibla na mëson rreth ligjit të dëshmitarëve se: “Çdo gjë do të qëndrojë me gojën e dy a tre dëshmitarëve” (2 Korintasve 13:1). Në përputhje me këtë ligj, Libri i Mormonit dhe Bibla dëshmojnë për Jezu Krishtin.

### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Gjeni referenca kryq rreth temave të mëposhtme në Librin e Mormonit dhe në Bibël. Shembujt janë dhënë në kllapa mbas çdo teme. Shtoni pjesë dhe tema të tjera nga vetja.

- Profetët (Amosi 3:7 dhe Jakobi 4:4–6 LiM)
- Braktisja (2 Timoteu 4:3–4 dhe 2 Nefi 28)
- Rivendosja (Veprat e Apostujve 3:19–21 dhe 1 Nefi 13:34–42)
- Fëmijë të Perëndisë (Veprat e Apostujve 17:29 dhe 1 Nefi 17:36)

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë thotë Bibla rreth Librit të Mormonit?

Gjoni 10:16  
Isaia 29:4, 11–18

Ezekieli 37:15–17

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Efraim,” nëntitull: “Druri i Efraimit  
ose i Jozefit”

**Çfarë thotë Libri i Mormonit rreth Biblës?**

1 Nefi 13:20–29, 40–41  
2 Nefi 29:3–14

3 Nefi 23:1

Mormoni 7:8–9

**Në ç'mënyrë këta dy libra shërbejnë si dëshmi të Krishtit?**

2 Nefi 29:8

Gjoni 20:31

Veprat e Apostujve 10:43

**Libri i Mormonit u Përgjigjet Pyetjeve të Shpirtit Njerëzor**

Presidenti Ezra Taft Benson tha se misionarët “duhet të tregojnë se si [Libri i Mormonit] u përgjigjet pyetjeve të mëdha të shpirtit” (“Flooding the Earth with the Book of Mormon,” *Ensign*, nëntor 1988, 5).

“Pyetjet e mëdha të shpirtit” mund të përfshijnë pyetje të tilla si: A ka me të vërtetë një Perëndi? A kam ekzistuar para se të lindesha? A do të jetoj pas vdekjes? Cili është qëllimi i jetës? A është Jezusi me të vërtetë Shpëtimtari?

Pyetje të tjera mund të përqendrohen mbi nevojat më tokësore: Si mund ta përmirësoj marrëdhënien time me bashkëshortin/bashkëshorten? Si mund t’i ndihmoj fëmijët e mi adoleshentë t’i shmangen drogës apo imoralitetit? Si mund të gjej punë që të mbështes familjen time?

Ungjilli i Jezu Krishtit na ndihmon t’u përgjigjem pyetjeve të të dyja llojeve. Ndërsa fitojmë besimin se Libri i Mormonit është i vërtetë, ne mund të fillojmë t’u përgjigjem pyetjeve rreth qëllimit të jetës dhe shpresës së jetës së përjetshme. Libri i Mormonit përshkruan planin e lumturisë, i cili i jep kuptim dhe një këndvështrim të ri jetës. Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme na mësohen qartë në Librin e Mormonit.



- A ka një Perëndi? (Alma 22)
- Çfarë pret Jezu Krishti nga unë? (2 Nefi 9)
- Si mund të më ndihmojë besimi në Jezu Krisht? (Alma 36)
- A ka jetë pas vdekjes? (Alma 40)
- Cili është qëllimi i jetës? (Alma 34)
- Pse lejon Perëndia që të ndodhin gjëra të liga dhe vuajtje? (2 Nefi 2; Alma 14:9–11; 60:13)
- A ka nevojë të pagëzohet fëmija im i porsalindur? (Moroni 8)
- A më njeh Perëndia mua? (Alma 5:38, 58)
- A i përgjigjet Perëndia lutjeve? (Enosi 1)
- Si mund të gjej paqe dhe gëzim? (Mosia 2, 4)
- Si mund të jetë familja ime më e lumtur dhe më e bashkuar? (Mosia 2)
- Si mund të ruaj ekuilibrin midis familjes time dhe karrierës? (3 Nefi 13)
- Si mund ta forcoj marrëdhënien me bashkëshortin/bashkëshorten tim/e? (3 Nefi 14)
- Si mund t’i shmang të ligat që kërcënojnë familjen time? (Alma 39)
- Si mund ta shmang mëkatit? (Helamani 5)

Kur e lexojmë Librin e Mormonit të udhëhequr nga Shpirti, ai do të na ndihmojë t'i përgjigjemi pyetjeve personale. Ai na mëson se lutja dhe zbulesa janë çelësi për të zgjidhur probleme të veçanta. Ai na ndihmon të kemi besim se Perëndia do t'i përgjigjet lutjeve tona.

Libri i Mormonit gjithashtu na ndihmon të kuptojmë se urdhërimet e Perëndisë nuk janë një listë kufizuese e gjërave që duhet të bëjmë dhe e atyre që nuk duhet të bëjmë, por një rrugë udhëzuese që të çon drejt një jete të lumtur e të begatë. Ndërsa fillojmë të kuptojmë se parimet dhe ordinancat e para të ungjillit janë rruga drejt jetës së begatë, ne do ta vlerësojmë faktin që këto parime ndihmojnë në përgjigjen e çdo pyetjeje dhe në plotësimin e çdo nevoje. Për shembull, ne kuptojmë se pendimi, falja dhe besëlidhja për t'u shërbyer të tjerëve janë thelbësore në përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore. Ne e kuptojmë se besimi në Krisht, pranimi dhe mbajtja e besëlidhjeve dhe ndjekja e nxitjeve të Shpirtit mund t'i ndihmojë adoleshentët të shmangin tundimet e fuqishme që i rrethojnë.

Ungjilli mund të zgjidhë pothuajse çdo pyetje ose nevojë. Për këtë arsye ju duhet të mësoni parimet e ungjillit që janë në Bibël dhe në Librin e Mormonit, në të cilin është plotësia e ungjillit (shih DeB 42:12).

*“Në një botë gjithnjë e më të rrezikshme...Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit ka fuqinë ushqyese për të shëruar shpirtat e uritur të botës.”*

—PRESIDENTI BOID K. PAKER  
“LIBRI I MORMONIT: NJË DËSHMI TJETËR E JEZU KRISHTIT,” *ENSIIGN*, NËNTOR 2001, 64

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Bëni një listë të disa “pyetjeve të mëdha të shpirtit” që ju kanë bërë kërkuesit. Gjeni vargje në Librin e Mormonit për t’ju përgjigjur këtyre pyetjeve. Shkruani përgjigjet në ditarin tuaj të studimit dhe përdorini ato ndërsa jepni mësim.

## Libri i Mormonit i Afron Njerëzit më Pranë Perëndisë

Lidhur me Librin e Mormonit, Profeti Jozef Smith tha se: “një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër” (hyrje e Librit të Mormonit). Libri i Mormonit është një trampolinë drejt dëshmisë dhe zbulësës personale. Përdoreni Librin e Mormonit për t’i ndihmuar njerëzit të kenë përvoja shpirtërore, veçanërisht një dëshmi nga Fryma e Shenjtë se vetë libri është i vërtetë. Duke i ftuar vazhdimisht njerëzit të jetojnë parimet që gjenden në Librin e Mormonit, ju i ndihmoni ata të zhvillojnë besim në Jezu Krisht dhe të afrohen më pranë Perëndisë.

Presidenti Gordon B. Hinkli deklaroi: “Ata që kanë lexuar [Librin e Mormonit] plot lutje, qofshin ata të pasur apo të varfër, të arsimuar ose jo, janë rritur nën fuqinë e tij...Pa asnjë rezervë unë ju premtoj se në qoftë se ju do ta lexoni plot lutje Librin e Mormonit, pavarësisht se sa herë e keni lexuar atë më parë, në zemrat tuaja do të vijë...Shpirti i Perëndisë. Do të vijë një vendim i përforcuar për t’ju bindur urdhërimeve të tij dhe një dëshmi më e fortë për realitetin e gjallë të Birit të Perëndisë” (“The Power of the Book of Mormon,” *Ensign*, qershor 1988, 6).

## Përdoreni Librin e Mormonit për t’iu Përgjigjur Kundërshtimeve

Shumë njerëz nuk do të besojnë gjithçka që ju u mësoni. Presidenti Ezra Taft Benson na mësoi se si Libri i Mormonit mund të jetë burimi kryesor në përgjigjen ndaj situatave të tilla:

“Ne duhet ta përdorim Librin e Mormonit për t’u bërë ballë kundërshtimeve ndaj Kishës...

... Të gjitha kundërshtitë, qoftë ato mbi abortin, poligaminë, adhurimin në ditën e shtatë etj., kryesisht varen nga ajo nëse Jozef Smithi dhe pasuesit e tij ishin dhe janë profetë të Perëndisë që marrin zbulesë hyjnore...

...I vetmi problem që kundërshtuesi duhet të zgjidhë për veten e tij është nëse Libri i Mormonit është i vërtetë. Sepse në qoftë se Libri i Mormonit është i vërtetë, atëherë Jezusi është Krishti, Jozef Smithi ishte profeti i tij, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e vërtetë dhe sot udhëhiqet nga një profet që merr zbulesë.

Detyra jonë kryesore është të shpallim ungjillin dhe ta bëjmë këtë në mënyrë efektive. Ne nuk jemi të detyruar t’i përgjigjemi çdo kundërshtimi. Herët a vonë çdo njeri gjendet i shtyrë pas murit të besimit dhe pikërisht aty ai duhet të marrë qëndrimin e tij” (*A Witness and a Warning*, 4–5).

Për shembull, kërkuesit e singhtë mund të kundërshtojnë për ato që ju u keni mësuar rreth Fjalës së Urtësisë. I ndihmoni ata të kuptojnë se pyetja e tyre e vërtetë është nëse Jozef Smithi foli si një profet i Perëndisë kur ky urdhërim u ripërtëri në këtë periudhë ungjillore. Ju mund të thoni: “Besimi për ta pranuar këtë mësim do të kërkojë sigurinë se ky urdhërim na erdhi me anë të zbulesës nga Perëndia dhënë profetit Jozef Smith. Mënyra për të ditur se Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë është të lexoni dhe të luteni rreth Librit të Mormonit.”

Kërkuesit duhet t’i zgjidhin vetë shqetësimet dhe kundërshtimet e tyre. Ju mund t’i ndihmoni duke e drejtuar vëmendjen e tyre në ato gjëra që do t’ua forcojnë besimin në Jezu Krisht— leximi dhe lutja rreth Librit të Mormonit. Kur ata forcojnë dëshminë e tyre për Rivendosjen, ata do të kenë forcën për të kapërcyer kundërshtimet dhe shqetësimet e tyre.

Ndërsa u përgjigjeni shqetësimeve të kërkuesve, mbani mend se të kuptuarit tonë vjen nga profetët modernë —Jozef Smithi dhe pasuesit e tij—që marrin zbulesë të drejtëpërdrejtë nga Perëndia. Kështu që, pyetja e parë që duhet t’i përgjigjet një kërkues është nëse Jozef Smithi ishte një profet dhe ai ose ajo mund t’i përgjigjet kësaj pyetjeje duke lexuar dhe duke u lutur rreth Librit të Mormonit.



My Servant Joseph © 2004 LIZ Lamon Swindle. Kjo foto është riprodhuar me lejen e Foundation Arts, American Fork, Utah 84003.

### Jozef Smithi dhe Libri i Mormonit

Një mënyrë për të ditur se Jozef Smithi është një profet i Perëndisë është të lexoni dhe të luteni rreth Librit të Mormonit.

### Aktivitet: Studim Individual

Në ditarin tuaj të studimit shkruani si do t’i referoheshit Jozef Smithit dhe Librit të Mormonit për t’iu përgjigjur kundërshtimeve ose shqetësimeve të mëposhtme:

- “Unë nuk besoj se Perëndia u flet më njerëzve.”
- “Unë besoj se mund ta adhuroj Perëndinë sipas mënyrës sime dhe jo me anë të një besimi fetar të organizuar.”

- “Pse duhet të mos pi më verë për të shoqëruar ushqimin në qoftë se bashkohem me kishën tuaj?”
- “Pse më duhet feja?”

## Si Duhet ta Përdorni Librin e Mormonit?

Shumë kërkuës ose nuk e lexojnë Librin e Mormonit ose nuk kuptojnë çfarë lexojnë. Ata që nuk e lexojnë ose nuk e kuptojnë Librin e Mormonit do ta kenë të vështirë të marrin një dëshmi se ai është i vërtetë.

### Lexoni Librin e Mormonit me Kërkuësit Tuaj

Kur lexoni së bashku, lutuni që Fryma e Shenjtë t’u dëshmojë kërkuësve se Libri i Mormonit është i vërtetë.



Ju mund t’i ndihmoni kërkuësit duke lexuar Librin e Mormonit me ta. Lutuni për ndihmë ndërsa zgjidhni pjesë që lidhen me shqetësimet dhe problemet e tyre. Ju mund të lexoni me ta si pjesë e takimit të mësimi ose gjatë një vizite ecurie. Ju gjithashtu mund të krijoni mundësi që anëtarët të lexojnë me kërkuësit.

Disa fragmente veçanërisht të rëndësishme përfshijnë faqen e titullit, hyrjen (veçanërisht dy paragrafët e fundit) dhe Moroni 10:3–5.

Këto fragmente i ndihmojnë kërkuësit të kuptojnë si të marrin një dëshmi për Librin e Mormonit. I nxisni ata ta lexojnë Librin e Mormonit që nga fillimi, duke përfshirë dëshminë e tre dhe tetë dëshmitarëve dhe dëshminë e Profetit Jozef Smith.

Lexoni dhe diskutoni fragmente të shkurtra (të tilla si 1 Nefi 3:7 ose Mosia 2:17) dhe fragmente më të gjata ose kapituj të plotë (të tilla si 2 Nefi 31, Alma 7, ose 3 Nefi 18).

Kur lexoni me kërkuësit, ndaloni herë pas here dhe diskutoni rreth atyre që lexoni. Kur lexoni me ta vini në pah mesazhe kryesore ose doktrina të rëndësishme. Ndani frymëzime të përshtatshme, ndjenja, dëshmi dhe përvoja personale. I ndihmoni të tjerët të ndiejnë fuqinë shpirtërore të Librit të Mormonit. Në këtë mënyrë ju mund t’u mësoni atyre doktrinën e vërtetë drejtpërsëdrejti nga Libri i Mormonit. Vazhdojeni këtë praktikë në vizitat e ardhshme kështu që njerëzit të cilët ju mësoni të mund të zhvillojnë aftësinë për të lexuar dhe për t’u lutur vetë.

*“Ju lutem mos e nënvlerësoni Librin e Mormonit. Lutuni për një vizion se si Libri i Mormonit mund të përdoret më me efektivitet në misionin tuaj. Unë ju premtoj se nëse e bëni këtë, mendja juaj do të ndriçohet me drejtimin që ju duhet të merrni.”*

– PLAKU JOZEF B. UËRTHLIN  
SEMINAR PËR PRESIDENTËT E RINJ TË MISIONIT, 23 QERSHOR 1999



Mësojuni atyre parime dhe doktrina duke përdorur fjalët dhe frazat e profetëve të Librit të Mormonit. U shpjegoni sfondin historik dhe kontekstin e fragmentit që lexoni. U shpjegoni fjalët dhe frazat e panjohura.

“Përshtatjani” vetes dhe kërkuesve tuaj ato që keni lexuar duke gjetur mënyra zbatimi që lidhen me ju dhe me kërkuesit tuaj (shih 1 Nefi 19:23). Të “përshtatësh” do të thotë të krijosh një urë mendore midis të kuptuarit të doktrinës dhe të jetuarit të doktrinës. Që të lexoni sinqerisht, me qëllim të vërtetë, ju dhe ata që mësoni duhet të jeni të gatshëm të veproni sipas doktrinës, ta përfshini atë në jetën tuaj të përditshme dhe, kur është e nevojshme, të pendoheni. Duke e jetuar doktrinën, ju do të fitoni një bindje se ajo është e vërtetë. Për shembull, ju mund t’i thoni një kërkuesi:

- “Nefi, ashtu si edhe ju, u përball me një sfidë të vështirë. Por kur ai ushtroi besim për të ‘shkuar dhe bërë’ çfarë Zoti e urdhëroi, ai mundi t’ia dilte në krye. (Lexo 1 Nefi 3:7.) Unë e di se Perëndia do të përgatisë një udhë për ju që të jetoni Fjalën e Urtësisë.”
- “Gjon, është mirë që ju doni të çliroheni nga faji që ndieni. Ashtu si Shpëtimtari u premtoi Nefitëve, nëse ju pendoheni, pagëzoheni dhe merrni Frymën e Shenjtë, ju do të jeni ‘të pafajshëm para Atit’.” (Lexo 3 Nefi 27:16.)

Mbështetuni tek premtimi në Moroni 10:3–5. Çdo njeri që lexon dhe lutet sinqerisht rreth këtij libri mund të dijë me siguri për vërtetësinë e tij nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë. Bëni gjithçka mundni për t’i ndihmuar kërkuesit:

- Të lexojnë Librin e Mormonit dhe të meditojnë mesazhin e tij në lidhje me Jezu Krishtin.
- T’i luten Perëndisë me besim në Jezu Krisht për të marrë një dëshmi se Libri i Mormonit është i vërtetë dhe se Jozef Smithi është profeti i Rivendosjes.
- Të luten sinqerisht dhe të kenë një qëllim të vërtetë, që do të thotë se ata kanë për qëllim të veprojnë sipas përgjigjes që marrin nga Perëndia.

Ju gjithashtu duhet ta zbatoni këtë premtim rregullisht për të forcuar dhe për të përtërirë dëshminë tuaj për Librin e Mormonit. Kjo dëshmi e ripërtërirë do t’ju ndihmojë të ruani një besim të patundur se kushdo që e vë në zbatim këtë premtim do të marrë përgjigje.

#### Përdoreni Librin e Mormonit në Çdo Aspekt të Punës Suaj

Libri i Mormonit është një burim i fuqishëm në kthimin në besim. Përdoreni atë si burimin tuaj kryesor për të dhënë mësim për të vërtetën e rivendosur.

#### Mbani Mend:

- Libri i Mormonit është guri kyç i dëshmisë sonë për Krishtin, doktrinës sonë dhe dëshmive tona.
- Libri i Mormonit mëson qartë doktrinën që gjendet në mësimet e misionarëve.
- Përdoreni Librin e Mormonit për t’iu përgjigjur pyetjeve të shpirtit dhe për t’iu përgjigjur kundërshtimeve ndaj Kishës.
- Lexoni vazhdimisht nga Libri i Mormonit me kërkuesit tuaj dhe të porsakthyerit në besim. Bëni gjithçka mundni për t’i ndihmuar ata të lexojnë vetë çdo ditë dhe të zbatojnë në jetën e tyre atë që kanë mësuar.
- Besoni premtimin e Zotit se çdo njeri që lexon dhe lutet sinqerisht rreth Librit të Mormonit do të dijë për vërtetësinë e tij nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Lexoni 2 Nefi 2, 9, 30, 31, 32 dhe nënvizoni sa herë përmendet Jezu Krishti. Bëni një listë të emrave dhe titujve të ndryshëm për Krishtin që përdoren në këta kapituj. Nënvizoni fjalët që ka thënë Krishti. Nënvizoni cilësitë edhe veprat e Tij. Ju mund të doni ta vazhdoni këtë praktikë ndërsa lexoni të gjithë Librin e Mormonit.
- Shënoni në ditarin tuaj të studimit se si u ndiet kur për herë të parë morët një dëshmi shpirtërore se Libri i Mormonit është i vërtetë.
- DeB 20:17 përdor frazën “nëpërmjet këtyre gjërave ne dimë” për të prezantuar doktrinat e mësuara dhe të sqaruara me anë të Librit të Mormonit. Lexoni DeB 20:15–35 dhe bëni një listë të doktrinave të përmendura. Zgjidhni një nga këto doktrina dhe përdorni Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta për të krahasuar listën tuaj me çka mëson Bibla rreth këtyre doktrinave.
- Krahasoni Predikimin në Mal në Mateu 5–7 dhe predikimin e Krishtit në tempull tek 3 Nefi 12–14. Bëni një listë të të vërtetave të qarta dhe të çmueshme të rivendosura me anë të Librit të Mormonit.
- Bëni një listë të pyetjeve që ju kanë bërë kërkuesit. Gjeni fragmente nga Libri i Mormonit që u përgjigjen këtyre pyetjeve dhe përdorini ato kur ju nevojiten në mësimdhënien tuaj të përditshme.
- Gjeni një shkrim të shenjtë nga Libri i Mormonit që ka ndryshuar jetën tuaj. Shkruani ndjenjat tuaja rreth këtij shkrimi të shenjtë në ditarin tuaj të studimit.
- Gjeni çdo shembull në Librin e Mormonit ku janë shënuar fjalët e lutjes se dikujt. Në ditarin tuaj të studimit shkruani elementet e përbashkët të këtyre lutjeve.
- Lexoni 2 Nefi 33:10–15 dhe Moroni 10:27–29, 34. Çfarë do t'i tregoni Nefit dhe Moronit para vendit të gjyqimit për mënyrën se si e keni përdorur Librin e Mormonit? Shkruani përgjigjen tuaj dhe vendosni qëllime për t'u përmirësuar.
- Nga krerët e kapitujve të Mosias 11–16 shkruani një përmbledhje të asaj që na mësoi Abinadi. Lexoni këta kapituj dhe shtjelloni përmbledhjen tuaj.
- Nga krerët e kapitujve të Mosias 2–5, shkruani një përmbledhje të asaj që i mësoi popullit të tij mbreti Beniamin. Lexoni këta kapituj dhe shtjelloni përmbledhjen tuaj.
- Ndërsa lexoni çdo ditë nga Libri i Mormonit, shkruani në ditarin tuaj të studimit fragmentet që ju bëjnë përshtypje. Shkruani se si do t'i zbatoni ato në jetën tuaj.

### Studim me Shokun

- Lexoni së bashku fragmente nga Libri i Mormonit. Ndani çka keni mësuar dhe keni ndier. Gjithashtu ndani dëshmitë me njëri-tjetrin.
- Cilit profet apo misionar të Librit të Mormonit do të donit t'i ngjanit dhe pse? Ndani përgjigjen tuaj me shokun/shoqen tuaj.
- Lexoni Alma 26 dhe 29 bashkë me shokun/shoqen. Ndani si ndiheni rreth misionit tuaj. Shkruani ndjenjat tuaja në ditarin e studimit.
- Lexoni Alma 37:9 dhe diskutoni sa vendimtare ishin shkrimet e shenjta për Amonin dhe shokët e tij misionarë. Gjeni referenca që përshkruajnë se si ata i përdorën shkrimet e shenjta.

- Lexoni Alma 11–14 me shokun/shoqen tuaj, njëri të bëjë rolin e Almës ose të Amulekut dhe tjetri atë të kundërshtarëve. Vini re se si këta misionarë iu përgjigjën pyetjeve të vështira.
- Lexoni tregimin e vërtetë që vijon më poshtë dhe diskutoni çfarë mësoni në lidhje me rëndësinë dhe fuqinë e Librit të Mormonit (emrat janë ndryshuar).

“Kur e ftuam çiftin Shanider të pagëzoheshin dhe të konfirmoheshin, motra Shanider ishte gati, por vëllai Shanider tha: ‘Mos shpresoni më kot, Eldëra. Unë nuk e di nëse do mund ta bëj ndonjëherë këtë!’ Megjithëse vëllai Shanider pranoi gjithçka që i mësuam dhe gjithmonë ishte i sjellshëm dhe miqësor, ai ishte shumë i shqetësuar se si familja e tij do të reagoonte ndaj bashkimit të tij me një kishë tjetër.

Pasi e vumë re se vëllain Shanider për disa javë e mundonte ky problem, shoku im dhe unë ndjemë se duhet të lexonim përsëri 3 Nefi 11 me çiftin Shanider. Kurrë nuk do ta harroj çfarë ndodhi atë natë. Kur hapëm Librin e Mormonit, shoku im shpjegoi: ‘Ky kapitull, siç mund t’ju kujtohet, tregon vizitën e Shpëtimtarit mes njerëzve të Librit të Mormonit. Këtu lexojmë rreth dashurisë së Shpëtimtarit për këta njerëz dhe çfarë Ai u mësoi atyre.’ Ne secili lexuam me radhë një ose dy vargje. Pasi lexoi vargun 5, shoku im e ndërpreu leximin dhe tha: ‘Mua gjithmonë më bën përshtypje përshkrimi i zërit që ata dëgjuan. Zëri nuk ishte i ashpër, ai nuk ishte i lartë dhe megjithëse ishte një zë i vogël, ai kishte një efekt përshkues mbi ta. Ky zë nuk u dëgjua vetëm me veshët e tyre, por u foli zemrave të tyre.’ Unë vështroja çiftin Shanider ndërsa ata dëgjonin me vëmendje shokun tim.

Pas disa diskutimesh rreth lutjes dhe dëgjimit të Shpirtit, ishte radha e vëllait Shanider të lexonte: ‘Dhe vini re, të tretën herë ata e kuptuan zërin që dëgjuan; dhe ai u tha atyre: Vini re Birin tim të dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur, në të cilin unë kam lartësuar emrin tim—dëgjojeni atë.’ Vëllai Shanider ndaloi, duke vështruar me ngulm Librin e Mormonit. Pastaj ai u drejtua nga unë dhe tha: ‘Ati Qiellor ishte vërtetë krenar për Birin e Tij, apo jo?’ ‘Po,’ thashë unë. Vëllai Shanider iu kthye sërish librit të tij dhe vështrroi ngultas faqet e hapura të librit si të ishte i zhytur në mendime të thella. Më në fund ai tha: ‘Unë do të doja që Ati Qiellor të jetë gjithashtu, krenar për mua. Dua të di se si Ai do të më kish prezantuar mua. Mendoj se, nëse unë... epo, nëse unë dua që Ai të jetë krenar për mua atëherë do të ishte më mirë të bëja atë që Ai do që të bëj.’ ‘Po,’ mendoj se do të ishte e rëndësishme,’ iu përgjigja. ‘Epo...,’ vazhdoi vëllai Shanider. ‘Mendoj se jam shqetësuar shumë rreth atyre që mendojnë të tjerët dhe jo aq shumë rreth asaj çfarë mendon Perëndia.’ Pas një pauze të shkurtër vëllai Shanider tundi kokën dhe me një vështrim të vendosur tha: ‘Mendoj se do të bëja mirë të pagëzohesha.’ Përgjigja e tij ishte kaq e papritur sa që shoku im dhe unë e vështruam të habitur. Më në fund, shoku im tha: ‘Po, kjo është gjëja më e drejtë që do të bëni. Në fakt, më pas në këtë kapitull, Shpëtimtari mëson...’ Ndërsa shoku im fliste, unë ndieja një zjarr në zemrën time dhe mirënjohje për fuqinë e Librit të Mormonit.”

Si e përdorën këta misionarë Librin e Mormonit? Si do ta përdorni ju dhe shoku/shoqja juaj atë më me efektivitet në përpjekjet tuaja misionare?

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Praktikoni përdorimin e Librit të Mormonit në secilën nga mënyrat e përmendura në krerët kryesorë të këtij kapitulli.
- Rendisni kundërshtimet ose pyetjet e ngritura nga kërkuesit. Shpjegojini njëri-tjetrit si do t’u përgjigjeshit këtyre pyetjeve duke përdorur Librin e Mormonit.
- Lexoni së bashku fragmente nga Libri i Mormonit. Ndani njohuri, ndjenja dhe dëshmi.

## Shënime

- Praktikoni përdorimin e Librit të Mormonit për të konfirmuar mesazhin e Rivendosjes.
- Zgjidhni një nga misionarët e mëdhenj të Librit të Mormonit. Diskutoni dhe u kërkoni misionarëve të rendisin karakteristikat e këtij misionari. Ftoni çdo misionar të vendosë një qëllim për të zbatuar një nga këto karakteristika. Përsëriteni këtë aktivitet rregullisht duke përdorur misionarët e Librit të Mormonit.
- I ftoni misionarët të ndajnë përvojat në të cilat Libri i Mormonit i ka ndihmuar kërkuesit e tyre në procesin e kthimit në besim.
- U kërkoni misionarëve të ndajnë përgjigjen më të mirë që i kanë dhënë një pyetjeje të shpirtit duke u bazuar në Librin e Mormonit.

**Presidenti i Misionit**

- U mësoni misionarëve si ta përdorin Librin e Mormonit për të konfirmuar vërtetësinë e mesazhit të Rivendosjes.
- Lexoni 1 Nefi 1 me misionarët dhe krahasojeni atë me përvojën e Jozef Smithit.
- U jepni misionarëve një kopje të re të Librit të Mormonit nga ato me kapak të thjeshtë. U kërkoni atyre të nënvizojnë me ngjyra të ndryshme:
  - Çdo referencë për Jezu Krishtin (të gjithë emrat e Tij ose përemrat që i referohen Atij).
  - Fjalët e Tij (të thëna nga Ai ose nga profetët kur ata thonë: “Kështu thotë Zoti”).
  - Cilësitë e Tij.
  - Doktrinat dhe parimet që përmban Libri i Mormonit.

Në fund të çdo faqeje u kërkoni misionarëve të numërojnë numrin e përgjithshëm të elementëve të referuar. Gjatë intervistave dhe mbledhjeve të distriktit gjatë periudhës dy-tre mujore për kryerjen e këtij aktiviteti, u kërkoni misionarëve të ndajnë me njëri-tjetrin se çfarë kanë mësuar. Ju mund të merrni në konsideratë zhvillimin e një aktiviteti të ngjashëm ku t'i kërkoni të gjithë misionarëve në mision të nënvizojnë vargjet ku bëhet fjalë për besimin në Jezu Krisht, pendimin, pagëzimin, dhuratën e Frymës së Shenjtë, ose për ndonjë nga parimet themelore të ungjillit.

- Gjatë intervistave, ftoni misionarët të ndajnë me ju shkrime të shenjta nga Libri i Mormonit që kanë ndryshuar jetën e tyre.
- I ndihmoni misionarët të kuptojnë se si Libri i Mormonit mëson doktrinat e përfshira në mësimet misionare. Për shembull, në qoftë se tema do të ishte Shlyerja, u kërkoni misionarëve të shkruajnë në një kolonë çdo element kryesor të Shlyerjes që mësohet në Librin e Mormonit, duke përfshirë edhe vendndodhjen e tyre. Pastaj, në një kolonë të dytë, u kërkoni të rendisin paralelisht po ato elementë që mësohen në Bibël. U kërkoni misionarëve të lënë bosh vendin për ato elementë që mungojnë ose nuk mësohen në Bibël. Kjo do ta bëjë shumë të qartë për misionarin se si Libri i Mormonit është guri kyç i doktrinës sonë. Ky aktivitet mund të bëhet edhe me doktrina të tjera që misionarët mësojnë.
- Identifikoni pyetje të shpirtit që mund të kenë njerëzit në misionin tuaj. I ftoni misionarët të gjejnë përgjigjet në Librin e Mormonit.



# Si të Zhvilloj Cilësi Si të Krishtit?

## Mbani Parasysh

- Si mund të zhvilloj unë cilësi që do të më bëjnë një misionar më të fuqishëm dhe më efektiv të ungjillit të Jezu Krishtit?
- Si do të më ndihmojë zhvillimi i cilësive si të Krishtit për të përmbushur qëllimin tim si misionar?
- Cilën cilësi kam nevojë të zhvilloj më shumë?

**N**ë fillim të shërbesës së Tij të vdekshme, Jezu Krishti duke ecur gjatë bregut të detit të Galileesë thirri dy peshkatarë, Pjetrin dhe Andrean. “Ndiqmëni,” tha Ai, “dhe unë do t’ju bëj peshkatarë njerëzish” (Mateu 4:19; shih gjithashtu Marku 1:17). Zoti ju ka thirrur ju gjithashtu në punën e Tij dhe Ai ju fton ta ndiqni Atë. Ftesa për ta ndjekur Krishtin është një ftesë për të ndjekur shembullin e Tij dhe për t’u bërë si Ai.

Disa kapituj në udhëzuesin Predikoni Ungjillin Tim përqendrohen në atë që ju duhet të bëni si misionar—si të studioni, si t’i mësoni të tjerët, si ta përdorni kohën me mençuri. Megjithatë, po aq e rëndësishme sa ajo që bëni është edhe se kush jeni.

Ungjilli i rivendosur ju ndihmon të bëheni si Ati Qiellor dhe Jezu Krishti. Shpëtimtari na ka treguar rrugën. Ai na dha një shembull të përkryer dhe na urdhëron të bëhemi siç është Ai (shih 3 Nefi 27:27). Mësoni nga Ai dhe përpiquni t’i bëni cilësitë e Tij pjesë të jetës suaj. Nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Tij, ju mund ta arrini këtë qëllim dhe t’i udhëhiqni të tjerët që edhe ata ta arrijnë atë.

Shkrimet e shenjta përshkruajnë cilësi si të Krishtit që janë thelbësore për ju që të zhvilloheni si një misionar dhe gjatë gjithë jetës suaj. Studioni fragmentet e shkrimeve të shenjta që gjenden në këtë kapitull dhe kërkoni shembuj të tjerë të cilësive si të Krishtit ndërsa studioni fragmente të tjera.

Cilësitë si të Krishtit janë dhurata nga Perëndia. Ato vijnë kur ju e përdorni me drejtësi zgjedhjen tuaj të lirë. I kërkoni Atit tuaj Qiellor t’ju bekojë me këto cilësi; ju nuk mund t’i zhvilloni ato pa ndihmën e Tij. Me dëshirën për ta kënaqur Perëndinë, pranoni dobësitë tuaja dhe jini të gatshëm dhe entuziastë për t’u përmirësuar.

Shënime

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Çfarë thonë këto shkrime të shenjta rreth ndjekjes së shembullit të Jezu Krishtit?**

3 Nefi 12:48

Gjoni 13:1–16

1 Pjetri 2:21

3 Nefi 27:21, 27

**Cila është lidhja ndërmjet parimeve të para të ungjillit dhe cilësive si të Krishtit?**

Moroni 8:25–26

**Ide për Studimin e Këtij Kapitulli**

Ka shumë metoda për studimin e këtij kapitulli. Provoni një nga idetë e mëposhtme:

- Ndërsa plotësoni “Aktivitetin e Cilësive” që gjendet në fund të këtij kapitulli, identifikoni cilësinë që ju keni nevojë ose që doni ta zhvilloni më shumë. Studioni pjesën rreth asaj cilësie dhe vendosni qëllime për ta zhvilluar atë.
- Lexoni gjithë kapitullin pa studiuar shkrimet e shenjta dhe vendosni se cilën cilësi doni ta studioni më shumë. Pastaj studioni shkrimet e shenjta kryesore që lidhen me atë cilësi. Kërkoni të tjera shkrime të shenjta që nuk janë renditur në këtë kapitull të cilat ju mësojnë rreth asaj cilësie. Shkruani në ditarin tuaj të studimit ide për zhvillimin e kësaj cilësie.
- Identifikoni një cilësi që ju dëshironi të studioni. Ndiqni shembullin nën titullin “Zhvillimi i Cilësive si të Krishtit” që gjendet në fund të kapitullit.

**Besim në Jezu Krisht**


Kur keni besim në Jezu Krisht, ju besoni në Të si Birin e Perëndisë, të Vetëmlindurin e Atit në Mish. Ju e pranoni Atë si Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tuaj dhe ndiqni mësimet e Tij. Ju besoni se mëkatet tuaja mund të falen nëpërmjet Shlyerjes së Tij. Besim në Krisht do të thotë se ju e besoni Atë dhe jeni të sigurtë se Ai ju do.

Besimi çon drejt veprimit, përfshirë pendimin, bindjen dhe shërbimin e përkushtuar. Kur keni besim në Jezu Krisht, ju e vendosni besimin tuaj tek Zoti aq shumë sa të ndiqni urdhërimet e Tij—madje edhe atëherë kur nuk i kuptoni plotësisht arsyet për këto urdhërime. Ju përmbushni ato që Zoti dëshiron të përmbushni. Ju ndihmoni për të sjellë atë që është e mirë në vetë jetën tuaj si dhe në jetën e të tjerëve. Ju mund të bëni mrekulli sipas vullnetit të Zotit. Besimi juaj do të tregohet me anë të zellit dhe të punës.

Besimi është një parim fuqie. Perëndia vepron nëpërmjet fuqisë, por fuqia e tij zakonisht ushtrohet në përgjigje të besimit (shih Moroni 10:7). Ai punon sipas besimit të fëmijëve të Tij. Dyshimi dhe frika janë të kundërtat e besimit.

Besimi juaj do të rritet nëpërmjet studimit të zellshëm, lutjes, shërbimit të përkushtuar dhe bindjes ndaj nxitjeve të Frymës së Shenjtë dhe urdhërimeve.

Besimi juaj në Jezu Krisht rritet kur ju njiheni më mirë me Të dhe mësimet e Tij. Kur studioni shkrimet e shenjta dhe i hetoni ato, ju mësoni për udhët e Tij, dashurinë e Tij për të gjithë njerëzit dhe për urdhërimet e Tij.



© 1989 Conceptions Unlimited Investments, Inc. Ndalohej fotokopimi.

Besimi përfshin gjithashtu besimin në misionin dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë. Me anë të besimit ju merrni përgjigjet e lutjeve tuaja dhe frymëzim personal për t'ju udhëhequr në punën e Zotit.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë është besimi?

Alma 32:21  
Ethëri 12:6

Hebrenjve 11:1; shih shënimin b  
në fund të faqes në variantin  
SHDM të Biblës në anglisht

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Besimi”  
Të Vërtetë ndaj Besimit, “Besim”, 20–22

#### Si mund të fitoni besim dhe çfarë mund të bëni me anë të besimit?

2 Nefi 25:29  
2 Nefi 26:13  
Mosia 4:6–12

Alma 32  
Helamani 15:7–8  
Ethëri 12:7–22

Moroni 7:33  
Romakëve 10:17  
Hebrenjve 11

#### Çfarë bekimesh vijnë nëpërmjet besimit?

Mosia 3:17  
Mosia 5:1–15

Helamani 5:9–12

Gjoni 14:6

## Shpresa

Shpresa është një besim i patundur se Zoti do të përmbushë premtimet që ju ka bërë. Ajo shfaqet në besimin, optimizmin, entuziazmin dhe në këmbënguljen e duruar. Shpresë do të thotë të besosh dhe të presësh pa dyshuar se diçka do të ndodhë. Kur keni shpresë, i kapërceni sprovat dhe vështirësitë me besimin dhe sigurinë se të gjitha gjërat do të bashkëveprojnë për të mirën tuaj. Shpresa ju ndihmon të mposhtni dekurajimin. Shkrimet e shenjta shpesh e përshkruajnë shpresën në Jezu Krisht si një siguri se ju do të trashëgoni jetën e përjetshme në mbretërinë celestiale.

Presidenti Xheims E. Faust na mësoi:

“Shpresa është spiranca e shpirtave tanë...

Shpresa është besimi në premtimet e Perëndisë, besim se nëse veprimet tani, bekimet e dëshiruara do të përmbushen në të ardhmen...

Burimi i pashtershëm i shpresës sonë është se ne jemi bij dhe bija të Perëndisë dhe se Biri i Tij, Zoti Jezu Krisht, na shpëtoi nga vdekja” (“Hope, an Anchor of the Soul,” *Ensign*, nëntor 1999, 59–60).

“Duke qenë të bekuar me shpresë, ne si dishepuj, le të ndihmojmë të gjithë ata, të cilët për çfarëdo lloj arsye, kanë [luajtur] nga shpresa e ungjillit’ (Kol. 1:23). Le të ndihmojmë për të forcuar duart e kapitura.”

— PLAKU NILL A. MAKSUELL  
“BRIGHTNESS OF HOPE,” *ENSIGN*, NËNTOR 1994, 36

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë është shpresa dhe për çfarë shpresojmë ne?

2 Nefi 31:20  
Alma 58:10–11  
Ethëri 12:4, 32

Moroni 7:40–48  
DeB 59:23  
DeB 138:14

Romakëve 8:24–25  
Hebrenjve 6:10–20  
Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Shpresë”

## Dashuria Hyjnore dhe Dashuria

Një herë një burrë e pyeti Jezusin: “Cili është urdhërimi i madh i ligjit?” Jezusi iu përgjigj: “‘Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’. Ky është urdhërimi i parë dhe i madh. Dhe i dyti i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsì vetveten’” (Mateu 22:36–39).

Dashuria hyjnore është “dashuria e pastër e Krishtit” (Moroni 7:47). Ajo përfshin dashurinë e përjetshme të Perëndisë për të gjithë fëmijët e Tij. Ne duhet të përpiqemi ta zhvillojmë këtë lloj dashurie. Kur jeni të mbushur me dashuri hyjnore, ju u bindeni urdhërimeve të Perëndisë dhe bëni gjithçka mundeni për t’u shërbyer të tjerëve dhe për t’i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur.

Dashuria hyjnore është një dhuratë nga Perëndia. Profeti Mormoni tha se ne duhet t’i “[lutemi] Atit me gjithë fuqinë e zemrës [tonë], që të [mbushemi] me këtë dashuri” (Moroni 7:48). Kur ju ndiqni këtë këshillë dhe përpiqeni të bëni vepra të drejta, dashuria juaj për të gjithë njerëzit do të rritet, veçanërisht për ata mes të cilëve punoni. Ju do të arrini të ndieni një shqetësim të sinqertë për mirëqenien dhe lumturinë e përjetshme të njerëzve të tjerë. Ju do t’i shikoni ata si fëmijë të Perëndisë me potencialin për t’u bërë si Ati ynë Qiellor dhe ju do të punoni për ta. Ju do të shmangni ndjenja negative si inati, zilia, dëshirat trupore, ose lakmia. Ju do të shmangni prirjen për t’i gjykuar të tjerët, për t’i kritikuar ata, ose për të thënë gjëra negative për ta. Ju do të përpiqeni t’i kuptoni ata dhe pikëpamjet e tyre. Ju do të jeni të duruar me ta dhe do të përpiqeni t’i ndihmoni kur ndodhen në vështirësi ose janë të dekurajuar. Dashuria hyjnore, ashtu si besimi, çon në veprim. Ju do të zhvilloni dashuri hyjnore kur kërkoni mundësi për t’u shërbyer të tjerëve dhe për t’u dhënë nga vetja juaj.



© 2001 Simon Dewey. Nivohet fotokopimi.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë është dashuria hyjnore?

Moroni 7:45–48

1 Korintasve 13

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Dashuri hyjnore”

#### Si e tregoi Jezusi dashurinë hyjnore?

1 Nefi 19:9

Ethëri 12:33–34

Lluka 7:12–15

Alma 7:11–13

#### Çfarë ju mësojnë këto vargje rreth dashurisë hyjnore?

2 Nefi 26:30

Alma 7:24

1 Timoteut 4:12

Mosia 2:17

Ethëri 12:28

1 Pjetër 4:8; shih shënimin a në fund të faqes në  
variantin SHDM të Biblës në anglisht

Mosia 28:3

DeB 88:125

## Virtyti

Virtyti buron nga mendimet dhe dëshirat tuaja më intime. Ai është një formë e mendimit dhe e sjelljes e bazuar në standarde të larta morale. Duke qenë se Fryma e Shenjtë nuk jeton



në tabernakuj të papastër, virtyti është një kërkesë e domosdoshme për të marrë udhëheqjen e Shpirtit. Ajo që ju zgjidhni të mendoni dhe të bëni kur jeni vetëm dhe kur mendoni se askush nuk po ju shikon është një masë e fortë e virtytit tuaj.

Njerëzit e virtytshëm janë të pastër dhe të panjollë shpirtërisht. Ata përqendrohen në mendime të drejta dhe lartësuese dhe largojnë nga mendja e tyre mendimet e padenja që çojnë në veprime të pahijshme. Ata i binden urdhërimeve të Perëndisë dhe ndjekin këshillën e udhëheqësve të Kishës. Ata lutën për forcë që t'i rezistojnë tundimit dhe të bëjnë atë që është e drejtë. Ata pendohen shpejt për ndonjë mëkat apo veprim të gabuar. Ata jetojnë të denjë për një rekomandim tempulli.

Mendja juaj i ngjan skenës së një teatri; megjithatë, në teatrin e mendjes suaj, në një kohë të caktuar mund të ketë vetëm një aktor në skenë. Në qoftë se skena lihet bosh, mendimet e errësirës dhe mëkatit shpesh hyjnë në skenë për të tunduar. Por këto mendime nuk kanë fuqi në qoftë se skena e mendjes suaj është e pushtuar nga mendime të moralshme, të tilla si një himn i mësuar përmendësh ose një varg nga shkrimet e shenjta të cilin mund ta kujtoni në një çast tundimi. Duke kontrolluar skenën e mendjes suaj, ju mund t'i rezistoni me sukses nxitjeve të vazhdueshme për t'iu dorëzuar tundimit dhe dhënies pas mëkatit. Ju mund të bëheni të pastër dhe të virtytshëm.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë do të thotë të jesh i virtytshëm?

DeB 4:6

DeB 46:33

2 Pjetri 1:3–8

DeB 25:2

DeB 121:45–46

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,

DeB 38:24

Nenet e Besimit 1:13

“Virtyt”

## Dituria

Zoti urdhëroi: “kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit” (DeB 88:118). Ai gjithashtu na paralajmëroi: “Është e pamundur për një njeri të shpëtohet në padituri (DeB 131:6). Kërkoni dituri, veçanërisht dituri shpirtërore. Studioni shkrimet e shenjta çdo ditë dhe gjithashtu studioni fjalët e profetëve të gjallë. Me anë të studimit dhe lutjes, kërkoni ndihmë për pyetjet specifike, sfidat dhe mundësitë tuaja. I kushtoni vëmendje të veçantë pjesëve nga shkrimet e shenjta që mund të përdorni kur mësoni dhe u përgjigjeni pyetjeve rreth ungjillit të rivendosur.

Mendoni si mund t'i zbatoni parimet e ungjillit në jetën tuaj. Ndërsa studioni me zell, plot lutje dhe me qëllim të pastër, Fryma e Shenjtë do të ndriçojë mendjen tuaj, do t'ju mësojë dhe do t'ju ndihmojë të kuptoni domethënien e shkrimeve të shenjta dhe mësimet e profetëve të gjallë. Ju gjithashtu fitoni dituri duke parë dhe dëgjuar të tjerët, veçanërisht udhëheqësit e Kishës. Ashtu si Nefi, ju mund të thoni: “Shpirti im kënaqet pa masë në shkrimet e shenjta dhe zemra ime i mediton ato... Vini re, shpirti im kënaqet pa masë në gjërat e Zotit; dhe zemra ime mediton vazhdimisht mbi gjërat që unë kam parë dhe dëgjuar” (2 Nefi 4:15–16).

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Si ndihmon dituria në kryerjen e punës së Zotit?

Alma 17:2–3

DeB 88:77–80

#### Si mund të fitoni dituri?

2 Nefi 32:1–5

DeB 42:61

DeB 88:118

Moroni 10:5

DeB 76:5–10

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Dije”

## Shënime

**Durimi**

Durimi është aftësia për të duruar vone-sën, shqetësimin, kundërvënien, ose vuajtjen pa u inatosur, zhgënjyer, ose pa u bërë i paduruar. Durimi është aftësia për të bërë vullnetin e Perëndisë dhe për të pritur kohën e Tij. Kur jeni të duruar, ju qëndroni të fortë përballë shqetësimeve dhe mund ta përballoni fatkeqësinë qetësisht dhe me besim. Durimi lidhet me shpresën dhe besimin—ju duhet të prisni që të përmbushen bekimet e premtuara nga Zoti.

Ju keni nevojë për durim në përvojat dhe marrëdhëniet tuaj të përditshme, veçanërisht me shokun/shoqen tuaj. Ju duhet të jeni të duruar me të gjithë njerëzit, duke përfshirë edhe veten tuaj, ndërsa punoni për të kapërcyer të metat dhe dobësitë.

*“Jeta është e mbushur me vështirësi, disa të vogla dhe të tjerat të një natyre më serioze. Duket sikur ka një pafundësi sfidash për këdo. Problemi ynë është se ne shpesh presim zgjidhje të menjëhershme të këtyre sfidave, duke harruar se shpesh kërkohet virtyti qiellor i durimit.”*

— PRESIDENTI TOMAS S. MONSON  
“PATIENCE—A HEAVENLY VIRTUE,” *ENSIGN*, NËNTOR 1995, 59.

**Aktivitet: Studim Individual**

- Studioni Mosia 28:1–9. Cilat ishin dëshirat e bijve të Mosias?
- Cilat ishin këshillat që Zoti u dha këtyre misionarëve? (Shih Alma 17:10–11 dhe 26:27.)
- Cilat ishin disa rezultate të durimit dhe zellit të tyre? (Shih Alma 26.)
- I shkruani përgjigjet tuaja në ditarin e studimit.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Pse është i rëndësishëm durimi? Si lidhet durimi me besimin?**

Mosia 23:21

Alma 34:40–41

2 Korintasve 6:1–10

Mosia 24:9–16

DeB 101:38

Jakobi 5:10–11 (Dhjata e Re)

Alma 31:31

Romakëve 5:3–5

Psalmet 46:10

Alma 32:41–43

Romakëve 8:24–25

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Durim”

**Përlësia**

Përlësia është gatishmëria për t’iu nënshtruar vullnetit të Zotit dhe për t’ia dhënë Zotit meritat për atë që është përmbushur. Ajo përfshin mirënjohje për bekimet e Tij dhe pranimin e nevojës tuaj të përhershme për ndihmën e Tij hyjnore. Përlësia nuk është një shenjë dobësie; ajo është një shenjë e forcës shpirtërore. Kur ju me përlësi besoni Atë dhe pranoni fuqinë dhe mëshirën e Tij, ju mund të keni sigurinë se urdhërimet e Tij janë për të mirën tuaj. Ju keni besim se mund të bëni gjithçka që Zoti kërkon nga ju në qoftë se mbështeteni tek Ai. Ju jeni gjithashtu të gatshëm të besoni shërbëtorët e Tij të zgjedhur dhe të ndiqni këshillën e tyre. Përlësia do



t'ju ndihmojë ndërsa përpiqeni të bindeni, të punoni pa u lodhur dhe të shërbëni me vetëmohim.

E kundërta e përlësisë është krenaria, që dënohet në shkrimet e shenjta. Të jesh krenar do të thotë të kesh besim më të madh tek vetja se sa te Perëndia apo shërbëtorët e Tij. Ajo gjithashtu do të thotë të vendosësh gjërat e botës përpara gjërave të Perëndisë. Njerëzit krenarë i marrin meritat për vete në vend që t'i japin lavdi Perëndisë. Krenaria është konkurruese; ata që janë krenarë kërkojnë të kenë më shumë dhe pandehin se janë më të mirë se njerëzit e tjerë. Krenaria zakonisht rezulton në ndjenjat e inatit dhe urrejtjes dhe është një pengesë e madhe.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë do të thotë të jesh i përlulur?

2 Nefi 9:28–29  
Mosia 4:11–12

Alma 5:26–29  
Alma 26:12

Mateu 26:39  
Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
“Përlul, Përlulësi”

#### Çfarë bekimesh merrni kur jeni të përlulur?

Alma 32:1–16  
Ethëri 12:27  
DeB 12:8

DeB 67:10  
DeB 112:10  
DeB 136:32–33

Mateu 23:12

#### Si mund ta dalloni krenarinë në veten tuaj?

1 Nefi 15:7–11  
1 Nefi 16:1–3

2 Timoteut 3:1–4  
Fjalët e Urta 13:10

Fjalët e Urta 15:10  
Fjalët e Urta 28:25

## Zelli

Zelli është përpjekja e qëndrueshme, e vazhdueshme, e ethshme dhe energjike për të bërë punën e Zotit. Zoti pret që ju të punoni me zell—me këmbëngulje dhe me përpjekje e kujdes të madh. Një misionar i zellshëm punon me efektivitet dhe rendiment. Zelli në punën misionare është një shprehje e dashurisë tuaj për Zotin dhe punën e Tij. Kur jeni të zellshëm ju gjeni gëzim dhe kënaqësi në punën tuaj.

Bëni shumë vepra të mira me vullnetin tuaj të lirë (shih DeB 58:27). Mos prisni që udhëheqësit tuaj t'ju thonë se ç'duhet të bëni. Vazhdoni deri sa të keni bërë sa mundni, madje edhe kur jeni të lodhur. Përqendrohuni në gjërat më të rëndësishme dhe shmangni humbjen e kohës. Lutuni për drejtim dhe forcë. Planifikoni rregullisht dhe efektivisht. Shmangni gjithçka që tërheq vëmendjen e mendimeve dhe veprimeve tuaja.

*“E kam thënë shpesh se një nga sekretet më të mëdha të punës misionare është puna! Në qoftë se një misionar punon, ai do të marrë Shpirtin; në qoftë se merr Shpirtin, ai do të mësojë me anë të Shpirtit; dhe në qoftë se mëson me anë të Shpirtit, ai do të prekë zemrat e njerëzve dhe do të jetë i lumtur. Nuk do të ketë mall për shtëpinë, shqetësim për familjen, sepse e gjithë koha, talentet dhe interesat janë përqendruar në punën e shërbesës. Punë, punë, punë—nuk ekziston asnjë zëvendësues tjetër i kënaqshëm, veçanërisht në punën misionare.”*

— PRESIDENTI EZRA TAFT BENSON  
THE TEACHINGS OF EZRA TAFT BENSON (1988), 200

## Shënime

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Çfarë do të thotë të jesh i zellshëm?**

Moroni 9:6 DeB 10:4	DeB 107:99–100	Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Zell”
------------------------	----------------	--

**Pse Zoti pret që ju të jeni të zellshëm?**

DeB 75:2–5 DeB 123:12–14	DeB 127:4	DeB 130:20–21
-----------------------------	-----------	---------------

**Si lidhet zelli me lirinë e zgjedhjes?**

Mosia 4:26–27	DeB 58:26–29
---------------	--------------

**Bindja**

Si një misionar, nga ju pritet të mbani urdhërimet me dëshirë, t’i bindeni rregullave të misionit dhe të ndiqni këshillat e udhëheqësve tuaj. Bindja është ligji i parë i qiellit. Ajo është një akt besimi. Ndonjëherë mund t’ju kërkohet të bëni gjëra që nuk i kuptoni plotësisht. Kur bindeni, ju rriteni në besim, dituri, urtësi, dëshmi, mbrojtje dhe liri. Përpiquni të jeni të bindur ndaj Zotit, profetit të gjallë dhe presidentit të misionit.

*“Disiplina e përfshirë në bindjen e përditshme, në jetën e pastër dhe të shëndetshme ngre rreth jush një mburojë mbrojtjeje dhe sigurie nga tundimet që ju rrethojnë teksa kaloni përmes vdekshmërisë.*

— PLAKU L. TOM PERRI.  
“CALLED TO SERVE,” *ENSIGN*, MAJ 1991, 39

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Çfarë do të thotë të jesh i bindur?**

1 Nefi 2:3 Mosia 5:8 Mosia 15:7	DeB 82:8–10 Mateu 7:24–27 Gjoni 7:17	Gjoni 14:15 Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, “Bindje, Bindur (I), Bindem”
---------------------------------------	--	--

**Çfarë mund të mësoni rreth bindjes nga këto shkrime të shenjta?**

1 Nefi 3:7	DeB 105:6	2 Mbretërve 5:1–14
------------	-----------	--------------------

**Pse u bindën me përpikmëri luftëtarët e rinj në ushtrinë e Helamanit?****Si u bekuan ata?**

Alma 56:45–48	Alma 57:21–27
---------------	---------------

**Zhvillimi i Cilësive Si të Krishtit**

Ndërsa studioni dhe mundoheni të zhvilloni cilësitë e përkrahura në këtë kapitull dhe cilësi të tjera që gjenden në shkrimet e shenjta, modeli i mëposhtëm mund t’ju ndihmojë:

- Identifikoni cilësinë që dëshironi të zhvilloni.
- Shkruani një përkufizim dhe një përshkrim të cilësisë.
- Shkruani pyetje për t’iu përgjigjur gjatë studimit.

- Rendisni dhe studioni me kujdes fragmente nga shkrimet e shenjta që mësojnë rreth asaj cilësie.
- Shkruani ndjenjat dhe përshtypjet tuaja.
- Vendosni qëllime dhe bëni plane për ta zbatuar këtë cilësi në jetën tuaj.
- Lutjuni Zotit t'ju ndihmojë për të zhvilluar cilësinë.
- Vlerësoni periodikisht përparimin tuaj në zhvillimin e çdo cilësie.

### Aktivitet: Studim Individual

Identifikoni një cilësi nga ky kapitull ose nga shkrimet e shenjta. Ndiqni shembujt e dhënë më sipër që të kuptoni dhe të planifikoni më mirë për zhvillimin e cilësisë.

Shikoni fotografinë e etiketës së emrit. Si ndryshon etiketa juaj e emrit nga ajo që vë i punësuar i një kompanie? Mos harroni se dy pjesët më të spikatura janë emri juaj dhe emri i Shpëtimtarit. Si mund të siguroheni se ju e përfaqësoni Shpëtimtarin si një nga dishepujt e Tij? Pse është e rëndësishme që njerëzit ta shoqërojnë emrin tuaj me emrin e Shpëtimtarit në një mënyrë pozitive? Shkruani mendimet tuaja në ditarin e studimit.



### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Cilat janë disa nga cilësitë e renditura në shkrimet e shenjta?

Mosia 3:19  
Alma 7:23  
DeB 4

DeB 121:41–45  
Nenet e Besimit 1:13

Filipianëve 4:8  
2 Pjetri 1:5–8

### Mbani Mend

- Ju duhet të jeni një misionar si Krishti, jo vetëm të bëni punë misionare.
- Të mësoni të jeni si Krishti është një përpjekje që zgjat gjithë jetën.
- Ndiqni shembullin e Krishtit—zhvilloni cilësitë e Tij—me veprime dhe vendime pa u ngutur që duhen bërë një nga një, në mënyrë të vazhdueshme.
- Shndërrimi për t'u bërë si Krishti kërkon ushtrim të besimit, pendim, mbajtje të besëlidhjeve, marrjen e një mase gjithmonë në rritje të Frymës së Shenjtë dhe durimin deri në fund.

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Përgatisni një bisedë pesë minutëshe rreth një prej cilësive të diskutuara në këtë kapitull.
- Duke përdorur Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta shikoni se në ç'mënyra Shpëtimtari i ka mishëruar cilësitë e përshkruara në këtë kapitull. Shkruani ato që mësoni në ditarin tuaj të studimit.
- Periodikisht plotësoni "Aktivitetin e Cilësive" në fund të këtij kapitulli.
- Identifikoni një cilësi në këtë kapitull. Pyesni veten:
  - Si mund ta zhvilloj këtë cilësi?
  - Çfarë duhet të ndryshoj në zemrën, mendjen dhe veprimet e mia për ta zhvilluar këtë cilësi?
  - Si më ndihmon mbajtja e besëlidhjeve për ta zhvilluar këtë cilësi?
  - Si do të më ndihmojë zhvillimi i kësaj cilësie të përgatitem për Frymën e Shenjtë dhe për t'u bërë një shërbëtar më i fuqishëm i ungjillit të Jezu Krishtit?
- Gjeni shembuj të cilësive si të Krishtit në jetën e burrave dhe të grave në shkrimet e shenjta. Shkruani përshtypjet tuaja në ditarin tuaj të studimit.

### Studim me Shokun

- Nga biblioteka e misionarit studioni referencat ku bëhet fjalë rreth cilësive si të Krishtit.
- Diskutoni lidhjet midis cilësive të ndryshme. Për shembull:
  - Si lidhet besimi me zellin?
  - Në ç'mënyrë janë të lidhura përlësia dhe dashuria?
  - Si e forcon dituria durimin?

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Disa ditë përpara mbledhjes së distriktit ose konferencës së zonës, i kërkonti çdo misionari të zgjedhë një nga cilësitë në këtë kapitull ose në shkrimet e shenjta dhe të përgatisë një bisedë pesë minutëshe rreth asaj cilësie, duke përfshirë shkrimet e shenjta që e kanë ndihmuar atë.

Lini kohë gjatë mbledhjes që disa misionarë të ndajnë bisedat e tyre.

- Ndajini misionarët në tre grupe dhe u jepni atyre detyrat e mëposhtme:

*Grupi 1:* Lexoni 1 Nefi 17:7–16 dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Si e ushtroi Nefi besimin e tij?
- Çfarë bëri Nefi që ishte si veprimet e Krishtit?
- Çfarë i premtoi Zoti Nefit në qoftë se ai do të ishte besnik dhe do të mbante besëlidhjet?
- Si lidhet ky tregim me punën misionare?

*Grupi 2:* Lexoni Jakobi 7:1–15 (LiM) dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Pse ishte aq i fuqishëm besimi i Jakobit sa t'i bënte ballë sulmit të Sheremit?
- Si e ushtroi besimin Jakobi kur bisedoi me Sheremin?
- Si ishin veprimet e Jakobit si të Krishtit?
- Çfarë duhet të bëjmë ne për të zhvilluar një besim si ai i Jakobit?

## Shënime

*Grupi 3:* Lexoni Joseph Smith—Historia 1:8–18 dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

- Në çfarë mënyrash Jozef Smithi ushtroi besimin në Jezu Krisht?
- Si u vu në provë besimi i tij?
- Çfarë bëri ai që ishte si veprimet e Krishtit?
- Çfarë mund të bëjmë ne që të ndjekim shembullin e Jozef Smithit?

Mbasi grupet të mbarojnë, mblidhni misionarët së bashku dhe u kërkoni atyre të ndajnë ato që diskutuan.

- Ndani një përvojë kur ju u bekuat ose u frymëzuat nga besimi i një personi tjetër.
- U kërkoni misionarëve t'i referohen “Aktivitetit të Cilësive.” I jepni çdo misionari një copë letër ku të shkruajë përgjigjen e tij ose të saj.

Pasi ta kenë plotësuar fletën e punës, i ftoni të vendosin qëllime personale.

U kërkoni disa prej misionarëve të ndajnë ato që kanë mësuar dhe kanë ndier ndërsa plotësuan fletën e punës.

Ndani dëshminë tuaj në lidhje me rëndësinë e zhvillimit të cilësive si të Krishtit.

### Presidenti i Misionit

- U kërkoni misionarëve të lexojnë një nga katër Ungjijtë në Dhjatën e Re ose 3 Nefi 11–28. U kërkoni atyre të nënvizojnë se çfarë bëri Shpëtimtari që mund ta bëjnë edhe ata.
- Përdorni vendosjen e qëllimeve dhe planifikimin për t'u mësuar misionarëve rreth zellit. Tregoni se si zelli në përqendrimin ndaj njerëzve është një shprehje e dashurisë.
- Gjatë intervistave, u kërkoni misionarëve të flasin rreth një cilësie që ata po përpiqen ta zhvillojnë.
- Në një konferencë zone, i ftoni misionarët të flasin rreth cilësive si të Krishtit që ata admirojnë tek shokët/shoqet e tyre.

## AKTIVITETI I CILËSIVE

Lexoni me kujdes secilën nga pikat e mëposhtme. Vendosni sa i vërtetë është ai pohim për ju dhe zgjidhni përgjigjen më të përshtatshme nga shpjeguesi i përgjigjeve. Shkruani përgjigjen tuaj për secilën pikë në ditarin tuaj të studimit. Rritja shpirtërore është një proces gradual dhe askush nuk është i përsosur, kështu që duhet të prisni që në disa pika ta vlerësoni veten më mirë se në disa të tjera.

Shpjeguesi i Përgjigjeve 1 = kurrë 2 = ndonjëherë 3 = shpesh 4 = pothuajse gjithmonë 5 = gjithmonë

### Besimi

- \_\_\_ 1. Unë besoj në Krisht dhe e pranoj Atë si Shpëtimtarin tim. (2 Nefi 25:29)
- \_\_\_ 2. Unë jam i/e sigurt se Perëndia më do. (1 Nefi 11:17)
- \_\_\_ 3. Unë kam aq shumë besim te Shpëtimtari sa të pranoj vullnetin e Tij dhe të bëj gjithçka që Ai më kërkon. (1 Nefi 3:7)
- \_\_\_ 4. Unë besoj pa asnjë dyshim se nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit mua mund të më falen të gjitha mëkatet. (Enosi 1:5–8)
- \_\_\_ 5. Unë kam besim të madh në Krisht për të marrë përgjigje për lutjet e mia. (Mosia 27:14)
- \_\_\_ 6. Unë mendoj për Shpëtimtarin gjatë ditës dhe kujtoj se çfarë ka bërë Ai për mua. (DeB 20:77, 79)
- \_\_\_ 7. Unë kam besimin e duhur për të më ndihmuar që të ndodhin gjëra të mira në jetën time ose në jetën e të tjerëve. (Ethëri 12:12)
- \_\_\_ 8. Unë e di nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë se Libri i Mormonit është i vërtetë. (Moroni 10:3–5)
- \_\_\_ 9. Unë kam aq shumë besim në Krisht sa të përmbush çdo gjë që Ai kërkon nga unë—madje edhe mrekulli, po të jetë e nevojshme. (Moroni 7:33)

### Shpresa

- \_\_\_ 10. Një nga dëshirat e mia më të mëdha është të trashëgoj jetën e përjetshme në mbretërinë çelestiale të Perëndisë. (Moroni 7:41)
- \_\_\_ 11. Unë kam besim se do të kem një mision të lumtur dhe të suksesshëm. (DeB 31:3–5)
- \_\_\_ 12. Unë ndihem i/e qetë dhe optimist/e për të ardhmen. (DeB 59:23)
- \_\_\_ 13. Unë besoj pa asnjë dyshim se një ditë do të banoj me Perëndinë dhe do të bëhem si Ai. (Ethëri 12:4)

### Dashuria Hyjnore dhe Dashuria

- \_\_\_ 14. Unë kam një dëshirë të sinqertë për mirëqenien dhe lumturinë e përjetshme të të tjerëve. (Mosia 28:3)
- \_\_\_ 15. Kur lutem, kërkoj të kem dashuri hyjnore—dashurinë e pastër të Krishtit. (Moroni 7:47–48)
- \_\_\_ 16. Unë përpiqem të kuptoj ndjenjat e të tjerëve dhe të kuptoj pikëpamjet e tyre. (Juda 1:22)
- \_\_\_ 17. Unë i fal ata që më kanë fyer ose janë sje-llë keq me mua. (Efesianëve 4:32)

- \_\_\_ 18. Unë përpiqem t'i ndihmoj të tjerët kur ata ndodhen në vështirësi ose kur ndihen të dekurajuar. (Mosia 18:9)
- \_\_\_ 19. Kur është e përshtatshme, unë u them të tjerëve se i dua dhe kujdesem për ta. (Lluka 7:12–15)
- \_\_\_ 20. Unë kërkoj mundësi për t'u shërbyer të tjerëve. (Mosia 2:17)
- \_\_\_ 21. Unë them gjëra pozitive për të tjerët. (DeB 42:27)
- \_\_\_ 22. Unë jam i sjellshëm dhe i duruar me të tjerët, madje edhe kur ata janë të pashoqërueshëm. (Moroni 7:45)
- \_\_\_ 23. Unë gëzohem për arritjet e të tjerëve. (Alma 17:2–4)

### Virtyti

- \_\_\_ 24. Unë jam i pastër dhe i kulluar në zemër. (Psalmet 24:3–4)
- \_\_\_ 25. Unë nuk kam dëshirë të bëj keq, por të bëj mirë. (Mosia 5:2)
- \_\_\_ 26. Unë jam i besueshëm—unë e bëj atë që them. (Alma 53:20)
- \_\_\_ 27. Unë përqendrohem në mendime të drejta e lartësuese dhe largoj nga mendja mendimet e pamoralshme. (DeB 121:45)
- \_\_\_ 28. Unë pendohem për mëkatet e mia dhe përpiqem të kapërcej dobësitë e mia. (DeB 49:26–28)
- \_\_\_ 29. Unë e ndiej ndikimin e Frymës së Shenjtë në jetën time. (DeB 11:12–13)

### Dituria

- \_\_\_ 30. Unë ndihem i/e sigurtë në kuptimin që kam për doktrinat dhe parimet e ungjillit. (Ethëri 3:19–20)
- \_\_\_ 31. Unë i studioj çdo ditë shkrimet e shenjtja. (Gjoni 5:39)
- \_\_\_ 32. Unë kërkoj me zell të kuptoj të vërtetën dhe të gjej përgjigje për pyetjet e mia. (DeB 6:7)
- \_\_\_ 33. Unë marr dituri dhe udhëheqje nëpërmjet Shpirtit. (1 Nefi 4:6)
- \_\_\_ 34. Unë i dua dhe i vlerësoj doktrinat dhe parimet e ungjillit. (2 Nefi 4:15)

### Durimi

- \_\_\_ 35. Unë pres me durim që të përmbushen bekimet dhe premtimet e Zotit. (2 Nefi 10:17)
- \_\_\_ 36. Unë mund të pres me durim realizimin e diçkaje pa u shqetësuar ose mërzitur. (Romakëve 8:25)
- \_\_\_ 37. Unë jam i/e duruar dhe këmbëngulës me sfidat e të qenit misionar. (Alma 17:11)

- \_\_\_ 38. Unë jam i duruar me të metat dhe dobësitë e të tjerëve. (Romakëve 15:1)
- \_\_\_ 39. Unë jam i duruar me veten dhe mbështetem tek Zoti ndërsa punoj për të kapërcyer dobësitë e mia. (Ethëri 12:27)
- \_\_\_ 40. Unë i bëj ballë me qetësi dhe shpresë fatkeqësive dhe vështirësive. (Alma 34:40–41)

### Përlësia

- \_\_\_ 41. Unë jam zemërbutë dhe i përlulur nga zemra. (Mateu 11:29)
- \_\_\_ 42. Unë mbështetem te Zoti për ndihmë. (Alma 26:12)
- \_\_\_ 43. Unë jam sinqerisht mirënjohës për bekimet që kam marrë nga Zoti. (Alma 7:23)
- \_\_\_ 44. Lutjet e mia janë të fuqishme dhe të sinqerta. (Enosi 1:4)
- \_\_\_ 45. Unë e vlerësoj drejtimin që marr nga udhëheqësit ose mësuesit e mi. (2 Nefi 9:28)
- \_\_\_ 46. Unë përpiqem t'i nënshtrohem vullnetit të Zotit, sido që të jetë. (Mosia 24:15)

### Zelli

- \_\_\_ 47. Unë punoj me efektivitet, edhe kur nuk jam nën presion ose nën vëzhgim. (DeB 58:26–27)
- \_\_\_ 48. Unë i përqendroj përpjekjet e mia në gjërat më të rëndësishme. (Mateu 23:23)
- \_\_\_ 49. Unë bëj lutje personale të paktën dy herë në ditë. (Alma 34:18–27)
- \_\_\_ 50. Unë i përqendroj mendimet e mia në thirrjen time si misionar. (DeB 4:2, 5)
- \_\_\_ 51. Unë vendos qëllime dhe planifikoj rregullisht. (DeB 88:119)
- \_\_\_ 52. Unë punoj shumë derisa puna të ketë përfunduar me sukses. (DeB 10:4)
- \_\_\_ 53. Unë gjej gëzim dhe kënaqësi në punën time. (Alma 36:24–25)

### Bindja

- \_\_\_ 54. Kur lutem, unë kërkoj forcë që t'i bëj ballë tundimit dhe të bëj atë që është e drejtë. (3 Nefi 18:15)
- \_\_\_ 55. Unë i mbaj urdhërimet e kërkuara për të qenë i denjë për një rekomandim tempullit. (DeB 97:8)
- \_\_\_ 56. Unë më dëshirë i bindem rregullave të misionit dhe ndjek këshillat e udhëheqësve të mi. (Hebrenjve 13:17)
- \_\_\_ 57. Unë përpiqem të jetoj në përputhje me ligjet dhe parimet e ungjillit. (DeB 41:5)





# Si Mund ta Mësoj më Mirë Gjuhën e Misionit Tim?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Pse duhet t'i përmirësoj vazhdimisht aftësitë e mia gjuhësore?
- Si mund ta përmirësoj aftësinë time për të folur dhe për të dhënë mësim në gjuhën e misionit tim?
- Si mund ta fitoj dhuratën e gjuhëve?

## Përgatisni Vetën Shpirtërisht

**Z**oti deklaroi: “çdo njeri do ta dëgjojë plotësinë e ungjillit në gjuhën e tij dhe në të folurën e tij, nëpërmjet atyre që shugurohen në këtë fuqi” ( DeB 90:11). Forconi dëshminë tuaj personale për t'i dhënë fjalëve tuaja fuqinë e kthimit në besim. Në fillim studioni doktrinat dhe mësimet në gjuhën tuaj amtare. Kështu duke i kuptuar ato do të forconi dëshminë dhe aftësinë tuaj për të mësuar të tjerët dhe për të dëshmuar në mënyrë bindëse. Më pas ju mund të mësoni të shprehni mesazhin e Rivendosjes në gjuhën e misionit tuaj nën udhëheqjen e Shpirtit.

Më poshtë janë renditur mënyra me anë të të cilave ju mund të forconi besimin tuaj se Zoti do t'ju ndihmojë të jepni mësim dhe të dëshmoni në gjuhën e misionit tuaj.

- Pranoni se ju u thirrët nga Perëndia me anë të një profeti.
- Jetoni të denjë për shoqërimin e Frymës së Shenjtë.
- Bindjuni urdhërimeve dhe standardeve misionare.
- Lutuni sinqerisht për ndihmë hyjnore.
- Studiojeni, praktikojeni dhe përdoreni çdo ditë gjuhën e misionit.

## Jini të Përkushtuar dhe të Zellshëm

Që të mësoni si ta përdorni gjuhën e misionit tuaj për të mësuar të tjerët me efektshmëri kërkon përpjekje të zellshme. Mos u habisni nëse kjo detyrë duket e vështirë në fillim. Mësimi i një gjuhe të huaj do kohë. Jini të duruar me veten. Kërkoni ndihmën e shokut/shoqes tuaj, anëtarëve, kërkuesve dhe misionarëve të tjerë.

Mos hiqni dorë nga përmirësimi i aftësive tuaja gjuhësore kur njerëzit fillojnë t'ju kuptojnë. Kur aftësia juaj për të folur rritet, njerëzit do t'i kushtojnë më shumë vëmendje asaj që thoni dhe jo si e thoni atë. Ju do të jeni më pak i shqetësuar rreth asaj se si t'i shprehni ndjenjat që janë në zemrën tuaj. Ju do të jeni më të përgatitur t'i përgjigjeni nevojave të kërkuesve dhe nxitjeve të Shpirtit.

Përpiquni ta përvetësoni gjuhën gjatë misionit si edhe pasi të jeni kthyer nga misioni. Zoti ju ka dhënë shumë bekime dhe Ai mund t'ju krijojë mundësi për të përdorur aftësitë tuaja gjuhësore më vonë në jetën tuaj. Plaku Xhefri R. Holland shpjegoi: “Ne do të...shpresonim se çdo misionar që po mëson të predikojë në një gjuhë të huaj do ta përvetësojë atë në çdo mënyrë të mundshme...Dhe ndërsa e bëni këtë, aftësitë tuaja për të predikuar dhe dëshmuar do të përmirësohen. Ju do të priteni më mirë dhe do t'u lini më tepër mbresa shpirtërore kërkuesve tuaj...Mos u kënaqni vetëm me atë që ne e quajmë fjalori i misionarëve. Punoni shumë për të përmirësuar gjuhën dhe do të mund të hyni më shpejt në zemrat e njerëzve” (transmetim satelitor misionar, gusht 1998).

Ju nuk jeni vetëm në mësimin e gjuhës së misionit tuaj. Sa herë që Zoti jep një urdhërim, Ai siguron një mënyrë për ta përmbushur atë (shih Nefi 3:7). Kërkoni ndihmën e Tij. Përkushtojuni studimit tuaj. Me kalimin e kohës ju do të fitoni aftësitë e nevojshme gjuhësore për të përmbushur qëllimin tuaj si misionar.

## Mësoni Anglisht

Në qoftë se nuk flisni anglisht, ju duhet ta studioni atë gjatë kohës që jeni në mision. Kjo do t'ju bekojë gjatë misionit dhe gjatë gjithë jetës suaj. Të mësuarit e anglishtes do t'ju japë mundësi të ndihmoni në ndërtimin e mbretërisë së Zotit në shumë mënyra të tjera dhe do të jetë një bekim për ju dhe familjen tuaj. Shumë nga sugjerimet që gjenden në këtë kapitull do t'ju ndihmojnë. Përqendrohuni veçanërisht në këto që vijojnë:

- Vendosni si qëllim që të flisni anglisht me shokun/shoqen tuaj. Në qoftë se shoku/shoqja juaj tashmë e di anglishten dhe po përpiqet të mësojë gjuhën tuaj, ju mund të zgjidhni të flisni anglisht në apartament dhe gjuhën e misionit kur jeni jashtë.
- Me shokun/shoqen tuaj, lexojeni Librin e Mormonit në anglisht. Ju gjithashtu mund të zgjidhni të alternoni: Ju lexoni një varg në anglisht dhe pastaj shoku/shoqja juaj lexon një varg në gjuhën e misionit. Korrigjoni shqiptimin dhe intonacionin e njëri-tjetrit.
- I kërkoni presidentit të misionit sugjerime mbi një libër gramatike të thjeshtë të gjuhës angleze në qoftë se nuk keni tashmë një të tillë.

## Parimet e Mësimin të Gjuhës

Kjo pjesë përshkruan parime që ju ndihmojnë të studioni dhe të mësoni gjuhën më me efektivitet.

- **Mbani përgjegjësi.** Krijoni ose riorganizoni rregullisht qëllimet tuaja për mësimin e gjuhës dhe planin e studimit. Përpiquni ta përdorni gjuhën në çdo mundësi.
- **Bëjeni studimin tuaj të kuptimtë.** Pyesni veten: Pse po e studioj këtë? Si do të më ndihmojë kjo të komunikoj më mirë? Bëni lidhjen midis asaj që studioni dhe situatave të jetës reale dhe aktiviteteve të përditshme. Studioni pjesë të gjuhës që do t'ju ndihmojnë të

thoni atë që doni të thoni. Për shembull, në qoftë se ka një histori nga shkrimet e shenjta që do të donit ta përfshinit në mësimin tuaj, mësoni fjalorin dhe gramatikën e nevojshme për ta treguar atë.

- **Përpiquni të komunikoni.** Përpiquni të gjeni një ekuilibër të përshtatshëm ndërmjet studimit të gramatikës e strukturës së gjuhës dhe të mësuarit nëpërmjet aktiviteteve të përditshme. Asgjë nuk e zëvendëson praktikimin e gjuhës me folësit e saj vendas.
- **Mësoni plotësisht konceptet e reja.** Ju do të jeni në gjendje të kujtoni dhe të përdorni me efektivitet parimet gjuhësore në qoftë se i rishikoni rregullisht ato që keni studiuar dhe nëse i përdorni përsëri në situata të reja.

## Krijoni një Plan Studimi për Gjuhën

Një plan studimi për gjuhën i ndihmon si misionarët e rinj, ashtu edhe ata me përvojë, të përqendrohen në atë që mund të bëjnë çdo ditë për të përmirësuar aftësitë e tyre për të folur gjuhën e misionit. Plani juaj duhet të përfshijë çfarë do të bëni gjatë kohës së studimit të gjuhës dhe çfarë do të bëni gjatë ditës.

Kur është e nevojshme, përdorni pak nga koha e studimit të gjuhës për të krijuar ose riorganizuar planin tuaj të studimit. Pastaj çdo mëngjes, gjatë kohës së studimit të gjuhës, mësoni gjuhën e nevojshme për aktivitetet e ditës. Udhëzimet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë në krijimin e një plani personal për mësimin e gjuhës:

1. **Vendosni qëllime.** Qëllimet javore dhe ditore do t'ju ndihmojnë të mësoni gjuhën e misionit tuaj. Përqendrojeni qëllimet tuaja në përmirësimin e aftësisë suaj për të komunikuar dhe për të dhënë mësim gjatë aktiviteteve të programuara, të tilla si takimet e mësimdhënies, mundësi për gjetjen e kërkuesve të rinj dhe mbledhjet e këshillit të lagjes. Rishikoni përparimin tuaj në arritjen e qëllimeve për mësimin e gjuhës. Pyesni veten se çfarë mund të bëni që të komunikoni me qartësi dhe fuqi më të madhe gjatë aktiviteteve tuaja të programuara.
2. **Zgjidhni se cilat materiale do të përdorni.** Rishikoni materialet e mëposhtme të gjuhës dhe vendosni se cilin do të përdorni për të arritur qëllimet tuaja:

- Veprat standarde në gjuhën e misionit tuaj.
- Mësimet në gjuhën e misionit tuaj.
- Një fjalor të vogël xhepi.
- Një libër të vogël gramatike.
- Materiale gjuhësore nga Qendra e Trajnimit të Misionarëve (QTM).
- Fletë të vogla shënimi.
- Një bllok xhepi.
- Materiale të tjera të Kishës në gjuhën e misionit tuaj.



3. **Mësoni përmendësh fjalor dhe shprehje.** Gjeni fjalë dhe shprehje që do t'ju ndihmojnë për të përmbushur qëllimet tuaja. Plani juaj gjuhësor mund të përmbajë idetë e mëposhtme:

- Gjeni fjalë dhe shprehje nga mësimet, broshurat, shkrimet e shenjta dhe botimet e tjera të Kishës që mund t'i përdorni gjatë mësimdhënies.

- Shkruani fjalët ose shprehjet që nuk i dini në një bllok shënimesh. Mbani me vete një fjalor të vogël dhe gjejini këto fjalë.
- Mbani me vete fletë të vogla shënimesh për të studiuar gjatë ditës. Shkruani një fjalë ose shprehje nga njëra anë dhe përkufizimin nga ana e kundërt. Veçoni fjalët që mësoni. Punoni me pjesën e mbetur të fjalëve që nuk i dini derisa t'i mësoni të gjitha ato.
- Përdorini fjalët dhe shprehjet e reja në fjali gjatë studimit individual, mësimdhënies dhe gjatë ditës.
- Praktikoni shqiptimin duke i thënë fjalët dhe shprehjet e reja me zë të lartë.
- Mësoni përmendësh shkrimet e shenjta kryesore në gjuhën e misionit.
- Mësoni përmendësh thënie të thjeshta nga mësimet ose broshurat që përmbajnë parime të rëndësishme të ungjillit. Gjeni mënyra të tjera për t'i shprehur këto ide.

**4. Mësoni gramatikën.** Përdorni materialet gjuhësore për të identifikuar rregullat gramatikore që do t'ju ndihmojnë të arrini qëllimet tuaja. Në qoftë se është e nevojshme, i kërkonti ndihmë shokut/shoqes tuaj, një misionari me përvojë, ose një anëtar. Merrni parasysh përfshirjen e disa prej ideve të mëposhtme:

- Përdorni tekstin gramatikor që morët në Qendrën e Trajnimit të Misionarëve ose një tekst të miratuar nga presidenti i misionit për t'ju ndihmuar të kuptoni gramatikën dhe llojet e strukturave të fjalive që gjenden në mësimet, broshurat dhe shkrimet e shenjta.
- Përgatisni fjali për t'i përdorur në aktivitetet tuaja të programuara ku zbatohen këto rregulla gramatikore. Praktikoni të folurit dhe të shkruarit e fjalive.
- I kushtoni vëmendje rendit të fjalëve në fjali si edhe vetë fjalëve e pjesëve të tyre.
- Kërkoni mundësi të praktikoni dhe të zbatoni gramatikën që mësoni çdo ditë.

**5. Dëgjoni në mënyrë aktive.** Merrni parasysh të përfshini sa më poshtë:

- Dëgjoni me kujdes folësit vendas. Imitoni atë që dëgjoni.
- Kur dëgjoni diçka që nuk e kuptoni, shkruajeni dhe gjeni se ç'do të thotë. Praktikoni përdorimin e fjalorit ose llojet e strukturave të fjalive.
- Kur dëgjoni, identifikoni fjalë dhe struktura fjalish që i keni mësuar kohët e fundit.
- Kur dëgjoni një shprehje të thënë ndryshe nga ç'do ta kishit thënë ju, shkruajeni dhe praktikojeni atë. Megjithatë, si një shërbëtor i Zotit, gjithmonë përdorni fjalor të përshtatshëm dhe jo zhargonin.
- Bëni një listë të gjërave që njerëzit mund t'ju thonë gjatë aktiviteteve tuaja të planifikuara. Kërkoni fjalët dhe shprehjet që lidhen me këto përgjigje. Planifikoni dhe praktikoni mënyra si mund të përgjigjeni.

**6. Përmirësoni aftësinë tuaj për të lexuar dhe për të shkruar.** Lexoni Librin e Mormonit në gjuhën e misionit tuaj për të mësuar fjalor dhe shprehje si dhe për të praktikuar gramatikën, shqiptimin dhe rrjedhshmërinë. Përdorimi i shkrimeve të shenjta në studimin e gjuhës ka një fuqi të madhe. Gjithashtu merrni parasysh idetë e mëposhtme:

- Mësoni të lexoni dhe të shkruani alfabetin, simbolet, ose germat e gjuhës suaj. Për sistemet e të shkruarit të bazuara në përdorimin e simboleve të veçanta, përqendrohuni në teknikat e leximit, si leximi i shkrimeve të shenjta, që do t'ju ndihmojë gjatë mësimdhënies.

- Lexoni me zë të lartë nga Libri i Mormonit, nga shkrimet e tjera të shenjta, ose nga revistat e Kishës në gjuhën e misionit tuaj. I kushtoni vëmendje fjalorit dhe shprehjeve të panjohura si edhe gramatikës. Në qoftë se nuk e kuptoni një fjalë, përpiquni ta kuptoni domethënien e saj nga konteksti i fragmentit përpara se ta shikoni në fjalor. Shkruajeni fjalën në fletët që përdorni për shënim. Përdorni paralelisht shkrimet e shenjta në gjuhën tuaj amtare dhe në gjuhën e misionit në qoftë se është e nevojshme.
- I kërkoni dikujt t’ju ndihmojë për shqiptimin, intonacionin dhe pauzat ndërsa lexoni.
- Praktikoni të shkruarin në gjuhën e misionit tuaj—për shembull, shënime personale dhe shënime të shkurtra që shërbejnë si kujtesë, letra, mesazhe falënderimi dhe mesazhe inkurajuese. Shkruani dëshminë tuaj në kopjet Librit të Mormonit që shpërndani.

### 7. U kërkoni të tjerëve t’ju ndihmojnë. Merrni në konsideratë përfshirjen e ideve të mëposhtme:

- Në qoftë se shoku/shoqja juaj është një folës vendas, përfitoni nga ky avantazh i madh duke i bërë pyetje të shpeshta dhe duke i kërkuar mendim.
- I kërkoni shokut/shoqes tuaj dhe folësve vendas t’ju korrigjojnë dhe t’ju sugjerojnë mënyra si të përmirësoheni. Në qoftë se ata përdorin një fjalë që nuk e kuptoni, u kërkoni që ta përkufizojnë atë për ju. Fëmijët dhe gjyshërit janë shpesh të gatshëm t’ju ndihmojnë.



- I ftoni ata që mësoni t’ju ndihmojnë. Shpjegojuni: “Unë po mësoj gjuhën tuaj. Ju lutem më ndihmoni. Në qoftë se unë mundohem të gjej një fjalë, ju lutem më ndihmoni.”
- Mos ngurrtoni të kërkoni ndihmë specifike duke pyetur: “Si i thoni \_\_\_\_\_ ?” “Si e shqiptoni \_\_\_\_\_ ?” “Çfarë do të thotë ?” “A mund ta përsërisni ju lutem?” I shkruani përgjigjet dhe studiojini ato.
- U kërkoni anëtarëve t’ju pyesin për të parë sa mirë i keni mësuar fjalët që keni shkruar në fletët e shënimeve ose në listën e fjalorit dhe t’ju ndihmojnë në leximin me zë të lartë të shkrimeve të shenjta.

### 8. Vlerësoni dhe rishikoni planin tuaj të studimit. Rishikoni çdo javë planin tuaj të studimit për të parë nëse ai po ju ndihmon të mësoni gjuhën. Ftoni shokun/shoqen tuaj dhe udhëheqësit e misionit t’ju sugjerojnë se në ç’drejtim duhet të punoni për t’u përmirësuar.

Përdoreni gjuhën e misionit në çdo rast. Flisni gjuhën e misionit me shokun/shoqen tuaj sa më shumë që të jetë e mundur gjatë ditës. Lutuni në gjuhën e misionit privatisht dhe publikisht për të mësuar gjuhën e përshtatshme për lutjen dhe për të mësuar të shprehni atë që keni në zemër.

Mos kini frikë të bëni gabime. Të gjithë ata që mësojnë një gjuhë të huaj bëjnë gabime. Njerëzit do t’ju kuptojnë dhe do të vlerësojnë përpjekjet tuaja për të mësuar gjuhën e tyre. Të mësuarit përmendësh i shprehjeve dhe shkrimeve të shenjta do t’ju ndihmojnë të shmangni gabimet, megjithatë nuk duhet të përdorni pjesë të gjata të mësuara përmendësh ose të përgatitura si një mënyrë për të shmangur gabimet.

**Aktivitet: Studim Individual**

Duke përdorur udhëzimet e përshkruara më sipër, krijoni një plan studimi. Rishikojeni planin tuaj më shokun/shoqen ose një nga udhëheqësit e misionit tuaj.

**Mësoni me Shokët Tuaj**

I ndihmoni shokët tuaj të jenë të suksesshëm dhe të fitojnë vetëbesim në mësimin e gjuhës sa më shpejt të jetë e mundur. Përgëzojini sinqerisht dhe vazhdimisht shokët tuaj dhe misionarët e tjerë për përparimin e tyre. Tregohuni të kujdesshëm që të mos thoni ose të mos bëni asgjë që mund të dobësojë vetëbesimin e tyre, por mos i përkrahni aq shumë sa ata të mos mësojnë. Mos e kurseni ndihmën kur është e nevojshme. U jepni atyre shumë mundësi për të mësuar dhe dëshmuar me sukses. Merrni parasysh idetë e mëposhtme për të mësuar me shokun/shoqen tuaj:

- I mësoni njëri-tjetrit gramatikën dhe fjalorin që keni mësuar.
- Praktikoni mësimdhënien në gjuhën e misionit. Në fillim, misionarët e rinj mund të japin mësim shumë thjesht, të ndajnë dëshmi të thjeshta dhe të thonë shkrime të shenjta që kanë mësuar përmendësh. Ndërsa vetëbesimi dhe aftësia e tyre rritet, ata do të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë më të plotë në mësimin e kërkuesve.
- Praktikoni përdorimin e gjuhës për të komunikuar në situata të zakonshme misionare.
- Bëjini njëri-tjetrit vërejtje të thjeshta dhe praktike me dashamirësi rreth asaj se çfarë bëni mirë dhe ku duhet të përmirësoheni. Është gjithashtu e rëndësishme që ju t'i pranoni vërejtjet pa u fyer.

Vini re se si një misionar më me përvojë e ndihmoi shokun e tij në këtë tregim të vërtetë që vijon më poshtë.

*Sapo kisha arritur në zonën time të dytë kur shoku im më tha se ishte radha ime të jepja mendimin shpirtëror në shtëpinë ku kishim një takim për darkë. Isha më shumë se paksa i frikësuar. Shoku im i parë kishte qenë gjithmonë i lumtur të bënte mësimin dhe unë isha mësuar të jepja pjesën time të vogël të mësimit dhe pastaj të dëgjoja ndërsa ai shpjegonte dhe i përgjigjej ndonjë pyetjeje.*

*U përpoqa ta bindja shokun tim se ishte ai që duhej ta jepte mendimin shpirtëror, por ai më nxiti ta bëja unë. Kështu praktikova me ndihmën e tij.*

*Kur erdhi çasti, hapa shkrimet e shenjta dhe lexova nga 3 Nefi 5 dhe 7. E kisha të vështirë, por arrita të shpjegoja pse e ndieja që pjesët që zgjodha ishin të rëndësishme dhe u ndjeva i lehtësuar pasi mbarova. Kur bëhej ndonjë pyetje, kthehesha nga shoku im dhe prisja që ai të përgjigjej, por ai nuk e hapte gojën. Ishte pikërisht atëherë kur unë u çudita me veten time nga dhënia e një përgjigjeje në një frëngjishte të kuptueshme. U mahnita edhe më shumë që anëtari nuk u duk ta kishte vënë re se unë isha i pasigurtë rreth aftësive të mia komunikuese. Unë fitova vetëbesim dhe e kuptova se frëngjishtja ime ishte shumë më mirë nga ç'e mendoja.*

*Javët kaluan dhe shoku im vazhdoi të më linte të jepja mësim—madje edhe atëherë kur unë mendoja se nuk do t'ia arrija, madje edhe kur ai ndoshta kishte frikë nëse unë do t'ia dilja mbanë. Dhe duke qenë se ai më inkurajonte të flisja, të dëgjoja dhe të jepja mësim, aftësitë e mia gjuhësore filluan të përparojnë më shpejt dhe unë e ndjeva se u bëra një vegël e Atit tonë në Qiell në vend që të isha thjesht shoku i heshtur i një misionari tjetër.*

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

- Në qoftë se po punoni me një misionar të ri, si mund ta ndihmoni më mirë shokun/shoqen tuaj të mësojë gjuhën?
- Në qoftë se jeni një misionar i ri, çfarë ndihme mund t'i kërkoni shokut/shoqes tuaj më të madh.

## Kultura dhe Mësimi i Gjuhës

Kultura dhe gjuha janë të lidhura ngushtë. Të kuptuarit e kulturës do t'ju ndihmojë të shpjegoni se përse gjuha përdoret në atë mënyrë. Përpiquni të kuptoni kulturën e njerëzve kështu që të mund t'u transmetoni atyre aspektet unike të mesazhit të Rivendosjes në një mënyrë të atillë që të jetë e kuptueshme për ta.

Një nga gjërat më të rëndësishme që mund të bëni për të fituar besimin dhe dashurinë e njerëzve është ta përqafoni kulturën e tyre në mënyra të përshtatshme. Shumë misionarë të mëdhenj kanë vepruar kështu (shih 1 Korintasve 9:20–23). Mundohuni që njerëzit të ndihen rehat me ju dhe gjuhën tuaj.

### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

- Imagjinoni sikur po shërbeni një mision në Azi. Po përgatiteni të mësoni dikë rreth ringjalljes dhe e dini se budistët besojnë në rimishërim. Si do ta shpjegoni ju ringjalljen në një mënyrë të tillë që kërkuesi do ta kuptojë se kjo doktrinë ndryshon dukshëm nga rimishërimi? Çfarë fjalësh dhe shprehjesh do t'ju duhet të mësoni për të përmbushur këtë detyrë?
- Mendoni rreth kulturës dhe traditës fetare të njerëzve që mësoni. Identifikoni një aspekt të traditës së tyre që mund të çojë në keqkuptime të doktrinave të ungjillit. Planifikoni mënyra për t'ua mësuar qartë këto doktrina.

## Dhurata e Gjuhëve

Kërkoni dhuratat e Shpirtit, përfshirë dhuratën e gjuhëve dhe të interpretimit të gjuhëve. Më shumë se çdo gjë tjetër, kjo do t'ju ndihmojë të flisni dhe të kuptoni gjuhën e njerëzve në misionin tuaj. Ju nuk do ta fitoni këtë dhuratë pa përpjekje nga ana juaj; ju duhet ta kërkoni atë me zell. Pjesë e të kërkuarit të dhuratës së gjuhëve është të punoni e të përpiqeni dhe të bëni gjithçka mundeni për të mësuar gjuhën. Besoni se Shpirti do t'ju ndihmojë ndërsa jetoni në mënyrën që duhet dhe bëni maksimumin tuaj. Kini besim se mund ta keni dhuratën e gjuhëve në kuptimin e saj më të vërtetë dhe më të plotë.

Kur e ndieni se e keni të vështirë të shprehni aq qartë sa do të donit, mbani mend se Shpirti mund t'u flasë zemrave të të gjithë fëmijëve të Perëndisë. Presidenti Tomas S. Monson na mëson: “Ekziston një gjuhë...që njihet nga çdo misionar—gjuha e Shpirtit. Ajo nuk mësohet në tekstet e shkruara nga studiues, as nuk mësohet përmes leximit dhe mësimet përmendësh. Gjuha e Shpirtit i jepet atij që kërkon me gjithë zemër të njohë Perëndinë dhe mban urdhërimet e Tij hyjnore. Përvetësimi i kësaj gjuhe lejon të depërtosh mure, të kapërcesh pengesa dhe të prekësh zemrën njerëzore” (“The Spirit Giveth Life,” *Ensign*, qershor 1997, 2).

### Mbani Mend

- Studioni fillimisht në gjuhën tuaj amtare doktrinën dhe mësimet që jepni.
- Mësoni t'i shprehni këto doktrina dhe ndjenjat tuaja rreth tyre në gjuhën e misionit tuaj.
- Krijoni një plan studimi për të mësuar gjuhën dhe rregullisht provoni ide të reja ndërsa përpiqeni të përmirësoheni në gjuhën e misionit tuaj.
- Kërkoni drejtimin e Shpirtit për t'ju ndihmuar të kuptoni dhe të komunikoni me njerëzit në misionin tuaj.

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Rishikoni sugjerimet në këtë kapitull. Gjeni një nga sugjerimet që nuk e keni provuar akoma dhe vendosni një qëllim ta provoni atë gjatë ditëve që do të vijë.
- Në mbledhjen e ardhshme të distriktit, pyesni një misionar me përvojë dhe me aftësi të mira gjuhësore se çfarë ka bërë ai ose ajo për të mësuar gjuhën.
- Lexoni dhe diskutoni thënien e mëposhtme nga Plaku Riçard G. Skot: “ Aty ku... traditat ose zakonet kombëtare bien ndesh me mësimet e Perëndisë, lërimi ato mënjane. Aty ku traditat dhe zakonet janë në harmoni me mësimet e Tij, ato duhet respektuar” (“Removing Barriers to Happiness,” *Ensign*, maj 1998, 87). Mendoni se në ç’mënyrë kultura e vendit ku shërbeni ndryshon nga kultura tuaj. Bëni një listë të ndryshimeve. Pastaj hiqini një vizë atyre që bien ndesh me mësimet e ungjillit. Mendoni për secilin nga ato ndryshime që mbeten (në listë) dhe se si mund t’i bëni këto zakone tuajat.
- Krijoni një plan studimi për t’u përgatitur të bëni një nga gjërat e mëposhtme në gjuhën e misionit tuaj:
  - Tregoni historinë e Jozef Smithit.
  - Përmbliidhni 3 Nefi 11.
  - Përmbliidhni Alma 32.
  - Tregoni historinë e Nefit dhe të fletëve prej tunxhi (shih 1 Nefi 3–5).
  - Shpjegoni periudhat ungjillore.
  - Ndani përvoja personale.
- Mbani shënim në fletë të vogla fjalët e panjohura që hasni në një nga mësimet. Mbajini ato me vete derisa t’i keni mësuar të gjitha.

### Studim me Shokun

- Praktikoni t’i mësoni njëri-tjetrit mësimet misionare në gjuhën e misionit tuaj.
- I kërkoni shokut/shoqes tuaj t’ju dëgjojë shqiptimin dhe t’ju ndihmojë të përmirësoheni.
- Zgjidhni histori nga shkrimet e shenjta ose fragmente që do të donit t’i përdornit gjatë mësimdhënies suaj. Praktikoni t’i përmbliidhni ato me fjalët tuaja.
- Rishikoni idetë në këtë kapitull. Diskutoni se cilat sugjerime mund të përdorni gjatë studimit me shokun/shoqen gjatë javës së ardhshme.
- Në qoftë se po trajtoni një misionar të ri, vini re situatat në të cilat shokun/shoqen tuaj nuk e kuptojnë kur flet. Bëni një listë të fjalëve, shprehjeve, ose gramatikës së përshtatshme që do ta ndihmonin shokun/shoqen tuaj. Shpjegoni dhe praktikoni si t’i përdorni ato që keni shkruar në listë gjatë aktiviteteve të ardhshme që keni planifikuar.

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Ftoni folës vendas në mbledhje. Organizojini misionarët që t’i mësojnë ata në grupe të vogla. U kërkoni folësve vendas të mbajnë shënime dhe të japin mendimin e tyre rreth gjuhës së misionarëve.
- Caktoni kohë më parë një ose dy misionarë të tregojnë rreth sukseseve që kanë patur në studimin e gjuhës. U kërkoni atyre të ndajnë idetë e tyre.



Shënime

- Caktoni një nga misionarët me përvojë të paraqesë shkurt disa pjesë të gjuhës që janë zakonisht të vështira për misionarët. Paraqisni shembuj të përdorimit të drejtë dhe u kërkonte misionarëve t'i praktikojnë ato.
- U kërkonte misionarëve vendas të ndajnë ide të dobishme.

### Presidenti i Misionit

- Herë pas here intervistojini misionarët në gjuhën që ata po mësojnë.
- U kërkonte ide udhëheqësve lokalë të priftërisë se si misionarët mund ta përmirësojnë gjuhën e tyre.
- Identifikoni gabimet më të zakonshme që bëjnë misionarët gjatë mësimit të gjuhës së misionit tuaj. Jepni udhëzime gjatë konferencave të zonës rreth korigjimit të këtyre gabimeve.
- U mësoni misionarëve doktrinën e dhuratave shpirtërore.
- Vëzhgojini misionarët kur japin mësim në gjuhën e vendit ku shërbejnë.
- Kërkonte mundësi për të përdorur gjuhën me misionarët tuaj.





# Si ta Përdor Kohën me Mençuri?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Si mund të më ndihmojnë qëllimet të jem një misionar më efektiv?
- Cila duhet të jetë epiqendra e qëllimeve të mia?
- Cilat janë materialet dhe burimet e planifikimit dhe si duhet t'i përdor ato?
- Pse është i rëndësishëm libri i territorit?
- Si i zhvilloj sesionet ditore dhe javore të planifikimit?
- Si mund ta kuptoj nëse qëllimet dhe planet e mia po më ndihmojnë për të çuar më tej punën e Zotit?

**J**u jeni caktuar të bëni punën e Zotit në një territor të caktuar. Ai do që ju të kujdeseni për territorin tuaj me dashuri dhe kujdes të madh. Qëllimi juaj është t'i ndihmoni të tjerët të vijnë tek Ai nëpërmjet pagëzimit dhe konfirmimit.

Bëni gjithçka mundni që ta lini territorin tuaj më të fortë nga ç'e gjetët. Qëllimet kuptimplote dhe planifikimi i kujdesshëm do t'ju ndihmojë të përmbushni atë që Zoti kërkon nga ju. Ndërsa kujdeseni për njerëzit në territorin ku jeni caktuar, ju do t'i raportoni Atij dhe udhëheqësve tuaj të misionit.

Në letrën e thirrjes së misionit thuhet: "Nga ju pritët gjithashtu t'ia kushtoni të gjithë kohën dhe vëmendjen tuaj shërbimit ndaj Zotit, duke lënë pas të gjitha punët e tjera personale. Ndërsa bëni këto gjëra, Zoti do t'ju bekojë dhe ju do të bëheni një avokat dhe lajmëtar i suksesshëm i së vërtetës. Ne vendosim besimin tonë tek ju dhe lutemi që Zoti do t'ju ndihmojë të plotësoni përgjegjësitë tuaja në përmbushjen e kësaj detyre të shenjtë." Ky kapitull do t'ju ndihmojë të kuptoni se si vendosja e qëllimeve, planifikimi dhe raportimi mund të ndihmojë shumë njerëz të pranojnë ungjillin e rivendosur.

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

Lexoni Jakobi 5:11–13, 61–64, 74–75 (LiM) dhe përgjigjiuni këtyre pyetjeve:

- Si ndihet Zoti për fëmijët e Tij?
- Çfarë përpjekjesh kërkon Zoti nga shërbëtorët e Tij?

**Treguesit Kyç për Kthimin në Besim**

Ndofta keni pyetur veten se cilat nga detyrat tuaja të shumta janë më të rëndësishmet. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ju duhet të kuptoni qëllimin tuaj dhe se si përdorimi efektiv i kohës mund t'ju ndihmojë ta përmbushni këtë qëllim.

Qëllimi juaj është t'i ftoni të tjerët të vijnë te Krishti, duke i ndihmuar ata të marrin ungjillin e rivendosur, nëpërmjet besimit në Jezun Krisht dhe Shlyerjes së Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund. Treguesit kyç janë përcaktuar nga udhëheqësit e Kishës për t'ju ndihmuar të përqendroheshi në këtë qëllim. Ndërsa përqendroheshi mbi këta tregues, ju do t'i ndihmoni njerëzit të përparojnë drejt pagëzimit, konfirmimit, aktivitetit të vazhdueshëm në Kishë dhe kthimit të përhershëm në besim.

**Treguesit Kyç që Duhën Dokumentuar dhe Raportuar**

- Kërkues të pagëzuar dhe të konfirmuar
- Kërkues që kanë një datë pagëzimi
- Kërkues që frekuentojnë mbledhjen e sakramentit
- Mësime dhënë kërkuesve në prani të një anëtari
- Të tjera mësime të dhëna
- Kërkues në përparim
- Rekomandime të marra dhe të kontaktuara
- Kërkues të rinj
- Mësime dhënë të porsakthyerve në besim dhe anëtarëve më pak aktivë

Këta tregues përcaktojnë ngjarje dhe etapa që tregojnë përparimin e një personi drejt kthimit të qëndrueshëm në besim. Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër për çdo tregues kyç:

**Të kthyer në besim të pagëzuar dhe të konfirmuar:** Çdo i kthyer në besim që ka marrë ordinancat e pagëzimit dhe konfirmimit.

**Kërkues që kanë një datë pagëzimi:** Çdo kërkues që ka pranuar të pagëzohet dhe të konfirmohet në një datë të caktuar.

**Kërkues që frekuentojnë mbledhjen e sakramentit:** Çdo kërkues që ka marrë pjesë në mbledhjen e sakramentit.

**Mësime dhënë kërkuesve në prani të një anëtari:** Numri i përgjithshëm i mësimeve që u janë dhënë të gjithë kërkuesve në praninë e një anëtari. Një mësime zakonisht përfshin diskutimin e një ose më shumë parimeve të ungjillit nga mësimet misionare, një lutje të hapjes dhe të

mbylljes dhe ftesa për të marrë zotime. Nuk është e nevojshme të diskutohen të gjitha parimet e një mësimi për ta konsideruar atë një mësım të plotë. Efektiviteti i mësımdhënies tuaj mund të matet nga ajo nëse kërkuesit po rriten në besimin e tyre te Shpëtimtari, po pendohen për shkeljet e tyre dhe nëse po përgatiten me zell për të marrë ordinancat e pagëzimit dhe konfirmimit.

**Të tjera mësime të dhëna:** Numri i përgjithshëm i mësimeve që u janë dhënë kërkuesve pa praninë e një anëtari.

**Kërkues në përparim:** Numri i përgjithshëm i kërkuesve që kanë marrë dy ose më shumë mësime dhe janë duke mbajtur zotime të tilla si: të lexojnë nga Libri i Mormonit, të marrin pjesë në kishë dhe të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim. Kërkuesit që kanë dëshirë të vazhdojnë të mësojnë rreth ungjillit, por që e kanë të vështirë të mbajnë zotimet, sipas përkufizimit të mësipërm, nuk janë kërkues në përparim. Ata klasifikohen ose si kërkues të rinj ose si kërkues të tjerë.

**Rekomandime të marra dhe të kontaktuara:** Numri i përgjithshëm i rekomandimeve që keni kontaktuar dhe (ose) me të cilët keni zhvilluar një mësım, ose keni lënë orar për t'i vizituar përsëri. Pasi të kontaktoni një të rekomanduar, i rekomanduari zhvendoset nga grupi i rekomandimeve dhe ose bëhet një kërkues i ri, ose shënohet për ndjekje të mëtejshme, ose hiqet fare nga lista. Një rekomandim konsiderohet gjithashtu i kontaktuar në qoftë se mbas shumë përpjekjesh ju nuk mund ta takoni personin ose zbuloni se adresa nuk është e saktë. Këto rekomandime i kthehen zyrës së misionit me një shënim që tregon pse nuk ishte e mundur të kontaktoheshin.

Totali i rekomandimeve të marra i referohet të gjitha rekomandimeve të marra që ende nuk janë kontaktuar (rekomandime nga anëtarë, kërkues, selia qendrore e Kishës etj.).

Për qëllime raportimi, numri i rekomandimeve që nuk janë kontaktuar ende, kalon nga java në javë. Çdo rekomandim i ri i shtohet këtij numri dhe çdo rekomandim i kontaktuar i zbritet këtij numri. Megjithatë, mbani mend se termi "rekomandime të kontaktuara" i referohet numrit të kontaktuar gjatë javës për të cilën po raportohet.

**Kërkues të rinj:** Numri i përgjithshëm i individëve që kanë marrë një mësım dhe kanë pranuar që ju t'i vizitoni përsëri.

**Mësime dhënë të porsakthyerve në besım dhe anëtarëve më pak aktivë:** Numri i përgjithshëm i mësimeve që u janë dhënë të kthyerve në besım të cilët kanë më pak se një vit që janë bërë anëtarë dhe anëtarëve më pak aktivë.

Ndërsa vendosni qëllime dhe bëni plane, vlerësoni çfarë bëni për sa i përket asaj se në ç'mënyrë përpjekjet tuaja do të shtojnë numrin e njerëzve të përfaqësuar nën secilin nga këta tregues kyç. Qëllimi juaj duhet të jetë që të keni shifra të larta për secilin nga treguesit kyç.

Ju do të bëni shumë gjëra që nuk janë përshkruar në treguesit kyç, si kontaktet në rrugë ose studim individual dhe studim me shokun. Këto aktivitete të rëndësishme kontribuojnë në një ose më shumë nga treguesit kyç. Për shembull, kur mësoni ata që i gjeni me anë të përpjekjeve tuaja, ju i shtoni kërkues të rinj grupit të kërkuesve që po mësoni. Gjithashtu, cilësia e studimit tuaj individual dhe me shokun do të përmirësojë aftësinë tuaj për të mësuar me anë të Shpirtit, gjë që do të bekojë kërkuesit tuaj të rinj dhe ata në përparim. Fuqia për të gjetur kërkues dhe për t'i mësuar ata do të ndikojë në çdo tregues kyç. Vlerësoni gjithçka që bëni duke u bazuar mbi atë nëse ajo që bëni e shton numrin e njerëzve në këto kategori. Në qoftë se ju dhe shoku/shoqja juaj nuk mund të kuptoni se si një aktivitet predikimi mund të ndihmojë në rritjen e numrit të njerëzve nën njërin ose më shumë prej treguesve kyç, duhet të vendosni nëse ja vlen të harxhoni kohë për këtë aktivitet.

## Shënime


**Aktivitet: Studim me Shokun**

Në ditarin tuaj të studimit, rendisni çdo aktivitet predikimi që keni bërë gjatë tre ditëve të fundit. Për çdo aktivitet, vendosni nëse ai ka ndikuar në ndonjë nga treguesit kyç. Nëse ka ndikuar, shkruani *po* pranë tij. Në qoftë se nuk ka ndikuar, shkruani *jo*. Për çdo aktivitet pranë të cilit keni shënuar një *po*, përshkruani si ndikoi ai. Për çdo aktivitet pranë të cilit keni shënuar një *jo*, vendosni pse e bëtë atë dhe nëse do të vazhdoni ta bëni në të ardhmen. Diskutoni listën tuaj me shokun/shoqen dhe shpjegoni pse i shënuat disa aktivitete me *po* dhe disa aktivitete me *jo*. Diskutoni se cilat aktivitete mund t'ju duhet t'i ndërprisni.

**Libri i Territorit dhe Materialet e Planifikimit dhe Raportimit**

Në lidhje me ata që u bashkuan me Kishën me anë të pagëzimit dhe konfirmimit në kohën e tij, Moroni mësoi: “Emrat e tyre u morën kështu që ata të mund të kujtoheshin dhe të ushqeheshin nga fjala e mirë e Perëndisë, për t’i mbajtur në udhën e drejtë” (Moroni 6:4).

Juve ju janë dhënë materialet për t’ju ndihmuar të shënoni informacione të rëndësishme rreth njerëzve që u jepni mësim. Këto materiale gjithashtu ju lejojnë të ndani sasinë e duhur të informacionit me ata të cilëve u nevojitet, siç tregohet në ilustrimin e mëposhtëm.



Këto mjete dhe i gjithë informacioni i nevojshëm për të kryer punën tuaj duhen mbajtur në librin e territorit dhe në Planifikuesin Ditor të Misionarit. Libri i territorit është organizuar si më poshtë:

- **Harta e Territorit**
  - Harta e territorit me një skicë të kufijve.
- **Dokumentet e Përparimit**
  - Formularët e Dokumentit të Përparimit
- **Kërkues që kanë një Datë Pagëzimi dhe Konfirmimi**
  - Formularët e Dokumentit të Mësimdhënies
- **Kërkues në Përparim**
  - Formularët e Dokumentit të Mësimdhënies
- **Kërkues të Rinj dhe Kërkues të Tjerë**
  - Formularët e Dokumentit të Mësimdhënies
- **Kërkues të Mundshëm**
  - Formularët për Kërkues të Mundshëm
  - Rekomandime nga media dhe dokumente rekomandimesh të tjera

- **Kërkues të Mëparshëm**
  - Formularët e Dokumentit të Mësimdhënies
- **Të Porsakthyer në Besim dhe Anëtarë më Pak Aktivë**
  - Formularët e Dokumentit të Mësimdhënies
  - Formularët e Listës së Veprimit me të Kthyerit në Besim
- **Informacion mbi Lagjen dhe Misionin**
  - Direktoria e Lagjes
  - Lista e thirrjeve në lagje
  - Plani i mbledhjeve të lagjes dhe të misionit
  - Lista e familjeve pjesërisht anëtare
  - Direktoria e misionarëve në zonën ose distriktin tuaj
- **Udhëheqja**
  - Raportet Përmbledhëse
- **Informacion rreth Territorit**
  - Informacion rreth apartamentit (të misionarëve)
  - Transporti publik
  - Rrojtoria
  - Lavanderia
  - Vendet për pazar
  - Vendet që duhen shmangur
  - Kontaktet

### Libri i Territorit

Çdo territor predikimi ka një libër territori, i cili kthehet në një dokument të përhershëm të përpjekjeve tuaja të përditshme. Azhurnoni informacionet e rëndësishme çdo ditë dhe referojuni atij çdo javë gjatë sesionit të planifikimit javor. Mbajeni atë pastër, me të dhënat e fundit dhe të saktë, në mënyrë që misionari që do të vijë pas jush në të ardhmen të mund të mbështetet mbi shërbimin e frymëzuar që ju keni dhënë. Kur t'ju kërkohet, merreni me vete librin e territorit në intervistat ose konferencat e zonës, ku udhëheqësit e misionit mund ta rishikojnë atë dhe t'ju ndihmojnë si ta përdorni më me efektivitet.

Ju duhet t'i referoheni çdo ditë disa pjesëve të librit të territorit, ndërsa rishikoni dhe ndryshoni planet tuaja. Kur t'ju kërkohet, merreni librin e territorit në konferencat e zonës dhe në intervistat në mënyrë që udhëheqësit e misionit të mund ta rishikojnë atë. Ky libër duhet të mbetet në apartamentin tuaj pasi të transferoheni kështu që misionarët e ardhshëm të mund të përdorin informacionin që ai përmban.

Në librin e territorit, mbani dokumente të sakta, të plota dhe të azhurnuara për të gjithë njerëzit me të cilët punoni. Më poshtë gjendet një shpjegim i këtyre mjeteve.

Shënime

Shënime

**Dokumenti i Mësimdhënies:** Ky formular ju ndihmon të regjistroni informacion të detajuar në lidhje me përparimin e kërkuesve, të porsakthyerve në besim dhe anëtarëve më pak aktivë që po mësoni.

- Informacion personal.
- Datat e pagëzimit dhe të konfirmimit.

**Dokument i Mësimdhënies**

KISHA E  
**JEZU KRISHTIT**  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

Teritori i predikimit \_\_\_\_\_ Lagja ose dega \_\_\_\_\_ Kurji ose distrikti \_\_\_\_\_

**Informacion Personal** (Shihni anën e pasme për informacion të mëtejshëm personal.)

Emri(ati) i (e) personit ose çiftit \_\_\_\_\_ \*Lloji \_\_\_\_\_ Moshë \_\_\_\_\_ Data e kontaktit të parë \_\_\_\_\_ Data e planifikuar e pagëzimit \_\_\_\_\_ Data aktuale e pagëzimit \_\_\_\_\_ Data e konfirmimit \_\_\_\_\_ Emrat e fëmijëve (Emra të tjerë mund të shkruhen në seksionin Informacion i Përgjithshëm që gjendet në anën e pasme.) \_\_\_\_\_ Moshë \_\_\_\_\_ Moshë \_\_\_\_\_ Moshë \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_ Numri i telefonit \_\_\_\_\_ Misionarët që filluan të jepnin mësimet \_\_\_\_\_

Emrat e shoqëruesve dhe të mësuesve të shtëpisë ose të mësuesveve të vizitave \_\_\_\_\_ Numri i telefonit \_\_\_\_\_ Adresa \_\_\_\_\_

\*Lloji: K = Kërkues; PK = I Porsakthyer në Besim; AMA = Anëtar Më Pak Aktiv; A = Anëtar; FPA = Familje Pjesërisht Anëtare

Data e Dhënies së Mësimeve dhe Parimeve (qarkoni me rreth në qoftë se mësimi është zhvilluar në pranishmëri të një anëtar.)		Urdhërimet		Gjendja e Zotimeve ose Aktiviteve për Kërkuesin ose Kryetarin e Familjes	
Mesazhi i Rivendosjes	Përpara / Pas Pagëzimit / Pagëzimit	Përpara / Pas Pagëzimit / Pagëzimit	Përpara / Pas Pagëzimit / Pagëzimit	Fuar të zotohet	Mban zotimin
Periudha Eshë Aji Yhe i Dashur Qafiler		Bindja			Të lexojë nga Libri i Mormonit
Ungjilli bekon familjet		Lutuni shpesh			Të lutet rreth Jozef Smithit dhe Librit të Mormonit
Periudhat Ungjillillore		Studioni shkrimet e shenja			Të frekuentojë mbledhjet e sakramentit dhe mbledhjet e tjera
Shërbesa tokësore e Shpëtimtarit		Mbani të shenjtë ditën e Shaballit			Fëmijët të frekuentojnë Filloren, të Rinjtë, ose të Rejat
Braktisja e Madhe		Pagëzimi dhe konfirmimi			Të prezantojë anëtarët e familjes dhe shokët me misionarët
Rivendosja: Jozef Smithi		Ndiqni profetin			Të frekuentojë një shërbesë pagëzimi
Libri i Mormonit		Zbatoni Dhjetë Urdhërimet			Të lexojë peshkopin dhe anëtarët e kështjillit të lagjes
Lutja, Fryma e Shenjtë		Jepni ligjin e dëllrësise			Të mësohet me anëtarët e lagjes
<b>Plani i Shpëtimt</b>		Binduni Fjalës së Urtesisë			Të zbatojë Dhjetë Urdhërimet
Jeta Paratokësore		Zbatoni Ligjin e së dhjetës			Të jetojë ligjin e dëllrësise
Krijimi		Zbatoni Ligjin e Agjërimt			Të jetojë Fjalën e Urtesisë
E Drejta për të Zgjedhur dhe Rënia		Si të dhuron të dhjetën dhe ofertat e agjërimt			Të jetojë ligjin e së dhjetës
Jeta jonë në tokë		Binduni dhe nderoni ligjin			Të jetojë ligjin e agjërimt
Shlyerja		<b>Ligjet e Ordinanct</b>			T'u bindet ligjeve të vendit
Bota e Shpirtitave		Priftëria dhe organizatat ndihmëse			Të intervistohet për pagëzimin dhe konfirmimin
Ringjallja, gjykimi dhe pavarësia		Puna misionare			Të ftojë shokët dhe familjen të marrin pjesë në pagëzimin dhe konfirmimin e tij/saj
Mortëritë e lavdisë		Martesa e pejetshme			Të pagëzohet dhe konfirmohet
<b>Ungjilli i Jezut Krishtit</b>		Tempujt dhe historia familjare			Të lutet dhe të studiojë çdo ditë shkrimet e shenja
Të pasruar nga mëdaji		Sherbimi			Të zhvillojë çdo ditë lutje familjare dhe studim të shkrimeve të shenja
Besim në Jezut Krisht		Mësimdhënia dhe të mësuarit			Të zhvillojë çdo javë mbledhje familjare të shtëpisë
Pendimi		Durimi deri në fund			Të marrë priftërinë
Pagëzimi, besëdhija jonë e parë		<b>Rishikoni Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit</b>			Të pranojë një thirrje në Kishë
Dhurata e Frymës së Shenjtë					Të marrë pjesë si mëkëmbës në pagëzimet për të vdekurit
Durimi deri në fund.					

(Shih anën e pasme për informacion personal të mëtejshëm)

© 2004 Fil. 704, 704, Prekë in Germany, 30587 101

(Përpara)

- Një dokument që tregon se kur e zhvilluat mësimin e parimeve nga secili prej pesë mësimeve dhe nëse një anëtar ishte i pranishëm. Ky seksion jua bën më të lehtë të ndiqni vazhden e mësimeve të zhvilluara, pavarësisht nga radha sipas të cilës keni zhvilluar mësimin e parimeve.
- Këtu ju mund të mbani shënim mësimit e zhvilluar përpara pagëzimit dhe mësimit e zhvilluar pas pagëzimit.
- Një dokument që tregon gjendjen e zotimeve që duhet të mbajnë kërkuesit. Në këtë seksion ju shkruani datën që bëtë ftesën dhe përkrah saj shënoni nëse ata janë të rregullt në mbajtjen e zotimeve.











Çdo ditë ndërsa planifikoni dhe predikoni, ju do ta përdorni planin ditor siç ilustronet më poshtë:

- Një plan ditor ku mund të shënoni takime mësimi, mbledhje dhe aktivitete për të gjetur kërkues. Planifikoni në mënyrë të tillë që të keni aktivitete kuptimplote për çdo orë të ditës. Gjithashtu është lënë vend për plane rezervë.
- Vend bosh për të renditur detyrat që duhet të kryeni (telefonata, kontakte me njerëzit, përgatitje për mësimet, ndjekje të ecurisë së zotimeve etj.).

- Vend bosh për të shkruar se çfarë do të studioni gjatë përgatitjes për takimet e mësimdhënies.
- Qëllimet ditore dhe rezultatet e arritura për ata tregues kyç që janë zgjedhur.

**Raportimi Javor i Misionarit:** Ky raportim ju jep mundësinë për t'i raportuar drejtpërsëdrejti presidentit të misionit mbi përpjekjet tuaja predikuese dhe rreth ndonjë çështjeje personale që do të donit ta ndanit me të. Kur shkruani këtë letër, jini specifikë dhe të përpiktë, por mos mendoni se duhet ta mbushni të gjithë hapësirën. Ai është i vetmi person që do ta lexojë këtë letër, kështu që ndihuni të lirë të tregoheni të hapur në komentet tuaja.

## Si të Vendosni Qëllime

Qëllimet pasqyrojnë dëshirat e zemrave tona dhe vizionin tonë për ato që mund të arrijmë. Nëpërmjet qëllimeve dhe planeve, shpresat tona shndërrohen në veprime.

Vendosja e qëllimeve dhe planifikimi janë vepra të besimit. Me anë të lutjes vendosni qëllime që janë në harmoni me urdhërimin e Shpëtimtarit: “bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë” (Mateu 28:19).

Vendosni qëllime për çdo tregues kyç. Ju gjithashtu mund të vendosni qëllime për zhvillimin tuaj personal. Bëni gjithçka brenda fuqisë tuaj për të arritur qëllimet tuaja ndërsa respektoni lirinë e zgjedhjes së të tjerëve. Masa përfundimtare e suksesit nuk është vetëm në arritjen e qëllimeve, por në shërbimin që jepni dhe përparimin e të tjerëve. Qëllimet janë një mënyrë për t’ju ndihmuar të sillni shumë të mira midis fëmijëve të Atit Qiellor. Ato nuk duhet të përdoren për të marrë lavdërime.

Qëllimet e shqyrtuara me kujdes do t’ju japin një orientim të qartë dhe do t’ju ndihmojnë të mbushni ditët tuaja me

aktivitete që i ndihmojnë njerëzit të forcojnë besimin e tyre te Shpëtimtari dhe të përparojnë drejt pagëzimit, konfirmimit dhe aktivitetit të plotë në Kishë. Qëllimet sfiduese do t’ju ndihmojnë të punoni me efektivitet dhe do t’ju bëjnë të përpiqeni më shumë e të rriteni. Ndiqni udhëzimet e mëposhtme ndërsa vendosni qëllime:

- Ndiqni Shpirtin.
- Përqendrohuni tek treguesit kyç.
- Përqendrohuni tek njerëzit. Edhe pse do të përdorni statistika, mundohuni t’i mbështesni numrat me emrat e njerëzve kur është e mundur.
- Jini specifike dhe realistë, por vendosni qëllime që do t’ju bëjnë të përpiqeni më shumë.
- Vendosni qëllime javore dhe ditore.
- Vendosni qëllime për studimin individual dhe me shokun, duke përfshirë studimin e gjuhës në qoftë se po mësoni një gjuhë të huaj.
- Matni përparimin tuaj çdo ditë, çdo javë dhe mbas çdo periudhe gjashtë javore. Kur dështoni në plotësimin e një qëllimi, vlerësoni përpjekjet tuaja dhe kërkoni mënyra për ta përmbushur qëllimin. Në qoftë se është e nevojshme, rishikoni edhe një herë kërkesat që keni nga vetja.

Me kalimin e kohës presidenti i misionit mund të vendosë standarde përsosmërie ose qëllime për misionin që synojnë të rrisin vizionin dhe besimin tuaj. Standardet e distriktit, zonës dhe misionit do t’ju ndihmojnë të përpiqeni më shumë, të punoni efektivisht dhe të arrini nivele të larta në punën tuaj. Ato nuk duhet të përdoren si kuota që imponojnë qëllime specifike mbi ju dhe shokun/shoqen tuaj.

*“Unë jam plotësisht i bindur se në qoftë se ne nuk vendosim qëllime në jetën tonë dhe nuk mësojmë si të përvetësojmë teknikat e të jetuarit për të arritur qëllimet tona, mund të arrijmë në një moshë të vjetër dhe të hedhim vështrimin pas në jetën tonë vetëm për të parë se kemi arritur vetëm një pjesë të vogël të potencialit tonë të plotë.*

*Kur një njeri mëson të përvetësojë parimet e vendosjes së qëllimeve, atëherë ai do të jetë në gjendje ta pasqyrojë atë ndryshim në rezultatet që arrin në jetë.”*

—PLAKU M. RASËLL BALLARD  
BISEDË DREJTUAR TË RINJVE TË RRITUR NË ZONËN E  
SALT LEJKUT, 18 TETOR 1981

**Aktivitet: Studim me Shokun**

Vendosni qëllime javore për çdo tregues. Për secilin nga qëllimet pyesni veten:

- A shoqërohen emrat me numrin e vendosur si qëllim?
- Është qëllimi specifik?
- Është qëllimi realist?
- A do të na ndihmojë ky qëllim të përpiqemi më shumë?
- A jemi të vendosur ta përmbushim këtë qëllim?

Diskutoni për secilin qëllim. Në qoftë se është e nevojshme, vendosni se si mund ta ndryshoni atë dhe pse.

**Sesioni i Planifikimit Javor**

Pasi t'i keni vendosur qëllimet, vendosni se si do t'i plotësoni ato. Ju dhe shoku/shoqja juaj duhet të zhvilloni një sesion planifikimi javor në një ditë dhe në një orë që është më pak produktive për predikim, si të enjten ose të premten në mëngjes. Presidenti i misionit do të caktojë ditën dhe orën për sesionin e planifikimit javor. Ky planifikim javor mund të kërkojë dy deri në tre orë për t'u përfunduar.

Diskutimi juaj duhet të përqendrohet mbi nevojat e njerëzve dhe si t'i ndihmoni ata të përparojnë. Gjatë këtij sesioni të planifikimit javor, rishikoni qëllimet e kaluara dhe vendosni qëllime të reja për javën që vjen. Mendoni rreth çdo aspekti të predikimit tuaj.

E diela në darkë është koha që rekomandohet për telefonatat e raportimit javor. Raportimi të dielën mbrëma pasqyron gjendjen më të saktë të misionit dhe në kohën më të përshtatshme, sepse shumica e pagëzimeve dhe konfirmimeve bëhen të shtunën ose të dielën.

Duke qenë se dita kur zhvilloni sesionin e planifikimi javor ka të ngjarë të mos jetë e njëjtë me ditën e raportimit, bëjeni planifikimin tuaj javor duke mbajtur mend se po planifikoni për 10 ditë. Për shembull, në qoftë se sesioni i planifikimit javor është të enjten, ju do të rishikoni përparimin e qëllimeve tuaja për javën deri në atë ditë (të enjten) dhe do të planifikoni se çfarë duhet të bëni për t'i arritur këto qëllime deri të dielën. Pastaj, vendosni qëllime dhe bëni plane për javën tjetër nga e hëna në të dielë. Të dielën në darkë do të nxirrni totalin dhe do të raportoni rezultatet e javës së kaluar dhe kështu do ta keni gati planin tuaj për javën që vjen. Më poshtë jepet një përshkrim se si udhëzimet e planifikimit zbatohen gjatë një sesioni planifikimi javor.

**1. Lutuni dhe kërkoni frymëzim.** Përpara se të filloni, mbani pranë vetes Planifikuesin Ditor të Misionarit dhe librin e territorit. Fillojeni sesionin e planifikimit me lutje. Kërkoni frymëzim ndërsa diskutoni për nevojat e njerëzve dhe planifikoni si t'u shërbeni dhe t'i ndihmoni ata të përparojnë në ungjill. Lutuni veçanërisht për kërkuesit tuaj. Kini besim t'i kërkoni Atit Qiellor t'i bekojë ata me përgjigje për pyetjet e tyre, me dëshirën për të shkuar në kishë etj.

**2. Vendosni qëllime dhe planifikoni për kërkuesit, që të pagëzohen dhe të konfirmohen javën e ardhshme.** Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo person që është zotuar për t'u pagëzuar dhe konfirmuar javën që vjen. Diskutoni planet që duhet të bëni për intervistat e pagëzimit, shërbesat e pagëzimit dhe konfirmimet. Duke përdorur Dokumentin e Mësimdhënies, diskutoni ndonjë zotim me të cilin këta njerëz po hasin vështirësi dhe se si ju mund t'i ndihmoni ata. Planifikoni të keni kontakte të përditshme me ta. Diskutoni se si mund ta ndihmoni udhëheqësin e misionit të lagjes të koordinojë me peshkopin për konfirmimin e tyre në mbledhjen e sakramentit.

**3. Vendosni qëllime dhe planifikoni për kërkuesit që kanë një datë pagëzimi.** Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo person që do të pagëzohet në javët që vijnë. Flisni rreth mësimëve që duhet t'u mësoni atyre. Mendoni se si mund t'i ndihmoni ata të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim. Diskutoni për kërkuesit që nuk u pagëzuan në ditën e caktuar. Shqyrtoni me kujdes dhe diskutoni për nevojat e tyre. Vendosni qëllime të reja dhe bëni plane që do t'i ndihmojnë ata të përparojnë drejt një dite dhe kohe të caktuar, kur ata mund të hyjnë në besëlidhjen e pagëzimit dhe të marrin ordinancën e konfirmimit. Në Dokumentin e Mësimdhënies shënoni me laps parimet që planifikoni t'u mësoni dhe zotimet që do t'i ndihmoni të mbajnë. Vendosni se çfarë mund të bëni për t'i ndihmuar ata të marrin këto mësimë dhe të mbajnë këto zotime.

**4. Vendosni qëllime dhe planifikoni për të ndihmuar kërkuesit të frekuentojnë mbledhjen e sakramentit.**

Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo kërkues dhe diskutoni rreth pjesëmarrjes së tij/saj në mbledhjen e sakramentit. Për kërkuesit që marrin pjesë rregullisht në mbledhjen e sakramentit, diskutoni se çfarë duhet të bëni për t'i ndihmuar ata të vazhdojnë të kenë një përvojë shpirtërore lartësuese. Për ata që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në mbledhjen e sakramentit, ata që kanë marrë pjesë vetëm një herë, ose ata që marrin pjesë me hope, diskutoni se çfarë mund t'i pengojë ata që të vijnë. Për shembull, ata mund të kenë nevojë për ndihmë në lidhje me transportin, mund të kenë frikë ose nuk janë mësuar me mbledhjet e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme, ose mund të kenë patur një përvojë negative në të kaluarën. Diskutoni se çfarë mund të bëni për t'i ndihmuar ata të kalojnë këto pengesa. Vendosni qëllime për numrin e kërkuesve që ju planifikoni të keni në mbledhjen e ardhshme të sakramentit. Planifikoni kush do t'i sjellë këta njerëz në kishë, kush do t'i mirëpresë dhe kush do të ulet me ta gjatë mbledhjeve. Planifikoni të kontaktoni me udhëheqësit e kuorumit dhe të organizatave ndihmëse dhe ndonjë mësues përgjegjës për klasat ku do marrin pjesë kërkuesit. Planifikoni të informoni peshkopin. Në Dokumentin e Përparimit, renditni mënyrat si mund t'ju ndihmojë këshilli i lagjes. Bëni plane se çfarë duhet të bëni çdo ditë të javës për t'i përgatitur këta njerëz të marrin pjesë në mbledhjen e sakramentit.



**5. Vendosni qëllime dhe planifikoni mësimet që do t'u jepen kërkuesve në përparim.** Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo kërkues në përparim që i janë dhënë mësimë në praninë e një anëtari. Diskutoni se si po e pranojnë ata mesazhin sipas mendimit tuaj. Rishikoni zotimet dhe ngjarjet nga Dokumenti i Mësimdhënies që ata po përpiqen t'i mbajnë ose t'i plotësojnë. Diskutoni si t'i ndihmoni anëtarët e lagjes dhe këshillin e lagjes të vazhdojnë të përfshihen në përparimin e tyre. Vendosni qëllime për mësimet që do të jepni; zotimet që do t'i ndihmoni të mbajnë, veçanërisht pjesëmarrjen në kishë; dhe përvoja të rëndësishme që do t'i ndihmoni të kenë në javët e ardhshme.

Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo kërkues në përparim, që ka marrë mësimë pa praninë e një anëtari. Këta kërkues mund të jenë njerëz që ju i keni gjetur me anë të përpjekjeve tuaja. Diskutoni se cili udhëheqës priftërie apo udhëheqës i organizatave ndihmëse mund të ftohet për t'i shoqëruar ata. Rishikoni mësimet që do t'u mësoni dhe zotimet që ju do t'i ndihmoni të mbajnë. Vendosni qëllime për mësimet që do t'u mësoni,



si do t'i përfshini anëtarët, dhe si do t'i ndihmoni këta kërkues të marrin pjesë në mbledhjen e sakramentit. Shkruajini këto qëllime në Dokumentin e Mësimdhënies dhe bëni planet e nevojshme.

**6. Vendosni qëllime dhe planifikoni mësimet që do t'u jepen të gjithë kërkuesve të tjerë.** Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për çdo kërkues që nuk po përparon. Diskutoni pse secili nga këta kërkues nuk po i mban zotimet. Diskutoni si do t'i përfshini udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse në shoqërimin e këtyre kërkuesve. Diskutoni shumë nga të njëjtat çështje të sugjeruara në pikën 5. Vendosni qëllime dhe bëni plane për t'i ndihmuar këta njerëz të përparojnë. Shkruajini këto qëllime në Dokumentin e Mësimdhënies.

**7. Vendosni qëllime dhe planifikoni për të kontaktuar dhe për të mësuar njerëzit që ju janë rekomanduar nga anëtarët, kërkuesit, joanëtarët dhe selia qendrore e Kishës.** Rishikoni formularët e Kërkuesve të Mundshëm. Rishikoni të gjitha rekomandimet që keni marrë. Rishikoni të gjitha rekomandimet që nuk i keni kontaktuar ende. Vendosni qëllime dhe bëni plane për të kontaktuar sa më shumë rekomandime të jetë e mundur gjatë javës—mirë do të ishte të kontaktohenin të gjitha rekomandimet. Rekomandimet nga selia qendrore e Kishës duhet të kontaktohen brenda 24 orëve, në qoftë se është e mundur. Diskutoni si mund t'i prezantoheni secilit prej këtyre personave ose familjeve dhe se çfarë mesazhi mund t'i mësoni. Në qoftë se rekomandimi është nga selia qendrore e Kishës, diskutoni si mund t'u mësoni një mesazh nga ungjilli duke përdorur video, libër, ose një material tjetër që ata kanë kërkuar. Sigurohuni që të keni materialin që ata kanë kërkuar. Nëse është e përshtatshme, kontaktoni me të rekomanduarin me telefon dhe planifikoni një takim. Diskutoni çfarë duhet të bëni për të ndjekur ecurinë.

**8. Vendosni qëllime dhe planifikoni për të kërkuar më shumë rekomandime nga anëtarët, kërkuesit dhe joanëtarët.** Me lutje identifikoni anëtarë dhe kërkues të tjerë që mund të vizitoni. Planifikoni si mund t'i ndihmoni ata të ftojnë shokët dhe anëtarët e familjeve të tyre të mësojnë rreth ungjillit të rivendosur. Diskutoni si mund t'i ftoni ata të marrin pjesë në punën misionare. Programoni takime dhe bëni planet e nevojshme.

**9. Vendosni qëllime dhe planifikoni për mësimet e dhëna të porsakthyerve në besim dhe anëtarëve më pak aktivë.** Rishikoni Dokumentin e Mësimdhënies për secilin të porsakthyer në besim dhe anëtar më pak aktiv që po mësoni. Vendosni qëllime dhe bëni plane për mësimet që do t'u mësoni. Vendosni si do t'i ndihmoni këta njerëz të marrin pjesë në mbledhjen e sakramentit dhe të mbajnë zotimet e tjera.

**10. Vendosni qëllime dhe planifikoni për të gjetur kërkues të rinj.** Rishikoni përpjekjet e javës së kaluar për të gjetur kërkues të rinj nëpërmjet rekomandimeve, mundësive të krijuara nga shërbimi dhe aktivitetet që ju bëni për të gjetur kërkues. Referojuni informacionit në seksionin "Kërkues të Mundshëm" në librin e territorit. Diskutoni pse disa njerëz u bënë kërkues të rinj dhe disa të tjerë jo. Vendosni qëllime se sa kërkues të rinj do të gjeni këtë javë. Identifikoni njerëz që mund të bëhen kërkues. Gjithashtu identifikoni anëtarë dhe familje që janë pjesërisht anëtarë të kishës që ju doni t'i vizitoni, rekomandime që do të vizitoni si dhe mundësi shërbimi që do të kërkoni. Planifikoni se cilat materiale do të përdorni për të gjetur kërkues, të tilla si karta porosie për materiale falas nga kisha, videokaseta, DVD, shkrime të shenjta, ose broshura. Gjithashtu diskutoni se ku do të shkoni të kontaktoni njerëz, sa njerëz do të kontaktoni çdo ditë, kërkues që do t'iu kërkoni rekomandime, kërkues të mëparshëm që do të vizitoni, mënyra se si këshilli i lagjes mund t'ju ndihmojë etj. Bëni plane specifike për të nesërmen. Mbusheni gjithë kohën e mbetur me aktivitete gjetëse që do t'ju ndihmojnë të arrini qëllimet tuaja. Vendosni qëllime dhe

planifikoni të flisni me sa më shumë njerëz që Zoti vendos në udhën tuaj. Gjithmonë përpquni të gjeni njerëz për të mësuar.

**11. Planifikoni se si të punoni me këshillin e lagjes.** Peshkopi është autoriteti kryesues. Respektoni dhe nderoni autoritetin e tij. Nën drejtimin e tij, rishikoni Dokumentin e Përparimit të përdorur në mbledhjen e mëparshme të bashkërendimit misionar ose të këshillit të lagjes. Diskutoni detyrat që keni marrë nga peshkopi ose udhëheqësi i misionit të lagjes dhe raportoni nëse i keni plotësuar ato. Diskutoni si mund të përfshini të tjerë që mund t'ju ndihmojnë, si udhëheqësi i misionit të lagjes, udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse dhe anëtarë të tjerë. Përgatisni me kujdes një Dokument Përparimi për mbledhjen e ardhshme të këshillit të lagjes, mbledhjen e komitetit ekzekutiv të priftërisë, ose mbledhjen e bashkërendimit misionar. Sigurohuni që ky dokument të shkruhet qartë dhe pastër. Vendosni qëllime dhe planifikoni që të punoni në harmoni me udhëheqësit e lagjes. Kur është e mundur, bëni kopje të Dokumentit të Përparimit për udhëheqësit e lagjes që do të marrin pjesë në mbledhje.

**12. Planifikoni takime që zhvillohen rregullisht.** Në Planifikuesin Ditor të Misionarit, programoni takime që ndodhin rregullisht, si mbledhjet e distriktit, konferencat e zonës, intervistat dhe mbledhjet e Kishës. Diskutoni detyrat që duhet të plotësoni përpara ndonjëres prej këtyre mbledhjeve dhe i shtoni ato në pjesën Shënime/Lista e Gjërave që Duhet Bërë.

**13. Bëni vlerësimin e marrëdhënieve me shokun.** Në fund të sesionit të planifikimit javor, ndani me shokun tuaj qëllime të përshtatshme dhe kërkoni ndihmën e tij/saj për t'i plotësuar ato. Diskutoni rreth forcës së marrëdhënies tuaj me shokun/shoqen. Diskutoni ndonjë sfidë që mund t'ju pengojë të punoni së bashku në unitet ose të jeni të bindur. Zgjidhni konfliktet. Ndani me shokun/shoqen tuaj cilat mendoni ju se janë pikat e forta të tij/saj. Kërkoni këshilla se si mund të përmirësoheni. Në qoftë se është e nevojshme vendosni qëllime që do të përmirësojnë marrëdhënien tuaj. Përfundoni me lutje.

### Sesioni i Planifikimit Ditor

Zhvilloni një sesion planifikimi në fund të çdo dite. Nëse jeni duke dhënë një mësim, mund të rrini jashtë deri në orën 21:30. Përndryshe, kthehuni në apartamentin tuaj në orën 21:00 dhe zhvilloni një sesion planifikimi ditor nga ora 21:00 deri në orën 21:30. (Presidentët e misionit janë të lirë ta përshtasin orarin sipas rrethanave lokale.) Zbatoni të njëjtat parime dhe udhëzime gjatë sesionit të planifikimit ditor që ndiqni gjatë sesionit javor, por në një mënyrë më të thjeshtuar. Lutuni ndërsa diskutoni mësimet ose temat që mund të studioni gjatë kohës së studimit tuaj individual ose me shokun që do t'ju ndihmojnë në planet tuaja. Shkruajini këto tema në vendin bosh që ndodhet në programin ditor. Rishikoni programin tuaj ditor. Planifikoni një aktivitet kuptimplotë për çdo orë të ditës. Gjatë sesionit të planifikimit të së dielës mbrëma, bëni totalin dhe paraqisni Raportin Përmbledhës javor, shkruajini letrën tuaj javore presidentit të misionit dhe vendosni përfundimisht qëllimet tuaja për javën që vjen.

Para se të largoheni nga apartamenti juaj të nesërmen, rishikoni qëllimet, planet dhe programin. Bëni ndryshime në qoftë se është e nevojshme. Gjithmonë lutuni përpara se të largoheni nga apartamenti. Ju mund ta kuptoni sa efektive janë planet tuaja ditore kur nuk ju duhet të pyesni të tjerët: "Po tani, çfarë duhet të bëj?"

## Përgjegjshmëria

Parimi i përgjegjshmërisë është themelor në planin e përjetshëm të Perëndisë. Ne të gjithë do të qëndrojmë para Zotit në gjykimin e fundit dhe do të japim llogari për ato që kemi bërë me mundësitë që Ai na ka dhënë (shih Alma 5:15–19, DeB 137:9). Ka shumë gjëra që mund të mësoni gjatë misionit rreth përgjegjshmërisë që do t'ju ndihmojnë gjatë gjithë jetës suaj. Parimi i përgjegjshmërisë do t'ju bekojë në qoftë se ju:

- E bëni planifikimin dhe vendosjen e qëllimeve tuaja me idenë se do t'i jepni llogari për përpjekjet tuaja udhëheqësve të misionit dhe Zotit nëpërmjet lutjes.
- Ndieni përgjegjësi personale për besimin e shenjtë që Zoti ka tek ju.
- Vendosni qëllime kuptimplote.
- Zgjidhni të merrni vetë iniciativën për t'i dhënë llogari për punën tuaj Zotit dhe udhëheqësve të misionit. Mos prisni t'jua kërkojnë këtë. Mos u kërkonit të tjerëve t'ju pyesin herë pas here për ecurinë tuaj. Kini dëshirën për të dhënë llogari për punën tuaj.
- Pranoni përgjegjësinë e plotë për përpjekjet tuaja. Kurrë mos i bëni me faj të tjerët për situatat e vështira ose mungesën e përparimit.
- Kërkoni të mësoni nga udhëheqësit tuaj dhe i ftoni ata t'ju sugjerojnë mënyra si të përmirësoheni.
- Jini të motivuar të punoni sa më mirë.

Përgjegjshmëria nuk vjen vetëm në fund të misionit tuaj. Ajo është një parim që ndikon si filloni, si mendoni dhe si ndiheni rreth përgjegjësive që ju ka dhënë Zoti, si e realizoni punën tuaj dhe sa të duruar tregoheni. Qëndrimi që ju mbani ndaj përvojës tuaj në mision është një pasqyrim i dashurisë tuaj për Atin tuaj Qiellor e Birin e Tij dhe respektin tuaj për priftërinë.

Ndërsa luteni personalisht dhe me shokun/shoqen, kërkoni frymëzim rreth asaj që duhet të bëni çdo ditë. Ndërsa ndiqni planet tuaja, lutuni dhe kërkoni drejtimin e Zotit. Mbani një lutje në zemër gjatë ditës, që Shpirti t'ju ndihmojë të dini ku të shkoni, çfarë të bëni dhe çfarë të thoni. Pyesni veten: "Çfarë mund të bëj më tepër?" Gjatë lutjes tuaj në fund të ditës, jepni një llogari të punës suaj.

Ju do t'i jepni llogari çdo javë udhëheqësve tuaj të misionit duke përdorur Raportin Përmbledhës. Në qoftë se jeni një udhëheqës misioni, do ta merrni këtë informacion nga misionarët e tjerë. Tregoni interes për jetën e tyre dhe për jetën e atyre që ata mësojnë dhe jo thjesht për numrat. Mos i përdorni këto materiale ose informacione që merrni si mënyra për të kontrolluar ose manipuluar. Informacioni që merrni me anë të këtyre materialeve do t'ju japë mundësi për t'i lavdëruar misionarët për përkushtimin e tyre dhe për të parë mundësi për trajnime të ardhshme.

*"Kur efektshmëria matet,  
efektshmëria përmirësohet.*

*Kur efektshmëria matet  
dhe raportohet, shkalla  
e përmirësimit  
përshejtohet."*

—PLAKU TOMAS S. MONSON  
"THOU ART A TEACHER COME FROM GOD,"  
IMPROVEMENT ERA, DHJETOR 1970, 101

Shënime

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë do të thotë të jesh i përgjegjshëm?

DeB 58:26–33

DeB 101:78

Ezekieli 33:1–6

#### Pse liria e zgjedhjes është e rëndësishme në përgjegjshmëri?

2 Nefi 9:26–29

Helamani 14:30–31

#### Si duhet të punojnë së bashku një misionar dhe një udhëheqës misioni?

DeB 38:23–25

Hebrenjve 13:17–18

### Mbani Mend

- Përqendrojini përpjekjet në qëllimet tuaja.
- Vendosni qëllime sipas treguesve kyç.
- Lutuni fuqishëm rreth qëllimeve dhe planeve tuaja.
- Përdorni librin e territorit dhe Planifikuesin Ditor të Misionarit për t'i ndihmuar njerëzit të zhvillojnë besim, të pendohen, të pagëzohen, të marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe të durojnë deri në fund.
- Për secilin tregues kyç, vendosni qëllime që ju ndihmojnë të përipiqeni më shumë, të ushtroni besim dhe të punoni me efektivitet.
- Zhvilloni sesione planifikimi ditore dhe javore që përqendrohen në ndihmën që duhet t'u jepni të tjerëve që të përparojnë në ungjill.
- Jepini llogari Zotit dhe udhëheqësve të misionit për përpjekjet tuaja.

## Ide për Studim dhe Zbatim

Shënime

### Studim Individual

- Në ditarin e studimit, shkruani një përgjigje me një fjali për secilën nga pyetjet që ndodhen nën seksionin “Mbani Parasysht.”
- Mendoni për disa minuta rreth ditës tuaj të fundit në fushën e misionit. Kur të vijë ajo ditë:
  - Çfarë do të donit të thonit se keni arritur si misionar?
  - Çfarë do të kishit dëshirë të ishit bërë?
  - Çfarë ndryshimesh do të donit që të tjerët të dallonin te ju?

Në ditarin e studimit, shkruani një përgjigje për secilën nga këto pyetje. Vendosni se çfarë duhet të bëni tani për t'i realizuar këto qëllime. Shkruani planet që ju vijnë në mendje.

### Studim me Shokun

- Duke përdorur librin e territorit përgjigjuni pyetjeve më poshtë:
  - A janë të gjitha dokumentet të azhurnuara, të sakta dhe të lehta për t'u lexuar?
  - Një misionar që është i ri në këtë territor, a do të ishte në gjendje që, duke studiuar librin e territorit, të dinte se në ç'fazë të përparimit të tyre shpirtëror ndodhen njerëzit dhe se çfarë duhet bërë më tepër për t'i ndihmuar ata?
  - A do mund të përfitonte një misionar që është i ri në këtë territor nga përpjekjet tuaja për të gjetur kërkues të rinj?
  - Përfytyroni veten duke ia treguar librin e territorit tuaj Zotit ndërsa i jepni llogari Atij se si jeni kujdesur për njerëzit në territorin tuaj. A do të ishte i kënaqur Zoti me përpjekjet tuaja?
- Diskutoni rreth një prej kërkuesve tuaj të rinj. Në Planifikuesin Ditor të Misionarit, gjeni faqen e titulluar “Ngjarjet Që Çojnë Drejt Pagëzimit, Konfirmimit dhe Aktivitetit në Kishë.” Zgjidhni një prej këtyre ngjarjeve dhe bëni një listë të të gjitha atyre që duhet të bëni në mënyrë që të ndodhë kjo ngjarje. Diskutoni se si mund t'i planifikoni këto detyra kështu që kjo ngjarje të mund të ndodhë sa më shpejt të jetë e mundur.
- Diskutoni analogjinë e mëposhtme me shokun/shoqen tuaj. Diskutoni për sa kohë “greqi juaj” është në ujë çdo ditë.

“Asnjë nga ne nuk duhet të jetë si peshkatar që mendon se ka peshkuar gjithë ditën kur në fakt ai e ka harxhuar më të shumtën e kohës rrugës për të shkuar dhe për t'u kthyer nga vendi ku ndodhet uji, duke ngrënë drekë dhe duke u marrë me pajisjet e tij. Peshkimi i suksesshëm ka të bëjë me atë se për sa kohë e keni mbajtur grepin në ujë, jo për sa kohë keni qëndruar jashtë apartamentit. Disa peshkatarë janë larg shtëpisë për dymbëdhjetë orë dhe e kanë grepin në ujë për dhjetë orë. Peshkatarë të tjerë janë larg shtëpisë për dymbëdhjetë orë dhe e kanë grepin në ujë vetëm për dy orë. Këta të tipit të fundit mund të habiten pse ata nuk kanë të njëjtin sukses si të tjerët.

I njëjti parim zbatohet për misionarët, të cilët Mjeshtri i quajti ‘peshkatarë njerëzish.’ Greqi i një misionari duhet të hidhet në ujërat e peshkimit, që në çastin që ai/ajo del nga apartamenti i tij” (Dallin H. Oaks, seminar për presidentët e rinj të misionit, 20 qershor 2000).

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- U lexoni misionarëve njëren nga situatat e mëposhtme. Në grupe të vogla, u kërkoni misionarëve të diskutojnë qëllimet dhe planet që do t'i ndihmonin njerëzit në këta shembuj të përparimit drejt pagëzimit dhe konfirmimit. I kërkoni çdo grupi të ndajë idetë me të tjerët.

## Shënime

*Situata një:* Ju u takuat me Lerin dhe Betin kur ata po shërbenin në një kuzhinë gatimi. Tashmë u keni mësuar atyre një mësim dhe tani ata duan të dinë më shumë. Ata nuk njohin asnjë anëtar të Kishës. Beti është e krishterë dhe Leri nuk i përket ndonjë besimi të veçantë. Ata nuk janë të martuar, por bashkëjetojnë. Leri punon nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Beti punon gjatë ditës.

*Situata dy:* Stivi i ka marrë të gjitha mësimet dhe shkon në kishë të paktën dy herë në muaj. Ai beson se Jozef Smithi është një profet dhe se Libri i Mormonit është i vërtetë. Anëtarët e familjes së tij janë katolikë të devotshëm dhe nuk i miratojnë takimet e tij me misionarët.

*Situata tre:* Xhill është një studente. Ajo ka një shok që është anëtar i Kishës. Shoku i saj anëtar e ftoi të takohet me ju. Ju i keni dhënë asaj dy mësimet. Shoku i saj anëtar ishte i pranishëm në të dy mësimet. Ajo nuk ka ardhur në kishë akoma dhe është aq e zënë me detyrat e shtëpisë sa që e ka të vështirë të lexojë nga Libri i Mormonit.

- I ftoni misionarët të ndajnë përvoja ku, nëpërmjet caktimit të qëllimeve dhe planifikimit, ata/ato kanë mundur të ndihmojnë njerëzit:
  - Të zhvillojnë besim më të madh te Shpëtimtari.
  - Të pendohen dhe të bëjnë ndryshime që i kanë afruar më pranë Perëndisë.
  - Të marrin besëlidhjen e pagëzimit dhe konfirmimit.
  - Të kthehen në Kishë dhe të përtërijnë besëlidhjen e pagëzimit.
- I ndani misionarët në tre grupe. U shpjegoni se çdo grup do të marrë një detyrë të rëndësishme. Pastaj i caktoni secilit grup një nga detyrat e mëposhtme:
  - Të hapin një territor të ri predikimi.
  - Të përgatisin një sesion trajnimi mbi prezantimin e Librit të Mormonit kërkuesve.
  - Të integrojnë në lagje një familje kërkuese që po mëson rreth ungjillit. Familja ka tre fëmijë: një vajzë 8 vjeçe, një vajzë 12 vjeçe dhe një djalë 16 vjeç.

U thoni misionarëve se kanë tetë minuta kohë të hartojnë një plan. Njëri nga misionarët duhet ta shkruajë planin, duke përfshirë aktivitetet e ditës.

I kërkoni çdo grupi të paraqesë planin e tij. Pas çdo prezantimi, pyesni:

  - Çfarë duhej të dinin misionarët në secilën situatë?
  - Cili mund të jetë rezultati nëse nuk planifikoni aktivitetet kuptimplota ose nuk planifikoni aspak?

Pas të gjitha prezantimeve, pyesni:

  - Në ç'mënyrë janë planifikimi dhe vendosja e qëllimeve akte dashurie? akte besimi?

### Presidenti i Misionit

- U kërkoni misionarëve të sjellin librat e territorit në konferencën e zonës ose në takimet për intervista. Përveçse t'i rishikoni ju vetë librat e territorit, merrni në konsideratë faktin që mund t'u kërkoni edhe udhëheqësve të misionit ose bashkëshortes tuaj të rishikojnë librat e territorit.
- Herë pas here vëzhgoni sesionet e planifikimeve ditore dhe javore të misionarëve.
- Herë pas here zhvillojini intervistat në apartamentet e misionarëve. Ndërsa ju merreni me intervistat, i kërkoni bashkëshortes suaj ose asistentëve të presidentit të rishikojnë librat e territorit dhe planifikuesit ditorë.
- Shpesh rishikoni planifikuesit ditorë të misionarëve.
- Herë pas here merrni pjesë në një mbledhje të këshillit të lagjes.



# Si të Gjej Njerëz për t'i Mësuar?

## Mbani Parasysh

- Çfarë do të thotë të gjeni ata që do t'ju pranojnë (shih DeB 42:8)?
- Si mund ta rris besimin tim për të gjetur njerëz për t'i mësuar?
- Pse duhet t'i përfshij anëtarët në përpjekjet e mia për të gjetur njerëz për t'i mësuar?
- Çfarë roli luajnë rekomandimet nga media dhe selia qendrore e Kishës?
- Cila është marrëdhënia që ekziston midis gjetjes dhe mësimit?
- Çfarë roli luan shërbimi në gjetjen e njerëzve për t'i mësuar?
- Cilat janë disa ide të tjera për të gjetur njerëz për t'i mësuar që nuk i kam provuar ende?

## Zhvilloni Besimin për të Gjetur

**D**oktrinat dhe parimet në këtë kapitull do të forcojnë besimin tuaj se Zoti po përgatit njerëz që do t'ju pranojnë ju dhe ungjillin e rivendosur. Ai do t'ju drejtojë ju tek ata ose ata tek ju. Gjetja e kërkuesve ndryshon në pjesë të ndryshme të botës. Misionarët dhe presidentët e misionit duhet t'u përshtaten rrethanave. Megjithatë, pavarësisht nga ndryshimet, parimet për gjetjen e kërkuesve janë universale.

**Familja e Perëndisë.** Të gjithë njerëzit në tokë ishin anëtarë të familjes së Perëndisë në jetën para lindjes (shih Veprat e Apostujve 17:26–29; Hebrenjve 12:9). Ne jemi pjesë e familjes së Perëndisë në këtë jetë dhe mund të gëzojmë madje bekime edhe më të mëdha, si pjesëtarë të familjes së Tij në jetën tjetër. Ne jemi të gjithë vëllezër dhe motra në familjen e Perëndisë. Kjo njohuri na jep një ndjenjë identiteti dhe përkatësie. Ajo na jep arsye të shpresojmë për jetën e përjetshme në praninë e Perëndisë. Ne i kuptojmë këto të vërteta themelore për shkak të Rivendosjes. Është përgjegjësia dhe bekimi juaj t'u mësoni vëllezërve dhe motrave tuaja të vërtetat e rivendosura. Ashtu si Alma që u përpoq të ndihmonte femohuesit zoramitë, ju mund të luteni: “O Zot, na jep mundësi

Shënime

që të kemi sukses për t'i sjellë ata përsëri te ti, në Krisht. Vër re, o Zot, shpirtrat e tyre janë të çmueshëm...; prandaj, na jep, O Zot, fuqi dhe urtësi që të mund t'i sjellim këta, vëllezërit tanë, përsëri tek ti" (Alma 31:34–35).

**Gjeni Ata Që Do T'ju Pranojnë.** Ju duhet të ndërtoni Kishën duke gjetur ata që do t'ju pranojnë (shih DeB 42:8). Këta njerëz do ta kuptojnë se ju jeni shërbëtorë të Zotit. Ata do të jenë të gatshëm të veprojnë sipas mesazhit tuaj. Shumë nga këta njerëz "mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë ku ta gjejnë atë" (DeB 123:12).

Zakonisht ju nuk e dini se kush janë këta njerëz. Ata mund të mos e kuptojnë menjëherë që ju jeni shërbëtorë të Zotit. Ata mund të mos kuptojnë se paqja, drejtimi dhe qëllimi më i madh në jetë do të vijnë nëpërmjet ungjillit të rivendosur më shumë se prej çdo gjëje tjetër. Ata shpesh nuk kuptojnë se po kërkojnë pikërisht ungjillin e rivendosur, derisa ta kenë gjetur atë. Për shembull, një i kthyer në besim tha: "Kur dëgjova ungjillin, ai më mbushi një zbrastësi në zemër që nuk e dija se ekzistonte." Një tjetër tha: "Përfundova një kërkim që nuk e dija se po e bëja."

Kudo që të jeni caktuar për të shërbyer, kujtoni se Zoti ju ka "lejuar të vini në këtë vend; sepse kështu ishte e dobishme për [Të] për shpëtimin e shpirtrave." Punoni me efektivitet që t'ia "ngrini zërat tuaj këtij populli; flisni mendimet që unë do të vë në zemrat tuaja" Nëse e bëni këtë, do të merrni premtimin se "nuk do të ngatërroheni përpara njerëzve" dhe "do t'ju jepet...në çastin e duhur, se çfarë duhet të thoni" (DeB 100:4–6). Gjetja me anë të Shpirtit është po aq e rëndësishme sa të mësuarit me anë të Shpirtit. Ashtu si në mësimdhënie, përpjekjet tuaja për të gjetur njerëz do të jenë efektive nëse udhëhiqeni nga Shpirti. Kini besim se do të dini çfarë të mësoni dhe çfarë të bëni për të gjetur ata që do ta pranojnë mesazhin tuaj.

#### Aktivitet: Studim me Shokun

Shumë nga anëtarët që ju vizitoni mund të jenë të kthyer në besim. Planifikoni një kohë për t'i pyetur ata si u njohën me Kishën dhe si arritën të kuptojnë se misionarët po u mësonin të vërtetën. Përmbledhni përvojat e tyre në ditarin tuaj të studimit.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Si përgatiten dhe si drejtohen fëmijët e Perëndisë drejt ungjillit të rivendosur?**

Alma 13:24

DeB 29:7

DeB 84:45–47, 88

Alma 16:16–17

DeB 33:6

DeB 136:32–33

### Flisni me të Gjithë

Ndërsa Profeti Jozef Smith po udhëtonte me një grup misionarësh në lumin Misuri, Zoti i dha këtë zbulesë: "nuk është e nevojshme për...[pleqtë e mi të lëvizin] me shpejtësi...ndërsa banorët në të dy anët po mbarojnë në mosbesim" (DeB 61:3). Ndërsa lëvizni me nxitim nga njëri aktivitet i planifikuar në tjetrin, lutuni që të keni aftësinë të shihni mundësi të paplanifikuara për t'u shërbyer e për të mësuar ata që po mbarojnë në mosbesim. Lutuni për ndjeshmërinë shpirtërore për të dalluar këto





mundësi. Ju do të zbuloni se Perëndia do të vendosë në udhën tuaj fëmijët e Tij që po përgatiten të pranojnë ungjillin e rivendosur.

Asgjë nuk ndodh në punën misionare derisa të gjeni dikë për ta mësuar. Flisni me sa më shumë njerëz që të mundeni çdo ditë. Është e natyrshme të jeni pak i frikësuar për të folur me njerëzit, por mund të luteni për besimin dhe forcën, për të qenë më të guximshëm kur të hapni gojën për të shpallur ungjillin e rivendosur. Mundohuni të zbatoni idetë e mëposhtme ndërsa përpiqeni të flisni me të gjithë ata që takoni:

- Flisni me njerëzit rreth familjeve të tyre. Ndihmojini ata të shohin si ungjilli i rivendosur mund të jetë një bekim për familjet e tyre.
- Kërkoni tregues të veçantë—si objekte në shtëpi ose oborr, shkrime në rroba, gjëra që kanë të bëjnë me fëmijët—për t’ju ndihmuar si të filloni bisedën.
- Dëgjoni me sinqeritet çfarë ju thonë njerëzit.
- Jini të ngrohtë, miqësorë dhe të gëzuar. Ofroni ndihmë.
- Besoni se Shpirti do t’ju vërë në mendje e zemër atë që duhet t’u mësoni.
- Ftojini të gjithë të mësojnë rreth ungjillit të rivendosur.
- Jepni karta porosie.
- U kërkoni të tjerëve emrat e të njohurve të tyre që mund të jenë të interesuar për mesazhin tuaj.

Ndërsa lexoni këtë tregim të vërtetë, vëreni se si ky person ishte përgatitur për të pranuar mesazhin e misionarëve dhe si misionarët përdorën një mundësi të paplanifikuar për t’i mësuar atij ungjillin.

*Kur isha fëmijë, kurrë nuk më mësuan të lexoja Biblën. Shkoja në kishë të dielave, por aty nuk kontribuoja asgjë dhe për pasojë nuk ndieja asgjë. Isha i zhgënjyer nga feja ime ...po kërkoja për...Perëndinë—duke dashur të di nëse Ai me të vërtetë ekzistonte. Isha i etur ta njihja Atë dhe fjalët e Tij. Po me sa dukej nuk po e gjeja atë që po kërkoja.*

*Kishte çaste kur u ndjeva shumë pranë shuarjes së etjes sime. Kur mbajta në krahë për herë të parë, fëmijën tim të parë, një vajzë, pata ndjesinë se Perëndia ekzistonte me të vërtetë. Shumë vite më vonë, kur lindi motra e saj, unë përjetova të njëjtën ndjenjë...Megjithatë, pjesën më të madhe të kohës, një lodhje e pashpjegueshme rëndonte mbi shpirtin tim. Isha i etur shpirtërisht e nuk kisha ku ta shuaja këtë etje.*

*Në prill 1994 jetoja në qytetin Monterey, Meksikë, duke siguruar jetesën si shofer taksie. Një ditë ra shi për orë të tëra, duke bërë që uji të rridhte poshtë faqeve të malit si ujëovarë. Pasi udhëtova për orë të tëra në shi, u gjenda në një qytezë rreth tetë kilometra larg Montereyt. Ishte pothuaj... ora për t’u kthyer në shtëpi. Papritur pashë dy të rinj që po ecnin në këmbë. Ata kishin veshur pantallona te errëta e këmisha të bardha dhe dukeshin se ishin bërë qull nga koka te këmbët.*

*Kur iu afrova, hapa derën e taksisë dhe thirra: "Hymi brenda! Po shkoj në Monterey."*

*Ai më i gjati, që kishte një lëkurë shumë të bardhë, u përgjigj: "Ne nuk kemi para."*

*"Falas," u përgjigja.*

*Ata hipën menjëherë në taksie.*

*Gjatë rrugës biseduam. Ata më pyetën nëse mund të ndanin një mesazh rreth Jezu Krishtit me mua. Unë pranova dhe u dhashë adresën time.*

*Kur u ktheva në shtëpi, zgjova gruan nga gjumi dhe i tregova për dy të rinjtë. "Çfarë rastësie," thashë. "Njëri është meksikan e tjetri amerikan e që të dy quhen Elder."*

*"Elder do të thotë misionar," u përgjigj gruaja ime, që dinte diçka rreth Kishës.*

*Ndjeva se diçka po trazohej thellë brenda meje. Këta të rinj më kishin lënë një ndjenjë habie të mrekullueshme në zemër. E ndjeva se isha pranë burimit që do shuante etjen time e se tashmë ai nuk ishte larg.*

## Shënime

Misionarët erdhën në shtëpinë tonë më 5 qershor dhe unë isha i lumtur t'i dëgjoja. Dy javë më vonë, më 19 qershor, unë u pagëzova. Gruaja ime u pagëzua katër muaj më vonë, në tetor. Vajza jonë e madhe merrte mësimet fetare në një shkollë. Kur vajti për herë të parë në kishë, ajo tha: "Babi, kjo është shumë më mirë se ato që kam mësuar në shkollë!" Edhe ajo u pagëzua në tetor.

Në dhjetor 1995 ne u vulosëm si familje në Tempullin e Qytetit të Meksikos, Meksikë, për këtë jetë e për gjithë përjetësinë. Tani ne jemi një familje që gëzon harmoni, paqe e lumturi. Ne dimë se kë adhurojmë. Ne e dimë nga kemi ardhur e ku shkojmë. Ne e duam fjalën e Perëndisë, veçanërisht Librin e Mormonit dhe e duam Kishën e Tij, Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Nëpërmjet këtyre dhuratave ne kemi gjetur atë burim të ujit të gjallë për të cilin Shpëtimtari i foli gruas nga Samaria: "Kush pi nga uji që do t'i jap unë nuk do të ketë më kurrë etje përjetë; por uji që unë do t'i jap do të bëhet në të një burim uji që gufon në jetë të përjetshme" (Gjoni 4:14). [Victor Manuel Cabrera, "Thirsting for the Living Water," Ensign, gusht 2001, 60–61]



© 2001 Simon Dewey. Ndalohet fotokopjimi.

### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

- Si ishte përgatitur ky person për të pranuar ungjillin e rivendosur?
- Ç'do të kish ndodhur nëse misionarët nuk do ta kishin hapur kurrë gojën për të ndarë mesazhin e ungjillit?
- Rishikoni atë që bëtë dje. A folët me sa më shumë njerëz që ishte e mundur? Nëse jo, planifikoni dhe vendosni qëllime për ta bërë këtë sot.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

**Çfarë thotë Zoti rreth asaj që ju duhet të hapni gojën e të flisni? Çfarë duhet të mësoni? Çfarë ju është premtuar?**

DeB 24:12

DeB 33:7–15

DeB 60:2–3, 7–8

DeB 28:16

## Mësoni Kur Gjeneri, Gjeneri Kur Mësoni

Gjetja e kërkuesve dhe mësimi i tyre janë aktivitete që lidhen ngushtë me njëra-tjetrën. Kur takoheni me njerëzit përgatituri t'u mësoni përmbledhje të shkurtra të së vërtetës së rivendosur në mënyrë që Fryma e Shenjtë të mund të dëshmojë se ju jeni shërbëtorë të Zotit. Në shumë situata, do t'ju duhet të jeni në gjendje të prezantoni një mesazh brenda një minute ose më pak. Njerëzit janë mësuar me thënie të shkurtra e të fuqishme. Për shembull, ju mund të dëshmoni për mesazhin e Rivendosjes me vetëm dy ose tre fjali:

*Pasi kishin humbur për shekuj të tërë, të vërtetat që Perëndia kishte zbuluar kohë më parë (ungjilli i Jezu Krishtit) u rivendosën nga një Perëndi i dashur me anë të një profeti të gjallë. Ne kemi një provë bindëse për këtë që ju mund ta mbani në duart tuaja, ta lexoni, të meditoni në zemër dhe të luteni për të mësuar të vërtetën e tij për veten tuaj. Do të na lejon të...*

Nëse keni pak më tepër kohë, mund të thoni më shumë:

*Perëndia është Ati Ynë. Ne jemi fëmijët e Tij. Ne jemi pjesë e familjes së Tij. Ai na do. Që nga fillimi i botës, Ai ka ndjekur një plan dashurie dhe përkujdesje. Shumë herë Ai është përpjekur me dashuri për të zbuluar ungjillin e Jezu Krishtit kështu që fëmijët e Tij të mund të dinë se si të kthehen tek Ai. Ai ua zbuloi atë profetëve si Adamit, Noeut, Abrahamit dhe Moisiut. Por disa njerëz vazhdimisht kanë zgjedhur ta mohojnë atë ungjill. Dy mijë vjet më parë, Vetë Jezu Krishti mësoi ungjillin e Tij. Çuditërisht, njerëzit mohuan madje Vetë Jezusin. Sa herë që njerëzit shpërfillin ose shtrembërojnë doktrinat dhe ordinancat e vërteta, Perëndia e tërheq autoritetin e Tij për të administruar Kishën.*

*Ne ju ftojme t'i shtoni më tepër të vërtetave që tashmë janë të dashura për ju. Mendoni për provën tonë që kemi se Ati ynë Qiellor i është afruar edhe një herë me dashuri fëmijëve të Tij dhe i ka zbuluar doktrinat dhe ordinancat e vërteta një profeti. Emri i këtij profeti është Jozef Smith. Prova e kësaj të vërtete të lavdishme gjendet në një libër—Libri i Mormonit. Ju mund ta mbani në duart tuaja, ta lexoni, të meditoni të vërtetën e tij në mendje dhe në zemër.*

Mënjaroni prirjen për të thënë gjëra të tilla si: "A keni disa minuta kohë që ne të mund t'ju mësojmë një mesazh rreth..." Përkundrazi, zhvilloni shprehinë që të filloni menjëherë të mësoni e të dëshmoni ndërsa takoheni me njerëzit. Ju do të gjeni më shumë njerëz për të mësuar ndërsa dëshmoni dhe bëni të mundur që ata të ndiejnë fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Pavarësisht se si mund ta keni nisur në fillim bisedën, kaloni menjëherë dhe thjesht në mesazhin e Rivendosjes së ungjillit, sepse ky është mesazhi ynë unik për botën. Ata që ju mësoni, shpesh kanë shokë ose të afërm që janë të përgatitur të pranojnë ungjillin e rivendosur. Në të gjitha situatat e mësimdhënies—si gjetja e kërkuesve, mësimi i kërkuesve, puna me anëtarët—pyesni: "Kë njihni që mund të jetë i interesuar dhe mund të përfitojë nga ky mesazh?" Pasi të merrni një rekomandim, pyesni: "Kush tjetër mund të përfitojë nga mesazhi ynë?" Mos ngurroni ta bëni këtë përsëri në mbledhjet e ardhshme. Ndërsa ata që ju mësoni provojnë bekimet e ungjillit, dëshira e tyre për ta ndarë atë do të rritet (shih Nefi 8:12). Ndërsa mësojnë ungjillin, ata shpesh do gjejnë shokë të rinj. Misionarët që zbatojnë këtë parim, zakonisht kanë shumë njerëz për të mësuar.

#### Aktivitet: Studim me Shokun

- Përgatisni një mesazh një-minutësh të bazuar në një nga mësimet. Mendoni mënyra si mund ta mësoni këtë mesazh në një situatë gjetjeje.
- Vendosni si mund ta lidhni pa humbur kohë këtë mesazh me Rivendosjen.
- Ndani mesazhin me shokun/shoqen tuaj.
- Vini si qëllim për ta mësuar këtë mesazh në një kohë të përshtatshme gjatë ditës së sotme për të shtuar kështu një kërkues të ri në grupin e atyre që po mësoni.
- Rishikoni listën e njerëzve që po mësoni aktualisht. Bëni një listë të atyre që u keni kërkuar rekomandime dhe të atyre që nuk u keni kërkuar. Praktikoni si do t'i ftoni njerëzit në secilin grup për t'ju dhënë rekomandime. Në planifikuesin tuaj, bëni një shënim për t'u kujtuar ta bëni këtë ftesë gjatë vizitës tuaj të ardhshme.

## Flisni rreth Rëndësisë së Familjes

Rivendosja e ungjillit të Jezu Krishtit bekon familjet. Duke jetuar parimet e ungjillit të rivendosur, familjet forcohen dhe mund të provojnë paqe, gëzim dhe një ndjenjë përkatësie dhe identiteti.

Përmendja e rëndësisë së familjes me të gjithë ata që takoni çdo ditë do t'ju ndihmojë të gjeni njerëz për të mësuar. Shumë njerëz kanë një interes të natyrshëm për familjen. Në shumë situata gjetjeje, ju mund të bëni shpejt një lidhje midis asaj që shumë njerëz dinë rreth familjes me mesazhin e Rivendosjes. Kur ndodheni në të tilla situata, ju mund të thoni diçka si më poshtë:



*Nuk ka gjë më të rëndësishme për ne, se sa familjet tona. Familja na lidh me njëri tjetrin, na jep një emër dhe na ndihmon të ndihemi të nevojshëm e të dëshiruar. Nga familjet tona ne trashëgojmë tipare të karakterit, cilësi dhe karakteristika fizike, që na japin një identitet të veçantë.*

*Të pasurit e një familje të shëndoshë e të lumtur është përparësia më e lartë për shumë njerëz në mbarë botën. Përmeshja e këtij qëllimi shpesh është e vështirë. Rritja e fëmijëve dhe të pasurit e një martese të fortë në botën e sotme, ndonjëherë mund të duket pothuajse e pamundur me gjithë të ligat që na rrethojnë.*

Pastaj, mund të kaloni te mesazhi i Rivendosjes:

*Ndjenjat e dashurisë dhe përkujdesjes që ne kemi për familjet tona janë të përjetshme dhe të rrënjësura thellë në shpirtat tanë. Ato janë të përqendruara në marrëdhënien tonë me Perëndinë. Ju keni qenë pjesë e familjes së Perëndisë që para se të lindnit. Ai është Ati ynë. Meqenëse Ai është Ati ynë, ne jemi vëllezër e motra. Ati Qiellor do që ne të kthehemi për të jetuar me Të si pjesë e familjes së Tij. Familjet këtu në tokë janë një lidhje me familjen e Perëndisë. Familjet mundet të jetojnë së bashku pas kësaj jete. Ne e dimë këtë, sepse pasi kishin humbur për shekuj të tërë, doktrinën dhe ordinancat e vërteta, të tilla si pagëzimi me anë të zhytjes në ujë, janë rivendosur në tokë nga Ati ynë i dashur Qiellor, me anë të një profeti të gjallë. Këto të vërteta të rivendosura, jo vetëm na ndihmojnë të kuptojmë vendin tonë në familjen e Perëndisë, por ato janë shpresa më e madhe që kemi për një familje të fortë dhe të lumtur, në këtë jetë. A mund t'ju mësojmë më tepër rreth...*

E njëjta gjë mund të bëhet me tema të tjera si lumturia, fatkeqësia, qëllimi i jetës ose vdekja. Cilado qoftë mënyra e përdorur për të gjetur kërkues, mbani mend që ta lidhni atë shpejt me mesazhin unik që ne kemi për botën.

## Rëndësia e Anëtarëve

Punoni me anëtarët e Kishës për të gjetur njerëz për t'i mësuar. Situata ideale është kur anëtarët i ftojnë të tjerët të mësojnë rreth ungjillit dhe janë të pranishëm gjatë mësimit. Kur anëtarët e bëjnë këtë, më shumë njerëz bekoen dhe qëndrojnë aktivë në Kishë. Shoqërimi me anëtarë është i rëndësishëm, sepse ai zbut zemrat e njerëzve dhe shpesh i bën ata të kenë dëshirë të mësojnë më shumë rreth ungjillit të rivendosur. Shpesh kjo do të thotë se ata bashkohen me rrethin e miqve të anëtarëve të Kishës, përfshirë këtu anëtarët aktivë dhe më pak aktivë, të porsakthyerit dhe familjet pjesërisht anëtare.

Presidenti Gordon B. Hinkli mësoi: “Shumë nga ne e konsiderojnë punën misionare thjesht si trokitje nëpër dyer. Të gjithë ata që e njohin këtë punë, e dinë se ka një mënyrë më të mirë. Kjo mënyrë është nëpërmjet anëtarëve të Kishës. Sa herë një anëtar prezanton një kërkues, pikërisht në atë çast krijohet menjëherë një sistem mbështetjeje. Anëtari dëshmon për vërtetësinë e kësaj pune. Ai shqetësohet për lumturinë e shokut të tij kërkues. Ai gëzohet kur shoku i tij përparon në mësimin e ungjillit.

Misionarët me kohë të plotë mund të bëjnë mësimin aktual, por anëtari, sa herë që është e mundur, do ta mbështesë atë mësim duke ofruar shtëpinë e tij për të kryer këtë shërbim misionar. Ai do të japë një dëshmi të sinqertë për hyjninë e kësaj pune. Ai do jetë atje për t’iu përgjigjur pyetjeve, kur misionarët nuk janë rrotull. Ai do jetë një shok për të kthyerin në besim i cili po bën një ndryshim të madh dhe shpesh të vështirë...Procesi i sjelljes së njerëzve të rinj në Kishë nuk është vetëm misioni i misionarëve. Ata përparojnë më shumë, kur anëtarët bëhen burimi nga i cili gjeihen kërkuesit e rinj” (*Ensign*, maj 1999, 105–6).

Pikënisja e ndërtimit të një marrëdhënie të fortë me anëtarët është peshkopi. Ofroni të ndihmoni dhe të shërbeni në çdo mënyrë të drejtë që ai ju kërkon. Rregullisht pyesni veten: “Jam unë një bekim apo një barrë për peshkopin?” Zhvilloni një qëndrim të tipit “Si mund të ndihmoj?” Nëse ju do kërkonti mundësi për të dashur, shërbyer e mësuar, peshkopi dhe anëtarët e lagjes, ka më shumë të ngjarë t’ju besojnë pjesëtarët e familjes dhe shokët e tyre për t’i mësuar.

Mendoni për fragmentin e mëposhtëm marrë nga letra e një misionari drejtuar presidentit të misionit:

*I dashur President,*

*Asistentët më telefonuan sot për të më thënë se do të transferohem. Ndjeva se duhej t’ju shkruaja e t’ju falënderoja që më dërguat në këtë zonë. Më duket sikur ishte dje, kur po më tregonit rreth sfidave që më prisnin.*

*E diela jonë e parë vërtetoi atë që më thatë. U pritëm ftohtë nga anëtarët e lagjes. E vetmja rreze drite atë të dielë të parë ishte Skoti, udhëheqësi i ri i misionit të lagjes. Ai ishte transferuar në bazën e Forcave Ajrore para një muaji dhe kishte vetëm dy javë që shërbente si udhëheqës i misionit të lagjes. Skoti na ftoi për darkë në shtëpinë e tij të dielën tonë të parë, për të diskutuar se çfarë mund të bënim për ta çuar punën përpara. Mbase hëngrëm darkë, u gjuhëzuam në lutje dhe i kërkua Atit Qiellor të na drejtonte. Gjatë lutjes, provuam një ndjenjë paqeje e vendosmërie. Arritëm në përfundimin se mënyra më e mirë për ta çuar punën përpara ishte të fitonim besimin e anëtarëve. Ne vendosëm të ndiqnim shembullin e Amonit dhe t’u shërbenim atyre.*

*Filluam me peshkopin. Për shkak të mungesës së pagëzimeve në atë zonë dhe mungesës së përpjekjeve të misionarëve të mëparshëm, kuptohej se ai nuk qe shumë i lumtur të na takonte. Si përfundim ai na ftoi në shtëpinë e tij për darkë. Ne mësuam se peshkopi po përgatitej të hiqte tapetin nga dhoma e ndenjes dhe të riparonte parketin që ndodhej nën të. Ne ofruam ndihmën tonë dhe ai pranoi. Në përfundim të projektit, peshkopi na kërkoi që të flisnim në një mbledhje sakramenti. Ne e konsideruam këtë si shenjë se ai po fillonte të kishte besim tek ne.*

*Ndoqëm të njëjtin plan shërbimi ndërsa u takuam me anëtarë të tjerë. Gjetëm mundësi për t’i ndihmuar ata në një sërë mënyrash të thjeshta. Kur nuk ishim me anëtarët, trokisnim në dyer dhe flisnim me sa më shumë njerëz të mundeshim rreth ungjillit të rivendosur. Ne u bekuam me njerëz për të mësuar dhe anëtarët panë se si ne sollëm në kishë njerëz që i kishim gjetur vetë. Qëndrimi i të gjithë lagjes filloi të ndryshojë. Pati një entuziazëm të madh rreth punës misionare. Kur anëtarët filluan të kishin besim te ne, puna u përshpejtua. Shumë pagëzime ndodhën më pas.*

*“Pas gjithçkaje që është thënë, detyra më e madhe dhe më e rëndësishmja është të predikojmë Ungjillin.”*

—PROFETI JOZEF SMITH  
TEACHINGS OF THE PROPHET JOSEPH SMITH, 113

## Shënime

Shumë anëtarë të Kishës kanë frikë të bëjnë punë misionare. Shumë janë të pasigurtë ku të fillojnë apo çfarë të thonë. Shumë tremben se mos humbasin shokët e ngushtë nëse përpiqen të ndajnë ungjillin me ta. Ka shumë mënyra për t'i ndihmuar anëtarët. Për shembull, ndihmojini të ndërtojnë besimin e tyre duke u mësuar mesazhin e Rivendosjes dhe doktrina të tjera që gjenden në mësim. Ndhimmojini të ndiejnë Shpirtin dhe fuqinë e mesazhit tonë. Forcimi i kuptimit të tyre për doktrinën e Krishtit, do të ndikojë në rritjen e besimit të tyre tek ju dhe në nxitjen e entuziazmit për të bërë punë misionare, më shumë se çdo gjë tjetër që ju mund të bëni. Ndhimmojini ata të kuptojnë se ndarja e ungjillit të rivendosur do të rrjedhë më natyrshëm në ato marrëdhënie ku ata po përpiqen t'i duan dhe t'u shërbejnë anëtarëve të familjes dhe shokëve të tyre. U mësoni atyre parimet nga seksioni "Përshkoheni Vendi Duke Bërë Mirë" të këtij kapitulli. I nxitni anëtarët të "[bashkohen] në agjërime dhe lutje të fuqishme për mirëqenien e shpirtit të atyre që nuk [e njohin] Perëndinë" (Alma 6:6). Në gjithçka që bëni me anëtarët, kërkonini të ngrini dhe të ndërtoni besimin e tyre për t'i ndihmuar të bëjnë punën misionare.

Përveç punës me anëtarët aktivë, përpiquni të gjeni njerëz për të mësuar nëpërmjet pleqve të mundshëm, anëtarëve më pak aktivë dhe anëtarëve të rinj. Këta anëtarë, ka të ngjarë të kenë shumë shokë të besimeve të tjera dhe të bekohen ndërsa ndajnë ungjillin e rivendosur me anëtarët e familjes dhe shokët e tyre.

Gjatë çdo vizite me anëtarët, bëni ç'të mundeni që t'i nxisni ata:

- Të luten dhe të ndjekin Shpirtin.
- Të shërbejnë.
- Të zhvillojnë miqësi.
- Të hapin gojën për të ndarë ungjillin e rivendosur.
- T'i ftojnë të tjerët të bëjnë ato gjëra që do të rrisin besimin e tyre në Krisht.

Çdo rekomandim që merrni nga një anëtar duhet trajtuar si diçka e çmuar. Kur një anëtar ju jep emrin e një shoku për t'i telefonuar ose vizituar, përgjigjuni me shpejtësi dhe ia komunikoni rezultatet anëtarit.

#### Ide për të Ndhimuar Anëtarët

Ka shumë mënyra për t'i nxitur anëtarët të angazhohen më shumë në punën misionare. Merrni parasysh idetë e mëposhtme:

- Kërkonini udhëheqjen e peshkopit dhe të udhëheqësve të tjerë të lagjes. Shih kapitullin 13 për më shumë ndihmë në këtë drejtim.
- U mësoni udhëheqësve të Kishës dhe anëtarëve mesazhin e Rivendosjes dhe mësim të tjera.
- Mësojuni atyre të duan dhe t'u shërbejnë të afërmeve dhe shokëve të tyre.
- I nxisni ata të agjërojnë dhe të luten për mundësi që të bëjnë punë misionare.



- I nxisni ata të vizitoni miq që kanë përjetuar së fundi një ndodhi vendimtare në jetë (lindje, vdekje në familje, martesë, ose transferime)
- Ftojini ata t'ju ndihmojnë në mësimdhënie. Situata ideale është të keni me vete një anëtar të Kishës, i cili më parë i përkiste të njëjtës kishë si kërkuesi.
- Ndihmojini ata të vendosin data se kur do t'i ftojnë shokët e tyre për të mësuar rreth mesazhit të Rivendosjes.
- Tregojuni atyre materiale që mund t'u japin të tjerëve si kopje të Librit të Mormonit, video dhe karta informuese.
- Nxitini ata të ftojnë shokët e tyre që të shkojnë në kishë ose të marrin pjesë në një mbrëmje familjare, të shohin një video të prodhuar nga Kisha, ose të marrin pjesë në një bisedë rreth ungjillit.
- Ndihmojini ata të praktikojnë se çfarë mund t'u thonë shokëve të tyre.
- Mësojuni atyre pse është me vlerë ta ndajnë ungjillin me të tjerët pavarësisht nga rezultati.

Ka shumë mënyra të tjera për t'i ndihmuar anëtarët të angazhohen më shumë. Mundohuni t'i shtoni kësaj liste gjatë misionit tuaj. Ndani idetë tuaja me misionarët e tjerë.

### Aktivitet: Studim me Shokun

Me shokun/shoqen tuaj, rishikoni çfarë keni bërë për t'i shërbyer dhe për ta ndihmuar peshkopin si dhe udhëheqësit dhe anëtarët e tjerë gjatë muajit të fundit. Diskutoni dhe planifikoni se çfarë mund të bëni gjatë muajit të ardhshëm për të zhvilluar një marrëdhënie më të fortë me ta.

Rishikoni idetë e renditura në kutinë "Ide për të Ndihmuar Anëtarët." Identifikoni disa ide që nuk i keni provuar ende. Duke përdorur planifikuesin tuaj ditor, planifikoni dhe provoni disa nga këto ide gjatë javës së ardhshme.

## Rekomandime nga Media dhe Selia Qendrore e Kishës

Rekomandimet janë një burim tjetër në gjetjen e atyre që janë të përgatitur për të pranuar ungjillin e rivendosur. Përveç rekomandimeve nga anëtarët, Kisha i ndihmon aktivisht fëmijët e Perëndisë në mënyra të ndryshme. Kisha nxit interesin nëpërmjet përpjekjeve të tilla si: reklamat në media, qendrat e vizitorëve, vendet historike, ndihma humanitare dhe të mirëqenies dhe Internetit ([www.mormon.org](http://www.mormon.org), [www.lds.org](http://www.lds.org), [www.familysearch.org](http://www.familysearch.org)). Rekomandimet e marra nga media dhe Selia Qendrore e Kishës përfaqësojnë njerëz që kanë pranuar të vizitohen nga përfaqësuesit e Kishës për t'iu çuar një nga materialet e Kishës (si Bibla apo Libri i Mormonit) dhe për t'iu mësuar më shumë rreth Kishës. Këto mundësi mësimi duhet të konsiderohen si një përgjegjësi e shenjtë nga misionarët.

Përpara se të vizitoni një të rekomanduar, sigurohuni që të jeni të familjarizuar me materialin e kërkuar. Planifikoni një mësim të shkurtër për të kaluar nga materiali i kërkuar në mësimin e mesazhit të Rivendosjes. Në disa raste rekomandimet ju çojnë tek njerëz të tjerë që Perëndia po i përgatit. Në qoftë se njerëzit që ju kontaktoni nuk janë të interesuar, pyesni nëse ata njohin dikë që mund të ketë interes. Gjithashtu flisni me anëtarë të tjerë të familjes dhe fqinjët e tyre. Pyesni secilin prej tyre se kush tjetër mund të jetë i interesuar në mesazhin tuaj. Ndoshta ju jeni drejtuar tek ky person, sepse dikush tjetër, në shtëpi ose në lagje, është gati për të pranuar ungjillin.

Kur punoni me rekomandime, mbani mend:

- T'i kontaktoni ata brenda 24 orësh.

## Shënime

- Nëse është e mundur, telefononi përpara për të caktuar një takim. Nëse ata nuk janë në shtëpi, përpiquni t'i telefononi në kohë të ndryshme gjatë ditës.
- Jepuni materialin e kërkuar dhe kujtojini se ata kërkuan të vizitoheshin nga ju. Mblidhni të gjithë ata që ndodhen në shtëpi për të dëgjuar.
- Mësojuni mesazhin e Rivendosjes.
- U drejtoni ftesa që do të ndërtojnë besimin e tyre në Krisht.
- U kërkoni rekomandime.
- Planifikoni për një vizitë tjetër.
- Planifikoni të punoni në atë lagje pasi të mbaroni takimin.
- Nëse personi nuk është në shtëpi, flisni me fqinjët.

**Aktivitet: Studim me Shokun**

Lokalizoni të gjitha rekomandimet e marra në territorin tuaj brenda muajit të fundit. Identifikoni ndonjë person që nuk është kontaktuar ende dhe vizitoheni atë. Vendosni se cili prej atyre që janë kontaktuar më parë, duhet vizituar përsëri.

**Historia Familjare**

Historia familjare apo gjenealogjia përbën një tjetër mënyrë si mund të gjeni njerëz për të mësuar. Historia familjare është kthyer tashmë në një nga veprimtaritë zbavitëse më të përhapura në botë. Shpirti i Elias po ndikon miliona njerëz kudo në mbarë botën për të kërkuar paraardhësit e tyre. Shumë njerëz dëshirojnë të kenë lidhje më të forta me familjen e tyre të gjerë. Kjo mund të çojë në dëshirën për të gjetur një lidhje dhe identitet me familjen e Perëndisë.

Përcaktoni se çfarë lloj burimesh të historisë familjare ekzistojnë në zonën tuaj. Për shembull, ju mund t'i ftoni njerëzit në qendrën lokale të historisë familjare ose t'i prezantoni ata me anëtarë që mund t'i ndihmojnë të bëjnë një kërkim fillestar të prejardhjes së familjes së tyre. Nuk është e thënë që ju të dini shumë rreth historisë familjare, për ta ofruar këtë shërbim, në qoftë se keni ndihmën e anëtarëve të Kishës. Në pjesën më të madhe të botës, ka anëtarë që mund t'i ndihmojnë të tjerët të kërkojnë rrënjët e tyre familjare. Përfshini anëtarët në mënyrë që kërkuesit e mundshëm të takojnë njerëz që mund të miqësohen me ta. Shpjegoni se përdorimi i qendrave të historisë familjare është një shërbim falas.

Kur bëni trokitje, mund t'u jepni njerëzve një kartë informuese të historisë familjare, ku ndodhet edhe numri i telefonit të qendrës së historisë familjare, duke u ofruar një shërbim fillestar falas të kërkimit të rrënjëve familjare. Pas një ose dy ditësh shkoni përsëri në shtëpitë ku latë kartën për të ndjekur ecurinë. Tregojani këto karta kërkuesve të cilët mund t'ua japin ato shokëve e të afërmve të tyre. Është gjithashtu një ide e mirë të mbani me vete tabelën tuaj të prejardhjes familjare prej katër brezash si një shembull dhe t'ua tregoni atyre që kanë të njëjtin mbiemër me ju.

*“Shpresoj të shoh që ne ta rrëzojmë kufirin artificial, që shpesh vendosim midis punës misionare dhe punës në tempull dhe punës gjenealogjike, sepse është e njëjta punë e madhe shëlbuese!”*

—PRESIDENTI SPENSER W. KIMBELL  
“THE THINGS OF ETERNITY—STAND WE IN JEOPARDY?” *ENSIIGN*, JANAR 1977, 3



Për të filluar, merrni parasysh të bëni sa më poshtë:

- Vizitoni një qendër të historisë familjare nëse ka një të tillë në zonën tuaj.
- Diskutoni me peshkopin dhe këshillin e lagjes dëshirën tuaj për t'u ofruar ndihmë për sa i përket historisë familjare atyre që takoni çdo ditë.
- Diskutoni me udhëheqësit e lagjes si ta bashkërendoni më mirë këtë përpjekje:
  - A është peshkopi dakord që ju t'u ofroni të tjerëve ndihmën e anëtarëve të lagjes?
  - Cilët anëtarë të lagjes shërbejnë në qendrën e historisë familjare apo kanë përvojë në punën e historisë familjare?
  - Cila është mënyra më e mirë për të kërkuar ndihmën e këtyre anëtarëve.
  - Kush mund t'ju shoqërojë kur prezantoni tabelën e prejardhjes familjare ose dokumentet e grupit familjar?

Lexoni ngjarjen e mëposhtme që tregohet nga një misionar i moshuar. Vini re rolin që luajti historia familjare në kthimin në besim të këtij çifti.

*Mildred Shulc ishte anëtare e devotshme e kishës së saj. Nuk ishte për t'u habitur që kur misionarët trokitën në derën e saj, ajo nuk humbi kohë për t'i ftuar brenda që të mund t'u mësonte atyre "të vërtetën." Ndërsa misionarët e mësuani, ajo u prek nga të vërtetat e ungjillit të rivendosur dhe u pagëzua. Gjatë gjithë procesit të mësimin, burri i saj, Frenku, zgjodhi të mos dëgjonte.*

*Pikërisht këtu dal në skenë unë. Misionarët na prezantuan me motrën Shulc. E ndihmuam atë të fillonte trugun e saj familjar dhe më pas e ftuam të na takonte në qendrën e historisë familjare. Dita e takimit tonë erdhi dhe Frenku e pyeti nëse edhe ai mund të shkonte me të për të kërkuar paraardhësit e vet. Sigurisht, ajo ishte entuziaste për atë që mund të ndodhte dhe kështu ata u nisën për tek qendra.*

*Misionarët kishin planifikuar të na takonin atje, më vonë gjatë ditës. Përpara se ata të vinin, ne i treguam Frenkut dhe Mildred bibliotekën dhe i prezantuam ata me motrën Rajt. Motra Rajt ishte specialistja e historisë familjare dhe ofroi të ndihmonte në gjetjen e informacionit rreth babait të Frenkut. Ajo e gjeti emrin e babait të tij në një libër dhe gjithashtu mundi t'i gjente Frenkut një hartë të Gjermanisë që tregonte vendlindjen e babait të tij. Ai ishte aq i gëzuar rreth këtyre zbulimeve, sa kur erdhën misionarët, i ftoi ata për darkë për t'u treguar fotografi e për të folur rreth historisë së familjes së tij. Shpirti i Elias i kish prekur dhe i kish zbutur zemrën dhe kishte hapur një derë që ungjilli të mbushte jetën e tij.*

*Atë mbrëmje, Mildred mendoi se çfarë mund të thoshte për ta ndihmuar Frenkun të tregonte më tepër interes për ungjillin. Një pyetje e erdhi në mendje. Ajo filloi: "Frenk, a do që të jesh me mua gjithmonë, edhe pas kësaj jete? A do që të kesh një familje të përjetshme?" Ai menjëherë, tha: "Oh, Mildred, patjetër që dua. Si mund ta bëj këtë?" Kjo ishte pyetja për të cilën ajo ishte lutur. Ajo u përgjigj: "Dëgjo se çfarë kanë për të thënë misionarët." Ai pranoi. Ndërsa misionarët e mësonin, zjarri i mesazhit të Rivendosjes shkriu dyshimet dhe frikën e tij. Ai pranoi me gatishmëri të vërtetat që misionarët ndanë. Ai e pranoi ftesën për t'u pagëzuar. Që nga ajo kohë, Frenku dhe Mildred kanë qenë anëtarë të fortë dhe aktivë të Kishës.*

*Frenku dhe Mildred u përpoqën shumë për ta përfunduar punën që kishin nisur kështu që ordnancat shpëtuese të mund të kryheshin për familjen e tyre. Ishte një ditë e gëzuar kur ata u pagëzuan në emër të pjesëtarëve të familjes së tyre. Gjatë procesit të kryerjes së punës së tempullit, vëllai Shulc pa një ëndërr rreth babait të tij. Ai pa të atin në fermën që kishte shërbyer si shtëpia e fëmijërisë së tij. Babai po qëndronte pranë karriges së tij në verandë, i veshur në të bardha me krahë të hapur drejt të birit. Frenku u zgjua nga ëndërra duke qarë. Ai e kuptoi se i ati e kish pranuar punën që ata kishin bërë.*

#### Aktivitet: Studim me Shokun

- Çfarë ndikoi te Frenku që ai të vendoste që misionarët ta mësonin?
- Si mund ta lidhni më mirë punën e historisë familjare me planin e Perëndisë për familjen?

## Shënime

- Si po e përdorni historinë familjare si një mjet gjetjeje? Në çfarë mënyrash mund t'iu ofroni informacion për historinë familjare njerëzve që takoni çdo ditë? Planifikoni të filloni ta përdorni historinë familjare si një mjet të fuqishëm në përpjekjet tuaja për të gjetur kërkues.

Historia familjare është një burim i fuqishëm për t'u përdorur në gjetjen e atyre që Zoti po i përgatit të pranojnë ungjillin e rivendosur. Lutuni që të jeni të vëmendshëm ndaj mundësive për ta përdorur historinë familjare në përpjekjet tuaja të gjetjes së kërkuesve. Njerëzit zakonisht kanë ndjenja shpirtërore kur flasin për familjet. Njerëzit gjithashtu e ndiejnë Shpirtin, ndërsa u mësohet doktrina në lidhje me arsyen se përse ne bëjmë punë për historinë familjare. Për më tepër, mbajtja aktive e të kthyerve në besim rritet ndërsa anëtarët e rinj kanë mundësi të kërkojnë rrënjët e tyre familjare dhe kryejnë ordinancat e shenjta në emër të paraardhësve të tyre.

## Studim i Shkrimeve të Shenjta

## Çfarë ka rivendosur Zoti në tokë nëpërmjet Elijas?

DeB 110:14–16

DeB 138:32–34

Malakia 4:5–6

DeB 128:16–18

## Aktivitet: Studim Individual dhe me Shokun

Planifikoni të vizitoni një qendër lokale të historisë familjare me një anëtar që ka përvojë në këtë fushë. Ndërsa vizitoni qendrën e historisë familjare, mësoni se çfarë lloj shërbimesh vihen në dispozicion. Mësoni të dhëna të tjera si, kur është e hapur qendra, kush shërben atje dhe çfarë t'iu ofroni atyre që takoni çdo ditë.

Praktikoni se si do t'iu ofroni ndihmë me historinë familjare atyre që takoni. Planifikoni të ofroni informacion për historinë familjare gjatë përpjekjeve tuaja për të gjetur kërkues.

Lexoni dhe diskutoni “Punë për Historinë e Familjes dhe Gjenealogji” në librin *Të Vërtetë ndaj Besimit* për të fituar një njohuri më të gjerë rreth punës së historisë familjare. Shkruani në ditarin tuaj të studimit se çfarë mësuat.

## Kërkues të Mëparshëm

Kërkuesit e mëparshëm janë një burim i çmuar për të gjetur njerëz për të mësuar. Ka shumë arsye pse njerëzit heqin dorë nga të mësuarit më shumë rreth Kishës. Arsyet përfshijnë: transferimin e misionarëve, kërkuesit shkojnë me pushime, misionarët nuk i vizitojnë më edhe pse kërkuesit akoma presin që ata t'i vizitojnë dhe kërkues që besojnë se misionarët nuk kanë asgjë të re për t'iu mësuar. Shumë nga kërkuesit e mëparshëm thonë se ata do të kishin dëshirë të takoheshin përsëri me misionarët.

Rishikoni shpesh librin e territorit për të identifikuar kërkuesit e mëparshëm. Me lutje mendoni rreth informacionit në librin e territorit që tregon se si kërkuesit ranë fillimisht në kontakt me Kishën, çfarë u është mësuar, si janë përgjigjur ndaj asaj që u është mësuar dhe pse ndaluan së kërkuari ungjillin. Nëse anëtarët kanë



© 2001 Dei Parson. Ndalohej fotokopjimi.

genë të përfshirë në mësimin dhe shoqërimin e këtyre kërkuesve të mëparshëm pyetini anëtarët se çfarë mbajnë mend rreth kësaj përvoja. Bazuar në këtë informacion, planifikoni të takoheni përsëri me këta kërkues.

Nëse dikush që ju po mësoni zgjedh të mos vazhdojë të mësojë më rreth ungjillit, shkruani në librin e territorit informacione që do të jenë të vlefshme për misionarët që do t'i kontaktojnë ata në të ardhmen.

Ndërsa lexoni përvojën e mëposhtme, mendoni për fuqinë e kontaktimit të kërkuesve të mëparshëm.

*Për çudinë time të madhe, unë u thirra të punoj në të njëjtin mision ku motra ime më e madhe kishte shërbyer një vit më parë. Pas disa muajsh në fushën e misionit, u transferova në një nga zonat ku kishte shërbyer motra ime. Kur mësoi për transferimin tim, motra më shkruajti e më kërkoi të vizitoja një familje që ajo dhe shoqja e saj kishin mësuar. Ajo shprehu dashurinë dhe afërshmërinë që kishte pasur me familjen Norman dhe zhgënjimin që ndjeu kur ata e ndërprejnë kërkimin e Kishës.*

*Unë dhe shoku im gjetëm se ku banonte familja Norman dhe u pranuan ngrohtësisht prej tyre. Ata pranuan ftesën tonë për të dëgjuar edhe njëherë ungjillin e rivendosur. Nuk jam i sigurt cili që ndryshimi këtë radhë, por ata ishin plotësisht të gatshëm për të pranuar mesazhin tonë. E gjithë familja u pagëzua dhe konfirmua.*

*Pas kësaj përvoje, mendova rreth kërkuesve të tjerë me të cilët motra ime kishte punuar. Mendova: "Nëse funksionoi me familjen Norman, ndoshta do të funksionojë edhe me familjet e tjera që ajo ka mësuar." Vendosa t'i shkruaja motrës rreth idesë për të kontaktuar njerëz të tjerë që ajo kishte mësuar. Ajo kërkoi në ditarin e saj dhe më dërgoi emrat e kërkuesve të tjerë që kish mësuar në atë zonë.*

*Unë dhe shoku im e kaluam javën tjetër duke kontaktuar këta njerëz. Për gëzimin tonë, pothuajse gjysma e tyre e pranuan ftesën për të dëgjuar përsëri ungjillin e rivendosur. Disa nga ky grup u pagëzuan dhe konfirmuan. Gjatë takimeve me këta kërkues të mëparshëm, ne gjithashtu u kërkua atyre rekomandime për shokët e të njohurit e tyre që mund të ishin të interesuar për mesazhin tonë. Si rezultat, ne gjetëm akoma më shumë njerëz për të mësuar. Kjo ishte koha më e ngarkuar e misionit tim.*

#### Aktivitet: Studim me Shokun

- Identifikoni të gjithë kërkuesit e mëparshëm në librin e territorit.
- Planifikoni të kontaktoni sa më shumë prej tyre që të jetë e mundur brenda 24 orëve.

## Gjetja nëpërmjet Përpjekjeve Tuaja

Pëpiquni të forconi besimin tuaj se Perëndia po përgatit fëmijët e Tij për të pranuar mesazhin e Rivendosjes. Ndërsa ju bëni ç'është e mundur nën drejtimin e Frymës së Shenjtë për të gjetur njerëz për të mësuar, Zoti do të vendosë njerëz të tillë në udhën tuaj.

Ka shumë mënyra të nderuara për të gjetur ata që po përgatiten për të pranuar ungjillin e rivendosur. Ju duhet të bëni ç'është e mundur për t'u gjendur në udhën e atyre që po përgatiten. Misionarët kanë zbuluar se idetë e mëposhtme i kanë ndihmuar të gjejnë njerëz për të mësuar nëpërmjet përpjekjeve të veta. Ndërsa rishikoni këtë listë, planifikoni të zbatoni disa nga idetë që janë të reja për ju. Kjo listë shërben gjithashtu si një pikënisje për ju që të filloni të mendoni për mënyra të tjera të nderuara me anë të të cilave mund të gjeni njerëz për të mësuar.

## Shënime

- Punoni me peshkopin dhe këshillin e lagjes për të identifikuar dhe kontaktuar ata që kanë një bebe të porsalindur, që sapo kanë lëvizur në atë zonë, ose kanë patur një vdekje në familje.
- Kërkoni mundësi për të ofruar shërbim të thjeshtë.
- Mësojuni anëtarëve—përfshirë anëtarët aktivë e më pak aktivë, të porsakthyerit në besim dhe familjet pjesërisht anëtare—mesazhin e Rivendosjes. Kërkojini atyre t’ju prezantojnë me njerëz që mund t’i mësoni.
- Planifikoni të zhvilloni për anëtarët mbrëmje rreth vatrës ku ata të mund të sjellin shokët e tyre ose ku ju mund të mësoni ungjillin dhe kërkoni rekomandime prej tyre.
- Ofroni ndihmën tuaj për t’u mësuar njerëzve se si të zhvillojnë një mbrëmje familjare të shtëpisë.
- I ftoni njerëzit që takoni, që bashkë me ju, të vizitojnë ndërtesën e kishës që ndodhet në atë zonë.
- Ofroni ndihmën tuaj për të planifikuar një takim të tyre me peshkopin.
- I ftoni njerëzit të vizitojnë faqen e Internetit [www.mormon.org](http://www.mormon.org).
- Organizoni një klasë për studimin e shkrimeve të shenjta.
- Jepni mësim të gjuhës angleze si gjuhë të dytë.
- I ftoni njerëzit të ndjekin seminarin ose institutin sipas moshave përkatëse.
- Shkoni shtëpi më shtëpi ose flisni me njerëzit në rrugë.
- Përdorni karta porosie për materiale të kishës; DVD; dhe broshura
- Kërkoni rekomandime nga kërkuesit e tanishëm kërkuesit e mëparshëm, anëtarët më pak aktivë, pleqtë e mundshëm dhe nga të gjithë ata që takoni.
- Punoni ngushtë me përfaqësuesit lokalë të Kishës për marrëdhëniet me publikun për të krijuar mundësi për botimin e artikujve në gazetën lokale rreth shërbimit tuaj misionar.
- Ftoni njerëz në mbledhjet e Kishës, aktivitete dhe në shtëpi të hapura.
- Ftojini njerëzit të marrin pjesë në shërbesat e pagëzimit. Këto shërbesa sigurojnë një prezantim të shkëlqyer me Kishën dhe ofrojnë mundësi të mira që kërkuesit të ndiejnë ndikimin e Shpirtit.



### Përshkojeni Vendin Duke Bërë Mirë

Besimi juaj për të gjetur njerëz për të mësuar tregohet nëpërmjet veprave tuaja. Gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, Shpëtimtari “[mori] trajtë shërbëtori” (Filipianëve 2:7). Ai “e përshkoi vendin duke bërë mirë” (Veprat e Apostujve 10:38) dhe “duke predikuar ungjillin” (Mateu 4:23). Ndërsa ecni sipas këtij shembulli, ju do të gjeni ata që do të pranojnë mesazhin tuaj.

Nëpërmjet shërbimit, ju dhe ata që janë të përgatitur për të pranuar ungjillin e rivendosur silleni së bashku në një mënyrë të fuqishme dhe frymëzuese. Veprat tuaja të mira do t’i ndihmojnë njerëzit t’ju pranojnë si një shërbëtor të Perëndisë dhe do t’ju çojnë drejt mundësive për t’iu mësuar atyre ungjillin e rivendosur.

Përvojat që pjesa më të madhe e misionarëve kanë pasur me shërbimin përpara misionit të tyre, përfshijnë “projekte shërbimi,” të tilla si ndihmë për të lëvizur plaçkat për dikë që ndërrohet shtëpinë, shërbim në fermën e Kishës, ose pastrimi i një oborri. Si një misionar, ju do të ofroni një të tillë shërbim të planifikuar çdo javë (shih *Missionary Handbook* për më tepër informacion).



Ai lloj shërbimi për të cilin bëhet fjalë në këtë seksion përqendrohet në mundësitë e planifikuara. Ky lloj shërbimi kërkon të dëgjoni Shpirtin për të dalluar mundësitë për vepra të vogla e të thjeshta mirësie që mund t’iu ofroni fëmijëve të Perëndisë. Lutuni dhe tregohuni të vëmendshëm gjatë çdo dite ndaj mundësive për të bërë mirë. Ndërsa përpiqeni të bëni mirë, ju do të drejtoheni tek ata njerëz që po përgatiten për të pranuar ungjillin e rivendosur.

Ndërsa lexoni tregimim e mëposhtëm, vini re se si misionarët “bënë mirë” dhe predikuan ungjillin.

*Pablo vinte rregullisht në klasën e anglishtes që ne zhvillonim çdo javë. Ai ishte një zotëri në pension që po mësonte anglisht për ta mbajtur mendjen larg nga gruaja e tij e sëmurë. Një javë ai pushoi së ardhuri. Askush nuk dukej ta dinte se përse. Rreth një muaj më vonë, ai erdhi në klasë përsëri. Dukej ndryshe. Ishte dobësuar dhe dukej i dëshpëruar. Nuk mori pjesë në mësim si më parë dhe u largua përpara se të kishim mundësi të flisnim me të.*

*Gjatë javës në vazhdim unë dhe shoku im u lutëm që Pablo të mund të kthehej në klasë që ne të mund të flisnim me të. Lutjet tona u plotësuan dhe ai erdhi në klasë javën tjetër. Ndërsa folëm me të mbas mësimin, ai na tregoi se e shoqja kishte vdekur. Ai na tregoi diçka rreth kësaj përvoje dhe ne shprehëm keqardhjen tonë. I thamë se donim ta ndihmonim të kuptonte si mund të ishte përsëri me gruan e tij. Ai ngriti kokën, më pa në sy dhe me lot, zemërim e dëshpërim tha: “Nëse vërtet do të më ndihmosh, mund të vish në shtëpinë time e të më ndihmosh ta kthej jetën time përsëri në normalitet. A nuk është kjo, çfarë bëjnë misionarët? Më duhet ndihmë të vë rregull në shtëpinë dhe punët e mia.”*

*Ne u befasuam dhe u ndjemë të përulur nga komentet e Pablos. I ofruam ndihmën tonë për çdo gjë që ai kishte nevojë. Mendoj se kjo ishte pika ku ai filloi t’i besonte qëllimeve tona. Ai na tha të shkonim në shtëpinë e tij të nesërmen për të krasitur pemët. Ne shkuam atje në kohën e caktuar dhe filluam të punojmë përkrah tij. Gjatë muajve që ishte kujdesur për gruan e tij, ai kish lënë pas dore punët në shtëpi dhe oborr. Kishte boll punë për të tre ne. Kjo u kthye në një përvojë javore shërbimi në shtëpinë e tij. Ne krasitëm pemët, hoqëm barërat e këqija dhe mblodhëm frutat. Nuk filluam ta mësonim —sapo përpiqeshim të fillonim, ai menjëherë e mbyllte bisedën. Ai ndihej më mirë kur flisnim për jetën dhe familjen e tij. Në më të shumtën, ne vetëm dëgjonim.*

*“A doni të jeni të lumtur?  
Harrojeni veten dhe  
humbisni në këtë kauzë të  
madhe. Kushtojani  
përpjekjet tuaja ndihmës  
ndaj të tjerëve... Qëndroni  
më lart, ndihmoni të  
forconi duart e kapitura  
dhe gjunjët e këputur.  
Jetoni ungjillin e Jezu  
Krishtit.”*

—PRESIDENTI GORDON B. HINKLI:  
TEACHINGS OF GORDON B. HINCKLEY, 597

## Shënime

Mbas rreth një muaj e gjysmë, Pablo na habiti duke na pyetur: “Vërtet do ta shoh gruan time përsëri?” Ne me gëzim iu përgjigjëm se ishte e mundur. Dëshmuam për familjet e përjetshme dhe bëmë ç’ishte e mundur për t’iu përgjigjur pyetjeve të tij.

Ne i mësuam Pablos planin e shpëtimit. Ai u prek nga doktrina. Para se të largoheshim, ai bëri një listë pyetjesh për të cilat donte përgjigje, si: “A do të ketë gruaja ime një trup kur ta shoh përsëri?” dhe “A do të jemi të çliruar nga sëmundjet dhe dhimbjet?” Ne ju përgjigjëm pyetjeve të tij dhe caktuam një takim tjetër për të diskutuar parimet e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit.

Shpejt pas kësaj, fytyra e Pablos ndryshoi. Ai buzëqeshte më shpesh dhe dukej më në paqe. Ai me të vërtetë kishte “[shpresë] për një botë më të mirë” (Ethëri 12:4). Shërbimi ynë e ndihmoi atë të besonte në gjërat që i mësuam.

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

- Në çfarë mënyrash “bënë mirë” misionarët në këtë tregim?
- Çfarë roli luajti shërbimi në vendimin e Pablos për t’i lejuar misionarët t’i mësonin ungjillin?
- A kërkoni ju mundësi për të bërë mirë gjatë çdo dite? A mund të përmirësoheni në këtë drejtim?

Shkruani në ditarin tuaj të studimit ose diskutoni me shokun/shoqen tuaj si mund të bëni më shumë të mira gjatë ditës për të gjetur më shumë njerëz për t’i mësuar.

Besoni se njerëzit që janë duke u përgatitur për të pranuar mesazhin e Rivendosjes do të dërgohen në udhën tuaj. Perëndia gjithashtu do t’ju dërgojë atje ku fjalët dhe veprat tuaja të mira do të përgatisin njerëz për të pranuar misionarët dhe anëtarët e Kishës. Në të gjitha përpjekjet tuaja për të gjetur kërkues, lutuni dhe kërkoni mundësi për të ndihmuar dhe për t’i ngritur shpirtërisht të tjerët. Ndërsa shërbeni, flisni me këdo që takoni. Kini besim se ju mund të ndani ungjillin e rivendosur.

Në çdo mënyrë që shërbeni, duhet ta bëni këtë, sepse ju i doni vëllezërit e motrat tuaja prandaj shpresoni, lutuni dhe dëshironi singërisht t’u mësoni atyre ungjillin e rivendosur.

**Udhëzime****Kujtoni udhëzimet e mëposhtme ndërsa përpiqeni të bëni mirë:**

- Qëndroni me shokun/shoqen tuaj.
- Ruani natyrën e shenjtë të thirrjes suaj.
- Zbatoni rregullat misionare dhe mos dhuroni ose mos përdorni paratë tuaja.
- Shikoni *Missionary Handbook* për udhëzime në lidhje me shërbimin javor në komunitet.

**Studim i Shkrimeve të Shenjta****Cili ishte roli i shërbimit në jetën e Shpëtimtarit?**

3 Nefi 17:7, 21                      Mateu 9:1–8                      Gjoni 4:46–54  
 Mateu 8:1–4                      Marku 1:21–28

**Cili ishte roli i shërbimit në misionet e Amonit dhe Aaronit?**

Alma 17:19–25                      Alma 18:8–10                      Alma 22:3

**Çfarë ju kërkon Zoti të bëni?**

3 Nefi 27:21

**Asnjë Përpjekje Nuk Shkon Dëm**

Kur njerëzit zgjedhin të mos vazhdojnë të mësojnë më rreth ungjillit të rivendosur, puna juaj nuk ka shkuar dëm. Përpjekjet tuaja të vazhdueshme për të shërbyer dhe mësuar sa më shumë njerëz që të mundeni është një mënyrë se si Perëndia i përgatit fëmijët e Tij që së fundi të pranojnë mësimet e shërbëtorëve të Tij. Ai shpesh u afrohet fëmijëve të Tij nëpërmjet jush. Edhe kur njerëzit nuk e pranojnë mundësinë për të mësuar ungjillin, shërbimi dhe fjalët tuaja janë dëshmi e dashurisë së Perëndisë për ta dhe mund të mbjellin fara që misionarët e ardhshëm dhe anëtarët e Kishës mund t'i korrin.

Mos u dekurajoni kur njerëzit nuk e pranojnë ungjillin. Ju e keni ngritur zërin e paralajmërimit. Ju u keni dhënë atyre një zgjedhje të qartë. Dishepujt e Krishtit ndiejnë keqardhje kur njerëzit zgjedhin të mos pendohen, por megjithatë ata (dishepujt) e ruajnë vizionin e asaj se kush janë e çfarë po bëjnë. Ata vazhdojnë të ecin përpara me këmbëngulje.

**Mbani Mend**

- Ndërtoni Kishën duke gjetur “ata që do t’ju pranojnë” (DeB 42:8).
- Kërkoni dhe ndiqni Shpirtin kur përpiqeni të gjeni kërkues.
- Njerëzit në territorin tuaj po përgatiten të pranojnë ungjillin e rivendosur.
- Anëtarët e Kishës—përfshirë ata që janë aktivë, më pak aktivë, pleq të mundshëm dhe të porsakthyer në besim—janë burimet tuaja më të mira për të gjetur njerëz për t’i mësuar, pagëzuar dhe konfirmuar.
- Zhvilloni një marrëdhënie të fortë me peshkopin dhe anëtarët.
- Mësoni kur gjeni dhe gjeni kur mësoni
- Tregohuni të vëmendshëm ndaj mundësive të paplanifikuara për të gjetur kërkues.
- Lutuni për mundësi për të bërë mirë dhe për të predikuar mesazhin e Rivendosjes së ungjillit të Jezu Krishtit.
- Ka shumë mënyra për të gjetur njerëz për të mësuar. Shmangni përqendrimin në vetëm një ose dy mënyra.

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Lexoni letrën e mëposhtme të një misionareje drejtuar prindërve të saj: “Unë mësova një zonjë të mrekullueshme në autobus. Po ktheheshim nga mbledhja e distriktit, ishte i vetmi vend bosh dhe unë u ula e po shikoja postën time. Sigurisht e para ishte letra juaj me foto të bebes Evan. Vura re se sytë e personit pranë meje po shikonin gjithashtu fotot, e ngrita kokën dhe ndesha në vështrimin e një gruaje më të moshuar. Ajo më dha një gjysëm buzëqeshje dhe u kthye nga dritarja. Më pas ajo mbylli sytë sikur po flinte. Unë u luta, ‘Atë Qiellor, unë dua të flas më të. Të lutem më ndihmo.’ Pas një minute ajo hapi sytë dhe qëndroi drejt dhe unë i thashë pa humbur kohë: ‘Nuk të duket i bukur?’ I tregova foto të bebes Evan dhe fillova të flas me të rreth familjeve. E pyeta për fëmijët e saj dhe ajo u përlot e më tregoi historinë se si vajza e saj e urrente dhe nuk donte të kishte asnjë lidhje me të. Ajo qau e unë qava me të. Unë i tregova rreth planit të shpëtimit dhe se si Ati Qiellor e njez atë dhe e di se çfarë po përjeton ajo. Qava dhe i thashë se unë e dija se e bija e donte, sepse unë vetë jam bijë e një nëne që më do dhe unë e dua atë. I shpjegova se ndonjëherë njerëzit marrin vendime të gabuara dhe se bija e saj ka të drejtë të zgjedhë. Ajo më tha duke buzëqeshur: ‘Jam e sigurtë se nënën tënde e ka marrë shumë malli për ty dhe s’ka për të lënë të ikësh kur të shohë përsëri.’ Ajo më falënderoi për bisedën dhe më dha adresën që ne të mund të ndanim ungjillin me të. Kur po zbriste nga autobusi ajo më tha: ‘Hipa gabimisht në këtë autobus, por nuk zbrita. Askush nuk u ul pranë meje derisa erdhe ti...dhe shiko se çfarë ndodhi’. Plani i Perëndisë është i përkryer!”

Cilat parime nga ky kapitull vëreni në këtë tregim? Rishikoni kapitullin dhe bëni një listë në ditarin tuaj të studimit. Cilin nga këto parime mund të provoni sot?

- Lexoni Gjoni 15:12–13; 21:15–17; 1 Thesalonikasve 2; dhe Mosia 18:8–10. Sa mirë po e përmbushni përgjegjësinë tuaj për të dashur e për t’u shërbyer të tjerëve? Si mund të përmirësoheni? Shkruani përgjigjen në ditarin tuaj të studimit.
- Si mund ta kuptojnë njerëzit se ju jeni shërbëtor i Perëndisë? Ndërsa mendoni rreth kësaj pyetje, studioni Moroni 7:3–5; Mateu 7:20; Gjoni 13:34–35. Shkruani mendimet tuaja në ditarin tuaj të studimit.
- Lexoni 3 Nefi 18:31–32; Alma 8:16; Alma 24:7–8; dhe Alma 32:41. Mendoni se çfarë ju mësojnë këto vargje rreth punës me kërkuesit e mëparshëm. Shkruani ato që mësoni në ditarin tuaj të studimit dhe mësojani ato shokut/shoqes tuaj.

### Studim me Shokun

- Duke përdorur planifikuesin tuaj ditor, bëni plane të takoheni me të porsakthyer në besim. Kërkojuni atyre t’ju tregojnë se si ata u përgatitën për ungjillin. Bëni pyetje të tilla si: Kur ratë për herë të parë në kontakt me Kishën? Çfarë ju bindi përfundimisht të takoheshit me misionarët? Shkruani në ditarin tuaj të studimit se çfarë mësuat.
- Rishikoni secilën nga temat e mëposhtme. Duke përdorur mësimet, përgatisni një mënyrë të thjeshtë për të gjetur kërkues. Praktikoni të mësoni dikë në një situatë gjetjeje duke e lidhur menjëherë çdo temë që diskutoni me Rivendosjen.
  - Ndjenja e nevojës për më shumë drejtim dhe qëllim në jetë.
  - Dëshira për t’u afruar më pranë Perëndisë.
  - Nevoja për ndihmë për vendime të rëndësishme.
- Lexoni faqet 66–68 të *Our Search for Happiness* dhe faqet 47-50, 136-139 të librit *Të Vërtetë ndaj Besimit* për të kuptuar më mirë bazën doktrimore të punës së historisë familjare. Përgatisni një bisedë rreth punës së historisë familjare dhe ndajeni atë me shokun/shoqen tuaj.



- Imagjinoni sikur ju dhe shoku/shoqja juaj jeni transferuar në një territor të ri. Ju e gjeni librin e territorit në gjendje të mirë, por nuk keni kërkues. Çfarë do të bënit për të shtuar, sa më shpejt të jetë e mundur, njerëz në grupin e kërkuesve që marrin mësimet? Planifikoni që të zbatoni disa nga këto ide sot.
- Ideja e mëposhtme ka qenë e suksesshme për shumë misionarë dhe anëtarë. Lexoni dhe studioni këtë ide me shokun/shoqen tuaj.
  - Ndhimjoni anëtarët të bëjnë një listë të shokëve, të afërme dhe miqve me të cilët ata mund të ndajnë ungjillin. Rishikojeni këtë listë me anëtarët dhe ndihmijoni ata që me lutje të zgjedhin dikë që do të donin ta përgatisin të dëgjonte ungjillin.
  - Ndhimjoni të caktojnë një ditë kur ata (a) do të punojnë për të pasur një person apo familje të përgatitur për t'u mësuar në shtëpinë e tyre ose b) do të bëjnë një aktivitet tjetër miqësor për t'i përgatitur ata. Caktimi i një date u jep anëtarëve një qëllim dhe i ndihmon ata të ushtrojnë besimin.
  - Ndhimjoni ata të planifikojnë se ç'do të bëjnë duke filluar që tani e deri në datën e caktuar.
  - Ndiqni ecurinë e tyre rregullisht për t'i përkrahur dhe për t'i inkurajuar ata. Ftojini të diskutojnë sukseset dhe shqetësimet e tyre.

Diskutoni se si mund ta zbatoni këtë ide në territorin ku shërbeni.

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Lexoni dhe diskutoni seksionin “Gjetja nëpërmjet Përpjekjeve Tuaja.”
  - Diskutoni se si këto ide i kanë ndihmuar misionarët të gjejnë njerëz për të mësuar.
  - Në dërrasën e zezë, rendisni ide të tjera për gjetjen e njerëzve për të mësuar. I ftoni misionarët të demonstrojnë idetë e tyre.
  - I ftoni misionarët të vënë qëllime personale për të përmirësuar përpjekjet e tyre për të gjetur kërkues.
- Krijoni një listë të situatave gjetëse.
  - Caktijini secilit misionar një nga situatat. Jepini secilit misionar 5 minuta të përgatitë se si ai ose ajo do të mund t'ua mësonin njerëzve në atë situatë mesazhin e Rivendosjes. U thoni atyre t'i referohen “Mesazhi i Rivendosjes së Ungjillit të Jezu Krishtit” nëse është e nevojshme.
  - Nënvizoni rëndësinë e ruajtjes së një kohëzgjatjeje të caktuar të mesazhit në përputhje me situatën. Për shembull, misionarët mund të shpenzojnë më shumë kohë duke mësuar në shtëpinë e një anëtari se sa po të mësonin dikë në një dyqan.
  - Lejoni aq misionarë sa ua lejon koha për të mësuar mesazhin e Rivendosjes në situatën e caktuar.
- Diskutoni parimet që gjenden në seksionin “Mësoni Kur Gjeni, Gjeni Kur Mësoni”
  - Caktoni secilin misionar të përgatisë një mesazh një-minutësh që ai apo ajo mund të ndajë në një situatë gjetëse. Këto mesazhe duhet të bazohen në doktrinën që gjendet në mësimet misionare.
  - Ftojini misionarët të praktikojnë ndarjen e mesazhit të tyre një-minutësh me njëri tjetrin. Ju mund të doni të krijoni një larmi të situatave gjetëse, të tilla si mësimi në shtëpinë e një anëtari, mësim në pragun e derës, në një trotuar apo

Shënime

kontaktimi i një të rekomanduari. U kërkoni misionarëve të praktikojnë se si do të japin mësim në secilën prej këtyre situatave.

### Presidenti i Misionit

- Jepni një shembull të punës anëtar-misionar në familjen tuaj. Ndani përvojat tuaja me misionarët dhe anëtarët.
- Këshillohuni me udhëheqësit e priftërisë për sa i përket mënyrave më të mira se si misionarët mund të gjejnë njerëz për të mësuar në misionin tuaj.
- Organizoni mbledhje misionare rreth vatrës ku mund t'u flisni kërkuesve në misionin tuaj. Bashkëpunoni me udhëheqësit lokalë të priftërisë që në këtë mbledhje rreth vatrës të marrin pjesë edhe anëtarë që mund të sjellin miqtë e tyre. Si pjesë e këtyre mbledhjeve, u kërkoni të porsakthyerve në besim të japin dëshmi dhe të tregojnë historinë e kthimit të tyre në besim para se ju ta merrni fjalën. Përqendrojini komentet tuaja në mesazhin e Rivendosjes.
- Tregojani tabelën tuaj të prejardhjes familjare prej katër brezash misionarëve dhe shpjegojuni si e përdorni ju atë në përpjekjet tuaja gjetëse.
- Herë pas here, shkoni me misionarët për t'i ndihmuar ata të gjejnë njerëz për të mësuar.



# Si Mund t'i Përmirësoj Aftësitë e Mësimdhënies?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Si duhet t'ua mësoj të tjerëve shkrimet e shenjta?
- Pse duhet të bëj pyetje kur jap mësim?
- Çfarë lloj pyetjesh duhet të bëj?
- Si mund t'i dëgjoj më mirë ata që mësoj dhe Shpirtin?
- Si mund t'i ndihmoj njerëzit të zgjidhin problemet e tyre?
- Si mund t'i ndihmoj të tjerët të mposhtin veset e këqija dhe varësitë prej tyre?

**J**u jeni thirrur t'u mësoni ungjillin e rivendosur të gjithë atyre që do t'ju dëgjojnë. Mësimi është në qendër të gjithçkaje që bëni. Ju zhvilloni cilësi si të Krishtit, studioni mësimet misionare, përmirësoni aftësinë tuaj për të folur në gjuhën e misionit tuaj dhe mbështeteni tek Shpirti në mënyrë që t'i mësoni të tjerët me fuqi bindëse. Zoti e shpalli këtë shumë thjesht si një urdhërim me një premtim: “Mos kërko të shpallësh fjalën time, por së pari ta fitosh fjalën time dhe atëherë gjuha jote do të zgjidhet; atëherë, nëse dëshiron, ti do të kesh Shpirtin tim dhe fjalën time, po, fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit” (DeB 11:21).

“Mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës dhe do t'ju jepet në çastin e duhur ajo pjesë që do t'i shpërndahet çdo njeriu” (DeB 84:85).

Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve ka deklaruar: “Qëllimi ynë është që t'ua mësojmë të tjerëve mesazhin e ungjillit të rivendosur në mënyrë të tillë që ta lejojmë Shpirtin të drejtojë si misionarët, ashtu edhe njerëzit që ata mësojnë. Është e rëndësishme që të mësohen [mësimet e misionarëve], por ato nuk duhen t'u mësohen të tjerëve si prezantime të mësuara përmendësh. Misionari duhet të ndihet i lirë të përdorë fjalët e veta ashtu siç nxitet nga Shpirti. Ai nuk duhet të paraqesë një recitim të cilin e ka

## Shënime

mësuar përmendësh, por të flasë nga zemra me fjalët e veta. Ai mund të mos ndjekë rendin e mësimëve, duke dhënë atë që është i frymëzuar të thotë, sipas interesit dhe nevojave të kërkuesve. Duke folur nga bindja e tij personale dhe me fjalët e veta ai duhet të dëshmojë për vërtetësinë e mësimëve të tij” (“Deklaratë rreth Punës Misionare,” letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002.

Mësohuni të mbështeteni te Shpirti që t’ju tregojë se çfarë duhet të thoni dhe të bëni. Duke studiuar, zhvilluar dhe përdorur aftësitë e mësimdhënies në këtë kapitull, ju do të bëheni një mjet më i aftë në duart e Zotit. Shpirti do të përdorë si burim njohuritë dhe aftësitë që keni fituar, për t’ju ndihmuar që t’i mësoni të tjerët me më tepër fuqi. Cilësia dhe fuqia e mësimdhënies tuaj do t’i ndihmojnë të tjerët të kuptojnë dhe të ndiejnë rëndësinë që ka për ta ungjilli i rivendosur. Të kuptuarit e tyre do të varet nga denjësia juaj personale. Të kuptuarit e tyre do të ndikohet gjithashtu edhe nga vëmendja që ju tregoni ndaj tyre, nga sa mirë ua shpjegoni ungjillin, përdorni shkrimet, ndani dëshmitë tuaja dhe i ftoni ata të marrin e mbajnë zotime.

**Ndiqui Shpirtin**

“Shpirti është elementi i vetëm më i rëndësishëm i kësaj pune. Me Shpirtin që lartëson thirrjen tuaj, ju mund të bëni mrekulli për Zotin, në fushën e misionit. Pa Shpirtin, ju kurrë nuk do të përparoni pavarësisht nga talenti dhe aftësitë tuaja” (Ezra Taft Benson, seminar për presidentët e rinj të misionit, 25 qershor 1986).

**Ftoni Shpirtin**

Sugjerimet e mëposhtme do t’ju ndihmojnë të ftoni Shpirtin ndërsa mësoni të tjerët:

- Lutuni.
- Përdorni shkrimet e shenjta.
- Jepni dëshmi.
- Ndani përvoja.
- Shprehni dashuri për Zotin dhe për të tjerët.

**Si të Filloni Mësimdhënien**

Çastet e para me kërkuesit janë shumë të rëndësishme. Kërkuesit duhet të mësojnë të kenë besim tek ju. Fillojeni vizitën e parë në një mënyrë të ngrohtë, të sinqertë e të respektueshme. Bëni disa pyetje të thjeshta për t’ju ndihmuar të kuptoni se cilës fe i përkasin dhe çfarë presin nga vizita juaj. Për shembull, pyesni: “Çfarë roli ka luajtur besimi fetar në jetën tuaj?” Megjithatë, mos bëni pyetje personale që t’i vini ata në pozitë të vështirë.

Para se të filloni, u kërkoni të gjithëve që janë të pranishëm të bashkohen me ju në mësim. I nxisni ata të fikin televizorin dhe të largojnë çdo gjë tjetër që do t’u tërhiqte vëmendjen në mënyrë që Shpirti i Zotit të mos pengohet.

Shpjegoni se ju do të donit ta fillonit dhe ta mbaronit çdo mësim me lutje. Sugjeroni që ta ofroni ju lutjen e hapjes. Lutuni thjesht, por me gjithë zemër që Zoti t’i bekojë njerëzit që ju po mësoni në çdo aspekt të jetës së tyre, e veçanërisht që ata të mund të ndiejnë të vërtetën e asaj që po u mësoni.

Tregoni dashuri dhe interes të sinqertë për kërkuesit dhe besim në fuqinë kthyesë të ungjillit (shih Moroni 7:43–48). Sipas udhëheqjes së Shpirtit, ju mund t’u flisni kërkuesve tuaj rreth mendimeve të mëposhtme:

- Duke qenë se Perëndia është Ati Ynë Qiellor, ne jemi vëllezër dhe motra. Do të na pëlqente t’u drejtoheshim si vëllezër e motra.

- Çdo person që ne mësojmë ka sfida dhe shqetësime personale. Pavarësisht se cilat janë nevojat apo shqetësimet tuaja, Shpëtimtari dhe mësimet e Tij—ungjilli—do t’ju ndihmojnë.
- Mesazhi ynë do t’ju ndihmojë të përmirësoni cilësinë e jetës suaj. Ai do t’ju ndihmojë të zgjidhni problemet dhe sfidat që secili nga ne has në jetë.
- Mesazhi ynë, që përqendrohet te Jezu Krishti, ka vlerë e rëndësi të madhe.
- Ne të gjithë bëjmë gabime në jetë dhe këto gabime krijojnë ndjesinë e fajit dhe turpit. Këto ndjenja nuk mund të lehtësohen pa pendim dhe falje. Ato mund të shërohen plotësisht nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit.
- Mesazhi ynë nuk mund të mësohet i gjithi menjëherë. Ai mund të kuptohet me kalimin e kohës nëpërmjet lutjes, studimit, përvojës dhe mbajtjes së urdhërimeve të Perëndisë.
- Ne kemi dobësi, ashtu siç ka çdo njeri. Ne mbase nuk e flasim gjuhën shumë mirë ose nuk jemi të aftë t’u përgjigjemi të gjitha pyetjeve tuaja. Por ne jemi thirrur nga një profet i Perëndisë të ndajmë atë që dimë. Ne e dimë se mesazhi ynë është i vërtetë.
- Ne do të shërbejmë si udhërrëfyes për ju që ju të mund të mësoni të vërtetën e mesazhit tonë për veten tuaj. Është zgjedhja juaj ta pranoni dhe të veproni sipas këtij mesazhi. Prandaj, ju duhet të ndiheni të lirë të bëni pyetje.
- Ndërsa do të përpiqeni sinqerisht për ta kuptuar mesazhin tonë, ju mund të hasni vështirësi, por Perëndia do t’ju ndihmojë.
- Ndërsa pranoni mesazhin tonë, ju do të mësoni si të bëni besëlidhje, ose premtime, me Perëndinë. Ju do të mësoni si të bëni ndryshime për ta sjellë jetën tuaj në harmoni të plotë me mësimet e Tij. Ju do të doni të ndiqni mësimet e Jezu Krishtit dhe të pagëzoheni nëpërmjet autoritetit të duhur (shih Gjoni 3:5).

Përpara se të filloni të mësoni doktrinat që përmban mësimi, kini parasysh të jepni një përmbledhje të thjeshtë të asaj që do të mësoni. Ndihmojini njerëzit të kuptojnë se ajo që do t’u mësoni do të lidhet personalisht me ta. Shumë nga kërkuesit që mësoni janë përgatitur nga Zoti (shih Alma 16:16–17). Ndërsa ndani përvoja shpirtërore së bashku në takimin e parë, ata do t’ju pranojnë si shërbëtorë të Zotit.

#### Aktivitet: Studim me Shokun

Me shokun/shoqen tuaj, praktikoni mënyra të ndryshme për të filluar një mësim duke përdorur disa nga këto sugjerime.

### Përshtatjani Mësimdhënien Tuaj Nevojave

Çdo person ose familje që mësoni, është unike. Edhe pse ju nuk do t’i kuptoni të gjitha interesat, arritjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, ju duhet të përpiqeni të jeni të ndjeshëm ndaj rrethanave të tyre. Pavarësisht nga nevojat apo problemet, të gjithë njerëzit ndihmohen më mirë kur ata pranojnë dhe jetojnë ungjillin. Ju do të mund ta përshtasni mësimdhënien tuaj ndërsa dëgjoni nxitjet e Shpirtit.

Ju mund ta ndryshoni rendin e mësimëve sipas frymëzimit që t’u



## Shënime

përshtateni nevojave dhe interesave të kërkuesve. Ju mund të përdorni më shumë se një takim për t'iu mësuar parimet që përmban një mësim dhe ndonjëherë mund të ndodhë që të mësoni përmbajtjen e dy mësimëve në një takim të vetëm. Ati Qiellor i njeh fëmijët e Tij, prandaj mbështetuni në frymëzimin që ju vjen për të marrë këto vendime ndërsa jepni mësim. Lutuni që të keni dhuratën e aftësisë për të dalluar dhe kushtojini vëmendje mendimeve që ju vijnë në mendje ose ndjenjave që keni rreth asaj që mësoni.

Juve do t'ju duhet ta përshtasni mësimdhënien tuaj në mënyrë të atillë që t'i kushtoni më shumë vëmendje atyre zotimeve që janë më të vështira për t'u mbajtur nga një kërkues. Për shembull, një person mund ta pranojë me lehtësi Librin e Mormonit si fjalën e Perëndisë, ndërsa një tjetër mund ta ketë të vështirë të pranojë çdo gjë tjetër veç Biblës. Një person mund ta ketë të vështirë ta lërë duhanin, por me gatishmëri do ta pranojë ligjin e të dhjetës.

Ndërsa planifikoni të mësoni doktrina të caktuara, jini të ndjeshëm rreth asaj se sa shumë informacion të ri ndani. Mësoni sipas një ritmi të përshtatshëm për kërkuesit. Disa do të përparojnë më shpejt ose më ngadalë se të tjerët. Sigurohuni që të bëni mjaft pyetje dhe të dëgjoni me kujdes përgjigjet e tyre për ta kuptuar mirë se sa shpejt dhe sa mirë kërkuesi po mëson dhe zbaton doktrinat që ju po i paraqisni.

Tregohuni të ndjeshëm ndaj kohës. Shumica e takimeve të mësimin nuk duhet të zgjasin më shumë se 45 minuta. Gjithsesi, një vizitë mësimi mund të përfundojë brenda 15 ose 20 minutave nëse është e nevojshme. Nëse personi ka vetëm 15 minuta kohë për t'u takuar me ju, përshtateni mësimin në mënyrë që të respektoni këtë limit kohor.

Besoni në premtimin se Shpirti "do t'ju [japë] në orën e duhur, po, në çastin e duhur, se çfarë duhet të thoni" (DeB 100:6).

**Aktivitet: Studim Individual**

Imagjinoni sikur po ecni në rrugë dhe vini re një burrë të moshuar që po mundohet të hedhë disa qese të rënda plehërash në kazanin e mbeturinave. Ju dhe shoku/shoqja juaj e ndihmoni dhe më pas ai ju pyet se kush jeni. Mbas disa diskutimesh, ai ju fton në shtëpi dhe pranon të dëgjojë mesazhin tuaj. Gjatë bisedës së parë ai ju tregon se:

- Gruaja e tij vdiq një vit më parë dhe ai ka vërtetë mall për të.
- Ai lodhet shpejt për arsye të problemeve të zemrës.
- Ai është kurioz, tani më shumë se kurrë, nëse Perëndia ekziston.

Çfarë mund t'i mësoni atij? Si mund ta përshtasni mësimin tuaj në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet më mirë nevojave dhe shqetësimeve të tij?

**Studim i Shkrimeve të Shenjta**

**Çfarë do të thotë "do t'ju jepet në çastin e duhur ajo pjesë që do t'i shpërndahet çdo njeriu"?**

Alma 29:8

DeB 84:85

**Çfarë u ka premtuar Zoti misionarëve besnikë?**

DeB 68:2–4

DeB 100:5–8

Mateu 10:19–20

**Mësoni në Unitet me Shokun Tuaj**

Zoti na ka urdhëruar: "Ju do të shkoni në fuqinë e Shpirtit tim, duke predikuar ungjillin tim, dy e nga dy" ( DeB 42:6). Mësimi juaj do të jetë më i fuqishëm e më interesant nëse ju dhe shoku/shoqja juaj punoni së bashku në unitet. Ndërsa planifikoni e studioni çdo ditë, diskutoni se si do të mësoni kështu që të jeni të bashkuar e të mësoni me një zë.

Mësimi juaj do të jetë më i fuqishëm nëse ju dhe shoku/shoqja juaj jepni me radhë pjesë të shkurtra të mësimit. Shmangni rënien në një rutinë gjatë prezantimit të mesazhit. Mbështeteni shokun/shoqen tuaj duke ofruar një dëshmi të dytë të së vërtetës për të cilën, ai ose ajo, ka dëshmuar. Ndiqni ndjenjat tuaja kur Shpirti ju nxit të thoni diçka. Si shokë/shoqe, jini të gatshëm t'i hapni rrugë njëri-tjetrit që të mos pengoni udhëheqjen e Shpirtit. Kur flisni, shikojeni në sy kërkuesin. Kur nuk flisni, lutuni për shokun/shoqen dhe me kujdes vëreni reagimet e kërkuesve.



### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Si e mbështesin shokët/shoqet njëri-tjetrin?

Alma 12:1

DeB 42:6

DeB 52:9–10

## Ftojini Anëtarë t'ju Ndhimojnë në Mësimdhënie

Sa herë që është e mundur ftoni anëtarë, mundësisht të porsakthyer në besim, t'ju ndihmojnë të jepni mësim. Situata ideale është të përfshini anëtarë të Kishës që më parë i përkisnin të njëjtës kishë si kërkuesit. U tregoni anëtarëve një kopje të mësimit dhe diskutoni se çfarë doni që ata të mësojnë. Diskutoni si do të punoni së bashku. Për shembull, si të jetë e përshtatshme, u kërkoni anëtarëve të tregojnë si ata arritën të mësojnë, të pranojnë dhe të jetojnë një parim të veçantë që diskutohet në mësim. U kërkoni atyre të tregojnë si e morën vendimin për t'u bashkuar me Kishën. Kur ju dhe anëtarët jepni mësim së bashku, ata do të kenë mundësi të ndiejnë gëzimin e punës misionare. Kjo gjithashtu siguron miqësi për kërkuesin. Presidenti Tomas S. Monson mësoi:

*Gjatë procesit të mësimdhënies, kërkuesit mund të përfitojnë nga forca e dëshmisë së një çifti anëtarësh, të cilët në vitet e fundit e kanë bërë hapin drejt pagëzimit dhe anëtarësisë. Në Misionin Kanadez në Ontario dhe Kebek, ku jetoi familja jonë kur unë kryesova mbi misionin, ne mësuam se shumica e popullsisë i përkiste ndoshta tre besimeve mbizotëruese: Kishës Katolike me qendër në Romë, Kishës Anglikane dhe Kishës së Bashkuar të Kanadasë. Në çdo qytet të misionit ne bëmë të mundur që një familje e sapopagëzuar, që vinte nga secili prej këtyre besimeve, të ishte në dispozicion të misionarëve, të cilët ishin në procesin e të mësuarit të kërkuesve të rinj, me qëllim që një çift anëtarësh të mund ta shoqëronte dyshen misionare ndoshta në vizitën e tyre të dytë apo të tretë.*

*A mund ta vlerësoni, për shembull, kur misionarët [po] punonin me ata që vinin nga Kisha e Bashkuar e Kanadasë, forcën e dëshmisë së [një vëllai dhe motre] të cilët kishin ardhur nga Kisha e Bashkuar e Kanadasë. [Bashkëshorti] do të thoshte: "Kur u bashkova me Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, ... gjeta të vërtetën në plotësinë e saj. Edhe ju mund ta bëni ndryshimin. Edhe ju mund të merrni të njëjtin vendim. Në fakt, na lejoni të vimë t'ju marrim të dielën në mëngjes, që të mund të ulemi së bashku në kishë. Më pas ju mund të dëgjoni dhe ndieni vetë. Do të jemi pranë jush."*

*Enthëni dhe Edit Belfilio u bënë një çift i tillë shoqërues për ata që kishin rrënjë nga Kisha Katolike e Romës. Përfundimi ishte i njëjtë. Mund të bëhet. Dhe të kthyer të tillë në besim, mbeten të kthyer. Përveç kësaj, çiftet e zgjedhura për ta përmbushur këtë detyrë të caktuar, i hodhën vetë rrënjët e tyre më thellë në një tokë të pasur të ungjillit. ... Vëllai Belfilio u bë [një*

## Shënime

*patriark] i shuguruar. Përpyqjet e bashkuara të anëtarëve dhe misionarëve në një bashkëpunim të tillë të veçantë, dhuruan një grumbullim të bollshëm të shpirtave të çmuar (transmetimi satelitor për trajnimin e misionarëve, 25 prill 2003).*

**Aktivitet: Studim Individual**

Mendoni sikur keni takimin e parë për t'i mësuar një mësim një familjeje në shtëpinë e një anëtarit. Vendosni si do ta përgatisnit secilin nga anëtarët e mëposhtëm për t'ju ndihmuar gjatë mësimin:

- Një misionar lagjeje që sapo është kthyer nga një mision me kohë të plotë
- Një prift
- Një të porsakthyer në besim
- Peshkopin

**Përdorni Shkrimet e Shenjta**

Veprat standarde të Kishës janë burimet tuaja bazë për mësimin e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Ju gjithashtu mund të përdorni fjalët e profetëve të gjallë. Ka shumë arsye se përse është e domosdoshme që t'i përdorni shkrimet e shenjta si bazë për mësimdhënien tuaj. Për shembull:

- Zoti dhe profetët e Tij na kanë udhëzuar ta bëjmë këtë (shih DeB 42:12, 56–58; 71:1). Një profet i ditëve të mëvonshme na këshilloi: “Fjalët dhe mënyra si ato janë përdorur në Librin e Mormonit nga Zoti...duhet të përdoren nga ne për mësimin e parimeve të ungjillit” (Ezra Taft Benson, “The Book of Mormon and the Doctrine and Covenants,” *Ensign*, maj 1987, 84).
- Shkrimet e shenjta ftojnë Frymën e Shenjtë në mësimdhënien tuaj. Ato mësojnë fjalën e Perëndisë me fuqi (shih Alma 31:5).
- Shkrimet e shenjta u përgjigjen pyetjeve të mëdha të shpirtit (shih 2 Nefi 32:3, Jakobi 2:8 LiM).
- Shkrimet e shenjta u japin autoritet dhe vërtetësi mësimëve tuaja, madje edhe në ato zona me prejardhje jo të krishtere.

Aftësia juaj për të mësuar me fuqi nga shkrimet e shenjta vjen në një masë të madhe nga koha që ju personalisht kaloni për t'i studiuar ato. Ndërsa ushqeheni me fjalën çdo ditë, aftësia juaj për të mësuar nga shkrimet e shenjta do të përmirësohet. Për më tepër, ftesat tuaja për të studiuar e medituar shkrimet e shenjta do të bëhen më të fuqishme, sepse ju po bëni të njëjtën gjë në jetën tuaj. I ndihmoni njerëzit të fitojnë besim në shkrimet e shenjta—veçanërisht në Librin e Mormonit—si burime të së vërtetës që na është zbuluar. Kur njerëzit arrijnë të besojnë shkrimet e shenjta, ju do të jeni më mirë në gjendje t'i ndihmoni ata për t'i kuptuar më saktë doktrinën. Sugjerimet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë.



© Greg K. Olsen. Ndarohet fotokopjimi



**Prezantoni shkrimin e shenjtë.** Përshkruani shkurtimisht sfondin historik dhe kontekstin e fragmentit që do të përdorni. Ftojini kërkuesin të kërkojë pika të veçanta në atë fragment. Kur po mësoni njerëz me njohuri të kufizuara në shkrimet e shenjta, mund t'ju duhet të filloni me përshkrimin e përmbajtjes së një fragmenti, duke përdorur një gjuhë të kuptueshme për ta. Më poshtë gjenden disa shembuj në lidhje me prezantimin e një shkrimi të shenjtë:

- “Këtu në historinë e Jozef Smithit kemi fjalët e vetë Jozefit që na tregojnë se çfarë i ndodhi atij kur vajti të lutej në koriye. Ai tha: ‘Unë pashë një shtyllë drite...’”
- “Në këtë fragment profeti Alma po i mëson njerëzve të varfër të ushtrojnë besimin e tyre në fjalët e Perëndisë. Ai i krahason fjalët e Perëndisë me një farë që mund të mbillet në zemrat tona. Do të filloni të lexoni vargun...”

**Lexoni fragmentin.** Lexoni vargjet me zë të lartë ose i kërkonti kërkuesit ta bëjë këtë.

Tregohuni të ndjeshëm ndaj atyre që kanë vështirësi në lexim. Nëse ata e kanë të vështirë për ta kuptuar një fragment, lexoni së bashku me kujdes dhe ndihmohuni ata të kuptojnë pikat më të vështira. Ose u jepni atyre të lexojnë një fragment më të thjeshtë. Ju gjithashtu mund të përkufizoni fjalët ose frazat e vështira.

- “Le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, [‘pa qortuar’ do të thotë që Perëndia nuk do ta quaj fajtor] dhe atij do t’i jepet” (Jakobi 1:5 Dhjata e Re).

Disa fragmente të shkrimeve të shenjta janë të qarta dhe nuk kanë nevojë për shpjegim. Ndërsa për disa të tjera mund t’ju duhet pak kohë për të shpjeguar se çfarë u lexua.

**Zbatoni shkrimin e shenjtë.** “Përshtatini” shkrimet me veten dhe kërkuesit duke treguar se si parimet lidhen me të sotmen (shih 1 Nefi 19:23). U tregoni kërkuesve se si ata mund t’i zbatojnë parimet në jetën e tyre. Ndërsa e bëjnë këtë, ata do të arrijnë të kuptojnë se doktrina është e vërtetë. Jepni dëshminë tuaj për parimin dhe u premtoni atyre bekime. Për shembull:

- “Njerëzit e Almës, ashtu si dhe ju, ishin ngarkuar me barra të rënda, pothuajse më shumë nga ç’mund të duronin. Por ndërsa ushtruan besim dhe ‘iu lutën me gjithë fuqi Perëndisë,’ Ai i forcoi ata që të duronin vështirësitë dhe më pas i çliroi nga vuajtjet e tyre. Po ashtu siç veptoi me këta njerëz, unë e di se Perëndia do t’ju ndihmojë edhe ju në vuajtjet tuaja ndërsa ju...”
- “Këshilla e Almës për njerëzit në ujërat e Mormonit gjen zbatim edhe tek ne sot. Gjon, a je i gatshëm të...”

Njerëzit që ju mësoni ndryshojnë së tepërmi në atë se si ata i konsiderojnë tekstet e shenjta, sa e njohin Biblën, sa mirë e kuptojnë gjuhën e shkrimeve të shenjta dhe në ç’masë besojnë ata se Bibla përmban fjalën e Perëndisë. Ndihmohuni të gjithë kërkuesit t’i vlerësojnë shkrimet e shenjta. Duke përdorur në mënyrë efektive shkrimet e shenjta në mësimdhënien tuaj, ju mund t’i ndihmoni kërkuesit të fillojnë vetë studimin e shkrimeve të shenjta. Mbas çdo vizite, u sugjeroni atyre të lexojnë kapituj ose vargje të veçanta. Ju mund t’i jepni atyre pyetje që mund t’i mbajnë parasysh ndërsa i lexojnë këto shkrime, të cilat mund t’i diskutoni në takimin e ardhshëm. Kjo do t’i nxisë ata t’i studiojnë çdo ditë shkrimet e shenjta në shtëpitë e tyre dhe të marrin pjesë në mbledhjet dhe klasat e Kishës ku përdoren shkrimet e shenjta.

### Nocionet Kulturore rreth Shkrimeve të Shenjta

Pjesa më e madhe e besimeve fetare kanë tekste të shenjta ose libra të shkrimeve të shenjta, por përdorimi dhe perceptimi i tyre mund të jetë i ndryshëm nga mënyra se si anëtarët e Kishës i konsiderojnë shkrimet e shenjta. Për shembull, ju mund t'ju duhet të shpjegoni se shënimet tuaja në shkrimet e shenjta dëshmojnë për dëshirën tuaj për t'i kuptuar dhe zbatuar mësimet e shkrimeve të shenjta dhe nuk janë një shenjë që tregon mungesë respekti. Ndhimojini ata që mësoni të kuptojnë se veprat standarde janë të rëndësishme, sepse ato përmbajnë fjalën e Zotit siç është shkruar nga profetët e Perëndisë dhe se ne i pranojmë ato si të vërteta.

### Aktivitet: Studim me Shokun

#### Rishikoni një nga fragmentet e mëposhtme. Vendosni si:

- Do të prezantoni fragmentin.
- Do të shpjegoni sfondin dhe kontekstin.
- Do të lexoni fragmentin dhe shpjegoni kuptimin e tij.
- Do t'i shpjegoni fjalët e vështira.
- Do t'i ndihmoni kërkuesit t'i zbatojnë ato në jetën e tyre.

Faqja e Titullit të Librit të Mormonit; 3 Nefi 11; Moroni 10:3–8; Gjoni 17:3; Romakëve 8:16–17; 1 Korintasve 15:29; Jakobi 1:5 (Dhjata e Re); 1 Pjetri 3:19–20; Amosi 3:7

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Pse është e rëndësishme t'i mësoni të tjerët nga shkrimet e shenjta?

1 Nefi 19:23  
2 Nefi 4:15–16

DeB 20:7–12

2 Timoteut 3:15–17

## Mësoni për të Kuptuar

Njerëzit mund ta kenë më të lehtë për ta besuar mesazhin e Rivendosjes së ungjillit kur ata e kuptojnë mesazhin. Presidenti Xheims E. Faust tha: “Studioni, meditoni dhe i mësoni të tjerët nga shkrimet e shenjta, veçanërisht nga Libri i Mormonit dhe Dhjata e Re. Njiheni të vërtetën aq mirë sa ta deklaroni atë me qartësi. B. H. Roberts shkroi: ‘Që të njihet, e vërteta duhet të shpallet dhe sa më e qartë dhe e plotë të jetë kjo shpallje, aq mundësi më të mëdha do të ketë Shpirti i Shenjtë për t’iu dëshmuar shpirttrave të njerëzve se kjo punë është e vërtetë.’ [New Witnesses for God, 3 vols. (1909), 2:vii]. Ju nuk mund t’i ktheni në besim të tjerët përtej asaj mase që ju vetë jeni të kthyer në besim” (“What I Want My Son to Know before He Leaves on His Mission,” *Ensign*, maj 1996, 41).

Ju jeni urdhëruar t’i analizoni dhe shpjegoni shkrimet e shenjta kur jepni mësim (shih DeB 68:1). *Të shpjegosh* do të thotë të shtjellosh dhe të qartësosh. Shpjegimi i ungjillit do të thotë se ju e shpjegoni kuptimin e doktrinës dhe të fragmenteve të shkrimeve të shenjta

*“Është zgjuarsia e vërtetë që një njeri të marrë një subjekt që është i panjohur dhe i madh në vetvete, e ta shpaltosë dhe ta thjeshtëzojë atë, në mënyrë që edhe një fëmijë të mund ta kuptojë.”*

—PRESIDENTI XHON TEJLËR  
THE GOSPEL KINGDOM, PËRZGJ.  
G. HOMER DURHAM (1943), 270

thjesht dhe qartë, duke u bazuar tek Shpirti për t'ju udhëhequr se çfarë duhet të thoni. Ju duhet të përdorni një gjuhë dinjitoze, por të thjeshtë për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë parimin doktrinor. Ju bëni pyetje për t'i ndihmuar ata të mendojnë rreth parimeve dhe për të parë nëse ata e kuptojnë dhe e pranojnë atë që ju u keni mësuar.

Në fund të secilit prej tre mësimëve të para në kapitullin 3 ndodhet një listë fjalësh që mund të jenë të panjohura për ata që ju mësoni. Pjesë e mësimdhënies për të kuptuar, është të siguroheni që t'i shpjegoni fjalët, frazat dhe idetë në mënyrë që të tjerët t'ju kuptojnë më mirë. Ju mund ta përmirësoni aftësinë tuaj për të shpjeguar ungjillin duke:

- Kuptuar fjalët që përdorni.
- Përkufizuar fjalët që të tjerët mund të mos i kuptojnë. Shumë fjalë që kanë kuptime të veçanta për anëtarët e Kishës janë përkufizuar thjesht në Udhëzuesin për Shkrimet e Shenjta dhe *Të Vërtetë Ndaj Besimit*.
- Duke u bërë njerëzve pyetje të tilla si: "A e kuptoni se çfarë nënkuptojmë kur themi...?" Ose "A mund ta përsërisni me fjalët tuaja atë që sapo thamë?"

Ndërsa studioni doktrinën në kapitullin 3, gjeni fjalë që ju mendoni se mund të jenë të vështira për një kërkues. Ndërsa u mësoni të tjerëve doktrinën në kapitullin 3, mbani shënime rreth fjalëve, frazave dhe ideve që janë të vështira për t'u kuptuar nga kërkuesit. Përkufizojini këto fjalë duke përdorur burimet e përmendura më sipër. Provoni nëse kërkuesit dhe të porsakthyerit në besim i kuptojnë përkufizimet tuaja.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Pse duhet t'i shpjegojmë ose t'i qartësojmë me kujdes doktrinën?

Mosia 8:3	Alma 12:1	DeB 68:1–5
Mosia 27:35	3 Nefi 26:1	DeB 71:1

#### Si mësojmë ne? Pse është e rëndësishme të shpalojmë ose të zbulojmë gradualisht informacionin?

2 Nefi 28:30	Mosia 2:9	DeB 98:11–12
Jakobi 4:13 (LiM)		

#### Pse është e rëndësishme qartësia?

2 Nefi 25:4, 7, 28	Alma 13:23	Nehemia 8:8
2 Nefi 32:7		

#### Si komunikon Zoti me fëmijët e Tij?

2 Nefi 31:3	DeB 1:24
-------------	----------

## Bëni Pyetje

Jezu Krishti shpesh bënte pyetje për t'i ndihmuar njerëzit të meditonin dhe të zbatonin parimet. Pyetjet e Tij nxisnin mendimin, kërkimin e shpirtit dhe zotimin.

Pyetjet e mira do t'ju ndihmojnë të kuptoni interesat, shqetësimet ose pyetjet që kanë të tjerët. Ato mund ta përmirësojnë mësimdhënien tuaj, të ftojnë Shpirtin dhe t'i ndihmojnë kërkuesit tuaj të mësojnë.

## Shënime

Pyetjet e dobëta mund t'i frikësojnë, bezdisin dhe fyejnë kërkuesit. Ato gjithashtu mund të bëjnë që ju të humbisni kontrollin e situatës gjatë mësimit. Mundohuni të bëni pyetje që:

- Janë të thjeshta dhe të lehta për t'u kuptuar.
- I ndihmojnë njerëzit të mendojnë rreth atyre që po u mësoni.
- Ju ndihmojnë të shikoni sa mirë kërkuesi e kupton atë që po i mësoni.
- I ndihmojnë njerëzit të zbatojnë atë që po u mësoni.



Ndërsa ata që ju mësoni u përgjigjen këtyre lloj pyetjesh, ata do ta kuptojnë se mund të flasin hapur. Pyetjet e mira mund t'i shtyjnë kërkuesit t'ju bëjnë pyetje kur ata nuk kuptojnë, kur kanë ndonjë shqetësim, apo kur ata duan të dinë se çfarë duhet të bëjnë. Pyetjet e mira mund t'i ndihmojnë ata që ju mësoni të ndajnë ndjenjat e tyre dhe duke e bërë këtë të zbulojnë një dëshmi në rritje. Shembuj të pyetjeve efektive përfshijnë:

- Çfarë pyetjesh keni rreth atyre që ju kemi mësuar?
- A besoni se Ati Qiellor ju do? Pse?
- Si bëjmë edhe ne nganjëherë të njëjtat gabime si njerëzit në këtë histori?

Për t'i ndihmuar ata që mësoni të përgatiten për t'iu përgjigjur pyetjeve, ju mund të thoni: "Ndërsa unë shpjegoj rëndësinë e mbajtjes të shenjtë të ditës së Shabatit, pyesni veten: 'Çfarë do të thotë për mua ky urdhërim?'" Shmangni pyetjet që:

- Përfshijnë më shumë se një ide.
- U referohen doktrinave për të cilat nuk keni diskutuar ende.
- Nuk kanë një qëllim të përcaktuar.
- Hetojnë dhe fusin hundët në punët e të tjerëve.

Bërja e shumë pyetjeve, veçanërisht në vizitën tuaj të parë, krijon përshtypjen se po kryeni një "hetim." Mos u kërkoni kërkuesve të japin përgjigje specifike rreth gjërave të parëndësishme apo detajeve të dukshme. Kjo do ta kthente një mjedis të mirë mësimi në një lojë hamendjesh. Kur t'ju duhet një përgjigje specifike, është më mirë të bëni pyetje faktike ose ta paraqitni informacionin në një mënyrë tjetër. Shmangni pyetjet që mund ta vënë në pozitë të vështirë dikë në qoftë se nuk e di përgjigjen. Pyetjet janë më të vlefshme kur bëhen mbasi keni mësuar dhe dëshmuar rreth një parimi të rëndësishëm. Më poshtë janë shembuj të disa pyetjeve jo efektive:

- Kush ishte profeti i parë? (Kur pyetja bëhet përpara se të jepet mësimi rreth periudhave ungjillore.)
- Si do të na ndihmojë mbajtja pastër e trupave tanë për të patur Shpirtin e për të treguar se jemi të gatshëm të ndjekim një profet të Perëndisë? (Më shumë se një ide.)
- A është e rëndësishme të dimë rreth urdhërimeve të Perëndisë? (Përgjigje e tipit po-jo dhe tepër e qartë.)

- Si ndiheni rreth Librit të Mormonit? (Përpara se ata ta kenë lexuar atë.)
- Çfarë është diçka që ne mund të bëjmë çdo ditë që do të na ndihmojë të ndihemi më pranë Perëndisë? (Pyetje e papërcaktuar që kërkon një përgjigje specifike: lutja.)
- Kush ishte profeti tjetër pas Noeut? (Kërkon hamendjen e tyre.)

Mësoni të bëni pyetje të nxitur nga Shpirti. Pyetja e duhur në kohën e duhur mund t'i ndihmojë së tepërmi ata që ju mësoni, të mësojnë ungjillin dhe të ndiejnë Shpirtin. Po kështu, një pyetje e gabuar ose një pyetje në kohën e gabuar mund të pengojë mësimin e tyre. Bërja e pyetjeve të duhura në kohën e përshtatshme kërkon që ju të jeni në harmoni me Shpirtin, t'i dëgjoni ata që mësoni dhe të përqendrohni gjatë gjithë përvojës së mësimdhënies. Mësimdhënia e efektshme kërkon mund, përpjekje dhe përqendrim nga ana juaj dhe e shokut/shoqes tuaj.



© 1985 Robert T. Barrett. Nafahet fotokopimi.

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Çfarë do të ndodhte me përparimin e një kërkuesi, nëse ai ose ajo do të hasej me situatat e mëposhtme dhe ju nuk do ta zbulonit?

- Kolegë që tallen vazhdimisht me gjërat shpirtërore.
- Anëtarë të familjes që janë anëtarë të fortë të një kisha tjetër.
- Shokë që besojnë se mormonët janë një kult jo i krishterë.
- Një përvojë shpirtërore nga leximi në Librin e Mormonit.

Mendoni për një pyetje që do të bënit për të mësuar më tepër rreth situatave të mësipërme. Shkruajini pyetjet në ditarin tuaj të studimit. Diskutoni me shokun/shoqen tuaj si mund të përmirësoni pyetjet që secili nga ju shkroi për këtë aktivitet.

## Dëgjoni

Kur i dëgjoni me kujdes të tjerët, i kuptoni ata më mirë. Kur ata e kuptojnë se mendimet dhe ndjenjat e tyre janë të rëndësishme për ju, ka më shumë të ngjarë që ata të pranojnë mësimet tuaja, të ndajnë përvoja personale dhe të marrin zotime. Ndërsa dëgjoni, do të mund t'ia përshtasni më mirë mësimin tuaj nevojave dhe interesave të tyre.

Veçanërisht dëgjoni për pëshpëritjet e Shpirtit. Ndërsa të tjerët ndajnë ndjenjat e tyre me ju, mendime ose ide të drejtuara nga Shpirti mund t'ju vijnë në mendje. Ju gjithashtu do të mund të kuptoni se çfarë po mundohen të shprehin të tjerët.

Gjatë kohës që të tjerët flasin me ju, shmangeni prirjen për të menduar se çfarë do të thoni. Sigurohuni që të jeni vërtetë të përqendruar te personi që flet e jo të planifikoni përgjigjen tuaj. Plaku Xhefri R. Holland mësoi: "Dëgjimi është më i rëndësishëm se e folura. Këta njerëz nuk janë objekte pa jetë të maskuar nën petkun e statistikave të pagëzimeve. Ata janë fëmijët e Perëndisë, vëllezërit e motrat tona dhe kanë nevojë për atë që ne kemi. Jini të çiltër. Ndihamoni me sinqeritet. Pyetini këta miq se çfarë është më e rëndësishme për ta. Çfarë vlerësojnë ata dhe çfarë konsiderojnë ata më të çmuar? Dhe pastaj dëgjoni. Nëse situata është e përshtatshme, ju mund të pyesni nga se tremben ata, çfarë

## Shënime

dëshirojnë ose çfarë ndiejnë se u mungon në jetë. Ju siguroj se *diçka* në atë që ata do të thonë *gjithmonë* do të vërë në dukje një të vërtetë të ungjillit rreth së cilës ju mund të dëshmoni dhe rreth së cilës ju më pas mund të flisni më shumë...Në qoftë se dëgjojmë me dashuri, nuk do të na duhet të vrasim mendjen se çfarë të themi. Ajo do të na tregohet nga Shpirti dhe nga miqtë tanë" ("Witnesses Unto Me," *Ensign*, maj 2001, 15; shkronjat kursive pjesë e origjinalit).

Njerëzit gjithashtu komunikojnë nëpërmjet mënyrës si ulen, shprehjeve të fytyrës, lëvizjeve të duarve, tonit të zërit dhe lëvizjes së syve. Vëreni me kujdes mesazhet e tyre të heshtura, ato mund t'ju ndihmojnë të kuptoni ndjenjat e atyre që mësoni. Gjithashtu tregoni kujdes edhe ndaj gjuhës së gjesteve tuaja. Dërgoni një mesazh interesimi dhe entuziazmi duke dëgjuar me sinqeritet.

Mos kini frikë nga heshtja. Njerëzve shpesh u nevojitet kohë të mendohen për t'u përgjigjur ose për të shprehur ndjenjat e tyre. Ju mund të bëni një pauzë pasi të keni bërë një pyetje, mbas ndarjes se një përvojë shpirtërore, ose kur njerëzit kanë vështirësi të shprehen. Sigurohuni t'i jepni kohë njerëzve që të përfundojnë mendimin e tyre përpara se të përgjigjen dhe mos i ndërprisni kur janë duke folur.

Kur mendoni se po e kuptoni çfarë po thuhet, bëni komente që tregojnë se po kuptoni, si p.sh.: "Pra ajo që po thoni është \_\_\_\_\_. Apo jo?" ose "Nëse e kuptova, ju ndieni se \_\_\_\_\_." Kur nuk jeni të sigurtë nëse kuptuat, pyesni personin për sqarime.

Disa njerëz mund të tentojnë ta mbizotërojnë bisedën dhe t'ju pengojnë të mësoni ungjillin e rivendosur. Ju duhet të mësoni që me takt ta merrni situatën nën kontroll. Për shembull: "Ne vlerësojmë atë që po ndani me ne, por kjo është *diçka* që do të donim ta diskutonim më vonë. Unë do t'i them shokut/shoqes tim/e ta mbajë shënim që të sigurohemi të mos harrojmë ta diskutojmë në një vizitë të mëvonshme." Mos harroni se ju do t'i ndihmoni më shumë njerëzit duke u mësuar atyre ungjillin e Jezu Krishtit.

Ndërsa dëgjoni me kujdes, Shpirti do t'ju ndihmojë të dini se çfarë të thoni. Dëgjimi kërkon përpjekje dhe përqendrim. Një misionar tregoi këtë përvojë të vërtetë (emrat janë ndryshuar):

*Unë dhe shoku im po mësonim familjen Sançes. Ishte vapë dhe fëmijët po bënë shumë zhurmë. Unë e pyeta motrën Sançes rreth leximit në Librin e Mormonit. Ndërsa ajo filloi të shpjegojë, vura re se djali i tyre kishte marrë bllokun e shënimeve të shokut tim dhe po vraponte nëpër dhomë duke e valëvitur atë në ajër. Edhe pse po shikoja motrën Sançes, mendjen e kisha tjetërkund. Thashë me vete: "Është shumë vapë dhe do doja që djali i tyre i vogël të qetësohet. Kështu nuk ka për të na ecur puna." Ndërsa mendjen e kisha gjetiu vura re se motra Sançes po mendohej të fliste. Një ide e shpejtë më erdhi për të dëgjuar. U mundova të mos mendoja më për vapën dhe zhurmën. E vështroja me kujdes fytyrën e saj ndërsa ajo fliste. Ajo hodhi sytë në tokë e më pas i ngriti lart duke vështruar shokun tim dhe mua. Burri i saj po mendohej më kot t'i qetësonte fëmijët. Pati një heshtje, e më pas me zërin që i dridhej ajo tha: "Bëra çfarë më kërkua. I lexova kapitujt që më thatë dhe u luta." Ajo ndaloi përsëri dhe vështroi poshtë. U hodhi një vështrim të shpejtë fëmijëve, e më pas sytë e saj ndeshën me sytë e mi. "Unë mora një përgjigje," tha me buzëqeshje dhe me lot në sy. "Është i vërtetë, unë e di se është i vërtetë." Shpirti mbushi dhomën. Me një zemër plot mirënjohje që e kisha dëgjuar, unë buzëqesha dhe thashë: "Po, është i vërtetë."*

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

Pasi të rishikoni historinë e mësipërme, ose shkruani një përgjigje për pyetjet e mëposhtme në ditarin tuaj të studimit ose diskutoni rreth tyre me shokun/shoqen tuaj.

- Çfarë do të kishte ndodhur në qoftë se misionari do të ishte shqetësuar më tepër për rehatinë e tij personale ose për bllokun e shënimeve të shokut të tij?
- Si u bekua ky kërkues ngaqë misionari dëgjoji?

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

A = Asnjëherë e vërtetë për mua      Z = Zakonisht e vërtetë për mua  
N = Nganjëherë e vërtetë për mua      GJ = Gjithmonë e vërtetë për mua

- Kur flas me të tjerët, mendoj për përvoja të ngjashme që mund të ndaj në vend që të dëgjoj me kujdes.
  - Kur të tjerët më tregojnë rreth ndjenjave të tyre, mundohem ta vë veten në vendin e tyre për të parë si do të ndihesha.
  - Kur mësoj kërkuesit, shqetësohem se çfarë do të them ose çfarë do t'u mësoj më pas.
  - Bezdisem kur kërkuesit duan të flasin shumë.
  - E kam të vështirë të ndjek ose të kuptoj se çfarë përpiqen të më thonë të tjerët.
  - Mendja ime endet gjatë kohës që shoku/shoqja im/e jep mësim.
  - Nervozohem nëse më ndërpresin apo ma tërheqin vëmendjen, kur dikush është duke folur me mua.
  - Unë marr nxitje shpirtërore për të thënë ose për të bërë diçka, por nuk i dëgjoj ato.
- Vendosni se çfarë mund të bëni për të përmirësuar aftësinë tuaj për të dëgjuar.

### Ndërtoni një Marrëdhënie të Mirë me Kërkuesit

Për të shmangur vënien në pozitë të vështirë, disa njerëz do t'u përgjigjen pyetjeve në atë mënyrë që ata mendojnë se ju doni që ata të përgjigjen, në vend që të ndajnë ndjenja të vërteta. Përpiquni të ndërtoni një marrëdhënie që i lejon ata të jenë të lirshëm të ndajnë ndjenjat e tyre të vërteta me ju.

## Ndihmohuni Njerëzit të Zgjidhin Shqetësimet e Tyre

Disave prej atyre që ju mësoni do t'u mungojë besimi për të mbajtur zotimet, të tjerë do të kundërshtojnë dhe të tjerë jo gjithmonë do të pranojnë gjithçka që ju ndani. Ata duhet të zgjedhin vetë, por ju duhet të bëni çfarë është e mundur për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre, për t'i ndihmuar të zgjidhin shqetësimet dhe ta kapërcejnë ndjenjën e kundërshtimit.

Ndonjëherë, shqetësimet e njerëzve janë si një ajsberg. Vetëm një pjesë e vogël është e dukshme mbi sipërfaqe. Këto shqetësime mund të jenë të ndërlikuara dhe të vështira për t'u zgjidhur. Për këtë arsye ju duhet të ndiqni Shpirtin dhe të përgjigjeni në atë mënyrë që do t'u përshtatet më mirë situatave. Lutuni për dhuratën e aftësisë për të dalluar dhe ndiqni ndjenjat tuaja. Ati Qiellor njih zemrat dhe përvojat e gjithë njerëzve (të gjithë ajsbergun) dhe do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë është gjëja më e mirë për secilin.

Kur ndihmoni të tjerët të zgjidhin shqetësimet e tyre, fillimisht mundohuni t'i kuptoni këto shqetësime duke bërë pyetje dhe duke dëgjuar. Mbështetuni te Shpirti për t'ju ndihmuar të dini se si t'i ndihmoni ata të zgjidhin shqetësimet e tyre. Për shembull, ju



Miaohet fotokopimi.

## Shënime

mund të përdorni një shkrim të shenjtë për të folur rreth shqetësimit në lidhje me nevojën për pagëzim, ose mund të ndani dëshminë tuaj për Profetin Jozef Smith.

Shpesh problemet janë më shumë shoqërore se doktrino. Për shembull, kërkuesit mund t'i tremben kundërshtimeve nga anëtarët e familjeve nëse ata bashkohen me Kishën. Ose mund t'i tremben tërheqjes së shokëve të tyre të punës. Cilido qoftë shqetësimi, kërkuesit tuaj mund të kenë përvoja nga e kaluara ose ndikime të tjera që janë pjesë e shqetësimit që ju nuk e kuptoni. Në shumë raste, anëtarët mund të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë t'i kuptoni dhe t'i ndihmoni të tjerët me shqetësimet e tyre.

Mënyra si e trajtoni shqetësimin e një kërkuesi varet nga natyra e këtij shqetësimi. Përcaktoni nëse shqetësimi ka lindur, sepse personi nuk ka një konfirmim shpirtëror për të vërtetën e Rivendosjes, apo nëse personi nuk dëshiron të zotohet për të jetuar një parim të vërtetë. Të kuptuarit në këtë mënyrë të burimit të shqetësimit do t'ju ndihmojë të dini nëse duhet të përqendroheni tek dëshmia ose zotimi.

**Aktivitet: Studim me Shokun**

Zgjidhni një nga ftesat për zotime që bëni kur jepni mësimet. Pastaj identifikoni shqetësime të ndryshme që mund ta pengojnë dikë ta pranojë ose ta mbajë atë zotim. Diskutoni dhe praktikoni se si mund t'i ndihmoni më mirë njerëzit ndërsa ata përpiqen të zgjidhin shqetësimet e tyre.

**Pendimi dhe Shërimi i Varësisë**

Pendimi është një proces shpirtëror që përfshin përlësinë, rrëfimin, zhdëmtimin dhe braktisjen e mëkatit. Ai është një ndryshim i përhershëm i mendimeve dhe veprimeve. Idealisht, pendimi për një mëkat të caktuar duhet të jetë i nevojshëm vetëm një herë. Megjithatë, nëse mëkati përsëritet, pendimi ofrohet si një mjet shërimi (shih Mosia 26:30; Moroni 6:8; DeB 1:31–32).

Pendimi mund të përfshijë një proces emocional dhe fizik. Njerëzit duhet të ndalojnë mënyrat e përsëritura e të ngulitura të sjelljes së papërshtatshme. Veprimet e padëshiruara duhet të zëvendësohen me sjellje të shëndosha dhe të hijshme.

Kështu, si pendimi edhe shërimi kërkojnë kohë. Ndonjëherë të kthyerit në besim, edhe pse me qëllimin më të mirë, dorëzohen para tundimit ndërsa përparojnë drejt një vetëdisipline më të madhe. Në raste të tilla, të porsakthyerit në besim punojnë me udhëheqësit e tyre të priftërisë e jo me misionarët, ndërsa përpiqen të mposhtin tundimin dhe të pendohen plotësisht.

Nëpërmjet pagëzimit dhe konfirmimit njerëzit marrin dhuratën e Frymës së Shenjtë, që do të forcojë aftësitë e tyre për të përballuar këto sfida. Por pagëzimi dhe konfirmimi mund të mos largojnë plotësisht shtytjet emocionale dhe fizike që shoqërojnë këto sjellje. Edhe pse një person mund të ketë sukses në fillim, një shërim i mëtejshëm emocional mund të jetë i nevojshëm që ai të pendohet dhe të shërohet plotësisht.

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

- Mendoni për një kërkues, për një të porsakthyer në besim, ose për një anëtar më pak aktiv që po mundohet të mposhtë varësinë.
- Rishikoni “Besim në Jezu Krisht” dhe “Pendimi” nga mësimi “Ungjilli i Jezu Krishtit” në kapitullin 3.
- Çfarë mund t'i mësoni këtij personi nga ky mësim dhe nga ky kapitull që mund ta ndihmojë atë të kapërcejë varësinë?
- Krijoni një plan mësimi për të ndihmuar këtë individ.



## Ndihmoni Kërkuesit dhe të Porsakthyerit në Besim të Kuptojnë Pendimin dhe Shërimin e Varësisë

Juve mund t'ju kërkohet t'u përgjigjeni pyetjeve dhe shqetësimeve rreth varësisë. Ju gjithashtu do të doni t'i ndihmoni njerëzit për të gjetur përgjigjet e pyetjeve të vështira që lidhen me këto probleme. Idetë e mëposhtme mund të jenë të vlefshme:

- Ndani dëshminë tuaj rreth natyrës shëruese të ungjillit, veçanërisht rreth Shlyerjes (shih Alma 7:11–13).
- Dëshmoni se vetëm Perëndia mund të përmbushë mrekullinë e shërimit shpirtëror (shih Psalmet 147:3).
- Shpjegoni se dhurata e shërimit është si për trupin edhe për shpirtin.

Hapat bazë që i ndihmojnë njerëzit në procesin e shërimit emocional përfshijnë:

- Të identifikosh dhe të pranosh problemin. Kjo kërkon vetë-ekzaminim të ndershëm dhe të kujdesshëm.
- Të pranosh se sjellja është e dëmshme. Ajo ndikon te të tjerët dhe kërkon ndryshime.
- Të jesh i përvuilur dhe të ndiesh keqardhje.
- Të kërkosh falje nga të tjerët që janë dëmtuar dhe të mësosh të falësh veten.
- Të heqësh dorë nga veprimet që të bëjnë të jesh i varur ndaj tyre dhe të fillosh të bësh gjëra të shëndetshme.
- Të qëndrosh besnik—të mbash besëlidhjet e pagëzimit, të japësh shërbim, të lutesh për ndihmën e Frymës së Shenjtë dhe të tregosh dëshirë për të mbajtur urdhërimet e Perëndisë.
- Të kuptosh se Zoti do t'i dojë gjithmonë fëmijët e Tij—madje edhe kur ata bëjnë gabime dhe u dorëzohen dëshirave të vjetra. Pendimi dhe rruga drejt shërimit ekzistojnë gjithmonë.



© 2000 Simon Dawey, Ndaloletë i fotokopimit.

## Një Plan për të Mposhtur Sjelljen e Varësisë nga një Ves

Kërkuesit dhe anëtarët e rinj e më pak aktivë mund të pyesin se çfarë mund të bëjnë për të mposhtur varësinë nga një ves. Ata besojnë në aftësinë tuaj për të ofruar drejtim dhe mbështetje. Sugjerimet e mëposhtme mund të jenë të vlefshme:

- U kërkoni atyre të bëjnë një listë të kohës, vendeve dhe njerëzve që ndikojnë në sjelljen e tyre. Pastaj diskutojeni listën me një bashkëshort/e, peshkop, misionar lagjeje, ose ndonjë shok tjetër të besuar. Flisni rreth asaj që ata duhet të bëjnë për të ndryshuar ose shmangur gjërat në listë.
- U kërkoni atyre të shkruajnë se çfarë kjo sjellje po i bën të humbasin tani, dhe nëse nuk korrigjohet, çfarë do t'u bëjë të humbasin në të ardhmen.
- U kërkoni atyre të shkruajnë gjëra të ndryshme që mund të bëjnë për të shmangur ose dekurajuar sjelljen e papërshtatshme. Kjo mund të përfshijë: të flasin me bashkëshortin/bashkëshorten, t'i kërkojnë mbështetje peshkopit ose një miku, të ushtrohen dhe çdo veprimtari tjetër që i ndihmon ata të mposhtin tundimin.
- Nxitinini ata të lutën rregullisht, të studiojnë shkrimet e shenjta, të dëgjojnë muzikë frymëzuese dhe të lexojnë libra të mirë.

## Shënime

- Nxitini ata të kërkojnë një bekim priftërie.
- Nxitini ata të vazhdojnë të jenë aktivë në Kishë, e cila i ndihmon ata të kapërcejnë problemet dhe të afrohen më pranë Zotit.
- Nxitini ata të marrin pjesë në një grup të përshtatshëm mbështetës apo të marrin ndihmë profesionale. Në disa vende, është i disponueshëm programi LDS Family Services (Shërbime për Familjen nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme).
- Nxitini ata të mos tërhiqen kurrë! Zoti do t'i ndihmojë edhe në qoftë se kjo do të kërkojë pak kohë.



Shenjtorët aktivë të ditëve të mëvonshme mund t'i ndihmojnë më mirë anëtarët e rinj që të qëndrojnë aktivë në Kishë duke qenë shokë me ta. Anëtarët duhet t'u qëndrojnë pranë kërkuesve dhe anëtarëve të rinj duke treguar një qëndrim të ngrohtë dhe pozitiv. Kërkuesit dhe të porsakthyerit në besim do të përgjigjen pozitivisht kur përshëndeten me një buzëqeshje, kur pyeten me sinqeritet se si janë, kur të tjerët ulen pranë tyre gjatë mbledhjeve dhe kur ftohen në një darkë apo mbrëmje familjare të shtëpisë.

Meqenëse ekziston mundësia që disa mund t'i rikthehen vesit, udhëheqësit e priftërisë dhe anëtarët nuk duhet të befasonen apo të dekurajohen në qoftë se mësojnë se një kërkues ose një anëtar i ri mund të jetë duke hasur vështirësi me probleme të tilla. Ata duhet të tregojnë besim tek individit dhe të mos jenë paragjykes nëse personi i kthehet një dëshire të vjetër. Ata duhet ta konsiderojnë këtë si një dështim të përkohshëm dhe të kuptueshëm. Dënimi i një kërkuesi apo të porsakthyerit në besim, që është i varur ndaj një vesi, nuk ndihmon dhe ka mundësi të çojë në dekurajim, dështim dhe mungesë aktiviteti në Kishë. Një i porsakthyer në besim, që papritur nuk shkon më në Kishë, mund t'i jetë rikthyer një vesi të vjetër dhe mund të ndjehet i padenjë dhe i dekurajuar. Një vizitë e menjëhershme për t'i dhënë kurajo dhe mbështetje, mund ta ndihmojë personin të ecë përpara. Anëtarët duhet të tregojnë me fjalë dhe vepra se ata i pranojnë të kthyerit në besim (shih 3 Nefi 18:32).

Qëndrimi aktiv në Kishë dhe përpjekja për të jetuar me besnikëri, janë gjërat më të rëndësishme që një individ mund të bëjë për të mposhtur problemet e varësisë nga vesi.

#### Aktivitet: Studim Individual

Mendoni për një zakon që keni—diçka që e bëni shpesh pa u menduar, si kërcitja e gishtërinjve, rregullimi i syzeve, e ngrëna e tepruar, apo të fjeturit shumë vonë. Tani përpiquni të kaloni një ditë pa e bërë këtë as edhe një herë. Kur përparoni, përpiquni të mos e bëni këtë për një javë të plotë. Diskutoni rreth përvojës tuaj me shokun/shoqen. Më pas përpiquni të mendoni se sa më e vështirë është për një kërkues të mposhtë një ves siç është abuzimi me alkoolin apo duhanin.

#### Lini Diçka Pas

Në fund të çdo vizite mësimi, kërkuesit duhet t'i lihet diçka për të lexuar dhe medituar me qëllim që të përgatitet për takimin e ardhshëm. Ju mund t'i caktoni atyre kapituj nga

Libri i Mormonit. Ju mund t'u jepni një broshurë që bën fjalë rreth asaj që mësuani ose rreth asaj që do t'u mësoni në vizitën e ardhshme, ose mund të jetë një lloj tjetër literature ose prezantim audioviziv. Nëse ata kanë mundësi të përdorin Internetin, inkurajojini të shkojnë në faqen [www.mormon.org](http://www.mormon.org). Atyre u duhet dhënë gjithnjë diçka rreth së cilës të mendohen, të meditojnë dhe të luten. Kjo mund të bëhet edhe tema e hapjes së diskutimit për takimin e ardhshëm.

#### Aktivitet: Studim me Shokun

Rishikoni materialet që keni në dispozicion për t'ua lënë kërkuesve, përfshirë broshura dhe materiale audiovizive. A ka materiale të tjera që duhet të merrni për t'i ndarë me kërkuesit tuaj? Në planifikuesin tuaj bëni një listë të materialeve që duhet të porositni.

Mendoni për secilin nga kërkuesit që keni planifikuar të vizitoni këtë javë. Cilët kapituj të Librit të Mormonit do të jenë më të vlefshëm për ta? Çfarë materialesh të tjera do t'i ndihmonin? Shënioni në planifikuesin tuaj në seksionin Shënime/Lista e Gjërave që Duhet Bërë se çfarë keni ndërmend t'i jepni secilit kërkues dhe çfarë do të bëni për të ndjekur ecurinë e tyre në vizitën tuaj të ardhshme.

### U Mësoni Ungjillin e Rivendosur Atyre që nuk i Përkasin Besimit të Krishterë

Disa nga njerëzit që mësoni mund të mos besojnë në Atin Qiellor dhe Jezun Krishtin apo nuk kanë tradita të krishtera. Megjithatë, shumë nga këta njerëz, kanë besime, praktika dhe vende që ata i konsiderojnë të shenjta. Si shërbëtor i Perëndisë, është thelbësore që të tregoni respektin e duhur për besimet dhe traditat e tyre fetare. Mos bëni asgjë që tregon mungesë respekti për çka është e rëndësishme për ta.

Ju mund të mendoni se si mund t'ia përshtasni mënyrën e mësimin këtyre njerëzve. Do të jetë me vlerë të kujtoni se që të mund të kthehen në besim, të gjithë fëmijët e Perëndisë, pavarësisht nga prejardhja, duhet të zhvillojnë besim në Jezun Krishtin, të pendohen, të marrin ordinancat e pagëzimit dhe konfirmimit dhe të durojnë deri në fund duke mbajtur urdhërimet dhe duke shërbyer. Parimet që i ndihmojnë të tjerët të ndërtojnë besim në Jezun Krisht janë të njëjta në të gjitha kulturat.

Ju mund t'i ndihmoni njerëzit të fitojnë një kuptim të saktë për Perëndinë si Atin tonë Qiellor dhe të zhvillojnë besim në Jezun Krisht duke i ndihmuar ata të kenë përvoja personale shpirtërore në vend që thjesht t'u tregoni atyre rreth natyrës së Perëndisë. Për shembull, ju do t'i ndihmoni njerëzit të fitojnë këtë kuptim ndërsa ata:

- Fitojnë një bindje shpirtërore se Perëndia Ati dhe Biri i Tij, Jezun Krishtin iu shfaqën Profetit Jozef Smith.
- Dëgjojnë mësimin tuaj të sigurtë dhe dëshminë për ungjillin, përfshirë pse ju zgjodhët të ndiqni Jezun Krishtin.
- Ju dëgjojnë shpesh ju dhe anëtarët e tjerë të flasin me Atin Qiellor në një lutje të thjeshtë e të përzemërt.
- Ju dëgjojnë të jepni dëshmi të fuqishme.
- Luten me ju dhe vetëm.
- Arrijnë të kuptojnë çfarë ndieni ju rreth shkrimeve të shenjta ndërsa i lexoni dhe diskutoni ato.
- Lexojnë përditë fjalën e Perëndisë nga shkrimet e shenjta (veçanërisht Librin e Mormonit).

## Shënime

- Shkojnë në kishë që kështu të mund të shikojnë si e adhurojmë Zotin.
- Takojnë anëtarë të Kishës që mund t'iu shpjegojnë se si arritën të besojnë në Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin.
- Mbajnë urdhërimet.

Këto veprimtari janë në të mirë të të gjithë njerëzve që mësoni, por ato janë thelbësore kur mësoni ata që nuk kanë prejardhje të krishterë, sepse këta njerëz ka më pak të ngjarë të kenë patur përvoja të tilla më parë.

Shumë të kthyer në besim, që nuk kanë prejardhje të krishterë, raportojnë se ata nuk kuptuan shumë nga ato çfarë u thanë misionarët, por se ata ndiejnë Shpirtin dhe donin të bënin çfarë u kërkuan misionarët. Ju duhet të bëni gjithçka që mundeni për t'iu ndihmuar kërkuesit të kuptojnë doktrinat e ungjillit. Jini të durueshëm dhe ofroni mbështetje, sepse mund të duhet pak kohë derisa njerëzit të mësojnë të identifikojnë dhe të shprehin ndjenjat që kanë brenda tyre. Ju mund t'ju duhet ta përshtasni ritmin dhe masën e mësimdhënies tuaj për t'iu ndihmuar ata t'ju kuptojnë. Ndërsa përgatiteni për të mësuar ata që nuk kanë prejardhje të krishterë, sugjerimet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë:

- Bëni përmbledhje të thjeshta dhe rishikime për çdo mësim.
- U kërkoni atyre t'ju tregojnë çfarë kuptojnë dhe çfarë kanë përjetuar.
- Merrni pak kohë për të përkufizuar fjalët dhe parimet thelbësore. Ata që mësoni mund të mos i njohin shumë nga fjalët që ju do të përdorni në mësimin tuaj.
- Rikthejuni mësimin të mëparshëm për ta mësuar doktrinën më qartë. Kjo mund të jetë e nevojshme në çdo çast gjatë procesit të mësimdhënies.

### Shembuj Shkrimesh të Shenjta

Shkrimet e shenjta përmbajnë shembuj të misionarëve të cilët mësuar ata që nuk besonin në Perëndi ose që keqkuptonin natyrën e Tij të vërtetë. Studioni shkrimet e shenjta më poshtë dhe pastaj shpjegojini shokut/shoqes tuaj ose shkruani në ditarin tuaj të studimit se si këta misionarë i ndihmuar njerëzit të fitojnë një dëshmi se Perëndia ekziston.

- Alma dhe Amuleku (Alma 9–12; 15)
- Amoni dhe Aaroni (Alma 17–22)
- Alma (Alma 30)
- Alma dhe të tjerët (Alma 31–35)
- Pali (Veprat e Apostujve 17:16–34)

### Aktivitet: Studimi me Shokun

Kur është e mundur, identifikoni një të kthyer në besim që nuk ka qenë pjesë e traditës së krishterë përpara se të takohej me misionarët. Lini një takim me të dhe pyeteni rreth përvojës që ai ose ajo patën me kthimin në besim. Për shembull, ju mund të pyeteni se çfarë e shtyu personin të besonte në Perëndi, herën e parë kur ai ose ajo u lutën, herën e parë kur ai ose ajo ndjenë se morën përgjigjen e lutjes, rolin e shkrimeve të shenjta në kthimin e tij ose të saj në besim dhe si ishte për ta ndjekja e shërbesave të dielave. Shkruani në ditarin tuaj të studimit se çfarë mësuat.

**Mbani Mend**

- Nevojat e njerëzve mund të plotësohen, kur atyre u mësohet ungjilli i rivendosur dhe e jetojnë atë.
- Planifikoni dhe studioni përditë me shokun/shoqen tuaj që të jeni të bashkuar e të mësoni me një zë.
- Ndani shpesh dëshminë tuaj.
- Shkrimet e shenjta, veçanërisht Libri i Mormonit, janë burimet tuaja bazë për mësim.
- Lutuni për dhuratën e aftësisë për të dalluar në mënyrë që të dini kur t'i përdorni aftësitë e diskutuara në këtë kapitull.

Shënime

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Supozoni se jeni vetë në situatat e mëposhtme. Si mund t'i përdorni parimet dhe aftësitë në këtë kapitull për t'i ndihmuar këta njerëz të përparojnë? Planifikoni se si do t'i zbatoni ato në çdo situatë.
  - Ndërsa po ecni në një park, shikoni një grua dhe një djalë të vogël të ulur vetëm në një stol. Gruaja po qan.
  - Ju shkoni në shtëpinë e kërkuesve që po përgatiten për pagëzim dhe ata ju thonë se nuk duan të takohen më me ju.
  - Ju po takoheni për herë të shtatë me një kërkues që është mësuar nga disa misionarë për një periudhë mbi dy vjeçare. Ka patur pak, për të mos thënë aspak, shenja përparimi.
  - Ju po filloni t'i mësoni një familjeje anëtare një mesazh të ungjillit dhe ata thonë: “Ne tashmë u kemi kërkuar të gjithë atyre që njohim të takohen me misionarët e ata të gjithë kanë thënë jo.”
- Zgjidhni një nga mësimet misionare. Identifikoni një ose dy nga fragmentet e shkrimeve të shenjta nga secili parim kryesor. Praktikoni të jepni mësim duke u bazuar në këto fragmente siç përvijohet në seksionin “Përdorni Shkrimet e Shenjta” të këtij kapitulli.
- Gjatë disa javëve me radhë, rishikoni mësimet e Shpëtimtarit në ungjijtë (Mateu, Marku, Lluka, Gjoni) dhe 3 Nefi. Bëni në ditarin tuaj të studimit një listë të pyetjeve që Ai bëri. Krahasoni këto pyetje me ato që ju bëni zakonisht.
- Lexoni tregimin e Amonit dhe mbretit Lamoni në Alma 18 dhe tregimin e Aaronit në Alma 22:4–18. Ndërsa lexoni, identifikoni dhe përshkruani se si Amoni dhe Aaroni:
  - Ndoqën Shpirtin dhe mësuan me dashuri.
  - Filluan të japin mësim.
  - Ia përshtatën mësimdhënien nevojave.
  - Dëshmuan.
  - Përdorën shkrimet e shenjta.
  - Bënë pyetje, dëgjuan dhe zgjidhën shqetësimet.
  - I nxitën ata që mësuan për të marrë zotime.
- Meditoni rreth thënieve të mëposhtme të Presidentit Harold B. Li në lidhje me të dhënit mësim për të kuptuar. Vlerësoni se me sa qartësi ju u mësoni të tjerëve doktrinat e ungjillit. Shkruani ato që mësoni në ditarin tuaj të studimit.
 

“Përmbajuni kontekstit të shkrimit të shenjtë dhe thjeshtojeni atë në terma të kuptueshëm.” (*The Teachings of Harold B. Lee*, përzgj. Clyde J. Williams [1996], 444).

“Tani, ju si mësues nuk jeni dërguar të mësoni doktrinë të re. Ju do të mësoni doktrinat e vjetra, jo aq qartë sa ata vetëm t'i kuptojnë, por duhet t'i mësoni doktrinat e Kishës aq qartë sa askush të mos i keqkuptojë.” (*The Teachings of Harold B. Lee*, 458).

### Studim me Shokun

- Rishikoni planin tuaj të mësimit nga një mësim i fundit që keni bërë. Shkruani një pyetje për çdo parim kryesor të nënvizuar në planin tuaj. Pastaj rishikoni pyetjet tuaja për të parë nëse ato janë në harmoni me atë që mësohet në këtë kapitull. Më pas, përgjigjuni çdo pyetjeje sikur të ishit një kërkues. Rishikoni pyetjet sipas

## Shënime

nevojës. Ndani përgjigjet tuaja me shokun/shoqen tuaj. Së bashku, vlerësoni pyetjet tuaja.

Merrni parasysh nevojat e kërkuesit që po mësoni. Diskutoni se si ai apo ajo mund t'u përgjigjen pyetjeve tuaja. Gjithashtu diskutoni se si këto pyetje mund të ftojnë Shpirtin dhe mund ta ndihmojnë kërkuesin të mësojë ungjillin.

- Mendoni për secilin nga kërkuesit tuaj të rinj. Diskutoni se çfarë mund të bëni ju për t'i ndihmuar ata të bëhen kërkues të përparuar. Shkruajini idetë tuaja në ditarin e studimit dhe bëni plane në planifikuesin tuaj ditor.

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Ftoni anëtarë ose kërkues të tanishëm në mbledhjen tuaj. Shpjegojini grupit se ju doni që misionarët të përmirësojnë aftësinë e tyre për të ndarë mesazhin e tyre të rëndësishëm. Zgjidhni një mësim dhe një aftësi. U kërkoni misionarëve t'u mësojnë anëtarëve apo kërkuesve mësimin që ju keni zgjedhur për 20 minuta, duke u përqendruar në aftësinë që keni përcaktuar. U kërkoni atyre të ndërrojnë rolet pas 20 minutave. Mbasi misionarët të kenë patur mundësinë për të mësuar, bashkoni grupin dhe u kërkoni anëtarëve dhe kërkuesve t'u tregojnë misionarëve se çfarë ishte më efektive dhe një mënyrë se si ata mund të përmirësohen.
- Shfaqni video që tregojnë shembuj të misionarëve duke dhënë mësim ose duke kontaktuar njerëz. Zgjidhni një aftësi dhe diskutoni në grup se sa mirë misionarët në video zbatuan parimet për atë aftësi.
- Zgjidhni një aftësi apo një aspekt të rëndësishëm të asaj aftësie dhe përcaktoni doktrinën ose fragmentet e shkrimit të shenjtë që e mbështesin këtë aftësi. Mësojuni misionarëve themelin doktrinor të kësaj aftësie.

### Presidenti i Misionit

- Herë pas here shoqërojini misionarët kur japin mësim. Planifikoni me ta se si ju mund të merrni pjesë në mësim.
- I nxisni udhëheqësit e priftërisë të shoqërojnë misionarët në vizitat e tyre të mësimit dhe t'u japin këshilla.
- Demonstroni përdorimin efektiv të shkrimeve të shenjta, pyetjeve dhe dëgjimit kur i mësoni misionarët gjatë konferencave të zonës dhe intervistave.







# Si t'i Ndhimoj Njerëzit të Marrin dhe të Mbajnë Zotime?

## Mbani Parasysh

- Pse duhet të përqendrohemi në të ftuarit e njerëzve për të marrë zotime?
- Si lidhen zotimet me kthimin në besim?
- Si mund të jap dëshmi të përlulur?
- Çfarë bekimesh mund të premtoj?
- Pse është e rëndësishme që të ndjek ecurinë (e zotimit) kur njerëzit marrin zotime?

## Bëni Ftesa për Zotime

**S**i një misionar, ju dëshironi shpëtimin e shpirtave (shih Mosia 28:3). Ju e dini se njerëzit mund të vijnë te Krishti dhe mund të shpëtohen vetëm në kushtet e pendimit (shih DeB 18:10–16). Një mënyrë për të përmbushur dëshirën tuaj është të predikoni pendim (shih Alma 5:49; DeB 15:6; 16:6) dhe t'i ftoni me guxim njerëzit të ushtrojnë besim për t'u penduar, të pagëzohen me anë të ujit dhe të Shpirtit dhe të durojnë me besnikëri deri në fund (shih 3 Nefi 27:16–20; Mormoni 7:10).

Zotimi është një pjesë thelbësore e pendimit. Ai është një akt i detyrimit të vetes për të ndjekur një drejtim të caktuar veprimi dhe më pas ta zbatosh me zell atë vendim. Kur njerëzit zotohen singërisht, ata kanë qëllim të vërtetë, në kuptimin që ata dëshirojnë plotësisht të bëjnë ato gjëra që janë zotuar t'i bëjnë. Ata marrin një vendim të palëkundur dhe serioz për të ndryshuar. Ata bëhen të devotshëm ndaj Krishtit dhe ja përkushtojnë veten ungjillit të Tij. Mbjajta e zotimeve të tyre është mënyra se si ata me të vërtetë manifestojnë me anë të veprave të tyre se kanë marrë Shpirtin e Krishtit për heqjen e mëkateve të tyre (shih DeB 20:37). Kur kërkoni marrjen e zotimeve si pjesë të mësimdhënies suaj, ju e ftoni kërkuesin të pendohet.

Shënime

Një nga mënyrat më të mira për t'i ndihmuar njerëzit të marrin dhe të mbajnë zotimet është t'u drejtosh një ftesë zotimi. Bërja e një ftese dhe ndjekja e ecurisë së zotimit është jetësore sepse:

- Njerëzit kthehen në besim kur jetojnë parimet që mësojnë (shih Gjoni 7:17) dhe ndiejnë Shpirtin që u konfirmon se gjërat që ata po bëjnë janë të pëlqyeshme për Atin e tyre në Qiell.
- Pendimi dhe ndryshimi do t'i ndihmojë njerëzit të mposhtin sfidat, të largojnë turpin dhe fajin e tyre dhe të përjetojnë paqen dhe gëzimin e faljes së Perëndisë.
- Mbajtja e zotimeve i përgatit njerëzit të bëjnë dhe të mbajnë besëlidhjet e shenjta.



© 2001 Simon Dewey. Ndalohej fotokopimi.

Ju mund ta tregoni dashurinë tuaj për njerëzit dhe besimin tuaj në premtimet e Perëndisë, duke ndjekur ecurinë e tyre për t'i ndihmuar ata të pendohen dhe të mbajnë zotimet e tyre.

Zotimet e kërkuara për pagëzim janë renditur në katër mësimet e para. Zotimet që lidhen me përparimin shpirtëror mbas pagëzimit dhe konfirmimit janë renditur në mësimin 5. Jini vazhdimisht të vëmendshëm ndaj nevojës për t'i ftuar njerëzit të bëjnë gjëra që do të forcojnë besimin e tyre në Krisht. Kujtoni parimet e mëposhtme:

- Çdo mundësi për të gjetur kërkues—me anëtarët, rekomandimet, ose kontaktet personale—duhet të çojë drejt një ftese për të vepruar, zakonisht për të mësuar më shumë rreth mesazhit të Rivendosjes.
- Rrallë, për të mos thënë kurrë, mund të flisni me njerëzit ose t'i mësoni ata pa u drejtuar një ftesë për të bërë diçka që do të forcojë besimin e tyre në Krisht.
- Përqendrohuni në një ose më shumë zotime kur jepni mësim. Në qoftë se ju nuk i ftoni njerëzit të marrin këto zotime, ju nuk po u kërkoni atyre të pendohen dhe të vijnë te Krishti.
- Ndërsa përgatiteni gjatë studimit me shokun/shoqen për të dhënë një mësim, merrni parasysh nevojat dhe gjendjen e çdo kërkuesi dhe përfshini një ose më shumë zotime në planin tuaj mësimor.
- Gjatë një mësimi ju mund të frymëzoheni të drejtoni ftesa për zotime të tjera përveç atyre që kishit planifikuar. Gjithmonë ftojini njerëzit të pendohen.
- Jini të guximshëm dhe të sigurtë kur i ftoni njerëzit të marrin zotime (shih Alma 38:12). Guximi tregon besimin tuaj se bindja ndaj urdhërimeve të Zotit sjell bekime.
- Njerëzit ka të ngjarë që të mos ndryshojnë në qoftë se nuk ftohen ta bëjnë këtë.

#### Studim i Shkrimeve të Shenjta

##### Pse është kaq jetësore të drejtojmë ftesa?

Alma 5:62

Moroni 7:13

##### Pse janë kaq të rëndësishme zotimet?

2 Nefi 31

Alma 32:27

Gjoni 7:17

Mosia 2:41

DeB 14:7

Alma 7:14–16

DeB 20:37

## Bëni Pyetje të Drejtpërdrejta

Një ftesë për t'u zotuar shpesh merr formën e një pyetjeje “a do të,” që kërkon një përgjigje *po* ose *jo*. Ftesat duhet të jenë specifike, të drejtpërdrejta dhe të qarta. Ato i ftojnë ose i bëjnë njerëzit të vendosin të ndjekin një drejtim të caktuar veprimi. Ato i kërkojnë atyre të marrin një zotim dhe të ushtrojnë besim aktiv në parimet që ju u keni mësuar.

Më poshtë gjenden disa shembuj të ftesave të mira, që pasohen nga fillimi i një premtimi dhe dëshmie:

- A do të lexoni [3 Nefi 11, Moroni 10:3–5, këtë fletëpalosje] përpara vizitës sonë nesër në orën 19:00? Unë e di se po ta bëni këtë ju do të...Unë dëshmoj se Libri i Mormonit është ...
- A do të luteni dhe të pyesni Perëndinë nëse Jozef Smithi ishte një profet? Unë e di se ndërsa luteni Perëndia do të...Unë e di se Jozef Smithi ishte një profet...
- A do të vini në kishë me ne këtë të dielë në orën 9:00? Në qoftë se do të vini, ju do të...Unë e di se Kisha e Krishtit është rivendosur...
- A do të filloni tani të jetoni ligjin e dëlirësisë ashtu siç e shpjeguem? Të jetuarit e këtij ligji do të...Si një shërbëtor i Zotit unë dëshmoj se të jetuarit e një jete të dëlirë...
- A do të ftoni ju [emri] përpara të premtës të takohet me ne dhe të fillojë të mësojë rreth ungjillit? Shpirti do t'ju ndihmojë...Ndarja e ungjillit do të bekojë jetën tuaj...
- A mund të vijmë në shtëpinë tuaj dhe t'ju tregojmë më shumë rreth asaj se si Perëndia thirri një profet në ditët e sotme ashtu siç bëri në kohët e lashta? Një qëllim, drejtim dhe paqe më e madhe do të vijë në jetën tuaj ndërsa filloni të kuptoni...Unë dëshmoj se Perëndia ka thirrur përsëri...

### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Në ditarin tuaj të studimit, shkruani një ftesë që është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë dhe e qartë për çdo zotim që përmban secili mësim. Në qoftë se e keni bërë këtë aktivitet më parë, përsëriteni atë dhe krahasoni ftesat tuaja të reja me variantet e mëparshme. Pyesni veten nëse aftësia juaj për të drejtuar ftesa është përmirësuar.

Rishikoni me shokun/shoqen tuaj ftesat që keni shkruar. Për çdo ftesë, diskutoni pyetjet e mëposhtme:

- Kur drejtoj ftesa, a i shpjegoj bekimet që Zoti ka premtuar? Në qoftë se jo, pse?
- A i shmangem drejtimit të kësaj ftese? Në qoftë se është kështu, pse?
- A ndihem në pozitë të vështirë kur drejtoj këtë ftesë? Si mund të përmirësohem?
- Sa e rëndësishme është për mua personalisht kjo ftesë?
- Sa shpesh kujtohem të ndjek ecurinë e ftesave që kam drejtuar? Si mund të përmirësohem?

Mendoni për kërkuesit ose anëtarët më pak aktivë që njihni dhe praktikoni të drejtoni këto ftesa sikur t'u drejtoheshit atyre individualisht.

Sipas nevojës, rishikoni ftesat në planin tuaj mësimor. Vendosni qëllime specifike që do t'ju ndihmojnë të drejtoni ftesa gjatë gjithë ditës dhe javës.

## U Premtoni Njerëzve Bekime

Njerëzve u duhet një arsye për të ndryshuar mendimet dhe veprimet e tyre. Bekimet e premtuara shpesh ofrojnë motive të fuqishme për t'iu bindur Perëndisë. Kur Zoti na jep një urdhërim, Ai shpesh premtot bekime për mbajtjen e atij urdhërimi (shih DeB 130:20–21). Ndërsa përgatisni njerëzit t'iu binden një urdhërimi specifik, u mësoni atyre që:

- Të jetuarit e urdhërimeve tregon dashurinë për Perëndinë dhe Birin e Tij.
- Ata tregojnë besimin e tyre në Perëndi kur i binden urdhërimeve të Tij.
- Si shkëmbim, ata do të marrin bekimet që Ai u ka premtuar.

Ndërsa dëshmoni për një urdhërim, flisni rreth bekimeve që keni marrë nga të jetuarit e atij urdhërimi. U premtoni atyre që mësoni se ata mund të gëzojnë bekime të ngjashme.

Ndërsa njerëzit përpiqen të mbajnë një zotim, u kërkoni atyre të flasin rreth bekimeve që Ati Qiellor u ka dhënë. I siguroni ata se edhe pse vështirësi do të vijnë në jetën e tyre, bekimet e Tij do të vazhdojnë ndërsa ata i binden vullnetit të Tij.

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Çfarë thotë Zoti rreth dëshirës së Tij për të na bekuar?

Alma 37:17

DeB 1:37

DeB 76:5–10

#### Aktivitet: Studim Individual

Lexoni Doktrina e Besëlidhje 82:10 dhe 130:20–21. Pastaj studioni shkrimet e shenjta që ndodhen më poshtë: Në ditarin tuaj të studimit bëni dy kolona. Në njërën anë shkruani urdhërimin që gjeni në secilën pjesë. Në anën tjetër shkruani premtimin për mbajtjen e këtij urdhërimi.

DeB 11:21

DeB 89:18–21

DeB 100:5–8

DeB 84:85

DeB 95:8–9

Malakia 3:10–12

Rishikoni zotimet e renditura në një nga mësimet misionare. Për çdo zotim, përgjigjuni këtyre pyetjeve:

- Çfarë bekimesh u ka premtuar Zoti atyre që mbajnë këtë zotim?
- Si do t'iu ndihmojë njerëzit bindja ndaj këtij parimi të fitojnë besim dhe dëshmi?
- Si do t'iu ndihmojë njerëzit ky zotim për t'iu penduar dhe për të qenë më të ndjeshëm ndaj Shpirtit?

## Dëshmoni Shpesh

Një dëshmi, është një dëshmi dhe siguri shpirtërore dhënë nga Fryma e Shenjtë. Të japësh dëshmi do të thotë të japësh një deklaratë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë besimi—një ndjenjë, një siguri, një bindje për vërtetësinë e ungjillit. Ndarja e dëshmisë tuaj shpesh është një nga mënyrat më të fuqishme për të ftuar Shpirtin dhe për t'iu ndihmuar të tjerët të ndiejnë Shpirtin. Ajo shton një dëshmi aktuale dhe personale të të vërtetave që ju keni mësuar nga shkrimet e shenjta. Një misionar efektiv mëson, dëshmon dhe fton të tjerët të

*“Në lidhje me dëshminë, kujtoni, se ai që me dëshirë e ndan, e ruan atë që ka, ndërsa ai që e mban për vete, e humbet atë...Mësoni dhe Dëshmoni. Nuk ekziston asnjë kombinim më i mirë.”*

—PLAKU TOMAS S. MONSON.  
PATHWAYS TO PERFECTION [1973], 100–101

bëjnë gjëra që ndërtojnë besim në Jezu Krisht. Kjo përfshin bërjen e premtimeve që vijnë nga të jetuarit e parimeve të vërteta. Për shembull, një misionar mund të thotë: “Unë e di se kur ju mbani ditën e Shabatit të shenjtë, ju do të gjeni më shumë paqe në zemrën tuaj.”

Që dëshmia juaj të ketë fuqi bindëse, ju duhet të jeni të sinqertë. Dëshmia e fuqishme nuk varet nga gojëtaria ose vëllimi i zërit, por nga bindja e zemrës. Përpiquni çdo ditë të forconi të kuptuarit dhe bindjen tuaj ndaj doktrinaeve dhe parimeve që u mësoni të tjerëve. Dëshmoni shpesh për të vulosur të vërtetën e parimeve ose doktrinës që mësoni. Sa më shpesh të jetë e mundur, jepni mësim, pastaj dëshmoni dhe dëshmoni ndërsa jepni mësim.

Dëshmia juaj mund të jetë e thjeshtë si “Jezu Krishti është Biri i Perëndisë” ose “Unë kam mësuar për veten time se Libri i Mormonit është i vërtetë.” Ju gjithashtu mund të ndani një përvojë të shkurtër se si i fituat këto njohuri. Jepni dëshmi disa herë në çdo mësim, jo vetëm në fund. Dëshmoni se ajo që shoku/shoqja juaj ka mësuar është nga Perëndia. Dëshmoni se parimi që ju do t’u mësoni do të bekojë jetën e kërkuesve në qoftë se ata do ta ndjekin atë. Flisni se si të jetuarit e një parimi ka bekuar jetën tuaj.



Ndonjëherë njerëzit mund t’i vënë në dyshim nga ana intelektuale ato që ju u mësoni, por është e vështirë të vësh në dyshim një dëshmi të sinqertë dhe që del nga zemra. Kur dëshmoni, lutuni që ata të cilët ju mësoni do të ndiejnë dëshminë konfirmuese të Frymës së Shenjtë. Kur dëshmoni, ju ndihmoni në krijimin e një mjedisi ku kërkuesit mund të ndiejnë Frymën e Shenjtë të konfirmojë dëshminë tuaj për të vërtetën. Kjo i përgatit ata të pranojnë zotimet që ju do t’u kërkoni të marrin.

Brigam Jangu nuk u pagëzua në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme gjatë vitit të parë që mësoi rreth ungjillit të rivendosur. Por për kthimin e tij në besim ai tha: “Në qoftë se i gjithë talenti, mjeshtëria, mençuria dhe sofistikimi i botës të më ishin dërguar me Librin e Mormonit dhe të më kishin shpallur me gojëtarinë më të lartë tokësore të vërtetën e tij duke marrë përsipër për ta provuar atë me anë të mësimit dhe të mençurisë së botës, do të kishin qenë për mua si tymi që ngrihet lart për t’u zhdukur më pas. Por kur pashë një njeri pa gojëtarinë ose talent për fjalime publike, i cili vetëm mund të thoshte: ‘Unë e di me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë se Libri i Mormonit është i vërtetë, se Jozef Smithi është një Profet i Zotit,’ Fryma e Shenjtë që buroi nga ai individ më ndriçoi kuptimin dhe drita, lavdia dhe pavdekësia ishin përpara meje. Unë isha i rrethuar prej tyre, i mbushur me to dhe atëherë unë e dija për veten time se dëshmia e atij njeriu ishte e vërtetë” (në *Journal of Discourses*, 1:90).

**Aktivitet: Studim Individual**

Pjesët e mëposhtme janë shembuj të dhënies së dëshmisë. Lexoni secilën nga pyetjet dhe shkrimet e shenja. Shkruajini përgjigjet në ditarin tuaj të studimit.

- Për çfarë dëshmojnë apostujt dhe profetët në këto vargje?
- Sa fort i besojnë ata ato që thonë? Si mund të kuptoni se ata janë të bindur për të vërtetën?
- Kur thoni, “Unë e di se \_\_\_\_\_ është e vërtetë,” çfarë nënkuptoni? Çfarë fjalësh të tjera mund të përdorni për të përçuar bindjen tuaj?

Jakobi 7:7–12 (LiM)

DeB 76:22–24

Veprat e Apostujve 2:14–38

Alma 5:45–48

Gjoni 3:3–11

Veprat e Apostujve 10:34–44

Alma 34:1, 8

**Studim i Shkrimeve të Shenja****Cilat janë disa nga parimet dhe premtimet e dhënies së dëshmisë?**

2 Nefi 33:1

DeB 84:61

Gjoni 15:26

DeB 62:3

DeB 100:5–8

**Ndiqni Ecurinë**

Bërja e një ftese, pa ndjekur ecurinë e saj, është si të fillosh një udhëtim pa e përfunduar atë, ose të blesh një biletë për në koncert dhe të mos shkosh në sallë. Pa veprimin e përfunduar, zotimi është i kotë.

Ndryshimi mund të jetë i vështirë. Roli juaj është t’i ndihmoni njerëzit të forcohen në vendimin e tyre për të ndryshuar. Ju duhet të bëni gjithçka mundni për t’i ndihmuar njerëzit të mbajnë zotimet e tyre.

Pendimi i sinqertë tregohet më mirë nëpërmjet veprimeve të drejta gjatë një periudhe kohe, veçanërisht për urdhërime të tilla si dëlirësia, Fjala e Urtësisë dhe e dhjeta. Ndërsa ju dhe udhëheqësit e lagjes punoni me njerëzit për t’i ndihmuar ata të mbajnë zotimet e tyre, tregoni mirëkuptim. Jini të duruar, por këmbëngulës. Ju nuk keni mbaruar shërbesën tuaj derisa njerëzit të jetojnë këto zotime, ose me fjalë të tjera derisa ata të jenë penduar (shih 3 Nefi 18:32). Ndonjëherë, mund të jenë të nevojshme disa vizita që t’i ndihmoni njerëzit të zhvillojnë besim të mjaftueshëm në një parim për t’i çuar ata në pendim.

Ndjekja e ecurisë nis kur ju filloni t’i vizitoni dhe t’i mësoni njerëzit:

- U kërkoni atyre të shkruajnë zotimin e tyre në literaturat që u keni lënë si një broshurë ose një kartë me emrat dhe numrat tuaj të telefonit.
- Sigurohuni që njerëzit ta dinë se ju do t’u bëni vizita ditore të shkurtra ndërmjet takimeve të mësimdhënies. U shpjegoni se qëllimi juaj është t’i mbështesni dhe t’i ndihmoni ata. U jepni një ide se çfarë do të bëni gjatë atyre vizitave.
- Bëni shënime specifike në seksionin e planifikuesit tuaj Shënime/Gjëra Për T’u Bërë që të nesërmen të ndiqni ecurinë e çdo ftese zotimi që keni drejtuar sot.

Kontakti shpesh, përditë nëse është e mundur, për të parë se si po përparojnë njerëzit në zotimet e tyre, për t’iu përgjigjur pyetjeve, për t’i ndihmuar të kapërcejnë vështirësitë, për të dhënë mësim shtesë, për të lexuar së bashku nga Libri i Mormonit, për të ndarë pjesë nga shkrimet e shenja, ose për të përdorur materiale audiovizive. Ndërsa i vizitoni shpesh njerëzit, ju do të forconi ndjenjat shpirtërore që ata ndjenë, kur ju u mësuat atyre

mesazhin e Rivendosjes të ungjillit të Jezu Krishtit. Ky ndikim mbështetës i Shpirtit është jetësor. Ndonjëherë ju mund t'i telefononi kërkuesit për t'i kujtuar dhe për t'i nxitur ata të mbajnë një zotim.

I ndihmoni kërkuesit të identifikojnë bekimet që kanë marrë kur kanë mbajtur zotimet e tyre. Veçanërisht i ndihmoni ata të përshkruajnë ndjenjat e tyre kur Shpirti i ka dëshmuar për vërtetësinë e mesazhit.

Përgëzoni dhe inkurajoni njerëzit që po përparojnë në mbajtjen e zotimeve. Kërkuesit po ndryshojnë jetën e tyre. Ata kanë shumë për të mësuar dhe për të bërë. Përgëzoni ata sinqerisht dhe vazhdimisht. Shprehni mirënjohjen tuaj për përparimin e tyre dhe besimin se ata mund të jenë të suksesshëm. Inkurajojini sa herë që jeni me ta.

Shprehni shqetësim dhe zhgënjim kur njerëzit dështojnë në mbajtjen e zotimeve të tyre duke dështuar në këtë mënyrë të provojnë bekimet.

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Shkruani në programin ditor planet tuaja për kontakte të përditshme me secilin nga kërkuesit. Planifikoni disa ditë më parë se çfarë do të bëni për të ndjekur ecurinë e kërkuesve.

Zgjidhni një ftesë zotimi që do të drejtoni kur të jepni mësim. Pastaj identifikoni shqetësimet e ndryshme që mund ta pengojnë dikë që ta pranojë ose ta mbajë atë zotim. Diskutoni dhe praktikoni se si ju mund t'i ndihmoni më mirë njerëzit ndërsa ata punojnë për të zgjidhur shqetësimet e tyre.

#### Mbani Mend

- Përqendrohuni të ftoni njerëzit për të marrë zotime në çdo situatë gjetjeje apo mësimdhënieje, si ata që nuk janë anëtarë të Kishës ashtu edhe me anëtarët e Kishës.
- Drejtoni ftesa zotimesh për t'i ndihmuar njerëzit të përjetojnë kthimin në besim.
- Premtoni Bekime.
- Dëshmoni.
- Ndiqni ecurinë për t'i ndihmuar njerëzit të mbajnë zotimet.

Shënime

## Ide për Studim dhe Zbatim

### Studim Individual

- Identifikoni një urdhërim të renditur në mësimin 4 ose 5. Mendoni mbi bekimet që keni marrë nga bindja ndaj këtij urdhërimi dhe shkruajeni atë në ditarin tuaj.
- Në një letër, i pyesni anëtarët e familjes se si janë bekuar ata nga bindja ndaj një urdhërimi specifik (për shembull, e dhjeta).
- Shkruani se si ndiheni rreth ftesave për t'u zotuar. Jeni i guximshëm ose i ndrojtur? A keni besim se njerëzit do të bekojnë, apo keni dyshime? A jeni i qëndrueshëm, i duruar dhe i dobishëm kur bëni kontakte ditore? A e dinë njerëzit se ju i doni ata? Si mund ta korrignoni ndonjë dobësi që ju konstatoi në ftesat tuaja?
- Rishikoni planin tuaj mësimor për çdo mësim. A keni përfshirë zotime specifike? Plani juaj mësimor a ju çon qartë drejt zotimeve?

### Studim me Shokun

- Duke u bazuar në planifikuesin ditë, bëni një listë të njerëzve që keni kontaktuar në dy ditët e fundit, duke përfshirë kërkuesit dhe anëtarët. Për çdo person, shkruani zotimin (zotimet) që ata kanë marrë dhe ftesa të tjera që ju mund ose duhej t'u kishit drejtuar. Diskutoni pse arritët të merrnit zotime nga disa prej këtyre njerëzve dhe çfarë ju ndaloi të merrnit zotime prej të tjerëve. Çfarë do të bëni për të ndjekur ecurinë e këtyre zotimeve?
- Shikoni në planifikuesin tuaj ditë dhe shkruani emrat e kërkuesve të veçantë që do t'i mësoni gjatë dy ditëve të ardhshme. Mendoni se cilat urdhërimet të renditura në mësimin 4 dhe 5 do t'i ftoni të jetojnë. Diskutoni se si do ta drejtoni ftesën për zotim dhe bekimet specifike që do të premtoni për bindjen ndaj tij.
- Merrni në konsideratë t'i tregoni kërkuesve Dokumentin e Mësimdhënies për t'u bërë të njohur se çfarë do të pritët prej tyre. Nëse është e përshtatshme, ndani një kopje me ta.
- Rishikoni Shënime/Lista e Gjërave që Duhet Bërë, në planifikuesin tuaj për tre ditët e shkuara, për të parë nëse i keni shkruar detyrat tuaja për të ndjekur ecurinë në çdo ftesë që keni drejtuar.

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Diskutoni ide efektive dhe krijuese për kontakte ditore me kërkuesit. Si kanë punuar efektivisht misionarët me anëtarët? Çfarë materialesh të shtypura ose audiovizive janë të dobishme? Çfarë mund të bëni kur njerëzit nuk janë në shtëpi ose janë shumë të zënë për t'ju takuar?
- Diskutoni mënyrat se si misionarët u kanë mësuar efektivisht kërkuesve urdhërimet që gjenden në mësimet 4 dhe 5.
- Diskutoni rreth shqetësimeve specifike të disa kërkuesve që (misionarët) po mësojnë tani. Cila është natyra e këtyre shqetësimeve? Çfarë mund të bëjnë misionarët për të zgjidhur shqetësimet e tyre?

### Presidenti i Misionit

- Herë pas here shoqërojeni misionarët kur japin mësim. I ndihmoni ata të përqendrohen në ndihmën që u japin njerëzve të marrin dhe të mbajnë zotime.
- I nxisni udhëheqësit e priftërisë dhe anëtarët të marrin pjesë aktive në kontaktimin e përditshëm me kërkuesit.
- Jini një shembull në drejtimin e ftesave në përpjekjet tuaja misionare dhe me misionarët që ju shërbeni.





# Si t'i Përgatis Njerëzit për Pagëzim dhe Konfirmim?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Çfarë duhet të bëj që t'i ndihmoj njerëzit të përgatiten për pagëzim dhe konfirmim?
- Si të drejtoj një intervistë efektive pagëzimi?
- Si planifikohet dhe drejtohet një shërbesë shpirtërore pagëzimi?
- Si duhet të punoj ngushtë me peshkopin për t'u siguruar që të kthyerit në besim të konfirmohen?
- Pse është e rëndësishme të plotësohen dokumentet e pagëzimit dhe konfirmimit?

## Përgatitini Njerëzit për Pagëzim dhe Konfirmim

**Q**ëllimi i mësimdhënies tuaj është t'i ndihmoni të tjerët të zhvillojnë besim në Jezu Krisht dhe të pendohen për mëkatet e tyre. Siç mësoi Mormoni: “fryti i parë i pendimit është pagëzimi” (Moroni 8:25). Intervista e pagëzimit është mënyra e vendosur nga Kisha për t'u siguruar që secili kandidat i plotëson standardet e Zotit për pagëzim dhe është i përgatitur të marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Me anë të kësaj interviste, kandidatët për pagëzim përmbushin kërkesën e shkrimeve të shenjta se ata dëshmojnë përpara një përfaqësuesi të autorizuar të Kishës se “janë penduar me të vërtetë për gjithë mëkatet e tyre” (DeB 20:37). Zotimet që marrin kërkuesit i përgatisin ata për të bërë dhe për të mbajtur besëlidhjen e pagëzimit. Njerëzit që kanë mbajtur zotimet të cilat ju i ftuat të marrin, do të jenë të përgatitur mirë për intervistën dhe për anëtarësinë e aktivitetin në Kishë.

Ndërsa i mësoni kërkuesit dhe i përgatisni ata për pagëzim dhe konfirmim, bëni të mundur që ata t'i plotësojnë kushtet për pagëzim.

**Plotësimi i Kushteve për Pagëzim****Doktrina e Besëlidhje 20:37:**

- Të përulen përpara Perëndisë.
- Të kenë dëshirë për t'u pagëzuar.
- Të kenë zemra të thyera dhe shpirtra të penduar.
- Të pendohen për të gjitha mëkatet e tyre.
- Të jenë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Jezu Krishtit.
- Të kenë vendosmërinë t'i shërbejnë Krishtit deri në fund.
- Të tregojnë me veprat e tyre se e kanë marrë Shpirtin e Krishtit për heqjen e mëkateve të tyre.

**Presidencia e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve:**

- Të bëjnë ndryshime të mjaftueshme në jetën e tyre për të plotësuar kushtet siç urdhërohet në Doktrina e Besëlidhje 20:37.
- Të zhvillojnë besim te Krishti.
- Të pendohen për shkeljet.
- Të jetojnë parimet e denjësisë morale.
- Të jetojnë Fjalën e Urtësisë.
- Të zotohen për të paguar të dhjetën.
- Të marrin të gjitha mësimet misionare [mësimet 1–4 në Dokumentin e Mësimdhënies dhe zotimet përkatëse].
- Të takojnë peshkopin ose presidentin e degës.
- Të marrin pjesë në disa mbledhje sakramenti.

(“Deklaratë rreth Punës Misionare,” letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002)

Kur një kërkues ka vendosur një datë të përcaktuar pagëzimi, planifikoni kur do t'i përfundoni të gjitha ngjarjet që çojnë në pagëzim dhe konfirmim siç është renditur në planifikuesin tuaj ditor. Rishikoni me kujdes Dokumentin e Mësimdhënies që të siguroheni që u keni mësuar doktrinat bazë dhe se kandidatët janë përgatitur t'i përgjigjen çdo pyetjeje në intervistën e pagëzimit. Rishikojeni këtë planifikim me personin gjatë takimit të ardhshëm. Në qoftë se është e mundur, personi duhet të marrë pjesë në një shërbesë pagëzimi para pagëzimit të tij/saj.

Në qoftë se ju e ndieni se personi të cilin po mësoni ka nevojë për përgatitje të mëtejshme, mos planifikoni një intervistë derisa kërkuesi të arrijë standardet. Në qoftë se kandidati është një i mitur, sigurohuni që prindërit ose kujdestarët të kenë dhënë lejen, mirë do të ishte që kjo leje të jepej me shkrim, që ai ose ajo të pagëzohet.

Ndërsa i ndihmoni njerëzit të përgatiten për intervistën e pagëzimit, u flisni atyre rreth qëllimit të intervistës. U mësoni atyre dhe jepni dëshmi për shenjtërinë e pagëzimit dhe marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë. U shpjegoni se ju doni të bëni të mundur që ata t'i kuptojnë parimet që u keni mësuar dhe besëlidhjen që do të bëjnë. Gjithashtu shpjegoni se intervista është një mundësi për ta të dëshmojnë para përfaqësuesit të Zotit se ata janë gati për këto ordianca të shenjta. Ndërsa mbajnë besëlidhjen e bërë në pagëzim dhe konfirmim, ata do të marrin një heqje të mëkateve. Ndani me ta pyetjet që intervistuesi do t'u bëjë rreth besimit të tyre në doktrina të rëndësishme, pendimit të tyre për mëkatet e kaluara dhe gatishmërinë e tyre për të besëlidhur se do t'i binden Jezu Krishtit gjatë

gjithë jetës së tyre. Theksoni se pagëzimi me anë të ujit nuk është i plotë pa konfirmimin dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë.

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

- Lexoni secilin nga fragmentet e mëposhtme dhe bëni një listë përmbledhëse të kërkesave nga shkrimet e shenja për pagëzimin dhe konfirmimin.

2 Nefi 9:23; 31:4–13

3 Nefi 27:13–21

DeB 20:37

Mosia 18:8–10

Moroni 6:1–4

DeB 22

Alma 7:14–15

Moroni 8:25–26

Veprat e Apostujve 2:37–39

- Në intervistat e pagëzimit kandidatët pyeten nëse ata janë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Krishtit. Çfarë mund të bëni për t'i ndihmuar ata ta kuptojnë këtë pyetje? Ndërsa mendoni rreth kësaj pyetjeje, studioni shkrimet e shenja që vijojnë:

Mosia 4–5

Mosia 26:18, 21–27

3 Nefi 27:1–10

Mosia 18:1–11

Ju gjithashtu mund të keni dëshirë të kërkonit fragmente të tjera që ju ndihmojnë të kuptoni këtë parim.

## Si të Drejtoni Intervistën

Personi që kryen intervistën duhet të përdorë pyetjet e intervistës së pagëzimit me udhëheqjen e Shpirtit, për të përcaktuar nëse kandidati për pagëzim plotëson kërkesat e përshkruara në Doktrina e Besëlidhje 20:37. Ai duhet gjithashtu t'i përshtasë pyetjet sipas moshës dhe pjekurisë së kandidatit.

Në qoftë se kandidati nuk i plotëson kushtet sipas pyetjeve të intervistës së pagëzimit, pagëzimi dhe konfirmimi duhet të shtyhen për më vonë. Kërkuesi duhet të marrë mësimë të mëtejshme nga misionarët me kohë të plotë dhe të ketë shoqërimin e anëtarëve të lagjes.

Udhëheqësi i distriktit ose udhëheqësi i zonës që drejton intervistën duhet:

- Ta zhvillojë intervistën në një vend të qetë dhe privat, që bën të mundur të ndihet Shpirti i Zotit. Shoku i intervistuesit duhet të jetë diku aty rrotull.
- Të fillojë me lutje.
- Ta ndihmojë kandidatin të ndihet i lirshëm.
- Ta bëjë intervistën një përvojë shpirtërore lartësuese.
- Të bëjë të mundur që kandidati të kuptojë qëllimin e intervistës.
- Të bëjë pyetjet e intervistës së pagëzimit. Të përdorë pyetje plotësuese për të krijuar një përshtypje për forcën e dëshmisë së personit dhe sinqeritetin e pendimit të personit.
- T'i përgjigjet pyetjeve të kandidatit.
- Ta ftojë personin të japë dëshmi dhe të shprehë ndjenjat e tij/saj.
- Në qoftë se personi ka vështirësi me dëshminë ose denjësinë, t'i shpjegojë se do të jetë më mirë ta shtyjë për më vonë pagëzimin derisa ai/ajo të jetë përgatitur më mirë.

Shënime

**Pyetjet e Intervistës së Pagëzimit**

1. A besoni se Perëndia është Ati ynë i Amshuar? A besoni se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës?
2. A besoni se Kisha dhe ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur me anë të Profetit Jozef Smith? A besoni se [Presidenti aktual i Kishës] është një profet i Perëndisë? Ç'do të thotë kjo për ju?
3. Çfarë do të thotë për ju të pendoheni? A e ndieni se jeni penduar për shkeljet tuaja të kaluara?
4. A keni kryer ndonjëherë një krim serioz? Nëse po, a jeni tani në periudhë prove ose lirim me kusht? A keni marrë pjesë në një abort? një marrëdhënie homoseksuale?
5. Juve ju është mësuar se anëtarësia në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme përfshin të jetuarit e standardeve të ungjillit. Çfarë kuptoni ju me standardet e mëposhtme? A jeni i gatshëm t'u bindeni atyre?
  - a. Ligji i dëlirësisë, i cili ndalon çdo marrëdhënie seksuale jashtë lidhjes së martesës ligjore midis një burri dhe një gruaje.
  - b. Ligji i së dhjetës.
  - c. Fjala e Urtësisë.
  - d. Dita e Shabatit, përfshin marrjen e sakramentit çdo javë dhe dhënien e ndihmës bashkëbesimtarëve.
6. Kur pagëzoheni, ju bëni besëlidhje me Perëndinë se jeni i gatshëm të merrni mbi vete emrin e Krishtit dhe të mbani urdhërimet e Tij gjatë gjithë jetës suaj. A jeni gati të bëni këtë besëlidhje dhe të përpiqeni të jeni besnik ndaj saj?

Në përfundim të një interviste të suksesshme, urojoni kandidatin. Bashkohuni me misionarët e tjerë dhe shpjegoni se çfarë do të ndodhë në shërbesën e pagëzimit.

Shpjegoni se konfirmimi do të ndodhë nën drejtimin e peshkopit në një mbledhje sakramenti të lagjes në të cilën ata banojnë.

Kur është e domosdoshme të shtyhet pagëzimi, udhëheqësi i distriktit ose udhëheqësi i zonës dhe misionarët e tjerë, duhet ta trajtojnë situatën me ndjeshmëri dhe fshehtësi. Sigurojeni kandidatin se ai ose ajo mund të përparojë dhe shpjegojini se disa shkelje kërkojnë më shumë kohë për një pendim të plotë. Shpjegoni se natyra e shenjtë e ordinancës kërkon standarde të larta denjësie. Sigurojeni kandidatin se ju dhe të tjerët do të bëni gjithçka që mundeni për ta mbështetur atë. Pastaj me besnikëri mbani premtimet tuaja.

**Pagëzimi dhe Konfirmimi: Pyetje dhe Përgjigje****Kush e drejton intervistën për pagëzim?**

Normalisht, udhëheqësi i distriktit interviston kandidatët e mësuar nga misionarët në distriktin e tij, duke përfshirë edhe kandidatët e mësuar nga udhëheqësit e zonës së tij. Udhëheqësi i zonës interviston kandidatët e mësuar nga udhëheqësi i distriktit. Presidenti i misionit ose dikush që cakton ai duhet të intervistojë njerëzit e përfshirë në mëkate serioze. Udhëheqësit e distriktit ose të zonës nuk intervistojnë kandidatët për pagëzim jashtë distriktit ose zonës së tyre, përveç rasteve kur presidenti i misionit i cakton ta bëjnë këtë.

**Cili është përkufizimi i pagëzimit të të kthyerit në besim?**

Pagëzimet e të kthyerve në besim janë pagëzimet e:

- Personave nëntë vjeç e lart të cilët nuk kanë qenë pagëzuar e konfirmuar kurrë më parë si anëtarë të Kishës.
- Fëmijët në moshën tetë vjeç prindërit e të cilëve nuk janë anëtarë ose do të pagëzohen dhe konfirmohen në të njëjtën kohë me fëmijën.

#### **A më duhet leje për të pagëzuar një fëmijë të mitur?**

Përpara se të mund të mësoni dhe të pagëzoni një kërkues që është nën moshën ligjore, ju duhet të merrni lejen e prindit (prindërve) ose kujdestarit (kujdestarëve) të ligjshëm, mirë do të ishte që kjo leje të jepej me shkrim. Përveç kësaj, ju duhet të keni arsye të mira që të besoni se fëmija e kupton besëlidhjen e pagëzimit dhe do të bëjë çdo përpjekje që ta mbajë këtë besëlidhje nëpërmjet bindjes ndaj ungjillit, përfshirë pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e Kishës.

#### **A më duhet leja e bashkëshortes/it në mënyrë që të pagëzoj një bashkëshort ose bashkëshorte?**

Po. Mos e pagëzoni një person të martuar pa miratimin e bashkëshortes/it të tij/saj.

#### **Në qoftë se babai në një familje nuk është gati për pagëzim, duhet ta pagëzoj familjen apo duhet të pres derisa babai të jetë gati?**

Në qoftë se babai i një familjeje nuk është gati për pagëzim dhe konfirmim, por anëtarët e tjerë të familjes janë gati, ju mund t'i thoni babait se do të preferoni të mos e pagëzoni familjen pa të, sepse Kisha respekton kreun e shtëpisë dhe sepse anëtarët e familjes mund të përparojnë më mirë në ungjill si një njësi familjare. Në qoftë se babai vazhdon të refuzojë, ju mund të pagëzoni dhe konfirmoni anëtarët e tjerë të familjes me pëlqimin e tij.

#### **Është një ide e mirë të shugurohet një baba në Priftërinë Aarone menjëherë pas pagëzimit kështu që ai të mund të pagëzojë anëtarët e tjerë të familjes?**

Jo. Babai duhet të konfirmohet në një mbledhje sakramenti dhe mbas një interviste me peshkopin, të mbështetet për të marrë Priftërinë Aarone. Pagëzimet e anëtarëve të familjes nuk duhet të shtyhen që babai të ketë mundësi t'i bëjë vetë pagëzimet.

#### **Mund të mësoj dhe të pagëzoj një person që ka qenë shkishëruar?**

Pagëzimet e personave të shkishëruar nuk janë pagëzime të të kthyerve në besim dhe misionarët nuk i intervistojnë persona të tillë për pagëzim. Ju mund të punoni me persona të tillë vetëm nën mbikëqyrjen e ngushtë të presidentit të misionit dhe të peshkopit.

#### **Çfarë duhet bërë nëse një person ka të programuar një datë pagëzimi, por nuk po i mban të gjitha zotimet?**

Në qoftë se e ndieni se dikush të cilin po e mësoni ka nevojë për përgatitje të mëtejshme, mos planifikoni një intervistë pagëzimi derisa kërkuesi të mbajë zotimet dhe të arrijë standardet.

#### **Çfarë duhet të bëj kur njerëzit duan të pagëzohen, por bashkëjetojnë pa qenë të martuar?**

Kandidatët për pagëzim që kanë jetuar jashtë lidhjeve martesore me një person të gjinisë së kundërt duhet ose të martohen ose të mos bashkëjetojnë më përpara se ata të mund të pagëzohen.

#### **Pyetja 4 në intervistën e pagëzimit pyet nëse një person ka qenë përfshirë në një mëkat serioz, siç është një abort, një marrëdhënie homoseksuale, ose një krim i rëndë. Çfarë duhet të bëj në qoftë se dikush do të rrëfejë një mëkat të tillë?**

1. *Udhëzime për misionarët që japin mësim.* Ndonjëherë kërkuesit vullnetarisht mund të japin informacion rreth mëkateve të tilla kur ju u mësoni urdhërimet dhe i ftoni të marrin zotime. Megjithatë, në qoftë se ata nuk thonë asgjë, por ju mendoni se ata mund të kenë një

## Shënime

problem, i përgatisni për intervistën e pagëzimit duke i pyetur nëse kanë qenë përfshirë në ndonjë nga këto mëkate. Në qoftë se ju viheni në dijeni të një mëkati serioz, mos pyesni rreth detajeve të mëkatit. Mos programoni një datë pagëzimi ose mos bëni ndonjë premtim rreth asaj nëse ata do të miratohen për pagëzim dhe konfirmim. Shprehni dashurinë tuaj dhe rishikoni parimin e pendimit. Me mirësjellje shpjegoni se këto mëkate janë serioze dhe se një person me më shumë maturi dhe përvojë (presidenti i misionit ose dikush që cakton ai) do të flasë me ta dhe do t'i ndihmojë në këto çështje. Pastaj i dërgoni drejtpërdrejt presidentit të misionit një kërkesë për intervistë pagëzimi.

2. *Udhëzime për personin që zhvillon intervistën për pagëzim.* Në qoftë se misionarët e kanë mësuar si duhet kandidatin përpara intervistës së pagëzimit, këto çështje, në qoftë se ato ekzistojnë, duhet t'i ishin drejtuar presidentit të misionit. Nëse të tilla probleme dalin, shprehni dashurinë tuaj dhe rishikoni urdhërimet dhe parimin e pendimit. Me mirësjellje shpjegoni se këto mëkate janë serioze dhe se një person me më shumë maturi dhe përvojë (presidenti i misionit ose dikush që cakton ai) do të flasë me ta dhe do t'i ndihmojë në këto çështje. Pastaj i dërgoni drejtpërdrejt presidentit të misionit një kërkesë për intervistë pagëzimi.

**Aktivitet: Studim Individual**

Mendoni se si do të ndiheshit ju po të intervistoheshit. Mendoni rreth pyetjeve që vijojnë:

- Cilat aspekte të intervistës mund të ishin të çuditshme për ju? Çfarë mund të bëjë ose të thotë intervistuesi për t'ju bërë të ndiheni mirë?
- Si do të donit që të sillej me ju intervistuesi?
- Si do të donit që t'ju përgjigjej intervistuesi nëse ju shprehnit dyshime apo keqkuptime ose nëse rrëfenit mëkate serioze?

I shkruani përgjigjet e këtyre pyetjeve në ditarin tuaj të studimit.

**Plotësoni Dokumentin e Pagëzimit**

Misionari që drejton intervistën duhet të plotësojë Dokumentin e Pagëzimit sipas udhëzimeve në formular. Ai duhet të shpjegojë se një dokument anëtarësie krijohet nga Dokumenti i Pagëzimit dhe do të përmbajë informacion të rëndësishëm rreth anëtarëve të rinj dhe ordinancave që ata kanë marrë. Kur anëtarët transferohen, dokumenti i anëtarësisë dërgohet në njësinë e re kështu që peshkopi i tyre i ri, të mund të sigurojë shoqërim dhe ndihmë për ta. Misionari duhet t'i kërkojë kandidatit të verifikojë informacionin në formular gjatë intervistës. Misionari që drejton intervistën duhet të marrë me vete në shërbesën e pagëzimit Dokumentin e Pagëzimit dhe t'ia japë atë personit që kryeson shërbesën.

Peshkopi duhet të sigurohet që të plotësohet një Dokument Konfirmimi/Certifikatë Pagëzimi dhe Konfirmimi për secilin kandidat sipas udhëzimeve në formular.

**Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun**

Studioni Mosia 6:1–3 dhe Moroni 6:1–4. Si lidhen këto fragmente me përgjegjësinë tuaj për të mbajtur dokumente të sakta të pagëzimeve dhe konfirmimeve?

## Shërbesa e Pagëzimit

Shpirti shfaqet fuqishëm gjatë kryerjes së ordinancave të shenjta të pagëzimit dhe konfirmimit. Shërbesa e pagëzimit dhe konfirmimi që vjen më pas, duhet të jenë përvojat më të bukura shpirtërore për të kthyerit e rinj në besim. Ju dhe udhëheqësi i misionit të lagjes, duhet të bëni gjithçka që mundeni për t'u siguruar që shërbesa e pagëzimit të jetë e organizuar, frymëzuese dhe e paharruar. Këto shërbesa duhet ta forcojnë të kthyerin e ri në besim në zotimet e tij për të qëndruar aktiv në Kishë.

Ftoni këshillin e peshkopit, udhëheqësit e kuorumit e të organizatave ndihmëse dhe mësuesit e shtëpisë e mësueset e vizitave (në qoftë se janë caktuar) të marrin pjesë në shërbesën e pagëzimit. Shokët dhe të afërmit e të kthyerve në besim dhe të gjithë të porsakthyerit në besim, duhet të ftohen të marrin pjesë në shërbesën e pagëzimit dhe në mbledhjet e sakramentit ku do të bëhet konfirmimi. Këto përvoja do t'i ndihmojnë ata të ndiejnë Shpirtin dhe të përgatiten të pranojnë ftesën për të mësuar më shumë rreth ungjillit. Punoni me kandidatin për pagëzim dhe udhëheqësin e misionit të lagjes për të ftuar shokët dhe të afërmit e kandidatit të marrin pjesë në shërbesën e pagëzimit. Pas shërbesës takohuni me ta për të diskutuar rreth përvojës së tyre dhe ftojini ata të mësojnë pse shoku/shoqja i/e tyre zgjodhi të pagëzohet.



Misionarët që mësuan kandidatin për pagëzim bashkëpunojnë me udhëheqësin e misionit të lagjes për të organizuar shërbesën. Shpjegojini kandidatit për pagëzim çfarë është planifikuar dhe pse. Diskutoni për veshjet e përshtatshme, duke përfshirë faktin se kandidatit do t'i jepen të veshë rroba të bardha për pagëzimin. Bini dakord për vendin dhe orën e pagëzimit. Zakonisht shërbesën e drejton një anëtar i presidencisë ose udhëheqësi i misionit të lagjes. Më poshtë ndodhen pika të rëndësishme për të planifikuar dhe organizuar shërbesën e pagëzimit.

Një shërbesë mund të përfshijë:

1. Muzikë preludi.
2. Një mirëseardhje të shkurtër nga udhëheqësi i priftërisë që drejton shërbesën (një anëtar i këshillit të peshkopit duhet të kryesojë).
3. Himnin dhe lutjen e hapjes.
4. Një ose dy biseda të shkurtra mbi temat e ungjillit, të tilla si pagëzimi dhe dhurata e Frymës së Shenjtë.
5. Një përzgjedhje muzikore.
6. Kryerjen e pagëzimit.
7. Një kohë për të treguar nderim gjatë kohës që njerëzit që morën pjesë në pagëzim ndërrohen. Kjo kohë mund të përfshijë një interval muzikor, këndimin e himneve të njohura dhe këngëve të Fillores, shfaqjen e një prodhimi audioviziv të Kishës, ose dhënien e dëshmimeve.

## Shënime

8. Një mundësi që të kthyerit e rinj në besim të japin dëshmitë e tyre, nëse dëshirojnë.
9. Himnin dhe lutjen e mbylljes.
10. Muzikë mbyllëse.

### Konfirmimi

Një person merr ordinancën e konfirmimit pasi ai ose ajo të jenë pagëzuar (shih DeB 20:41). Një i kthyer i ri në besim konsiderohet një anëtar i Kishës pasi është kryer ordinanca e pagëzimit dhe konfirmimit (shih Gjoni 3:5; DeB 33:11). Të kthyerit e rinj në besim konfirmohen në një mbledhje sakramenti të lagjes ku ata banojnë, jo në shërbesën e pagëzimit. Peshkopi është përgjegjës për t'u kujdesur që konfirmimi të ndodhë sa më shpejt të jetë e arsyeshme pas pagëzimit. Peshkopi ose një nga këshilltarët e tij merr pjesë në konfirmim. Peshkopi mund të ftojë misionarët që ndihmuan në mësimin e të kthyerit në besim të marrin pjesë në konfirmim. Punoni ngushtë me peshkopin dhe udhëheqësin e misionit të lagjes për t'u siguruar që kjo ordinancë thelbësore të kryhet.



### Pas Pagëzimit dhe Konfirmimit

Nën drejtimin e peshkopit, misionarët mund të vazhdojnë të shoqërojnë anëtarët e rinj. Vazhdoni t'i mësoni dhe të rishikoni ato që u keni mësuar. Nxitini dhe mbështetini ata, lexoni me ta Librin e Mormonit dhe ndihmohjini të ndajnë ungjillin me anëtarët e familjes dhe shokët. Si të jetë e përshtatshme, vazhdoni gjatë gjithë jetës suaj të komunikoni me ata të cilët ju i keni mësuar dhe t'i nxisni e mbështesni ata.

Mbas konfirmimit, vazhdoni të përdorni Dokumentin e Mësimdhënies për të shënuar përparimin tuaj në dhënien e mësimëve 1–4 përsëri dhe në dhënien e mësimit 5. Punoni ngushtë me udhëheqësin e misionit të lagjes dhe udhëheqjen e lagjes për ta ndihmuar të kthyerin e ri në besim të qëndrojnë aktiv dhe të marrë të gjitha bekimet e Shlyerjes së Jezu Krishtit.

#### Mbani Mend

- Përgatitini si duhet kandidatët për pagëzim për intervistën e pagëzimit dhe konfirmimit.
- Sigurohuni që kandidatët i plotësojnë kërkesat për pagëzim dhe konfirmim.
- Ndihmoni të siguroni që shërbesat e pagëzimit të jenë shpirtërisht lartësuese.
- Përdorini shërbesat e pagëzimit dhe konfirmimit si mundësi për të gjetur kërkues.
- Plotësoni saktësisht dokumentet e pagëzimit dhe konfirmimit.



## Ide për Studim dhe Zbatim

Shënime

### Studim Individual

- Bëni një listë të sfidave që mund të hasë një kandidat për pagëzim. Pse është e rëndësishme që kandidatët të ndiejnë dashurinë dhe shoqërinë e anëtarëve të Kishës?
- Studioni Moroni 6 dhe Doktrina e Besëlidhje 20:68–69. Çfarë mësoni nga këto vargje rreth përgatitjes së njerëzve për pagëzim dhe konfirmim? Shkruani çfarë mësoni dhe ndani mendimet tuaja me shokun/shoqen tuaj gjatë studimit me shokun.

### Studim me Shokun

- Plaku Henri B. Ajring shpjegoi pse standardet e larta janë të rëndësishme. Diskutojeni këtë këshillë me shokun/shoqen tuaj dhe vlerësoni si ndiheni rreth ndihmës së guximshme që duhet t'u jepni njerëzve që ata t'i arrijnë këto standarde. “Zoti vendos standardet e Tij që të mund të na bekojë. Mendoni rreth këtyre bekimeve: Ai u premtonte atyre që i arrijnë këto standarde ndihmën e Frymës së Shenjtë. Ai premtonte paqe personale. Ai premtonte mundësinë për të marrë ordinancat e shenjta në shtëpinë e Tij. Dhe Ai u premtonte atyre që durojnë deri në fund në të jetuarit e standardeve të Tij, se ata do të kenë jetën e përjetshme...Duke qenë se ne i duam njerëzit të cilëve u shërbejmë, të gjithë ne duam të bëjmë më të mirën për lartësimin e fëmijëve të Atit tonë Qiellor drejt besnikërisë dhe pastërtisë që u nevojitet për të pasur të gjitha bekimet e Zotit...Ju filloni ta bëni këtë duke mbajtur lart standardet e Zotit me qartësi dhe pa shfajësim. Dhe sa më shumë bota largohet prej tyre dhe tallet me to, aq më të guximshëm duhet të jemi për ta bërë këtë” (“Standards of Worthiness,” *First Worldwide Leadership Training Meeting*, janar 2003, 10–11).
- Ndani me shokun/shoqen tuaj çfarë keni mësuar nga ky kapitull rreth përgatitjes së njerëzve për pagëzim dhe konfirmim.
- Rishikoni shërbesën e fundit të pagëzimit në të cilën keni qenë. Krahasojeni këtë me udhëzimet në seksionin e titulluar “Shërbesa e Pagëzimit.” Çfarë shkoi mirë? Çfarë mund të ishte përmirësuar? Diskutoni se si mund të bëni të mundur që shërbesat që planifikoni të jenë shpirtërore dhe lartësuese.
- Praktikoni si do ta përgatisni një kërkues të caktuar për intervistën e pagëzimit.
- Rishikoni pyetjet e intervistës së pagëzimit. Mendoni si do t'i trajtonit situata të ndryshme, të tilla si ato që vijojnë:
  - Kandidati nuk ju ka treguar se ai është në lirim me kusht për një krim të kryer më parë.
  - Personi nuk ka marrë një përgjigje të fortë për lutjen se Jozef Smithi ishte një profet.
  - Kandidati ka pirë një cigare dy ditë më parë.
  - Kandidatja nuk është e sigurtë nëse ajo ka marrë një përgjigje për lutjet e saj.
  - Familja ndjeu presionin e miqve dhe nuk janë të sigurtë nëse janë gati për pagëzim.
- Rishikoni formularin e Dokumentit të Pagëzimit dhe Dokumentit të Konfirmimit dhe formularin e Certifikatës së Pagëzimit dhe të Konfirmimit. Si mund të siguroheni se informacioni që ju dokumentoni është i saktë dhe i plotë.

Shënime

### Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës

- Rishikoni rëndësinë e intervistës së pagëzimit. Diskutoni se si misionarët duhet t'i përgatisin kërkuesit për intervistë.
- Diskutoni si t'i përdorni shërbesat e pagëzimit dhe konfirmimit si mundësi për të gjetur kërkues.

### Presidenti i Misionit

- Punoni me udhëheqësit lokalë të priftërisë për të siguruar që Dokumenti i Përparimit të përdoret në mënyrë efektive.
- Herë pas here zhvilloni intervistën e parë për pagëzim.
- Mësoni udhëheqësit e distriktit dhe udhëheqësit e zonës si të drejtojnë intervistat e pagëzimit.
- Udhëzoni anëtarët e presidencisë së misionit dhe udhëheqësit e priftërisë si të drejtojnë intervista pagëzimi për ata kandidatë për pagëzim që kanë kryer mëkate serioze.



# Si të Punoj me Udhëheqësit e Kunjit dhe të Lagjes?

Shënime

## Mbani Parasysh

- Për çfarë kanë nevojë të kthyerit e rinj dhe anëtarët më pak aktivë me qëllim që të bëhen anëtarë aktivë të Kishës?
- Cilat janë përgjegjësitë e udhëheqësve të kunjit dhe të lagjes në punën misionare, mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve dhe riaktivizimin?
- Si mund t'i ndihmoj udhëheqësit e lagjes për të ndërtuar Kishën?
- Çfarë duhet të ndodhë në mbledhjen javore të bashkërendimit me udhëheqësin e misionit të lagjes?

**J**u keni mundësinë e mrekullueshme të punoni me shumë udhëheqës dhe anëtarë gjatë misionit tuaj. Së bashku ju do të forconi dhe do të vendosni mbi themele të forta Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Marrëdhëniet që ju do të krijoni me drejtuesit e Kishës do t'ju bekojnë gjatë gjithë jetës. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme ndërsa ju dhe anëtarët e Kishës përpiqeni t'ia sillni ungjillin e rivendosur fëmijëve të Atit Qiellor. Të kuptuarit e elementëve bazë të punës brenda organizimit të lagjes do t'ju ndihmojë të ecni përpara me përqendrim dhe fuqi më të madhe.

## Forcimi i Anëtarëve të Rinj dhe më Pak Aktivë

Kur të kthyerit në besim pagëzohen dhe konfirmohen, ata bëjnë premtime të shenjta për t'iu bindur dhe shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve për gjithë jetën. Ata bëhen kandidatë për shpëtim në mbretërinë çelestiale. Për të marrë bekimet e premtuara, ata duhet të durojnë deri në fund me besim te Jezu Krishti. Anëtarët e Kishës janë faktori kryesor për të ndihmuar të kthyerit e rinj në besim që të mbeten aktivë dhe besnikë.

Presidenti Gordon B. Hinkli tha: "Nuk ka absolutisht asnjë kuptim kryerja e punës misionare po të mos i ruajmë frytet e asaj përpjekjeje. Këto të dyja duhet të jenë të

## Shënime

pandashme... Çdo i kthyer në besim përbën një përgjegjësi të madhe dhe serioze” (“Find the Lambs, Feed the Sheep” *Ensign*, maj 1999, 108).

Nën drejtimin e peshkopit, këshilli i lagjes ka përgjegjësinë kryesore për forcimin e anëtarëve të rinj dhe atyre më pak aktivë. Ata bëjnë të mundur që të porsakthyerit në besim dhe anëtarët më pak aktivë të kenë miq, të ushqehen me fjalën e Perëndisë dhe të pranojnë thirrje dhe përgjegjësi. Ata mund t’u kërkojnë misionarëve me kohë të plotë të ndihmojnë në mësimet e shtëpisë (ose motrat misionare në mësimin e vizitave) dhe në vizitat tek anëtarët e rinj, anëtarët më pak aktivë dhe tek ata që po përgatiten të shugurohen në detyrën e plakut. Do të ishte më mirë që ju të shkoni në vizita të tilla me një anëtar tjetër.

Ju jeni gjithashtu përgjegjës për këta njerëz. Presidenti Hinkli tha: “Ju misionarë ... jeni pjesë e kësaj përgjegjësie për të krijuar një lidhje të të kthyerve në besim me Kishën. Ndoshta ju nuk do të keni mundësi të vazhdoni t’i vizitoni ata. Por ju mund t’u shkruani atyre herë pas here dhe t’i inkurajoni...Kur të shkoni në shtëpi mos i harroni. Gjatë gjithë kohës jetoni të denjë për besimin që ata kanë tek ju. U shkruani atyre herë pas here, duke i siguruar ata për dashurinë tuaj” (*Ensign*, maj 1999, 109).

Gjatë mbledhjeve të kishës, ju dhe shoku/shoqja juaj duhet të uleni me kërkuesit tuaj ose me anëtarët për të cilët po kujdeseni për t’i mbështetur e forcuar. Ju nuk duhet të uleni në një grup me misionarët e tjerë.

Një pjesë jetësore e misionit tuaj është që ta vendosni Kishën në themele të forta dhe të forconi njësitë ku shërbeni. Këtë ju e bëni pjesërisht duke i ndihmuar të kthyerit e rinj në besim të qëndrojnë aktivë dhe duke i ndihmuar anëtarët më pak aktivë t’i rikthehen aktivitetit në Kishë. Një nga detyrat tuaja është që të bashkoheni me misionarët e lagjes për të dhënë përsëri katër mësimet e para dhe mësimin 5. Misionarët e lagjes, mësuesit e shtëpisë dhe mësueset e vizitave mund të ndihmojnë gjithashtu në mësimin e këtyre parimeve.

Presidenti Gordon B. Hinkli tregoi historinë e mëposhtme rreth sfidave me të cilat përballen shumë nga të kthyerit në besim:

*Një ditë mora një letër shumë interesante. Ajo ishte shkruar nga një grua e cila u bashkua me Kishën një vit më parë. Ajo shkruan:*

*“Udhëtimi im për në Kishë ishte i pakrahasueshëm dhe mjaft sfidues. Viti që shkoi ishte viti më i vështirë i jetës sime. Por në të njëjtën kohë edhe më i çmuari. Si një anëtare e re, unë vazhdoj të përballen me sfida çdo ditë.”*

*Ajo e vazhdon letrën duke thënë se kur u bashkua me Kishën, nuk e ndjeu mbështetjen e udhëheqjes së lagjes. Peshkopi dukej indiferent ndaj saj si një anëtare e re. Duke e ndier veten të braktisur, ajo iu drejtua presidentit të misionit, i cili i krijoi mundësi të tjera.*

*Ajo theksoi se: “Anëtarët e Kishës nuk e dinë ç’do të thotë të jesh një anëtar i ri...Prandaj, është pothuaj e pamundur që ata të dinë si të na mbështesin.”*

*Unë ju nxis juve, vëllezërit dhe motrat e mia, që nëse nuk e dini se ç’do të thotë të jesh një anëtar i ri, të përpiqeni ta imagjinoni. Mund të jetë një vetmi e tmerrshme. Mund të jetë zhgënjyese. Mund të jetë e frikshme. Ne anëtarët e kësaj Kise jemi shumë më të ndryshëm nga bota nga sa jemi të prirur të mendojmë se jemi. Kjo grua vazhdon: “Kur ne si kërkues bëhemi anëtarë të Kishës, habitemi kur zbulojmë se kemi hyrë në një botë tërësisht të huaj, një botë që ka traditat, kulturën dhe gjuhën e vet. Ne zbulojmë se nuk ka asnjë apo asnjë vend referimi që ne të mund t’i drejtohem për udhëheqje në udhëtimin tonë në këtë botë të re. Në fillim udhëtimi është ngacmues, gabimet tona janë madje dëfruese, pastaj ky udhëtim bëhet dekurajues dhe më në fund dekurajimi kthehet në zemërim. Dhe është pikërisht*



*në këto etapa të dekurajimit dhe zemërimit që ne largohemi. Dhe kthehemi përsëri në botën nga e cila erdhëm, ku e dinim se kush ishim, ku kontribuonim dhe gjuhën e së cilës mund ta flisnim“ [Ensign, maj 1999, 108].*

#### Aktivitet: Studim Individual ose me Shokun

Lexoni tregimin e mësipërm. Shkruani përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme në ditarin tuaj të studimit, ose diskutojini ato me shokun/shoqen tuaj. Bëni plane dhe qëllime të duhura.

- Sipas këtij tregimi, cilët janë disa nga faktorët që e bëjnë të vështirë për anëtarët e rinj që të mbeten aktivë?
- Si mund të ndihmojë përfshirja e anëtarëve që në fillim të procesit të mësimit në përballimin e këtyre sfidave?
- Mendoni për ata që po mësoni. Si mund t'i përfshini më mirë anëtarët për t'i ndihmuar kërkuesit që të fillojnë të bëjnë kalimin shoqëror në Kishë?

### Mësimi i Shtëpisë dhe Mësimi i Vizitave

Presidentët e kunjit dhe peshkopët, duke bashkërenduar me presidentin e misionit, mund t'i përdorin misionarët për të vizituar anëtarët më pak aktivë dhe familjet që janë pjesërisht anëtare. Në rrethana të përshtatshme, ata mund të kërkojnë që misionarët me kohë të plotë të marrin pjesë në mësimet e shtëpisë dhe në mësimin e vizitave. Këto mundësi për të mësuar duhet t'i forcojnë anëtarët, të rrisin aftësitë e misionarëve për mësimdhënie dhe t'i ndihmojnë misionarët të marrin rekomandime (shih “Deklaratë rreth Punës Misionare,” letër e Presidencisë së Parë, 11 dhjetor 2002).

### Punoni me Këshillin e Lagjes për të Forcuar Anëtarët e Rinj dhe Ata më Pak Aktivë

Mësimi dhe pagëzimi i kërkuesve bëhet nën drejtimin e presidentit të misionit. Megjithatë, puna e shpalljes së ungjillit do të ecë përpara edhe më fuqishëm atëherë kur misionarët me kohë të plotë dhe anëtarët të bashkërendojnë përpjekjet dhe të punojnë së bashku në unitet. Ju shpesh mund të ftoheni të merrni pjesë në mbledhjet e këshillit të lagjes dhe mbledhjet e komitetit ekzekutiv të priftërisë. Përparësia juaj numër një është të siguroheni që kërkuesit tuaj të jenë në Kishë. Shpesh kjo do të thotë që ju duhet t'i shoqëroni ata. Nëse ka një konflikt midis pjesëmarrjes në mbledhjen e këshillit të lagjes dhe shoqërimit të dikujt për në kishë, bëni këtë të fundit. Në këtë rast, jepini një kopje të Dokumentit të Përparimit udhëheqësit të misionit të lagjes dhe sigurohuni që ai të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për këshillin e lagjes ose komitetin ekzekutiv të priftërisë.



© 1999 Greg K. Olsen. Përdorur me leje nga Mill Pond Press. Ndaloherë fotokopjimi.

Shënime

## Shënime

Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Çdo i kthyer në besim ka nevojë për tre gjëra:

1. Një mik në Kishë tek i cili ai mund të drejtohet vazhdimisht, që do të ecë përkrah tij, që do t’i përgjigjet pyetjeve të tij, që do të kuptojë problemet e tij.

2. Një detyrë. Aktiviteti është gjeniu i kësaj Kise. Ai është procesi nëpërmjet të cilit ne rritemi. Besimi dhe dashuria për Zotin janë si muskujt e krahut tim. Nëse unë i përdor, ata bëhen më të fortë. Nëse i lidh me një fasho, ata bëhen më të dobët. Çdo i kthyer në besim meriton një përgjegjësi...

3. Çdo i kthyer në besim duhet të ‘ushqehet me fjalën e mirë të Perëndisë’ (Moroni 6:4). Është e domosdoshme që ai apo ajo të anëtarësohet në një kuorum priftërie ose Shoqatën e Ndihmës, tek të Rejat, të Rinjtë, në Shkollën e së Dielës, apo tek Fillorja. Ai ose ajo duhet të nxitet të vijë në mbledhjen e sakramentit për të marrë sakramentin, për të përtërirë besëlidhjet e bëra në kohën e pagëzimit” (*Ensign*, maj 1999, 106).

Këshilli i lagjes duhet të luajë rolin kryesor në gjetjen e një miku, një përgjegjësie dhe ushqimit shpirtëror për të porsakthyerit në besim. Ju do t’i ndihmoni ata sipas kërkesave të tyre. Udhëheqësit e priftërisë dhe anëtarët janë ata që do kujdesen për shoqërimin, të ndihmuar nga ju.

### Miqësia

- Para pagëzimit dhe konfirmimit, bëni të mundur që anëtarët të jenë të pranishëm në çdo mësim, në qoftë se është e mundur. Këta anëtarë duhet të jenë me kërkuesit shpesh që t’iu përgjigjen pyetjeve të tyre, të kuptojnë sfidat e tyre dhe t’u japin kurajo.
- Ftojini anëtarët të marrin pjesë në shërbesën e pagëzimit dhe të mirëpresin në lagje të kthyerit e rinj në besim. Anëtarët i ndihmojnë të kthyerit e rinj në besim të ndihen mirë gjatë mbledhjeve të ndryshme të Kishës. Ata gjithashtu duhet t’i prezantojnë ata me anëtarë të tjerë.
- Prezantojini kërkuesit, sa më shpejt të jetë e mundur, me peshkopin, këshilltarët e tij, presidentin e kuorumit të pleqve dhe presidenten e Shoqatës së Ndihmës si dhe me udhëheqësit e tjerë të lagjes. Shpjegoni rolin e peshkopit dhe udhëheqësve të tjerë të lagjes.



### Mundësi për të Shërbyer

- Ndihejini meshkujt e kthyer në besim të kuptojnë dhe të përgatiten për të marrë Priftërinë Aarone dhe Priftërinë Melkizedeke. Shpjegoni se kuorumet e priftërisë sigurojnë mundësi për të mësuar, adhuroar dhe shërbyer së bashku.
- Përfshijini të kthyerit e rinj në besim dhe anëtarët më pak aktivë në mundësi shërbimi të tilla si ndihmë për një të ve ose për një të sëmure, apo të marrin pjesë në projektet e ndihmës së mirëqenies.
- Prezantojini të kthyerit në besim me konsulentët e historisë familjare në mënyrë që ata të mund të plotësojnë një dokument të grupit familjar dhe një tabelë të prejardhjes familjare.

Nëse rrethanat e lejojnë, ndihmojini ata të përgatiten për t'u pagëzuar në tempull për paraardhësit e vdekur.

- Ftojini të kthyerit në besim të përgatisin anëtarë të familjes dhe shokë që të marrin mësim nga misionarët. Misionarët duhet t'u kërkojnë rekomandime të kthyerve të rinj në besim dhe anëtarëve më pak aktivë.

### Të Ushqyerit me Fjalën e Perëndisë

- Përfundoni mësimin e parimeve në mësimin 5, "Ligjet dhe Ordinancat."
- I rikujtoni të porsakthyerit në besim dhe anëtarët më pak aktivë për zotimet që ata morën përpara pagëzimit dhe besëlidhjen që bënë kur u pagëzuan dhe u konfirmuan.
- Nxitini ata të lutën çdo ditë si individë dhe me familjet e tyre.
- Nxitini ata të studiojnë shkrimet e shenjta çdo ditë, veçanërisht Librin e Mormonit.
- Forconi dëshmitë e të kthyerve të rinj në besim për Rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit me anë të Profetit Jozef Smith. Rishikoni mësimet që u keni mësuar përpara pagëzimit dhe konfirmimit, duke ia përshtatur ftesat për zotime nevojave të tyre aktuale.
- Vazhdoni t'u mësoni rëndësinë e pjesëmarrjes në kishë çdo të dielë dhe marrjen me denjësi të sakramentit. Merrni pjesë dhe uluni me të kthyerit e rinj në besim dhe anëtarët më pak aktivë.
- Ftojini ata të marrin pjesë në klasën e Parimeve të Ungjillit gjatë Shkollës të së Dielës.
- U mësoni atyre si të zhvillojnë mbërme familjare të shtëpisë të hënave në darkë duke përdorur *Family Home Evening Resource Book*.
- Nxitini atë të ndajnë ungjillin e rivendosur me të tjerët.
- Ndihmoji ata të regjistrohen në seminare apo klasat e institutit.
- Vëriini ata në dijeni të burimeve informuese të Kishës të tilla si faqet e Internetit [www.mormon.org](http://www.mormon.org) dhe [www.familysearch.org](http://www.familysearch.org).

### Studim i Shkrimeve të Shenjta

#### Ushqeni me Fjalën e Perëndisë

Mosia 18:18–20

Alma 31:5

Moroni 6:4

#### Shërbimi

Mosia 2:17

Mateu 25:40

Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta,  
"Shërbej" dhe "Shërbim"

## Cili Është Roli i Presidentit të Misionit me Kohë të Plotë?

Presidenti i misionit me kohë të plotë mban çelësat për pagëzimet e të kthyerve në besim. Nën drejtimin e tij, misionarët me kohë të plotë kanë përgjegjësinë kryesore për të mësuar kërkuesit. Megjithatë, peshkopi mbikëqyr përparimin dhe shoqërimin e kërkuesve gjatë kohës që ata marrin mësimet. Plani misionar i lagjes zbatohet nën autoritetin kryesues të peshkopit. Presidenti i misionit takohet rregullisht me presidentët e kunjit për t'u siguruar që misionarët me kohë të plotë të bashkëpunojnë me udhëheqësit lokalë të priftërisë. Ai bashkërendon përpjekjet predikuese dhe ofron të ndihmojë presidentin e kunjit për të siguruar udhëzime mbi parimet dhe praktikatat e punës misionare.

## Cilat Janë Përgjegjësitë e Udhëheqësve të Kunjtit dhe të Lagjes?

Udhëheqësit lokalë të Kishës dhe anëtarët janë aleatët tuaj më të mirë. Respektojini ata dhe mundohuni të krijoni marrëdhënie të mira me ta. Ndërsa punoni me këta udhëheqës, mbani parasysh se ata kanë edhe përgjegjësi të tjera që lidhen me thirrjet e tyre. Përpiquni të jeni një bekim dhe jo një barrë për udhëheqësit tuaj të kunjtit dhe të lagjes. Qëndrimi juaj duhet të jetë një qëndrimi i tipit “Si mund të ndihmojmë?” Këshillohuni me peshkopin dhe udhëheqësin e misionit të lagjes në lidhje me planet dhe aktivitetet tuaja. Sigurohuni që ajo që ju bëni, të mbështesë planet e misionit të lagjes.

Rolet e udhëheqësve lokale të priftërisë në punën misionare janë përshkruar më poshtë. Kuptimi i roleve të tyre do t’ju ndihmojë të punoni më mirë me ta.

### Presidenti i Kunjtit

Presidenti i kunjtit mbikëqyr peshkopët në përgjegjësitë e tyre për punën misionare, për mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve në besim dhe riaktivizimin. Në intervistën e tij mujore me peshkopët, ai diskuton planet dhe përparimin e kërkuarve dhe anëtarëve të veçantë. Ai siguron që doktrinat që lidhen me punën misionare të mësohen rregullisht në mbledhjet e kunjtit e të lagjes dhe që udhëheqësit e priftërisë e të tjerët të trajnohen për përgjegjësitë e tyre misionare.

Presidenti i kunjtit gjithashtu takohet rregullisht me presidentin e misionit për të bashkërenduar përpjekjet misionare, duke përfshirë trajnimin e drejtuesve dhe të anëtarëve, përdorimin dhe vendosjen e misionarëve me kohë të plotë dhe ndihmën në përpjekjet aktivizuese.


### Këshilltari i Lartë

Një këshilltar i lartë caktohet nga presidencia e kunjtit për të nxitur punën misionare, punën për mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve në besim dhe punën aktivizuese në kunj. Ai i raporton rregullisht për përparimin e kësaj pune presidencisë së kunjtit. Ai siguron gjithashtu që udhëheqësit e misionit të lagjes të trajnohen siç duhet për detyrat e tyre duke përfshirë edhe përgatitjen e planit të misionit të lagjes.

### Peshkopi

Peshkopi është përgjegjës për përpjekjet misionare, për mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve në besim dhe për përpjekjet aktivizuese në lagje. Pjesëmarrja dhe udhëheqja e tij personale janë thelbësore. Për të ndihmuar në realizimin e kësaj pune, peshkopi thërret një mbajtës të denjë të Priftërisë Melkizedeke që të shërbejë si udhëheqës i misionit të lagjes. Ai gjithashtu thërret një numër të mjaftueshëm të misionarëve të lagjes të plotësojnë nevojat në lagje.

Peshkopi përdor komitetin ekzekutiv të priftërisë dhe këshillin e lagjes për të bashkërenduar përpjekjet misionare, për mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve në besim dhe përpjekjet aktivizuese. Ai i jep drejtim zhvillimit dhe zbatimit të planit të misionit të lagjes.





**Aktivitet: Studim me Shokun**

Planifikoni një kohë për t'u takuar me peshkopin. Kërkoni udhëheqjen e tij rreth asaj se si mund të shërbeni sa më mirë në lagje.

**Udhëheqësit e Priftërisë dhe të Organizatave Ndhmëse**

Udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndhmëse duhet ta rishikojnë rregullisht gjendjen e anëtarëve të rinj dhe anëtarëve më pak aktivë dhe të planifikojnë si t'i shoqërojnë dhe t'i forcojnë më mirë ata. Ata gjithashtu duhet të punojnë ngushtë me udhëheqësin e misionit të lagjes për të bashkërenduar përpjekjet misionare, për mbajtjen aktive në Kishë të të kthyerve në besim dhe përpjekjet aktivizuese me misionarët e lagjes dhe misionarët me kohë të plotë.

**Udhëheqësi i Misionit të Lagjes**

Nën drejtimin e peshkopit, udhëheqësi i misionit të lagjes:

- Jep një shembull në ndarjen e ungjillit me të tjerët dhe shoqërimin e kërkuesve, të të kthyerve të rinj dhe anëtarëve më pak aktivë.
- Bashkërendon punën e misionarëve të lagjes dhe misionarëve me kohë të plotë me udhëheqësit e priftërisë, udhëheqësit e organizatave ndhmëse dhe anëtarët.
- Përdor: Dokumentin e Përparimit, Listën e Veprimeve për të Kthyerit, Listën e Veprimeve dhe Intervistave të Këshillit të Peshkopit për të parë përparimin e kërkuesve, të të kthyerve në besim dhe anëtarëve më pak aktivë në komitetin ekzekutiv të priftërisë dhe në mbledhjet e këshillit të lagjes.
- Lista e Veprimeve për të Kthyerit dhe Lista e Veprimeve dhe Intervistave të Këshillit të Peshkopit janë raporte që krijohen duke përdorur kompjuterin e ndërtesës së mbledhjeve të lagjes. Ato përdoren për të ndjekur përparimin e të porsakthyerve në besim dhe të anëtarëve të tjerë.
- Drejton mbledhjet javore bashkërenduese misionare.
- Organizon shërbesat e pagëzimit për të kthyerit në lagje në bashkëpunim me misionarët me kohë të plotë. Një anëtar i këshillit të peshkopit ose udhëheqësi i misionit të lagjes drejton këto shërbesa.

Udhëheqësi i misionit të lagjes gjithashtu shërben në komitetin ekzekutiv të priftërisë, këshillin e lagjes, komitetin e mirëqenies së lagjes dhe merr pjesë në mbledhjet e udhëheqjes së priftërisë në rang kunji.

**Misionarët e Lagjes**

Vëllezër dhe motra të përgatitur thirren për të shërbyer si misionarë të lagjes. Ata mbikëqyren nga udhëheqësi i misionit të lagjes.

Misionarët e lagjes gjejnë, shoqërojnë dhe mësojnë kërkuesit. Gjithashtu ata udhëzojnë dhe shoqërojnë të kthyerit e rinj në besim dhe anëtarët më pak aktivë.

Një misionar i lagjes që mban Priftërinë Melkizedeke mund të thirret të shërbejë si ndihmës i udhëheqësit të misionit të lagjes.

**Bashkërendimi Misionar**

Puna misionare e lagjes bashkërendohet zakonisht në komitetin ekzekutiv të priftërisë dhe në mbledhjet e këshillit të lagjes duke përdorur Dokumentin e Përparimit, që sigurohet nga misionarët me kohë të plotë. Objektivi misionar i këtyre mbledhjeve është të

## Shënime

raportojë, planifikojë dhe të bashkërendojë detyrat për të gjetur, mësuar, shoqëruar dhe aktivizuar sipas asaj që është nënvizuar në paragrafët që vijojnë.

*Gjetja e Njerëzve për t'i Mësuar.* Komiteti ekzekutiv i priftërisë dhe këshilli i lagjes diskutojnë plane për përgatitjen e njerëzve të veçantë që do të mësohen nga misionarët me kohë të plotë. Ata diskutojnë përparimin e anëtarëve të veçantë të lagjes në përgatitjen e individëve dhe familjeve për të marrë mësimet e misionarëve.

*Mësimdhënia dhe Pagëzimi.* Komiteti ekzekutiv i priftërisë dhe këshilli i lagjes rishikojnë Dokumentin e Përparimit çdo javë, i cili përshkruan përparimin e çdo personi që po merr mësimet nga misionarët me kohë të plotë. Ata gjithashtu bashkërendojnë planet për dhënien e mësimëve në shtëpitë e anëtarëve, shoqërimin e kërkuesve dhe sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve në shërbesat e pagëzimit.

*Shoqërimi dhe Mësimi i Anëtarëve të Rinj.* Komiteti ekzekutiv i priftërisë dhe këshilli i lagjes rishikojnë Listën e Veprimeve për të Kthyerit për të monitoruar përparimin e çdo anëtari të ri. Ata diskutojnë gjithashtu si do të shoqërohen anëtarët e rinj. Sipas kërkesës së peshkopit, ata rekomandojnë thirrje të mundshme për të kthyerit e rinj në besim.

*Shoqërimi dhe Mësimi i Anëtarëve më Pak Aktivë.* Komiteti ekzekutiv i priftërisë dhe këshilli i lagjes bashkërendojnë përpjekjet aktivizuese të kuorumeve të priftërisë dhe të misionarëve me kohë të plotë. Ata gjithashtu planifikojnë si do të shoqërohen anëtarët më pak aktivë, veçanërisht duke i ftuar ata në mbledhjet dhe aktivitetet e Kishës.

### **Bashkërendim i Mëtejshëm me Udhëheqësin e Misionit të Lagjes.**

Puna misionare në lagje bashkërendohet zakonisht në komitetin ekzekutiv të priftërisë dhe në mbledhjet e këshillit të lagjes. Nëse është nevoja për një bashkërendim të mëtejshëm, udhëheqësi i misionit të lagjes mund të organizojë mbledhje bashkërenduese misionare me misionarët me kohë të plotë. Të tjerë që mund të ftohen të marrin pjesë në këtë mbledhje përfshijnë: misionarët e lagjes, një ndihmës nga udhëheqja e grupit të priftërinjve të lartë, një këshilltar nga presidencia e kuorunit të pleqve dhe një këshilltare nga presidencia e Shoqatës së Ndihmës.

Ata që marrin pjesë në mbledhje mund të rishikojnë dhe raportojnë detyrat dhe qëllimet e mbledhjes së mëparshme dhe të diskutojnë planet për javën që vjen. Nëse është e nevojshme, ata gjithashtu mund të bashkërendojnë detyrat e misionarëve të lagjes që ata të punojnë me misionarët me kohë të plotë dhe të diskutojnë si t'i bëjnë më efektive përpjekjet e përbashkëta të misionarëve të lagjes dhe misionarëve me kohë të plotë.

### **Plani i Misionit të Lagjes**

Shumë lagje kanë konstatuar se zhvillimi i një plani për misionin e lagjes nxit punën misionare. Një plan i tillë mund të përfshijë qëllime, iniciativa dhe aktivitete për t'i ndihmuar anëtarët e lagjes t'i ftojnë të tjerët për të dëgjuar ungjillin. Individët dhe familjet gjithashtu përfitojnë nga një plan i tillë për t'u udhëhequr në përpjekjet e tyre misionare.

Anëtarët duhet të përdorin çdo mjet të ndershëm për të gjetur njerëz që janë të gatshëm për të dëgjuar mesazhin e Rivendosjes. Ata duhet t'i kushtojnë vëmendje gjetjes së baballarëve, nënave dhe fëmijëve që do të vijnë në Kishë si familje. Më poshtë janë disa sugjerime që duhen marrë parasysh për zhvillimin e një plani misionar.

- Lutuni që Zoti të përgatisë zemrat e njerëzve të veçantë për të dëgjuar ungjillin. Lutuni gjithashtu që të jeni të ndjeshëm ndaj atyre që Ai po përgatit (shih Alma 6:6). "Do të jetë

një ditë e madhërishme” mësoi Presidenti Gordon B. Hinkli, “ajo ditë kur njerëzit tanë jo vetëm që do të luten për misionarët kudo në botë, por do t’i kërkojnë Zotit t’i ndihmojë ata, në mënyrë që të ndihmojnë misionarët, të cilët po punojnë në lagjen e tyre.” (“Missionary Service,” *First Worldwide Leadership Training Meeting*, janar 2003, 19).

- Jini të vëmendshëm ndaj mundësive për t’i ndihmuar të tjerët. Jini miqësor dhe ndihmoni me dashuri të gjithë njerëzit.
- Kërkojuni miqve dhe fqinjëve të shërbejnë përkrah anëtarëve në gjëra të tilla si: të japin shërbim në komunitet, të sigurojnë ushqim për ata që janë në nevojë, të japin mësim në miniklasat e aktiviteteve pasuruese të Shoqatës së Ndhimës, të ndihmojnë në aktivitetet e lagjes, të ndihmojnë ata që po lëvizin në një shtëpi të re, të punojnë në Skautizëm dhe të ndihmojnë për historinë familjare dhe projektet e mirëqenies.
- Ftoni të afërmit, miqtë dhe fqinjët që nuk janë anëtarë, të marrin pjesë në pagëzime, konfirmime dhe në shugurimet e priftërisë.
- Ftoni jo anëtarët të jenë të pranishëm në ngjarje të veçanta, të tilla si një mëngjes në një ditë feste kombëtare.
- Bëjini mbledhjet e lagjes, aktivitetet, takimet rreth vatrës apo shtëpitë e hapura të një niveli dhe interesi të tillë që anëtarët të presin me padurim t’i ftojnë miqtë e tyre të marrin pjesë në to.
- Ftoni njerëz në mbrëmjet familjare të shtëpisë.
- Vizitoni njerëz të cilët po përjetojnë ndryshime në jetën e tyre, të tilla si martesë, lindje ose vdekje.
- Vizitoni dhe ndihmoni njerëz të cilët po lëvizin me shtëpi në lagjen tuaj. Ndani informacion rreth komunitetit, lagjes dhe Kishës.
- Shfrytëzoni çdo mundësi për të folur rreth ungjillit. Diskutoni rreth çështjeve të tilla si Shpëtimtari, Libri i Mormonit, Bibla, qëllimi i jetës, familja dhe historia familjare.
- Nxitini të rinjtë të miqësohen me të rinjtë e tjerë dhe t’i ftojnë ata në mbledhjet dhe aktivitetet e Kishës.
- Punoni me familjet pjesërisht anëtare.
- Planifikoni mbledhje sakramenti që të ngrenë shpirtërisht.

#### Aktivitet: Studim me Shokun

- Me shokun/shoqen tuaj, lexoni dhe diskutoni faqet 5-9 të librit *Të Vërtetë ndaj Besimit*, “Administrim i Kishës.”
- Ndani me shokun/shoqen tuaj dhe shkruani ato që mësoni në ditarin tuaj të studimit.
- Diskutoni se si idetë tuaja të frymëzuara do të ndikojnë në mënyrën se si punoni me udhëheqësit e Kishës.

### Zotimi për të Qëndruar Aktiv në Kishë

Puna misionare e ka efektin e saj më të madh kur njerëzit marrin dhe mbajnë zotimin për të qëndruar aktivë në Kishë gjatë gjithë jetës së tyre. Nuk është e mjaftueshme që njerëzit vetëm të vijnë në Kishë. Ata duhet të vijnë që të qëndrojnë. Të gjitha mësimet dhe ftesat tuaja duhet të drejtohen rreth këtij përfundimi. Me qëllim që të marrin të gjitha bekimet që Ati ynë Qiellor ka rezervuar për ta, anëtarët duhet të vazhdojnë të jetojnë ungjillin dhe të jenë aktivë në Kishë.

## Shënime

Nefi mësoi: “Dhe tani, vëllezërit e mi të dashur, pasi ju të keni hyrë në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar, unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; ... shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, ... dhe duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:19–20).

Jepni përpjekjet tuaja më të mira për t’i ndihmuar njerëzit të përgatiten për “jetë[n] e përjetshme, dhuratë e cila është më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë” (DeB 14:7).

**Mbani Mend**

- Krijoni marrëdhënie të forta me peshkopin dhe anëtarët e këshillit të lagjes.
- Merrni pjesë në mënyra të përshtatshme në mbledhjet e komitetit ekzekutiv të priftërisë dhe të këshillit të lagjes.
- Jini në shërbim të këshillit të lagjes. Kur anëtarët e këshillit kërkojnë ndihmën tuaj:
  - Jini të gatshëm të shoqëroni të kthyerit në besim dhe anëtarët më pak aktivë, t’i ndihmoni ata në thirrjet e tyre e në mundësitë për të shërbyer dhe u mësoni përsëri anëtarëve të rinj mësimet misionare.
  - Bashkë me anëtarët, u mësoni të porsakthyerve në besim mësimin “Ligjet dhe Ordinancat.”

## Ide për Studim dhe Zbatim

Shënime

### Studim Individual

- Duke përdorur planifikuesin ditor, bëni plane për të folur me të kthyerit e rinj në besim dhe me anëtarët e aktivizuar kohët e fundit rreth ndryshimeve në jetën e tyre dhe pjesëmarrjes në kishë. Çfarë i ka ndihmuar ata më shumë? Shkruani në ditarin tuaj të studimit mendimet tuaja rreth përvojave të tyre. Çfarë keni mësuar që do t'ju ndihmojë në punën me kërkuesit tuaj të tanishëm?
- Studioni 2 Nefi 31:18–20; Alma 26:1–7 e 32:32–43; dhe Moroni 6. Shkruani çfarë mësuar nga këto vargje për forcimin e të kthyerve të rinj në besim.

### Studim me Shokun

- Gjatë mbledhjes së këshillit të lagjes, pyeteni peshkopin nëse ka ndonjë anëtar më pak aktiv në territorin tuaj që ai do të donte që ju ta vizitonit këtë javë. Ndërsa vizitoni këta anëtarë më pak aktivë, përpiquni të ndërtoni besimin e tyre te Jezu Krishti. U kërkoni atyre rekomandime.
- Studioni 1 Korintasve 3:2; Hebrejve 5:12; dhe Doktrina e Besëlidhje 19:22. Kujt i referohet qumështi? Çfarë është mishi? Krahasoni përgjigjet tuaja me doktrinën në kapitullin “Çfarë Duhet të Studioj dhe t'u Mësoj të Tjerëve?” Pse duhet të jepni në fillim qumështin dhe pastaj mishin sipas radhës dhe sasisë së duhur? Si e bëni ju këtë?
- Lexoni thëniet e mëposhtme në të cilat Presidenti Jozef F. Smith përshkruan ndjenjat që pati në kohën e pagëzimit të tij:

“Ndjenja që më pushtoi ishte një ndjenjë paqeje e pastër, dashurie dhe drite. Unë ndjeva në shpirtin tim se nëse kisha mëkatuar—dhe sigurisht që nuk isha pa mëkat—se ai më ishte falur; se unë në të vërtetë isha pastruar nga mëkati; zemra ime ishte prekur dhe ndieja se nuk do të mund t'i bëja keq as edhe insektit më të vogël nën këmbët e mia. U ndjeva sikur dëshiroja të bëja mirë kudo, kujtdo dhe çdo gjëje. Ndjeva risinë e jetës, risinë e dëshirës për të bërë çfarë ishte e drejtë. Në shpirtin tim nuk kishte mbetur më asnjë pikë dëshire për të ligën...Ky ishte ndikimi që ndjeva dhe e di se ai erdhi nga Perëndia dhe ishte dhe gjithmonë ka qenë një dëshmi e gjallë për mua e pranimit të Zotit” (*Gospel Doctrine*, botimi i 5-të [1939], 96).

Tani lexoni se çfarë ka thënë Presidenti Smith rreth ndjenjave të tij shumë kohë pas pagëzimit të tij:

“Oh! Sikur ta kisha ruajtur të njëjtin shpirt dhe të njëjtën dëshirë të zjarrtë në zemrën time çdo çast të jetës që nga [dita e pagëzimit tim] e deri tani. Megjithatë, shumë nga ne të cilët e kanë marrë atë dëshmi, atë lindje të re, atë ndryshim të zemrës, edhe pse mund të kemi gabuar në gjykim apo të kemi bërë shumë gabime dhe ndoshta shpesh të kemi dështuar në mbajtjen e standardit të vërtetë në jetën tonë, jemi penduar për atë të ligë dhe kemi kërkuar herë pas here falje nga dora e Zotit; kështu që sot e njëjta dëshirë dhe qëllim që sundoi shpirtin tanë kur u pagëzuam dhe morëm faljen për mëkatet tona, ende na pushton zemrat dhe ende është ndjenja dhe pasioni sundues i shpirtave tanë” (*Gospel Doctrine*, 96).

- Çfarë mësuar ju personalisht nga Presidenti Smith rreth dëshmisë tuaj dhe zotimit për të jetuar ungjillin?
- Çfarë mësuar rreth vështirësive me të cilat përballen të kthyerit e rinj në besim, madje edhe profetët e ardhshëm?
- Duke menduar për të porsakthyerit në besim dhe anëtarët më pak aktivë, çfarë mund të bëni për t'i ndihmuar ata të rifitojnë “dëshirën dhe qëllimin” që kishin dikur?

Shënime

**Mbledhjet e Distriktit dhe Konferencat e Zonës**

- Ftoni një peshkop të flasë rreth sfidave të punës me anëtarët më pak aktivë dhe të kthyerit e rinj në besim. I kërkonti atij të theksojë se si misionarët mund të ndihmojnë në këto sfida.
- Diskutoni rreth shëmbëlltyrës së deleve të humbura, dhrahmisë së humbur dhe djalit plangprishës (shih Lluka 15).

**Presidenti i Misionit**

- Punoni me udhëheqësit lokalë të priftërisë për t'i nxitur ata të ndihmojnë të kthyerit e rinj:
  - Të shugurohen në priftëri.
  - Të kenë mësues shtëpie.
  - Të përgatisin emrin e një paraardhësi për ta çuar në tempull dhe të kryejnë pagëzime për të vdekurit.
  - Të marrin mësimin “Ligjet dhe Ordinancat” në praninë e mësuesve të shtëpisë.
- Mësojini udhëheqësve lokalë si t'i përdorin misionarët në këshillin e lagjes.
- U mësoni udhëheqësve lokalë qëllimin dhe përdorimin e Dokumentit të Përparimit.
- Herë pas here u kërkonti misionarëve t'ju tregojnë një kopje të Dokumentit të Përparimit.
- Herë pas here ndiqni ecurinë e të porsakthyerve në besim për të parë si po ja kalojnë dhe se si misionarët dhe anëtarët mund t'i ndihmojnë.
- Ftoni udhëheqësit e kunjit ose të lagjes të flasin me misionarët për t'u shpjeguar se si misionarët mund të jenë një ndihmë e madhe.
- Ftoni të porsakthyerit në besim t'u flasin misionarëve dhe t'u tregojnë rreth përvojave të tyre si anëtarë të rinj të Kishës.
- Herë pas here u kërkonti anëtarëve që janë kthyer në besim të ndajnë përvojën e tyre të kthimit në besim në një konferencë zone.

**A**

Aborti, dhe denjësia për pagëzim, 214–215  
 Agjërimi, ligji i, 81  
 Ajsberg, shqetësimet janë si, 193  
 Aktiviteti i cilësive, vetë-vlerësimi, 130  
 Anëtarët e rinj, forcimi, 221–222  
 marrja e mësimave, 29  
 misionarët e caktuar për shoqërim, 218  
 një burim për gjetjen e kërkuesve, 168–169  
 marrja e mësimave përsëri, 218  
 Anëtarët e shkishëruar, nëse pagëzohen, 215  
 Anëtarët, frika për të bërë punë misionare, 168  
 ndihmë për të gjetur kërkues, 166–169  
 si të ndihmoni, me punë misionare, 166–169  
 Anëtarët më pak aktivë, një burim për gjetjen e kërkuesve, 162  
 forcimi, 168–169, 221–222  
 Ardhja e Dytë e Jezu Krishtit, 37  
 Ati në Qiell, 48  
 Ati Qjellor, 31–32  
 Autoriteti, i misionarëve, 4  
 E rivendosur, 36  
 Priftëria, e humbur, 35

**B**

Baballarët, detyra e, 86  
 Ballard, M. Rasëll, mbi qëllimet, 152  
 mbi fuqinë e Shpirtit, 96  
 Bashkërendimi Misionar 227  
 Bekimet, dhe zotimet, 206–207  
 Benson, Ezra Taft, mbi çuarjen e ungjillit botës, 2  
 mbi Librin e Mormonit si guri kyç, 106–107  
 mbi përgjigjen pyetjeve me Librin e Mormonit, 112–113  
 mbi punën, 125  
 mbi pyetjet e mëdha të shpirtit, 111  
 mbi rëndësinë e Shpirtit, 182  
 Besimi, dhe gjetja e njerëzve për t'i mësuar, 161  
 dhe lutja, 93–95  
 te Jezu Krishti, 61–62, 120–121  
 Besëlidhja, përkufizim, 71  
 shpjegim, 63  
 Bëni mirë, 174–175  
 Bibla, mbështet Librin e Mormonit, 110  
 Biblioteka misionare, viii–ix  
 Bindja, 126  
 një urdhërim, 73  
 Biseda, ide për, me të tjerët, 162–163  
 mjet për gjetje, 161–163  
 Bota e shpirtave, 53  
 Braktisja, përkufizimi, 33  
 e Madhe, 35–36  
 Buda (Gotama), 46

**C**

Cabrera, Viktor Manuel, histori kthimi në besim, 163–164  
 Cilësitë si të Krishtit, dhurata nga Perëndia, 119  
 si t'i zhvilloni, 126–127  
 nevoja për t'i zhvilluar, 119  
 Cilësitë, si të studiojmë, 120  
 Krishtit, 119

**D**

Dashuria, 122  
 Dashuria hyjnore, 122  
 Deklaratat profetike mbi punën misionare, 12–13  
 Dëgjimi, për të përmirësuar aftësitë e gjuhës, 134  
 përdorimi i, në mësimdhënie, 191–192

Dëlirësia, ligji i, 78  
 Dëshmia, dëshmoni shpesh, 206–207  
 Dita e Shabatit, mbajtja, e shenjtë, 75  
 Ditari i studimit, shpjegim, x  
 Dituria, 123  
 Dokumentet, për pagëzim dhe konfirmim, 216  
 Dokumenti i Mësimdhënies, përshkrimi i formularit, 146–147  
 Dokumenti i Përparimit, përshkrimi i formularit, 147–148  
 Drita e Krishtit, 92  
 Durim, 124  
 Durimi deri në fund, 66, 89  
 përkufizim, 71

**DH**

Dhjetë Urdhërimet, bindja ndaj, 77–78  
 Dhurata e Frymës së Shenjtë, 65, 93  
 Dhurata e gjuhëve, 137  
 Dhuratat e Shpirtit, 93

**E**

E dhjeta, ligji i, 80  
 Ekzaltimi, 53–54  
 përkufizim, 58

**F**

Familja e Perëndisë, 31–32, 161  
 "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës" 3, 86  
 Familja, qëllimi i, 86  
 Familjet, bekuar nga ungjilli, 32  
 bekimet e ungjillit të rivendosur, 3  
 mësimdhënia rreth rëndësisë së, 166–167  
 Faust, Xheims E., mbi shpresën, 121  
 mbi të mësuarit qartë, 188  
 Fëmijët e vegjël, dhe pagëzimi, 215  
 Fillorja, organizimi, 85  
 Fjala e Urtësisë, 79  
 Fleksibiliteti, në studim, vii  
 në mësimdhënie, vii  
 Ftesat për zotime, 203–204  
 Fryma e Shenjtë, fuqia e, 92  
 dhuratë e, 93  
 personazh i, 92  
 të mësuarit me anë të, 18

**GJ**

Gjenealogjia, si një burim për gjetjen e kërkuesve, 170–171  
 Gjetja, dhe mësimdhënia, 164–165  
 me anë të Shpirtit, 162  
 me anëtarët, 166–167  
 Gjetja e kërkuesve, sugjerime për, 173–174  
 Gjetja e njerëzve për t'i mësuar, 162–162  
 Gjuha angleze, nevoja për ta mësuar, 132  
 Gjuha e misionit, dhe gjuha amtare, 131  
 përgatitja për të mësuar, 127  
 kërkon përkushtim, 132  
 Gjuhët, dhuratë e, 137  
 Gjykimi, përkufizim, 58  
 i fundit, 53–54

**H**

Hanter, Hauard W., mbi dallimin e pranisë së Shpirtit, 101  
 Hinkli, Gordon B., mbi besimin dhe lutjen, 95–96  
 mbi dallimin e pranisë së Shpirtit, 99  
 mbi leximin e Librit të Mormonit plot lutje, 112  
 mbi lutjet misionare, 96

mbi mbajtjen e të kthyerit në besim, 221  
 mbi ndihmën e misionarëve nga anëtarët, 167  
 mbi nevojat e të kthyerve të rinj, 222–223  
 mbi shërbimin, 174–175  
 misionarët të lidhin të kthyerin në besim me  
 Kishën, 222–223  
 Hir, përkufizim, 71  
 Historia e familjes, si një burim për gjetjen e  
 kërkuesve, 170–171  
 Holland, Xhefri R., mbi mësimin e gjuhës, 132  
 mbi dëgjimin, 191  
 mbi mësimdhënien me fuqi, 8  
 Hyjnia, adhurimi i duhur i, 77

## I

Ide për studim dhe zbatim, si t'i përdorni, xi  
 Idhujt, 77  
 Indamenti, 87  
 Intervista e pagëzimit, kush drejton, 213–214  
 përgatitja e kërkuesve për, 212  
 pyetje, 214  
 si të drejtohet, 213–214

## J

Jang, Brigam, mbi marrjen e dëshmimeve, 207  
 Jetë e përrjetshme, përkufizim, 70  
 Jetë në tokë, 50  
 Jetë para lindjes, përkufizim, 59  
 Jetë paratokësore, 48  
 përkufizim, 59  
 Jezu Krishti, iu shfaq Jozef Smithit, 37  
 ndihma e njerëzve të mësojnë rreth, 47–48  
 si Shëlbues, 51–52, 60–61  
 Shlyerja e. *Shih* Shlyerja, shërbesa tokësore e, 34

## K

Kalvin, Xhon 46  
 Kërkuesit e mëparshëm, si një burim për gjetjen  
 e njerëzve për t'i mësuar, 172  
 Kërkuesit, misionarët të përgatiten, për intervistën  
 e pagëzimit, 212  
 vendosja e qëllimeve për, 153–156  
 për të lexuar Librin e Mormonit, 114–115  
 Kërkues të Mundshëm, përshkrimi i formularit, 148  
 Këshilli i Lagjes, 156, 223–224  
 dhe shoqëria e të kthyerve të rinj në besim, 224  
 dhe ndihma e të kthyerve të rinj në besim të  
 shërbejnë në thirrjet, 225  
 dhe ushqimi i të kthyerve të rinj, 224–225  
 përgjegjësia për të shoqëruar, 221–222  
 Këshilltari i lartë i kunjit, detyrat e, 226  
 Kimball, Spenser W., mbi punën misionare dhe  
 në tempull, 170  
 mbi veçimin, 4  
 Konferencat e zonës, dhe studimi, viii  
 Konfirmimi, 65  
 përkufizim, 71  
 përgatitja për, 211–212  
 si ta kryeni, 218  
*Shih gjithashtu* Pagëzimi dhe konfirmimi  
 Konfuci, 46  
 Kopshti i Edenit, 49  
 Krijimi, i tokës, 49  
 Krimi i rëndë, dhe denjësia për pagëzim, 215–216  
 Krishti, Drita e. *Shih* Drita e Krishtit  
 Krishti. *Shih* Jezu Krishti  
 Kthimi në besim, roli i misionarëve në, 95  
 Roli i Shpirtit në, 95  
 Kujdes, në marrjen e zbulesës, 101–102  
 Kultura, nevoja për ta mësuar, 137

Kundërshtitë, si t'u përgjigjeni, me Librin e  
 Mormonit, 112  
 Kutitë informuese, në *Predikoni Ungjillin Tim*, x–xi

## L

Libri i Mormonit, afron njerëzit tek Perëndia, 112  
 dëshmon për Jezu Krishtin, 109  
 i përgjigjet pyetjeve të shpirtit, 111–112  
 lexoni, të mësoni gjuhën e misionit, 134–135  
 mbështet Biblën, 110  
 provë e hyjnisë së Jezu Krishtit, 109  
 provë e Rivendosjes, 7, 38–39, 107  
 qëllimi i, 38  
 si guri kyç, 107–108  
 si ta përdorni, 114–115  
 si të lexoni, me kërkuesit, 114–115  
 Libri i Zonës, përshkrimi, 144–145  
 përdoret për të gjetur kërkues të mëparshëm,  
 172–173  
 Ligjet dhe ordinancat, ndiqni pagëzimin, 83–90  
 si të studioni, 84  
 si të jepni mësim rreth, 83  
 Ligji, bindjuni dhe nderojeni, 82  
 Ligji civil, bindjuni dhe nderojeni, 82  
 Li, Harold B., mbi rëndësinë e familjeve, 3  
 mbi mësimdhënien për të kuptuarit, 200  
 Liria e zgjedhjes, 48, 49  
 Luter, Martin, 45  
 Lutja, një urdhërim, 74  
 do të thotë të mësoni të vërtetën, 39  
 dhe besimi, në kthimin në besim, 93–95  
 roli i, 39  
 si të jepni, 39  
 sugjerime për, 96–97  
 shkalla e vlerësimit, 97

## M

Maksuell, Nil A., mbi shpresën, 121  
 Mandati (detyra e ngarkuar), për t'iu mësuar  
 ungjillin e rivendosur, 1  
 Martesa e përrjetshme, 86  
 Marrëdhëniet homoseksuale, dhe denjësia për  
 pagëzim, 215–216  
 Mbledhjet e distriktit, dhe studimi, viii  
 qëllimi, ix  
 Mbledhjet, bashkërendimi misionar, 227–228  
 Mbretëria Çelestiale, 53  
 Mbretëria Telestiale, 53  
 Mbretëria Terrestriale, 53  
 Mbretëritë e lavdisë, 53  
 Mbrëmja familjare e shtëpisë, 85  
 Mesazhi i Presidencisë së Parë, v  
 Mesazhi i Rivendosjes, 31  
 dhe familjet, 166–167  
 shpjegim, 6–8  
 Mëkati, këndvështrimi nga kultura të ndryshme, 61  
 Mësimdhënien, dhe dëgjimi, 191–192  
 dhe gjetjet, 164–165  
 dhe mësimi përmendësh, vii  
 gjatësia e mësimëve, vii  
 Këshilla e Presidencisë së Parë mbi, 181–182  
 kohëzgjatja e takimeve, 184–185  
 me anëtarët, 185–186  
 me anë të Shpirtit, 3–4  
 me pyetjet, 189–190  
 me shokun, 184–185  
 me shkrimet e shenjta, 186–187  
 në thirrjen e Kishës, 89  
 njerëzit me prejardhje jo të krishtere, 197–198  
 përshtateni për të plotësuar nevojat, 183–184  
 si të filloni, 182–183



ungjilli si një misionar, 181  
 Mësimet, për anëtarët e rinj, 29  
 përdorni për studim dhe trajnim, 29  
 të mësoni kërkuesit, 29  
 Mësimi i gjuhës, dhe i gramatikës, 134  
 dhe mësimi përmendësh, 133–134  
 me shokët, 136–137  
 mjetet për, 133  
 parimet e, 132–133  
 plani i studimit, 133–134  
 qëllimet, 133  
 Mësimi i shtëpisë, 223  
 Mësimi i vizitave, 223  
 Mësimi përmendësh, dhe mësimdhënia, vii  
 Mësimi, një proces i marrjes së zbulësës, 18  
 si një anëtar i Kishës, 89  
 me anë të Frymës së Shenjtë, 18  
 Mëshira, përkufizim, 71  
 Misionarët e ardhshëm, si një burim për gjetjen  
 e kërkuesve, 168–169  
 Misionarët e lagjes, detyrat e, 226  
 si ta përdorni "*Predikoni Ungjillin Tim*," xi  
 Monson, Tomas S., mbi durimin, 124  
 mbi dhënien e dëshmisë, 206–207  
 mbi gjuhën e Shpirtit, 137  
 mbi matjen e efektshmërisë, 157  
 mbi mësimdhënien me anëtarët, 185–186  
 Muhamedi, 46

## N

Ndërtoni Kishën, 162–163  
 Ndiqni profetin, 76–77  
 Ndjekja e ecurisë, dhe zotimi, 208  
 Nënata, detyra e, 86  
 Nënvizimi i Shkrimeve të Shenjta, 24

## O

Ordinanca, përkufizim, 63  
 Ouks, Dallin H., mbi ftesën të tjerëve të vijnë te  
 Krishti, 9

## P

Pablo, historia e kthimit në besim nëpërmjet  
 shërbimit, 174–175  
 Pagëzimi dhe konfirmimi, 9, 75  
 dokumente, 216–217  
 pyetje dhe përgjigje rreth, 214–216  
 Pagëzimi, ftesa besëlidhja jonë e parë, 63–64  
 drejtuar, 40, 66  
 e nevojshme për anëtarësi në Kishë, 64  
 i kandidatëve që nuk i plotësojnë kërkesat,  
 214–215  
 jo i nevojshëm për fëmijët e vegjël, 64  
 kërkesat për, 212  
 me zjarr, 65  
 përgatitja për, 211–212  
 Pagëzimi i të kthyerve në besim, përkufizim,  
 214–215  
 Pagëzimi për të vdekurit, 87  
 Paker, Boid K., mbi dallimin e pranisë së Shpirtit,  
 98, 101  
 mbi dritën e Krishtit, 92  
 mbi përvojat shpirtërore, 101  
 mbi forcimin e gjërave shpirtërore, 105  
 mbi fuqinë ushqyese të Librit të Mormonit, 112  
 mbi pagëzimin me ujë dhe zjarr, 9  
 mbi se si studimi ndryshon sjelljen, 19  
 mbi Shpirtin në kthimin në besim, 94  
 Pastruar nga mëkati, 2, 5–6, 60–61  
 Pavdekësi, përkufizim, 59  
 shpjegim, 53

Pema e Jetës, aktivitet, 2  
 Pendimi, 62–63, 194–195  
 dhe zotimi, 203  
 Perëndia Ati, iu shfaq Jozef Smithit, 37  
 Perëndia, Ati ynë Qjellor, 31–32, 48  
 Perëndia, mësimi i jo të krishterëve mbi, 32  
 Periudha ungjillore, përkufizim, 33  
 Periudhat ungjillore, 32–34  
 Perri, L. Tom, mbi bindjen, 126  
 Peshkopi, 155–156  
 detyrat misionare të, 226  
 drejton përpjekjet misionare të lagjes, 222–223  
 dhe puna misionare, 167  
 Përdorimi i kohës, efektiv, 141  
 Përgjegjshmëria, 157  
 Përkufizime, të fjalëve të panjohura, 21  
 Përlësia, 124–125  
 Piramida e Informacionit, 144  
 Planifikuesi Ditor i Misionarit, përkufizim, 149–151  
 Plani i misionit të lagjes, 228  
 Plani i shpëtimit, 47–54  
 tabela, 54  
 "*Predikoni Ungjillin Tim*," përdoret nga misionarët  
 dhe udhëheqësit e lagjes, xi  
 si ta përdorni këtë manual, vii  
 Prejardhja jo e krishtere, mësimdhënia e ungjillit  
 njerëzve me, 197–198  
 Presidencia e parë, mbi punën misionare, 29–30  
 Presidenti i Kishës, mbi punën misionare, 12–13  
 Presidenti i kunjit, detyrat e, 226  
 Presidenti i Misionit, detyrat e, 226  
 Priftëria Aarone, e rivendosur, 37  
 Priftëria, Aarone, 84  
 Melkizedeke, 84  
 përkufizim, 32  
 rivendosja e, 37, 84  
 Priftëria dhe organizatat ndihmëse, 83–84  
 Priftëria Melkizedeke, e rivendosur, 37  
 Profetët, shpjegime, 34  
 roli i, 32–33  
 Programi. Shih Programi ditor i misionarit  
 Programi ditor i misionarit, viii  
 Puna e historisë familjare, 87–88  
 Puna misionare, anëtarët të bëjnë, 85  
 Pyetjet, dhe zotimi, 204  
 përdorimi i, në mësimdhënie, 189–190  
 si të përgjigjeni, me Librin e Mormonit, 111–113  
 Pyetjet e Shpirtit, dhe Libri i Mormonit, 111–112

## Q

Qendrat e historisë familjare, si një burim për  
 gjetjen e kërkuesve, 170–171  
 Qëllimet, dhe sesioni i planifikimit javor, 153–155  
 si t'i vendosni, 155  
 Qëllimi misionar, të përfaqësojë Jezu Krishtin, 2  
 Qëllimi, si një misionar, 1

## R

Raportimi Javor i Misionarit, përshkrimi i  
 formularit, 151  
 Raport Përmbledhës, përshkrimi formulari, 149  
 Reformimi, 35  
 Reformatorë, 45  
 Rekomandimet e medias, 169  
 Rekomandimet e selisë qendrore të Kishës, 169  
 Rekomandimet, udhëzues për punën me, 169  
 Rënia e Adamit dhe Evës, 49–50  
 përkufizim, 58  
 Rikthimi, përkufizim, 70  
 Rimishërimi, dhe ringjallja, 53

Ringjallja, 53  
përkufizim, 51, 59  
Rivendosja, mesazhi i, shpjegim, 6–8  
i ungjillit, 36–37  
Roli i misionarit në kthimin në besim, 95

**S**

Sakramenti, 64  
Sesioni i planifikimit ditor, 156  
Sesioni i planifikimit javor, si mbahet, 153–156  
Smith, Hairëm, mbi mësimdhënien e parimeve të para, 6  
Smith, Jozef, dhe Rivendosja, 36–37  
dhe Vegimi i Parë, 37  
mbi dhuratën e Frymës së Shenjtë, 93  
mbi Librin e Mormonit si guri kyç, 107  
mbi mbështetjen të Shpirtit, 100–101  
mbi mësimin e të gjithëve, 162–163  
mbi nevojën për zbulesë, 91  
mbi pagëzimin me ujë dhe Fryma e Shenjtë, 9  
mbi predikimin e ungjillit, 167  
Smith Jozef F., mbi ndjenjat kur ai u pagëzua, 231  
Studim, burimet e miratuara për, 23  
efektiv, 17  
filloni me lutje, 17, 22  
si përgatitje për të dhënë mësim, 19–22  
sugjerime për efektiv, 22–24  
udhëzues për, 20–21  
Studimi individual, qëllimi, viii–ix  
programi, viii  
Studimi i shkrimeve të shenjta, një urdhërim, 74–75  
Studimi me shokun, qëllimi, ix  
programi, viii  
Suksesi misionar, 10–11  
Suksesi, përkufizim, 10–11

**SH**

Shanider, historia e, 117  
Shëlbimi, përkufizim, 59  
Shërbimi i pagëzimit, si të drejtohet, 217–215  
Shërbimi, si një anëtar i Kishës, 88  
si një burim për gjetjen e kërkuesve, 174–175  
Shërimi prej varësisë, 194  
Shkrimet e shenjta, nënvizime, 24  
përdorimi i, në mësimdhënie, 186–188  
Shlyerja, 31–33, 34, 48, 51–52, 60–61  
përkufizimi, 58  
Shoqata e Ndihmës, 84  
Shoqërimi, i anëtarëve të rinj, 218  
Shpëtimi, i disponueshëm për të gjithë, 87  
përkufizim, 59  
plani i, 47–54  
Shpirti, duhet të drejtojë mësimdhënien, 182  
fuqia e, në kthimin në besim, 93–94  
mësimdhënie me anë të, 3–4  
nxitjet e, 98–99  
Shpirti i Elias, 170–171  
Shpirti i Shenjtë i Premtimit, 93  
Shpresa, 121  
Shqetësimet, nevoja për t'i zgjidhur të kërkuesve,  
193–194  
Shulc, Frenk dhe Mildred, histori kthimi në  
besim, 171

**T**

Taindëll, Uilliam, 46  
Tejlor, Xhon, mbi mësimdhënien thjeshtë, 188

Tempujt, adhurimi në, 87  
Të dhjetat dhe ofertat, dhurimet, 81–82  
Të Rejat, organizimi, 85  
Të Rinjtë, organizimi, 85  
Të Vërtetë ndaj Besimit, 21  
Treguesit kyç, përkufizim, 142–143  
për kthimin në besim, 142–143  
vendosja e qëllimeve për, 152–153

**TH**

Thirrja misionare, dhe përgjegjësia, 4  
fuqia dhe autoriteti i, 4–5  
për t'u mësuar të tjerëve ungjillin e  
rivendosur, 181  
Thirrje, në Kishë, 88  
*Shih gjithashtu* Thirrja misionare

**U**

Uajklif, Xhon, 45  
Udhëheqësi i misionit të lagjes, detyrat e, 227–228  
Udhëheqësit e lagjes, dhe puna misionare, 221  
detyrat e, 226  
Udhëheqësit e kunjtit, dhe puna misionare, 221  
detyrat e, 226  
Udhëheqësit e Organizatave Ndihmëse, detyrat  
e, 227  
Udhëheqësit e priftërisë, detyrat e, 227  
Uirthlin, Jozef B., mbi përdorimin e Librit të  
Mormonit, 114  
Ungjilli, 60–66  
bekon familjet, 3, 32  
përkufizim, 5, 71  
plotëson nevojat e njerëzve, 1–2  
qëllimi i, 6  
Rivendosja e, 36–37  
Ungjilli i Jezu Krishtit. *Shih* Ungjilli  
Urdhërimet, 72–82  
si të studioni, 73  
si të jepni mësim rreth, 72–73

**V**

Vdekje fizike, përkufizim, 59  
Vdekje shpirtërore, përkufizim, 59  
Vdekshmëri, 50  
përkufizim, 59  
qëllimi i, 31–32  
Vendosja e Kishës mbi themele të forta, 10  
Vendosja e qëllimit, 141  
Virtyti, 122–123  
Vlerësimi i marrëdhënieve me shokun 156

**Z**

Zbulesa personale, 91–92  
Zbulesa, personale, 91–92  
Zelli, 125  
Zgjedhja e lirë, 48, 49  
Zotimet, qëllimi i, 8  
Zotimi, dhe bekimet, 206  
dhe drejtoni pyetje, 205  
dhe ndiqni ecurinë, 208–209  
pjesë e nevojshme e pendimit, 203–204  
rrit besimin, 204

**ZH**

Zhgënjimi, 10–11

## Mbani mend ...

- Qëllimi juaj është të sillni shpirta te Krishti.
  - Përgatisni njerëzit që të plotësojnë kushtet për pagëzim që gjenden në Doktrina e Besëlidhje 20:37 dhe në pyetjet e intervistës së pagëzimit.
- 
- Lutuni për veten dhe për të tjerët.
  - Mbështetuni te Shpirti për t'ju treguar ku të shkoni, çfarë të bëni dhe çfarë të thoni.
  - Jini përpikmërisht të bindur.
  - Studioni gjuhën e misionit tuaj çdo ditë.
- 
- Planifikoni çdo ditë dhe përqendrohuni mbi treguesit kyç.
  - Punoni me efektivitet gjatë gjithë ditës, çdo ditë.
- 
- Kërkoni rekomandime nga **kushdo!**
  - Mësoni kur gjeni; gjeni kur mësoni.
- 
- Lexoni Librin e Mormonit me ata që mësoni.
  - U mësoni njerëzve se një mënyrë e rëndësishme për të ditur se Jozef Smithi është një profet i Perëndisë është të lexojnë dhe të luten rreth Librit të Mormonit.
  - Kontaktoni çdo kërkues çdo ditë.
  - Dëshmoni shpesh.
  - Merrni me vete një anëtar në çdo mësim po të jetë e mundur.
  - Gjithmonë caktoni data dhe orare specifike për mësimin e ardhshëm.
  - Ftoni të gjithë kërkuesit në shërbesat e pagëzimit.
  - Pas çdo mësimi, i jepni kërkuesit diçka për të lexuar dhe medituar në përgatitje për takimin e ardhshëm.
- 
- Krijoni marrëdhënie me anëtarët duke u shërbyer atyre dhe duke punuar me udhëheqjen e lagjes.
  - Ndihmoni udhëheqësit e lagjes në aktivitetet për mbajtjen aktivë të të kthyerve në besim dhe riaktivizimin.
- 
- Ndihmoni secilin prej atyre që mësoni të marrin zotime që do t'i sjellin pendim dhe do ta forcojnë besimin e tyre te Shpëtimtari.
  - Duajeni Zotin dhe shërbejini Atij sa më mirë të mundeni.

KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

